



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 26

Tiranë – E mërkurë, 16 shkurt 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 3/2022, datë 27.1.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë, për vitin 2020, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II)..... 2943
Dekret i Presidentit nr. 13457, datë 4.2.2022	Për shpallje ligji..... 3029
Ligj nr. 5/2022, datë 27.1.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri”..... 3029
Dekret i Presidentit nr. 13459, datë 4.2.2022	Për shpallje ligji..... 3062
Vendim i Kuvendit nr. 10, datë 10.2.2022	Për rrëzimin e listës në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”..... 3062
Vendim i Kuvendit nr. 11, datë 10.2.2022	Për rrëzimin e listës në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”..... 3062
Vendim i Kuvendit nr. 12, datë 10.2.2022	Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore..... 3063
Vendim i Kuvendit nr. 13, datë 10.2.2022	Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë..... 3064

Dekret i Presidentit nr. 13472, datë 14.2.2022	Për propozimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.....	3065
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 3, datë 9.2.2022	Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar.....	3065
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 478, datë 9.12.2021	Për miratimin e aktit normativ administrativ “Rregullore për procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes midis konsumatorit dhe operatorit ujësjellës-kanalizime, nga struktura e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes”.....	3077
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 536, datë 30.12.2021	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të tarifave të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Konispol.....	3083
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 537, datë 30.12.2021	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të tarifave të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kukës.....	3083
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 538, datë 30.12.2021	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të tarifave të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Bulqizë.....	3084



LIGJ
Nr. 3/2022

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË FINANCIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMISIONIT TË BASHKIMIT
EVROPIAN, NË LIDHJE ME
PROGRAMIN VJETOR KOMBËTAR PËR
SHQIPËRINË,
PËR VITIN 2020, NË KUADËR TË
INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS
SË PARAANËTARËSIMIT (IPA II)**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë, për vitin 2020, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.1.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13457, datë 4.2.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

**MARRËVESHJE FINANCIMI
KUSHTET E VEÇANTA**

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si “Komisioni”, i cili vepron në emër të Bashkimit Evropian, më poshtë i referuar si “Unioni”, nga njëra anë, dhe

Republika e Shqipërisë, në vijim e referuar si “Përfituesi IPA II”, i përfaqësuar nga Zyra e Kryeministrit, nga ana tjetër, bien dakord si më poshtë:

**Neni 1
Programi**

1. Unioni bie dakord të financojë dhe përfituesi IPA II bie dakord të pranojë financimin e Programit në vijim:

Programi Vjetor i Veprimit për Shqipërinë për vitin 2020.

Numri i angazhimit global (CRIS): 2020/042-914.

Numri i angazhimit global (CRIS): 2020/042-915.

Ky Program financohet nga Buxheti i Unionit sipas aktit themelor në vijim: Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit, IPA II.¹

2. Kostoja totale e vlerësuar e këtij programi është 105 421 991 euro dhe kontributi maksimal i Unionit në këtë program gjithashtu është vendosur 103 300 000 euro.

Ky program kërkon kontribut financiar nga të dy palët, përfituesi IPA II dhe Bashkimi. Ndarja e kostove të secilit kontribut financiar gjendet në shtojcën I.

3. Programi do të zbatohet në përputhje me përshkrimin e parashikuar në shtojcën I, që detajohet më tej në dokumentet e veprimit, për të cilat do të bihet dakord nëpërmjet shkëmbimit të letrave ndërmjet Komisionit dhe përfituesit IPA II.

Neni 2

Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional

1. Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi, siç përcaktohet në nenin 12, të shtojcës II (Kushtet e Përgjithshme) është caktuar për 12 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Kohëzgjatja e periudhës së zbatimit operacional, siç përcaktohet në nenin 12, të shtojcës II (Kushtet e Përgjithshme) është caktuar

¹Rregullorja (BE) nr. 231/2014, e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 mars 2014, mbi krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), GZ L 77, 15.3.2014, faqe 11.



për 6 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 3

Adresat dhe komunikimi

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Financimit do të bëhen me shkrim, dhe do t'i referohen shprehimisht këtij Programi, siç përcaktohet në nenin 1(1) dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

1. Për Komisionin

Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR)

Drejtoria D

Rue de la Loi 15

B-1049 Bruksel

Belgium (Belgjikë)

Adresa funksionale *email*-it: [NEAR-](mailto:NEAR-D4@ec.europa.eu)

D4@ec.europa.eu

2. Për përfituesin IPA II

Koordinatori Kombëtar i Fondeve IPA- Zyra e Kryeministrit, Kryeministri

Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr. 7, Tiranë, Shqipëri

Adresa funksionale e *email*-it:

zef.mazi@kryeministria.al

Neni 4

Pika e kontaktit të OLAF-it

Pika e kontaktit të përfituesit IPA II, që gëzon kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Antimashtrim (OLAF), me qëllim që të lehtësojë aktivitetet operacionale të OLAF-it, do të jetë znj. Blerina Naskaj – Në drejtorinë për inspektimet publike financiare/AFCOS (DIFP@financa.gov.al).

Neni 5

Marrëveshja Kuadër

Programi do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e asistencës financiare të Unionit për Shqipërinë, sipas Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), që ka hyrë në fuqi në datën 16 prill 2015 (në vijim e referuar si “Marrëveshja Kuadër”). Marrëveshja e Financimit plotëson dispozitat e

Marrëveshjes Kuadër. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të Marrëveshjes së Financimit, nga njëra anë, dhe dispozitave të Marrëveshjes Kuadër, nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi.

Neni 6

Shtojcat

1. Marrëveshja e Financimit përbëhet nga:

a) këto kushte të veçanta;

b) shtojca I: Programi Kombëtar i Veprimit për Shqipërinë për vitin 2020, ku përshkruhen hollësisht objektivat, rezultatet e parashikuara, aktivitetet, përshkrimi i detyrave të besuara për zbatimin e buxhetit dhe buxheti i Programit;

c) shtojca IA: Mbështetje Buxhetore BE për Mirëqeverisjen dhe shtojca IA bis – Mbështetje Buxhetore BE për rimëkëmbjen ekonomike;

d) shtojca II: Kushtet e përgjithshme;

e) shtojca III: Model raporti vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II, sipas neneve 58 dhe 59 (1), të Marrëveshjes Kuadër;

f) shtojca IV: Model raporti financiar sipas nenit 59(2) të Marrëveshjes Kuadër;

g) shtojca V: Specifikimet minimale të sistemit të kontabilitetit me bazë shtimi;

h) shtojca VI: Masat e këtij rasti për dhënien e detyrave për zbatimin e buxhetit sipas këtij Programi.

2. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të shtojcave nga njëra anë, dhe dispozitave të kushteve të veçanta nga ana tjetër, përparësi do të kenë këto të fundit. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të shtojcës I dhe/ose shtojcës IA/IA bis, nga njëra anë, dhe dispozitave të shtojcës II, nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast të konfliktit midis dispozitave të shtojcës I, nga njëra anë, dhe dispozitave të aneksit IA/IA bis, nga ana tjetër, e para do të kenë përparësi.

Neni 7

Dispozita që përjashtojnë ose plotësojnë shtojcën II

Transfertat në valutë do të llogariten sipas datë-valutës në datën e njoftimit të kreditimit të llogaria e Thesarit nga Banka e Shqipërisë. Norma e këmbimit e përdorur për qëllime raportimi – për tabelën fiskale të Qeverisë – do të jetë një normë këmbimi fikse e llogaritur nga Banka e Shqipërisë për të gjitha transfertat hyrëse, në përputhje me



klauzolën e mosdiskriminimit, në datë-valutën kur vjen transferta hyrëse *forex* – konkretisht, norma e këmbimit fikse në ALL e përcaktuar në vendimin nr. 66, të gushtit 2006, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës dhe dispozitat vijuese.

Nuk është e mundur që të rialokohen fondet midis shumës 77 300 000 euro të numrit të angazhimit global 2020/042-914 dhe shumës 26 000 000 euro të numrit të angazhimit global 2020/042-915.

Neni 8 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi hyn në fuqi në datën në të cilën është nënshkruar nga pala e fundit, jo më vonë se data 31 dhjetor 2021.

Kjo Marrëveshje Financimi hartohet në dy kopje në gjuhën angleze, njëra i dorëzohet Komisionit dhe kopja tjetër i dorëzohet përfituesit IPA II.

Për Përfituesin IPA II:

Z. Zef Mazi

Kryenegociator,

Koordinator Kombëtar i IPA-s

Zyra e Kryeministrit, Kryeministria,

Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr. 7

Tiranë, Shqipëri

Data:

Për Komisionin:

Znj. Genoveva Ruiz Calavera

Drejtor

Komisioni Evropian

DG NEAR/D

Rue de la Loi 15

B-1049 Bruksel, Belgjikë

Data:

MARRËVESHJA FINANCIARE PËR PROGRAMIN VJETOR KOMBËTAR IPA II – SHTOJCA II – KUSHTET E PËRGJITHSHME (PRILL 2020)

SHTOJCA II KUSHTET E PËRGJITHSHME

Përmbajtja

SHTOJCA II – KUSHTET E PËRGJITHSHME

Pjesa e parë: Dispozitat e zbatueshme të aktiviteteve për të cilat përfituesi IPA II është Autoriteti Kontraktues

Neni 1 – Parime të përgjithshme

Neni 1a – Detyrimi për të informuar, sanksionet administrative dhe mosveprimi

Neni 2 – Vizibiliteti dhe komunikimi

Neni 3 – Kontrollat *ex-ante* për procedurat e granteve dhe prokurimit dhe kontrollat *ex-post* për kontratat dhe grantet që do të kryhen nga Komisioni

Neni 4 – Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe shpenzimet e pranura

Neni 5 – Dispozitat mbi pagesat e bëra nga Komisioni për përfituesin IPA II

Neni 6 – Ndërprerja e pagesave

Neni 7 – Rikuperimi i fondeve

Pjesa e dytë: Dispozitat e zbatueshme për mbështetjen buxhetore

Neni 8 – Dialogu mbi politikat

Neni 9 – Verifikimi i kushteve dhe disbursimit

Neni 10 – Transparenca e mbështetjes buxhetore

Neni 11 – Rikuperimi i mbështetjes buxhetore

Pjesa e tretë: Dispozitat e zbatueshme për marrëveshjen përkatëse të financimit pavarësisht nga metoda e menaxhimit

Neni 12 – Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues

Neni 13 – Lejet dhe autorizimi

Neni 14 – Kërkesat e raportimit

Neni 15 – Të drejtat e pronësisë intelektuale

Neni 16 – Konsultimi ndërmjet përfituesit IPA II dhe Komisionit

Neni 17 – Ndryshimi i Marrëveshjes përkatëse të Financimit

Neni 18 – Pezullimi i Marrëveshjes përkatëse të Financimit



Neni 19 – Përfundimi i Marrëveshjes përkatëse të Financimit

Neni 20 – Masat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

PJESA E PARË
DISPOZITAT E ZBATUESHME TË
AKTIVITETEVE PËR TË CILAT
PËRFITUESI IPA II ËSHTË AUTORITETI
KONTRAKTUES

Neni 1

Parime të përgjithshme

1. Qëllimi i pjesës së parë është përcaktimi i rregullave për zbatimin e detyrave të besuara për zbatimin e buxhetit të parashikuara në shtojcën I dhe përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve përkatësisht të përfituesit IPA II dhe Komisionit në kryerjen e këtyre detyrave.

Pjesa e parë do të zbatohet për detyrat e zbatimit të buxhetit që i besohen përfituesit IPA II vetëm në lidhje me kontributet e Bashkimit ose të kombinuara me fondet e përfituesit IPA II apo të një pale të tretë, në rast se fonde të tilla zbatohen në një bashkëfinancim, d.m.th. aty ku janë të bashkuara.

2. Përfituesi IPA II mbetet përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financimi dhe në Marrëveshjen Kuadër, edhe nëse i nënlejon subjekteve të tjera të përcaktuara në shtojcën I për kryerjen e disa detyrave të besuara për zbatimin e buxhetit. Komisioni, në veçanti, rezervon të drejtën të pezullojë pagesat, dhe të pezullojë/ose të anulojë këtë Marrëveshje Financimi mbi bazën e veprimeve, mosveprimeve dhe/ose situatave të ndonjë subjekti të përcaktuar.

3. Detyrat e referuara në paragrafin 1 të këtij neni kryhen nga përfituesi IPA II në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e prokurimit dhe kontratat e grantit në veprimet e jashtme, të cilat ishin në fuqi në kohën e fillimit të procedurës në fjalë (PRAG), si dhe në përputhje me standardet e kërkuara për vizibilitetin dhe komunikimin, të përmendura në nenin 2(2).

Përfituesi IPA II kryen procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve, lidh kontratat që rezultojnë, dhe siguron që të gjitha dokumentet përkatëse për gjurmën e auditit të jenë në gjuhën e Marrëveshjes së Financimit në fjalë. Për qëllimet e

Pjesës së Parë të kësaj Marrëveshjeje Financimi, çdo referencë në kontratat e granteve do të përfshijë gjithashtu marrëveshje kontributi dhe çdo referencë për përfituesit e granteve do të përfshijë gjithashtu organizata që kanë nënshkruar marrëveshje kontributi.

4. Përfituesi IPA II duhet të respektojë normën minimale të kontributeve të tij të përcaktuara në shtojcën I. Në rastin kur kontributet jepen si nga përfituesi IPA II dhe nga Bashkimi Evropian, kontributi i përfituesit IPA II do të vihet në dispozicion në të njëjtën kohë si kontributi përkatës nga Unioni.

5. Përfituesi IPA II duhet të ruajë të gjitha dokumentet mbështetëse përkatëse financiare dhe kontraktuese nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi ose nga data më e hershme në rast se procedurat e prokurimit, thirrjet për propozime apo procedura e drejtpërdrejtë e dhënies së granteve në mënyrë të drejtpërdrejtë ka filluar para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Financimit.

a) Për procedurat e prokurimit në veçanti:

a) njoftimi i parashikimit me dëshminë e publikimit të njoftimit të prokurimit dhe çdo ndreqje të gabimeve;

b) caktimi i panelit të listës përfundimtare;

c) raporti i listës përfundimtare (përfshirë anekset) dhe aplikimeve;

d) dëshmia e publikimit të njoftimit të listës përfundimtare;

e) letrat për kandidatët që nuk janë pjesë e listës përfundimtare;

f) ftesa për tender ose ekuivalente;

g) dosja e tenderit, duke përfshirë anekset, sqarimet, procesverbalet e mbledhjeve, dëshminë e publikimit;

h) caktimi i komisionit të vlerësimit;

i) raporti për hapjen e tenderit, duke përfshirë anekset;

j) raporti i vlerësimit/negocimit, duke përfshirë anekset dhe ofertat e pranuar²;

k) letër njoftimi;

l) shkresë përcjellëse për dorëzimin e kontratës;

m) letrat për kandidatët e pasuksesshëm;

n) njoftimi për dhënie/anulim, duke përfshirë dëshminë e publikimit;

² Eliminimi i ofertave të pasuksesshme pesë vjet pas përfundimit të procedurës së prokurimit.



o) kontratat e nënshkruara, amendamentet, klauzolat shtesë, raportet e zbatimit dhe korrespondenca përkatëse.

b) Për thirrjet për propozime dhe procedurat e drejtpërdrejta për dhënien e granteve në veçanti:

a) caktimi i komisionit të vlerësimit;

b) hapja dhe raporti administrativ përfshirë anekset dhe aplikimet e pranuar³;

c) letër për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm pas vlerësimit të prospektit;

d) raporti i vlerësimit të prospektit;

e) raport vlerësimi i aplikimit të plotë ose raport negociimi me anekset përkatëse;

f) kontrolli i përshtatshmërisë dhe dokumentet mbështetëse;

g) letra për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm, së bashku me listën e miratuar rezervë pas vlerësimit të aplikimit të plotë;

h) letër përcjellëse për dorëzimin e kontratës së grantit;

i) njoftimi i dhënies/anulimit me dëshminë e publikimit;

j) kontratat e nënshkruara, amendamentet, klauzolat shtesë, raportet e zbatimit dhe korrespondenca përkatëse.

Gjithashtu, dokumentet financiare dhe kontraktuale, të përmendura në paragrafin 5(a) dhe (b) të këtij neni, do të plotësohen me të gjitha dokumentet mbështetëse përkatëse, siç kërkohet nga procedurat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje me pagesat, rikuperimet dhe shpenzimet operationale, për shembull projekti dhe raportet e kontrolleve në terren, pranimi i furnizimeve dhe punimeve, garancitë, raportet e inxhinierëve mbikëqyrës.

Të gjitha dokumentet financiare dhe kontraktuale përkatëse do të ruhen për të njëjtën kohëzgjatje, në përputhje me nenin 49 të Marrëveshjes Kuadër.

6. Në respekt të nenit 25 të Marrëveshjes Kuadër për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të ndershme dhe transparente, të mblidhen për qëllime të ligjshme, të përshtatshme, relevante dhe të kufizuara për atë qëllim që nevojiten. Të përpunohen në mënyrë që të dhënat personale të

jenë të sigurta, të bëhet eliminimi i aplikimeve të pasuksesshme pas tre viteve të mbylljes së procedurave të grantit. Marrëveshja Financiare për programet vjetore IPA II – shtojca II – Kushtet e përgjithshme (V. prill 2020) mbahet në një formë që lejon identifikimin e të dhënave të subjekteve për jo më shumë kohë sesa nevojitet për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat. Të dhënat personale që përfshihen në dokumente që do të mbahen nga përfituesit, bazuar në nenin 1.5, duhet të eliminohen kur afati final i përcaktuar në këtë nen ka mbaruar.

Neni 1a

Detyrimi për të informuar, sanksionet administrative dhe mosveprimi

1. Kur aplikohet për procedurat dhe dokumentet standarde të publikuara nga Komisioni për rastet e pagesave të prokurimeve dhe kontratave grant, përfituesi IPA II duhet të sigurojë që asnjë prokurim i financuar nga BE-ja ose kontratë granti t'i paguhet një operatori ekonomik ose aplikanti të grantit që ai vetë, ose dikush që e përfaqëson ose merr vendim, ose e kontrollon atë, të jetë në një nga situatat e përjashtuara për procedurat relevante dhe dokumentet standarde të Komisionit.

2. Përfituesi IPA II duhet të informojë Komisionin menjëherë kur një kandidat, tenderues apo aplikant është në situatë përjashtimi nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit, kur ka parregullsi apo mashtrim, ose kur ka shkelje të rëndë të detyrimeve kontraktuale.

3. Përfituesi IPA II merr përgjegjësinë mbi informacionin e përmbajtur në “Sistemin e Identifikimit dhe Përjashtimit të Hershëm” (EDES) të Komisionit, kur jepen kontratat e prokurimeve dhe granteve. Qasja në informacion mund të ofrohet nëpërmjet çikës/ave ndërlidhëse ose nëpërmjet konsultimit me rrugë të ndryshme: (Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Buxhetin, Zyrtarin Kontabilist të Komisionit, BRE2-13/505, B-1049 Bruksel, Belgjikë dhe nëpërmjet *email*-it drejtuar Komisionit BUDG-C01-EXCL-DB@ec.europa.eu, të përcaktuar në nenin 3, të Kushtet e Veçanta).

4. Kur përfituesi IPA II vihet në dijeni për situatën e përjashtimit në zbatimin e detyrave të përshkruara në shtojcën I, përfituesi vendos

³ Eliminimi i aplikimeve të pasuksesshme tre vjet pas përfundimit të procedurës së grantit.



përfshirjen e operatorit ekonomik apo aplikantit për grant nga procedura në vijim të prokurimit ose dhënies së grantit. Përfituesi IPA II mund të vendosë penalitete financiare në raport me vlerën e kontratës në fjalë. Përfshirjet dhe/ose gjobat financiare vendosen pas procedurës së kundërshtimit që garanton të drejtën e mbrojtjes së personit në fjalë. Përfituesi IPA II njofton Komisionin sipas paragrafit 1 të këtij neni.

5. Në lidhje me paragrafin 4 të këtij neni, përfituesi IPA II konsiderohet në kushtet e mosveprimit, nëse nuk vendos përfshirjen apo/dhe penalitetet financiare mbi operatorin ekonomik apo aplikantin e grantit.

6. Në rast të pamundësisë për të vepruar, përfituesi IPA II njofton Komisionin duke shpjeguar arsyet e pamundësisë për të vepruar. Komisioni rezervon të drejtën e përfshirimit të operatorit ekonomik ose aplikantit për grant nga procedurat në vazhdim të BE-së të dhënies së financimit, dhe/ose të vendosë penalitetet financiare mbi një operator ekonomik apo aplikant për grant midis 2–10% të vlerës totale të kontratës në fjalë.

Neni 2

Vizibiliteti dhe komunikimi

1. Në përputhje me nenin 24(3) të Marrëveshjes Kuadër, përfituesi IPA II merr masa për të siguruar vizibilitetin e financimit të BE-së për aktivitetet që i janë besuar atij, dhe për të përgatitur një plan koherent aktivitetesh vizibiliteti dhe komunikimi, i cili duhet t'i paraqitet Komisionit për pëlqim brenda 2 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Financimit.

2. Këto aktivitete komunikimi dhe vizibiliteti duhet të jenë në përputhje me Manualin e Vizibilitetit dhe Komunikimit për Veprimet e Jashtme të BE-së, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni në fuqi në kohën e aktiviteteve.

Neni 3

Kontrollet *ex-ante* për procedurat e granteve dhe prokurimit dhe kontrollet *ex-post* për kontratat dhe grantet që do të kryhen nga Komisioni

1. Komisioni mund të ushtrojë kontrolle *ex-ante* mbi tenderimin e kontratave, lançimin e thirrjeve

për propozime dhe dhënien e kontratave dhe granteve për fazat vijuese të dhënies së prokurimit apo grantit:

a) miratimi i njoftimeve të kontratës për prokurim, programet e punës për thirrjet për propozime dhe çdo korrigjim të tyre;

b) miratimi i dosjeve të tenderit dhe udhëzimeve për aplikantët, për grantet;

c) miratimi i përbërjes së Komiteteve të Vlerësimit;

d) miratimi i raporteve të vlerësimit dhe të marrjes së vendimeve⁴;

e) miratimi i dosjeve të kontratave dhe shtesave të kontratave.

2. Lidhur me kontrollet *ex-ante* Komisioni vendos:

a) të kryejë kontrolle *ex-ante* në të gjitha fushat; ose

b) të kryejë kontrolle *ex-ante* në një nga këto fusha; ose

c) të heqë dorë plotësisht nga kontrollet *ex-ante*.

3. Nëse Komisioni vendos të kryejë kontrolle *ex-ante*, në përputhje me paragrafin 2(a) ose (b) të këtij neni, ai nuk do të informojë përfituesin IPA II mbi dosjet e përzgjedhura për kontrolle *ex-ante*. Përfituesi IPA II duhet t'i paraqesë Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm menjëherë pasi informohet mbi përzgjedhjen e një dosje për kontroll *ex-ante*, më së fundi në kohën e dorëzimit të njoftimit të kontratës apo programit të punës për publikim.

4. Komisioni mund të vendosë të kryejë kontrolle *ex-post*, përfshirë auditimet dhe kontrollet në terren, në çdo kohë për çdo kontratë dhe grant të dhënë nga përfituesi IPA II që rrjedh nga kjo Marrëveshje Financimi. Përfituesi IPA II duhet t'i paraqesë Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm menjëherë pasi informohet mbi përzgjedhjen e një dosje për kontroll *ex-post*. Komisioni mund të autorizojë një person ose subjekt që të kryejë kontrolle *ex-post* në emër të tij.

⁴ Për kontratat e shërbimit ky hap përfshin kontrolle *ex-ante* në lidhje me miratimin e listës përfundimtare.



Neni 4

Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe shpenzimet e pranuar

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, Fondi Kombëtar dhe struktura operuese e përfituesit IPA II, që është Autoriteti Kontraktues për Programin, do të hapë të paktën një llogari bankare të shprehur në euro. Bilanci i përgjithshëm bankar për Programin do të jetë shuma e balanceve për të gjitha llogaritë bankare të Programit të mbajtura nga Fondi Kombëtar dhe të gjitha strukturat operuese pjesëmarrëse në përfituesin IPA II.

2. Përfituesi IPA II duhet të përgatisë dhe t'i paraqesë Komisionit planet e parashikimit të disbursimit për kohëzgjatjen e periudhës së zbatimit të Programit. Këto parashikime duhet të përditësohen për raportin vjetor financiar të përmendur në nenin 14(2) dhe për çdo kërkesë për fonde. Parashikimet duhet të bazohen në një analizë të hollësishme të dokumentuar (duke përfshirë programin e planifikuar të kontraktimit dhe pagesave për katërmbëdhjetë muajt në vijim), e cila do të vihet në dispozicion të Komisionit, nëse kërkohet.

3. Plani fillestar për parashikimin e disbursimit duhet të përmbajë një përmbledhje të parashikimeve vjetore të disbursimit për të gjithë periudhën e zbatimit dhe parashikimet mujore të disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e Programit. Planet e mëvonshme do të përmbajnë përmbledhje të parashikimeve vjetore të disbursimit për bilancin e periudhës së zbatimit të Programit dhe parashikimet mujore të disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm të Programit.

4. Përfituesi IPA II kërkohet që të krijojë dhe të ruajë një sistem kontabiliteti në përputhje me klauzolën 2(3)(b), të shtojcës A, të Marrëveshjes Kuadër, e cila do të përmbajë të paktën të dhëna për kontratat e menaxhuara në kuadrin e Programit të parashikuar në shtojcën V.

5. Shpenzimet e pranuar në sistemin e kontabilitetit, të parashikuar në pjesën 4 të këtij neni, duhet të jenë kryer, paguar dhe pranuar dhe të korrespondojnë me shpenzimet reale të provuara me dokumente mbështetëse dhe duhet të përdoren, kur është e nevojshme, për të likuiduar paraфинancimin e paguar nga përfituesi IPA II, sipas kontratave lokale.

6. Përfituesi IPA II duhet t'i sigurojë Komisionit raportet në vijim:

- a) raporti i ndërprerjes siç përcaktohet në nenin 14(4);
- b) raportet vjetore siç përcaktohet në paragrafët 2 deri 4, të nenit 14;
- c) kërkesën për raportet e fondeve, referuar në nenin 5.

Neni 5

Dispozitat mbi pagesat e kryera nga Komisioni për përfituesin IPA II

1. Përfituesi IPA II duhet të paraqesë parashikimet e tij fillestare të disbursimit, të përgatitura sipas nenit 4(2), së bashku me kërkesën e pagesës së parë të paraфинancimit. Pagesa e parë e paraфинancimit duhet të jetë për 100% të disbursimeve të parashikuara për vitin e parë të planit të parashikimit për disbursimet.

2. Përfituesi IPA II duhet të paraqesë kërkesat e pagesave vijuese të paraфинancimit kur bilanci i përgjithshëm bankar për Programin bie nën nivelin e parashikimeve të disbursimit për pesë muajt e ardhshëm të Programit.

3. Çdo kërkesë për paraфинancim shtesë duhet të mbështetet nga dokumentet e mëposhtme:

- a) një pasqyrë përmbledhëse e të gjitha disbursimeve të kryera për Programin;
- b) bilancet bankare për Programin në datën e ndërprerjes së kërkesës;
- c) një plan parashikimi të disbursimeve për Programin, për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm, që nga dita e ndërprerjes së kërkesës, në përputhje me pikën "d", të shtojcës IV.

4. Përfituesi IPA II mund të kërkojë për çdo financim të mëvonshëm shumë të disbursimeve totale të parashikuara për katërmbëdhjetë muajt që nga data e ndërprerjes së kërkesës, pa bilancet e përmendura në pjesën 3(b) të këtij neni, në datën e ndërprerjes së kërkesës për fonde të rritura me ndonjë shumë të financuar nga përfituesi IPA II, sipas paragrafit 5 të këtij neni, dhe që nuk është rimbursuar ende.

Komisioni rezervon të drejtën për të reduktuar çdo pagesë të mëvonshme paraфинancimi nëse bilancet e përgjithshme bankare, të kryera nga përfituesi IPA II në kuadrin e këtij Programi dhe të gjitha programet e tjera IPA I ose IPA II, të menaxhuara nga përfituesi IPA II, tejkalojnë



parashikimin e disbursimit për katërbëdhjetë muajt e ardhshëm.

5. Kur pagesa reduktohet sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfituesi IPA II duhet të financojë Programin nga burimet e veta deri në shumën e reduktimit. Përfituesi IPA II mund të kërkojë më pas rimbursimin e financimit si pjesë e kërkesës së radhës për fonde të parashikuara në paragrafin 4 të këtij neni.

6. Komisioni ka të drejtë të rikuperojë bilancet e tepërta bankare që kanë mbetur pa u përdorur për më shumë se dymbëdhjetë muaj. Para ushtrimit të kësaj të drejte, Komisioni fton përfituesin IPA II të japë arsyet e vonës në disbursimin e fondeve dhe të demonstrojë nevojën e vazhdueshme për ta gjatë dy muajve të ardhshëm.

7. Interesat e gjeneruara nga parafinancimi i bilanceve bankare të Programit nuk do të paguhen.

8. Sipas nenit 33(4) të Marrëveshjes Kuadër, nëse ndërprerja e afatit kohor për kërkesën e pagesës tejkalon dy muaj, përfituesi IPA II mund të kërkojë një vendim nga Komisioni lidhur me faktin nëse do të vazhdojë ndërprerja e afatit kohor.

9. Deklarata financiare përfundimtare përmendur në nenin 37(2) të Marrëveshjes Kuadër i paraqitet ZKA-së jo më vonë se 16 muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit operacional.

Neni 6

Ndërprerja e pagesave

1. Pa cenuar pezullimin ose përfundimin e Marrëveshjes së Financimit, në përputhje përkatësisht me nenet 18 dhe 19, si dhe pa cenuar nenin 39 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të ndërpresë pagesat pjesërisht ose plotësisht, nëse:

a) Komisioni ka vendosur ose ka shqetësime serioze se përfituesi IPA II ka kryer gabime të konsiderueshme, parregullsi apo mashtrime që vënë në dyshim ligjshmërinë ose rregullsinë e transaksioneve të veçanta themelore në zbatimin e Programit, ose nuk ka përmbushur detyrimet e tij në kuadrin e Marrëveshjes së Financimit, duke përfshirë detyrimet në lidhje me zbatimin e planit të vizibilitetit dhe komunikimit;

b) Komisioni ka vendosur ose ka shqetësime serioze në lidhje me faktin nëse përfituesi IPA II ka kryer gabime sistematike ose të përsëritura, parregullsi, mashtrime ose shkelje të detyrimeve në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi apo

detyrimeve të tjera të ngjashme, me kusht që këto gabime, parregullsi, mashtrime ose shkelje e detyrimeve, të kenë ndikim material në zbatimin e Marrëveshjes së Financimit apo të vënë në dyshim besueshmërinë e sistemit të brendshëm të kontrollit të përfituesit IPA II ose ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve kryesore.

Neni 7

Rikuperimi i fondeve

1. Përveç rasteve të përmendura në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të rikuperojë fondet nga përfituesi IPA II, siç parashikohet në Rregulloren e Financimit, veçanërisht në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni ka vendosur se nuk janë përmbushur objektivat e Programit të përcaktuara në shtojcën I;

b) shpenzime të papranueshme;

c) mosrespektimi i normës së kontributit, siç parashikohet në shtojcën I;

d) shpenzime të krijuara si rezultat i gabimeve, parregullsive, mashtrimeve ose shkeljes së detyrimeve në zbatimin e Programit, veçanërisht në procedurën e prokurimit dhe dhënies së granteve.

2. Në përputhje me të drejtën kombëtare, përfituesi IPA II rikuperon kontributin e Bashkimit që i paguhet përfituesit IPA II nga marrësit të cilët ishin në çdonjërin nga situatat e përcaktuara në paragrafin 1, pikat “b” ose “d” të këtij neni ose të përmendur në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër. Fakti që, përfituesi IPA II nuk mund të rikuperojë një pjesë apo të gjitha fondet, nuk pengon Komisionin të rikuperojë fondet nga përfituesi IPA II.

3. Shumat e paguara në mënyrë të parregullt ose të rikupëruara nga përfituesi IPA II, shumat nga garancitë financiare, të performancës dhe parafinancimit të paraqitura mbi bazën e procedurave të prokurimit dhe dhënies së granteve, shumat nga penalitetet financiare të vendosura nga përfituesi IPA II për kandidatët, ofertuesit, aplikantët, kontraktuesit ose përfituesit e granteve për përfituesin IPA II do të përdoren sërish për Programin ose do t'i rikthehen Komisionit.



PJESA E DYTË
DISPOZITAT E ZBATUESHME PËR
MBËSHETJETEN BUXHETORE

Neni 8
Dialogu mbi politikat

Përfituesi IPA II dhe Komisioni marrin përsipër se do të angazhohen në një dialog të rregullt konstruktiv në nivelin e duhur për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 9
Verifikimi i kushteve dhe disbursimit

1. Komisioni verifikon kushtet për pagesën e kësteve të komponentit të mbështetjes buxhetore, siç përcaktohet në shtojcën I dhe shtojcën IA.

2. Në rastin kur Komisioni nxjerr përfundimin se nuk janë përmbushur kushte për pagesat, ai informon pa vonesë përfituesin IPA II.

3. Kërkesat e disbursimit të paraqitura nga përfituesi IPA II janë të pranueshme për financimin e BE-së, me kusht që ato të jenë në përputhje me dispozitat e përcaktuara në shtojcën I dhe shtojcën IA, dhe të jenë paraqitur gjatë fazës së zbatimit operacional.

4. Përfituesi IPA II do të zbatojë rregullat e tij kombëtare në kursin e këmbimit të monedhave të huaja në mënyrë jodiskriminuese për të gjitha disbursimet e komponentit të mbështetjes buxhetore.

Neni 10
Transparenca e mbështetjes buxhetore

Përfituesi IPA II me këtë rast bie dakord për publikimin nga Komisioni të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe çdo ndryshimi të saj, përfshirë me mjete elektronike, si dhe të informacionit bazë për mbështetjen buxhetore që Komisioni e çmon të nevojshme. Përmbajtja e publikimit do të jetë në përputhje me ligjet e BE-së, të zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 11
Rikuperimi i mbështetjes buxhetore

Të gjitha disbursimet e mbështetjes buxhetore apo pjesë të tij mund të rikuperohen nga Komisioni, me respektimin e duhur të parimit të

proporcionalitetit, nëse Komisioni vendos se pagesa ka qenë e pavlefshme për shkak të një parregullsie serioze që i atribuohet përfituesit IPA II, veçanërisht nëse përfituesi IPA II ka dhënë informacione të pabesueshme ose të pasakta apo nëse ka vend për korrupsion apo mashtrim.

PJESA E TRETË
DISPOZITAT E ZBATUESHME PËR
MARRËVESHJEN PÛRKATËSE TË
FINANCIMIT PAVARËSISHT NGA MËNYRA
E MENAXHIMIT

Neni 12
Periodha e ekzekutimit, periodha e zbatimit
operacional dhe afati kontraktues

1. Periodha e ekzekutimit është periodha gjatë së cilës zbatohet Marrëveshja e Financimit dhe përfshin periudhën e zbatimit operacional, si dhe fazën e mbylljes. Kohëzgjatja e periudhës së ekzekutimit përcaktohet në nenin 2(2) të Kushteve të Veçanta dhe fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Periodha e zbatimit operacional është periodha gjatë së cilës kryhen të gjitha aktivitetet operationale të mbuluara me prokurim, kontratat e granteve dhe marrëveshjet e delegimit. Kohëzgjatja e kësaj periudhe përcaktohet në nenin 2(2) të Kushteve të Veçanta dhe fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

3. Periudhat e ekzekutimit dhe zbatimit operacional respektohen nga Autoriteti Kontraktues kur lidh dhe zbaton prokurimet, kontratat e granteve dhe marrëveshjet e delegimit në këtë Marrëveshje Financimi.

4. Shpenzimet e lidhura me aktivitetet janë të pranueshme për financimin e BE-së vetëm nëse janë shkaktuar gjatë periudhës së zbatimit operacional; shpenzimet e kryera nga përfituesi IPA II para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Financimit nuk janë të pranueshme për financimin e BE-së.

5. Kontratat e prokurimeve dhe granteve do të përfundojnë maksimumi brenda tre viteve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Financimit, përveç:

- a) ndryshimeve të kontratave që janë lidhur;
- b) kontratave individuale të prokurimit që do të lidhen pas ndërprerjes së parakohshme të kontratës ekzistuese të prokurimit;



c) kontratave në lidhje me auditimin dhe vlerësimin, të cilat mund të nënshkruhen pas zbatimit operacional;

d) ndryshimit të subjektit të ngarkuar me detyrat e besuara.

6. Një kontratë prokurimi ose granti e cila nuk ka mundësuar ndonjë pagesë brenda dy viteve nga nënshkrimi i saj, do të ndërpritet automatikisht dhe financimi i saj do të tërhiqet.

Neni 13

Lejet dhe autorizimi

Çdo lloj leje dhe/ose autorizimi i kërkuar për zbatimin e Programit duhet të sigurohet në kohën e duhur nga autoritetet kompetente të përfituesit IPA II, në përputhje me të drejtën kombëtare.

Neni 14

Kërkesat e raportimit

1. Për qëllimet e kërkesave të përgjithshme të raportimit në Komision, të përcaktuara në nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër dhe kërkesat specifike të raportimit, sipas menaxhimit të tërthortë të përcaktuar në nenin 59(1) të Marrëveshjes Kuadër, për raportin vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II, KKIPA-ja duhet të përdorë modelin e parashikuar në shtojcën III të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Për qëllimet e kërkesave specifike të raportimit sipas menaxhimit të tërthortë, të përcaktuar në nenin 59(2) të Marrëveshjes Kuadër, për pasqyrat ose raportin financiar vjetor, për përfituesin IPA II, ZKA-ja duhet të përdorë modelin e parashikuar në pikat “a” dhe “b”, të shtojcës IV të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

3. Për qëllimet e nenit 59(4) të Marrëveshjes Kuadër, KKIPA-ja duhet të paraqesë një raport përfundimtar mbi zbatimin e asistencës IPA II të këtij Programi në Komision jo më vonë se katër muaj pas disbursimit të fundit për kontraktuesit e vet ose përfituesit e granteve.

4. Për qëllimet e nenit 59(6) të Marrëveshjes Kuadër, ZKA-ja duhet të sigurojë në format elektronik, deri më 15 janar të vitit financiar vijues, një kopje të të dhënave të mbajtura në sistemin e kontabilitetit të përcaktuar në nenin 4(4). Kjo kopje duhet të shoqërohet me një përmbledhje të audituar dhe të nënshkruar të raportit financiar, në përputhje me pikën “c”, të shtojcës IV.

Neni 15

Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Kontratat e financuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi duhet të parashikojnë që përfituesi IPA II fiton të gjitha të drejtat e nevojshme të pronësisë intelektuale, në lidhje me teknologjinë e informacionit, studimet, skicat, planet, publicitetin dhe çdo material tjetër të bërë për qëllime planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi.

2. Përfituesi IPA II duhet të garantojë që Komisioni ose kushdo, apo person tjetër i autorizuar nga Komisioni, do të ketë qasje dhe të drejtën që të përdorë një material të tillë. Vetëm Komisioni do të përdorë një material të tillë për qëllimet e veta.

Neni 16

Konsultimi ndërmjet përfituesit IPA II dhe Komisionit

1. Përfituesi IPA II dhe Komisioni konsultohen me njëri-tjetrin para krijimit të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e mëtejshëm të kësaj Marrëveshjeje Financimi, në zbatim të nenit 20.

2. Në rastet kur Komisioni vihet në dijeni për problemet në kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, ai vendos të gjitha kontaktet e nevojshme me përfituesin IPA II për të rregulluar dhe për të marrë çdo hap të nevojshëm.

3. Konsultimi mund të çojë në një ndryshim, pezullim ose përfundim të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

4. Komisioni vë në dijeni rregullisht përfituesin IPA II mbi zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në shtojcën I, të cilat nuk janë në pjesën e parë të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 17

Ndryshimi i Marrëveshjes përkatëse të Financimit

1. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje Financimi bëhet me shkrim.

2. Nëse përfituesi i IPA II kërkon një ndryshim, kërkesa duhet t'i paraqitet Komisionit, të paktën



gjashtë muaj para se ky ndryshim është planifikuar të hyjë në fuqi.

3. Komisioni mund të ndryshojë dokumentet model në shtojcën III, IV dhe V, pa e bërë të nevojshme ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi. Përfituesit IPA II informohen me shkrim për çdo ndryshim të tillë dhe hyrjen e tij në fuqi.

Neni 18

Pezullimi i Marrëveshjes përkatëse të Financimit

1. Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi IPA II shkel një detyrim, sipas kësaj Marrëveshjeje Financimi;

b) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi IPA II shkel ndonjë detyrim të përcaktuar, sipas procedurave dhe dokumenteve standarde të përmendura në nenin 18(2) të Marrëveshjes Kuadër;

c) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi IPA II nuk përmbush kërkesat për t'i besuar detyrat e zbatimit të buxhetit;

d) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse përfituesi IPA II vendos të pezullojë ose të pushojë procesin e aderimit të anëtarësimit në BE;

e) Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje Financimi, nëse përfituesi IPA II shkel një detyrim në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe shtetit ligjor, si dhe në rastet e rënda të korrupsionit, ose përfituesi IPA II është fajtor për drejtëm të keq profesional, faktuar me prova të qarta. Drejtëm i gabuar profesional nënkuptohet si në vijim:

- Një shkelje e ligjeve ose rregulloreve të zbatuara ose shkelje e etikës standarde profesionale të cilit i përket një person ose entitet, ose;

- Çfarëdolloj drejtëm i gabuar i një personi ose subjekti që ka ndikim në kredibilitetin profesional, kur një drejtëm i tillë ka synime të gabuara ose neglizhencë të madhe;

f) Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e forcës madhore, siç përcaktohet më

poshtë. “Forcë madhore” nënkupton çdo situatë ose ngjarje të paparashikueshme dhe të jashtëzakonshme përtej kontrollit të palëve që pengon secilën prej tyre në përmbushjen e detyrimeve të tyre, që nuk i atribuohet një gabimi apo pakujdesie nga ana e tyre (ose nga ana e kontraktuesve, agentëve apo të punësuarve të tyre) dhe që rezulton e pakapërcyeshme me gjithë kujdesin e duhur. Defektet në pajisje ose materiale apo vonesat në vënien e tyre në dispozicion, mosmarrëveshjet në punë, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të përdoren si forcë madhore. Një palë nuk mund të shpallet në shkelje të detyrimeve të saj nëse pengohet t'i përmbushë ato nga një rast i forcës madhore për të cilin pala tjetër është informuar në mënyrën e duhur. Një palë që përballlet me forcë madhore duhet të informojë palën tjetër pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, dhe ndonjë masë për minimizimin e dëmit të mundshëm. Nëse forca madhore ndikon vetëm në një pjesë të Programit, pezullimi i Marrëveshjes së Financimit mund të jetë i pjesshëm;

g) Asnjë nga Palët nuk mund të shpallet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve të saj sipas një Marrëveshjeje Financimi nëse pengohet në përmbushjen e tyre për shkak të një force madhore, me kusht që të marrë masat për të minimizuar çdo dëm të mundshëm.

2. Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

3. Komisioni mund të marrë të gjitha masat e nevojshme paraprake para se të ndodhë pezullimi.

4. Në rastin kur njoftohet pezullimi, duhet të tregohen pasojat për prokurimin në vijim apo që do të nënshkruhet dhe kontratat e granteve, si dhe marrëveshjet e delegimit.

5. Pezullimi i Marrëveshjes së Financimit bëhet pa cenuar ndërprerjen e pagesave dhe përfundimin e një Marrëveshjeje Financimi nga Komisioni, në përputhje me nenin 6 dhe nenin 19.

6. Palët e përfshira rifillojnë zbatimin e Marrëveshjes së Financimit menjëherë pasi këtë e lejojnë kushtet me miratimin paraprak me shkrim të Komisionit. Kjo bëhet pa cenuar ndonjë ndryshim të një Marrëveshjeje Financimi që mund të jetë i nevojshëm për të përshtatur Programin me kushtet e reja të zbatimit, duke përfshirë, nëse është e mundur, zgjatjen e zbatimit operacional dhe



periudhat e ekzekutimit, ose përfundimin e një Marrëveshjeje Financimi në përputhje me nenin 19.

Neni 19

Përfundimi i Marrëveshjes përkatëse të Financimit

1. Nëse çështjet që çuan në pezullimin e një Marrëveshjeje Financimi nuk janë zgjidhur brenda një periudhe maksimale prej 180 ditësh, secila palë mund ta përfundojë Marrëveshjen e Financimit pas një njoftimi brenda 30 ditëve.

2. Në rastin kur përfundimi njoftohet, duhet të tregohen pasojat për prokurimin në vijim dhe kontratat e granteve, si dhe marrëveshjet e delegimit që do të nënshkruhen.

3. Përfundimi i Marrëveshjes përkatëse të Financimit nuk përjashton mundësinë që Komisioni të kryejë korrigjime financiare në përputhje me nenet 36–44 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 20

Masat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen e Financimit që nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nëpërmjet konsultimeve midis palëve të parashikuara në nenin 16, mund të zgjidhet nëpërmjet arbitrazhit me kërkesën e një prej palëve.

2. Secila palë cakton një arbitër brenda 30 ditëve nga kërkesa për arbitrazh. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (Hagë) të caktojë një arbitër të dytë. Dy arbitrat nga ana e vet caktojnë një arbitër të tretë brenda 30 ditëve. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit të caktojë arbitrin e tretë.

3. Nëse arbitrat nuk vendosin ndryshe, zbatohet procedura e përcaktuar në Gjykatën e Përhershme të Rregullave Opsionale të Arbitrazhit për Arbitrazhin që përfshin Shtetet dhe Organizatat Ndërkombëtare. Vendimet e arbitrave merren me shumicë brenda një periudhe tremujore.

4. Secila palë është e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të arbitrave.

SHTOJCA I

PROGRAMI KOMBËTAR VJETOR I VEPRIMIT PËR SHQIPËRINË PËR VITIN 2020

1. Identifikimi

Përfutuesi	Shqipëria
Akti Bazë	Rregullorja (BE) nr. 231/2014, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2014, për krijimin e një Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)
Referencat CRIS/ABAC për alokimin Kostoja totale	2020/042-914 79 421 991 euro
Kontributi i BE-së Linja e buxhetit	77 300 000 euro 22.02.01.01
Referencat CRIS/ABAC për alokimin Kostoja totale Kontributi i BE-së Linja e buxhetit	2020/042-915 26 000 000 euro 26 000 000 euro 22.02.01.02
Metodat e Zbatimit	Menaxhim direkt nga Komisioni Evropian; Menaxhim indirekt nga Shqipëria; Menaxhim indirekt nga subjekti(et) që do të përzgjidhet/n në pajtim me kriteret e përcaktuara në seksionin 2.2(3)(a).
Afati për lidhjen e Marrëveshjeve të	Jo më vonë se data 31 dhjetor 2021.



Financimit me përfituesin IPA II	
Afati për kontraktimin, së bashku me lidhjen e marrëveshjeve të kontributit/delegimit	3 vjet pas datës së lidhjes së Marrëveshjes së Financimit.
Periudha indikative e zbatimit operacional	6 vjet pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit.
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit (data kur ky program duhet të mbyllet)	12 vjet pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit.

2. Përshkrimi i programit të veprimit

2.1 Sektorët e përzgjedhur në këtë program veprimi

- Argumentimi për përzgjedhjen e sektorëve specifikë në këtë program:

Dokumenti Strategjik Indikativ i rishikuar për Shqipërinë (2014–2020) pohon se asistencë e paraanëtarësimit, për periudhën 2014–2020, do të përqendrohet në sektorët e mëposhtëm: i. demokracia dhe qeverisja; ii. shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore; iii. mjedisi, veprimi për klimën dhe energjia; iv. Transporti; v. konkurrueshmëria, novacioni, bujqësia dhe zhvillimi rural; vi. arsimi, punësimi dhe politikë sociale; vii. bashkëpunimi territorial dhe bashkëpunimi rajonal.

Programi IPA 2020 ka shtatë veprime në sektorët e mëposhtëm: i. demokracia dhe qeverisja; ii. shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore; dhe iii. konkurrueshmëria, novacioni, bujqësia dhe zhvillimi rural.

Veprimi **BE-ja për Qeverisje të Mirë** synon të kontribuojë për një sektor publik më të aftë dhe reagues ndaj nevojave të qytetarëve dhe bizneseve, si edhe të avancojë dhe t'i u përgjigjet kërkesave të procesit të integritetit në BE. Ky veprim do të përmirësojë administratën publike që të bëhet më efikase, llogaridhënëse, transparente, përfshirëse dhe efektive në nivel qendror dhe vendor. Rezultatet kyçe përfshijnë përmirësimin e mobilizimit të të ardhurave të brendshme, kapaciteteve fiskale të njësisë të qeverisjes vendore; planifikimit, buxhetimit dhe koordinimit; forcim të kontrolleve mbi alokimet dhe reduktim të borxheve të prapambetura përmirësim të menaxhimit të burimeve njerëzore; forcim të menaxhimit të investimeve publike; rritje të integritetit të institucioneve publike; përmirësim të transparencës dhe aksesit në informacion për qytetarët; dhe përmirësim të cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.

Veprimi **Mbështetja e BE-së për Pjesëmarrjen në Programet dhe Agjencitë e saj**

do të lehtësojë dhe mundësojë pjesëmarrjen e institucioneve shqiptare në Programet dhe Agjencitë e BE-së. Ai do të promovojë përafrimin e mëtejshëm të Shqipërisë me politikën dhe metodat e punës së Bashkimit Evropian dhe do të rritë pjesëmarrjen aktive dhe angazhimin e Shqipërisë në Programeve të BE-së. Veprimi do të kontribuojë për të arritur objektivat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), në veçanti ato që lidhen me arsimin dhe formimin profesional, bashkëpunimin në kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik.

Veprimi **Instrumenti i Integritetit në BE** do të forcojë kapacitetet dhe llogaridhënien e administratës publike shqiptare që të garantojë rolin e qëndrueshëm të Qeverisë në përgatitjet për anëtarësimin në BE. Mbështetja do të jetë përcaktuese për forcimin e kapaciteteve për harmonizimin dhe zbatimin e kërkesave të *acquis*, reformave dhe strategjive.

Veprimi **BE-ja për Shtetin e së Drejtës** synon të kontribuojë në forcimin e shtetit të së drejtës përmes: i) përmirësimit të kapaciteteve të Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit, Byrosë Kombëtare të Hetimit, Prokurorisë së Përgjithshme, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe agjencive përkatëse që të ofrojnë besim, siguri dhe mjedis të sigurt për qytetarët shqiptarë; dhe ii) të përmirësojë kapacitetet e institucioneve të pavarura të drejtësisë që të kryejnë siç duhet detyrat e tyre. Plan i Përbashkët i Veprimit kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor është nënshkruar në vitin 2018.

Veprimi **BE-ja për Të Drejtat e Pronësisë** do të mbështetë reformën në sektorin e tokës, që është ndër pesë prioritetet më të rëndësishme të qeverisë shqiptare. Objektivi i përgjithshëm i këtij veprimi është të kontribuojë në forcimin e mbrojtjes së të drejtës së pronës në Shqipëri dhe kapaciteteve të Shqipërisë që të garantojë në praktikë të drejtën e pronësisë, si një nga të drejtat themelore të njeriut. Kjo do të arrihet përmes një sistemi të rregulluar



dhe të harmonizuar të pasurive të paluajtshme, i cili ofron tituj pronësie të qartë dhe të sigurt për të gjithë, në pajtim me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020. Objektivi specifik i veprimit është të zhvillojë një treg toke dinamik përmes krijimit të një kuadri të qartë për të drejtat e pronësisë në Shqipëri.

Veprimi **Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM): Mbështetje për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri – Faza II** synon të forcojë pavarësinë, transparencën, efikasitetin, llogaridhënien dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, në pajtim me standardet evropiane dhe *acquis* të BE-së. Aktivitetet do t'i kushtohen: rritjes së cilësisë profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve; reduktimit të ndikimit të krimit të organizuar, politikës dhe korrupsionit në dhënien e drejtësisë; si dhe të rritjes së integritetit dhe llogaridhënies së institucioneve të gjyqësorit.

Veprimi **BE-ja për Rimëkëmbjen Ekonomike** do të zbutë ndikimin e krizës së COVID-19 në Shqipëri, duke reduktuar efektet makroekonomike dhe përçarjet në ekonomi, dhe duke garantuar që bizneset vulnerabil dhe të papunët të kenë akses në ndihmë ekonomike.

Vështrim mbi veprimet e shkuara dhe aktuale të BE-së, donatorëve të tjerë dhe/ose përfituesit IPA II në sektorët përkatës:

BE-ja i ka dhënë mbështetje thelbësore Shqipërisë në fushat e demokracisë dhe qeverisjes, shtetin e së drejtës dhe të drejtat themelore. Pothuajse gjysma e fondit kombëtar IPA II është caktuar për të mbështetur këta sektorë, në përputhje me parimet e IPA II, duke u përqendruar së pari në elementet bazë. Siç thuhet në Dokumentin Strategjik Indikativ për Shqipërinë 2014–2020, mësimet e rëndësishme nga IPA I (2007–2013) janë: a) ndërtimi i kapaciteteve dhe investimet kërkojnë një nivel bazë të burimeve njerëzore si nga aftësia ashtu edhe nga numri; b) autorësia për investimet e financuara nga BE-ja,

vihen në rrezik nëse nuk lidhen me strategjitë sektoriale dhe buxhetet e ministrive përkatëse, si dhe nevojën për një vlerësim të kujdesshëm të kujdesit të duhur institucional. Veprimet janë në përputhje me dokumentet kryesore të strategjive siç janë Strategjia e Reformës në Administratën Publike dhe Strategjia e Menaxhimit Financiar Publik.

Për **shtetin e së drejtës**, asistencë e mëparshme IPA u përqendrua në reformat kryesore institucionale dhe ndërtimin e kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm të gjyqësorit, kryesisht përmes asistencës për modernizimin e sistemit të drejtësisë. Një sërë projektsh infrastrukturore kanë rritur kapacitetin e sistemit gjyqësor dhe të burgjeve për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Programi i mbështetjes buxhetore sektoriale për zbatimin e Strategjisë së Drejtësisë është plotësues i kësaj ndihme. Mbështetja për operacionin ndërkombëtar të monitorimit për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve është përgatitur. Nga ana e zbatimit të ligjit, mbështetja e mëhershme u përqendrua në konsolidimin dhe ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e ligjit, si dhe në luftën kundër krimit të organizuar.

Për sa i përket **konkurrueshmërisë dhe novacionit**, asistencë e mëparshme përfshinte veprimin e IPA 2018, “BE-ja për Zhvillimin Ekonomik – zhvillimi ekonomik vendor i udhëhequr prej turizmit, me fokus të trashëgimia kulturore”, që synon të mbështetë territorin e synuar që të shfrytëzojë potencialin e vet për të tërhequr vizitorë, si edhe të rritë cilësinë e ofertës së turizmit. Ky veprim në vetvete vijon nga veprimi i IPA 2017, “Mbështetja e BE-së për modelin e udhëhequr nga turizmi për Zhvillimin Ekonomik Vendor, që synon të mbështetë zhvillimin ekonomik vendor në katër teritore/qarqe (Shkodër, Fier, Berat dhe Korçë), duke shfrytëzuar asetet potenciale vendore/rajonale pak të përdorura, me qëllim që të maksimizohen mundësitë për rritje ekonomike dhe konkurrueshmëri.



Lista e Aksioneve të parashikuara sipas Sektorëve/Prioriteteve të përzgjedhura:

Sektori/prioriteti/veprimi	Menaxhim direkt	Menaxhim indirekt	
		Me subjekt të besuar	Me përfituesin IPA II
Demokracia dhe Qeverisja			
Veprimi 1. BE-ja për qeverisje të mirë.	45 600 000 euro	2 500 000 euro	0
Veprimi 2. Mbështetja e BE-së për pjesëmarrjen në Programet dhe Agjencitë e saj.	0	0	1 500 000 euro
Veprimi 3. Instrumenti i Integritetit në BE.	5 850 000 euro	0	2 450 000 euro
Shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore			
Veprimi 4. BE-ja për Shtetin e së Drejtës.	0	5 000 000 euro	0
Veprimi 5. BE-ja për Të Drejtat e Pronësisë	5 700 000 euro	0	0
Veprimi 6. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM): Mbështetje për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri – Faza II.	0	8 700 000 euro	0
Konkurrueshmëria, novacioni, bujqësia dhe zhvillimi rural			
Veprimi 7. BE-ja për Rimëkëmbjen Ekonomike.	26 000 000 euro	0	0
TOTALI	83 150 000 euro	16 200 000 euro	3 950 000 euro

2.2 Përshkrimi dhe zbatimi i veprimeve

Asistenca e parashikuar duhet të respektojë kushtet dhe procedurat e përcaktuara nga masat kufizuese të miratuara në zbatim të nenit 215 të TFBE-së⁵.

Sektori	Demokracia dhe Qeverisja	57 900 000 euro
Veprimi 1	BE-ja për Qeverisjen e Mirë	48 100 000 euro

⁵ www.sanctionsmap.eu. Ju lutem, vini re se harta e sanksioneve është mjet TI për të identifikuar regjimet e sanksioneve. Burimi i sanksioneve buron nga aktet juridike të publikuara në Fletoren Zyrtare. Në rast mospërputhjeje midis akteve ligjore të publikuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, versioni në GZ do të ketë përparësi.



1. Përshkrimi i veprimit, objektivi, rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës:

- Përshkrimi i veprimit dhe objektive:

Objektivi i përgjithshëm është të kontribuojë në një sektor publik më të aftë dhe reagues ndaj nevojave të qytetarëve dhe bizneseve, si edhe të avancojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të proceseve të integritetit në BE.

Objektivi specifik është të përmirësohet administrata publike që të bëhet më efikase, llogaridhënëse, transparente, përfshirëse dhe efektive në nivel qendror dhe vendor.

- Rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës:

Rezultatet e pritshme të këtij veprimi janë:

- Përmirësimi i mobilizimit të të ardhurave të brendshme;

- Përmirësimi i kapaciteteve fiskale të njërive të qeverisjes vendore;

- Planifikim buxheti dhe koordinim politikash i mirëintegruar dhe efikas;

- Forcimi i kontrolleve mbi alokimet;

- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore;

- Përmirësimi i menaxhimit të investimeve publike;

- Rritje e integritetit të institucioneve publike;

- Përmirësim i transparencës dhe aksesit në informacion për qytetarët;

- Përmirësim i kuadrit rregullator dhe kapaciteteve në qeverisjen vendore;

- Përmirësim i ofrit të shërbimeve për qytetarët;

Treguesit kyç të performancës (për objektivin specifik):

- Rezultati për paanësinë dhe efikasitetin e procedurave administrative;

- Rezultati për transparencën;

- Rezultati për konsultimin publik;

- Rezultati i indeksit të buxhetit të hapur për mbikëqyrjen buxhetore;

- Rezultati për ofrimin e shërbimeve të orientuara drejt qytetarit;

- Rezultati i aksesueshmërisë së shërbimeve publike.

2. Supozimet dhe kushtet

Supozimet për këtë veprim janë: i. vijimi i angazhimit politik për zbatimin e reformave të qeverisjes së mirë dhe agjendës së aderimit në BE; dhe ii. prania dhe forcimi i mëtijshëm i

kapaciteteve menaxhuese dhe teknike në administratën qendrore dhe vendore.

Kushtet e veprimit janë:

Deri në 2022/2023, do të miratohen strategjitë sektoriale dhe planet e veprimit të rishikuara për: Reformën në Administratën Publike (RAP), Menaxhimin e Financave Publike (MFP), Luftën Kundër Korrupsionit (AK), Shqipërinë Digjitale, Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (përfshirë kostimin, informacionin buxhetor afatmesëm dhe integrimin gjinor pas kërkesave të BE/OECD/Sigma) në kuadrin e grupit tematik të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) pas konsultimit me partnerët për zhvillim dhe organizatat e shoqërisë civile përpara nënshkrimit të marrëveshjes së financimit.

Miratimi i Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve mbi 'matricën e kompetencave të vetëqeverisjes vendore' duke përfshirë rishikimin e legjislacionit për të adresuar boshllëqet dhe mbivendosjet në lidhje me caktimin e qartë të përgjegjësisë midis autoriteteve të qeverisjes qendrore dhe vendore deri në fund të vitit 2019.

Qeveria qendrore do të japë bashkëfinancim të paktën sa 10% e shumës së secilit nëngrant të përfshirë në skemën e granteve të BE-së për bashkitë (në kohën e nënshkrimit të granteve).

Mosrespektimi i kërkesave më lart mund të rezultojë në rikuperimin e fondeve nga ky program dhe/ose rialokimin e tyre në financime të ardhshme.

3. Modalitetet e zbatimit

3. a) Menaxhim direkt përmes Mbështetjes Buxhetore

a) Pranueshmëria për mbështetjen buxhetore

Politikat Publike

Politika e Qeverisjes së Mirë bazohet në disa strategji të ndërlidhura sektoriale dhe ndërsektoriale. Koordinimi dhe monitorimi i tyre është parashikuar në kuadër të GMIP-së dhe grupeve tematike të punës për Qeverisjen e Mirë që mbulojnë politikëbërjen dhe sistemet, RAP-it, MFP-së, Antikorrupsionin, Drejtësinë, Qeverisjen Vendore/Decentralizimin, Agjendën Digjitale, Shërbimet Publike dhe Statistikat. Hartimi dhe zbatimi i këtij programi bazohet në besueshmërinë, relevancën dhe progresin e



kënaqshëm në zbatimin e strategjive RAP dhe MFP. Për më tepër, do të sigurohet monitorimi përkatës i politikave për zbatimin e strategjive “plotësuese”, d.m.th.: Antikorrupsioni, Pushteti Vendor dhe Agjenda Digjitale.

Strategjia ndërsektoriale RAP 2015–2020, strategjia e reformimit të MFP-së 2019–2022, si edhe strategji të tjera plotësuese të kuadrit të reformave për qeverisjen e mirë – strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit 2015–2020, Strategjia kombëtare ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015–2020 dhe Strategjia për një Shqipëri Digjitale 2015–2020, – formojnë së bashku kuadrin e reformës në administratën publike – që është në lidhje edhe me kuadrin strategjik të RAP-it. Strategjia RAP, si dokumenti kryesor publik i politikave – bashkë me strategji të tjera plotësuese për qeverisjen e mirë, – vazhdon të jetë relevante dhe është e harmonizuar me dokumente të tjera kombëtare planifikimi, konkretisht me SKZHI-në; adreson problemet kryesore në sektor dhe është i akorduar me angazhimet e politikave në kuadrin e aderimit të Shqipërisë në BE. Strategjia RAP, e koordinuar nga Kryeministria dhe DAP-i, trajton dobësitë kyçe: i. formulimin e politikave dhe cilësinë e legjislacionit; ii. organizimin dhe funksionimin e administratës publike; iii. shërbimin civil: menaxhimi i burimeve njerëzore; iv. procedurat administrative dhe mbikëqyrja. Strategjia RAP është në përputhje edhe me gjashtë fushat kryesore të Administratës Publike sipas SIGMA-s, si dhe pasqyron prioritetet e përcaktuara në kuadrin e “qeverisjes për zhvillim”, të Strategjisë 2020 të Evropës Juglindore. Lidhur me strategjitë e tjera plotësuese për qeverisjen e mirë:

Objektivat specifikë të strategjisë MFP 2019–2022, të koordinuara nga MFE-ja, adresojnë dobësitë kryesore në lidhje me: i. kuadrin fiskal të qëndrueshëm dhe të matur; ii. planifikimin e mirë-integruar dhe efikas; iii. mobilizimin e të ardhurave; iv. ekzekutimin efikas të buxhetit; v. transparencën e financave publike; vi. kontrollin e brendshëm efektiv; dhe vii. mbikëqyrjen e jashtme efektive të financave publike (shih gjithashtu Gatishmëria për Mbështetje Buxhetore MFP më lart).

Strategjia kundër Korrupsionit, e koordinuar nga MD-ja, në rolin e saj si Koordinatorë

Kombëtare kundër Korrupsionit, kombinon 18 objektiva komplekse të lidhura me parandalimin, goditjen dhe ndërgjegjësimin, me 97 masa në planin e veprimit 2018–2020, në një mjedis multiinstitucional. Strategjia u përgjigjet drejtpërdrejt përparësive kryesore të përcaktuara në agjendën e Integritetit Evropian. Këshilli i Ministrave miratoi një plan veprimi të ri për periudhën 2019–2023, me kosto dhe objektiva të përditësuara për treguesit e performancës.

Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015–2020, e koordinuar nga MB-ja, adreson dobësitë e identifikuar: i. efikasitetin e strukturave të qeverisjes vendore; ii. autonominë fiskale dhe financiare; iii. zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; dhe iv. qeverisjen e mirë. Ekziston nevoja për qartësim të ndarjes së përgjegjësisë, lidhje më të mirë të objektivave dhe aktiviteteve/treguesve, dhe përmirësim të lidhjeve midis decentralizimit dhe politikës rajonale.

Strategjia ndërsektoriale “Agjenda Digjitale për Shqipërinë 2015–20” e koordinuar nga Kryeministria, përqendrohet në: i. zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe ofrimin e shërbimeve publike interaktive për qytetarët dhe bizneset; ii. zhvillimin e komunikimeve elektronike në të gjithë sektorët; iii. krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore. Strategjia synon të adresojë disa nga sfidat kryesore në drejtim të qeverisjes elektronike, ofrimit të shërbimeve publike dhe nevojave të infrastrukturës së komunikimit elektronik.

Hartimi i këtyre strategjive dhe rishikimi i tyre afatmesëm u informua nga proceset e konsultimit me palët e interesuara përkatëse, përfshirë aktorët shtetërorë dhe joshetërorë. Ndërsa ecuria në zbatimin e strategjive është përgjithësisht pozitive, pavarësisht ngadalësimit pas zgjedhjeve të vitit 2017 dhe ristrukturimit të qeverisë, strategjitë fillestare vuajtën nga kostimi i dobët dhe ndonjëherë përfshirja joadekuate në buxhetin afatmesëm. Rreziqet për qëndrueshmërinë e reformave lidhen me angazhimin politik dhe autorësinë e brishtë të disa shtyllave, si dhe me kapacitetin e ulët të burimeve njerëzore të disa aktorëve të administratës publike, për sa i përket numrit të personelit dhe aftësive. Mundësia për të



koordinuar strategjitë e ndërlidhura është ringjallur me ringritjen e Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) në fund të vitit 2018.

Duke pasur parasysh hartimin, ecurinë e zbatimit dhe qëndrueshmërinë, strategjia RAP mund të konsiderohet e besueshme. Plani i veprimit RAP 2018–2020 është pothuaj plotësisht i kostuar (90%). 96% e kostove të identifikuar janë të përfshira në PBA. Strategjia e rishikuar MFP përfshin një plan veprimi për 2019–2023 dhe kostim për periudhën 2019–2022. Brenda kuadrit të strategjisë së decentralizimit, ligjet e reja për vetëqeverisjen vendore dhe ndarjen territoriale dhe administrative të Shqipërisë hedhin themelet e sistemit të vetëqeverisjes vendore, duke synuar rritjen e kontaktit të drejtpërdrejtë me bashkitë dhe qytetarët. Ligji i vitit 2017, për financat vendore, përcakton qartë rregullat, parimet dhe procedurat e financave të qeverisjes vendore. Sipas raportit vjetor të monitorimit të vitit 2018, mbi zbatimin e Strategjisë së Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore, zbatimi është i kënaqshëm me 36% të veprimeve të realizuara, 49% në proces, 13% të vonuara dhe 2% që fillojnë pas vitit 2017. Është shënuar progres në zbatimin e strategjisë së Agjendës Digjitale (AD) në fushën e shërbimeve elektronike. Përgjegjësia për Agjendën Digjitale u transferua tek AKSHI në 2017. Mungesa e një mekanizmi të fortë koordinimi pengon progresin dhe qëndrueshmërinë.

Monitorimi dhe vlerësimi janë përmirësuar vazhdimisht që nga miratimi i RAP-it dhe i strategjive të tjera që lidhen me qeverisjen e mirë, përfshirë plane veprimi të hartuara rishtazi me tregues dhe objektiva; përveç Agjendës Digjitale për të cilën është caktuar së fundmi një institucion koordinues, AKSHI ka hartuar një plan veprimi të ri deri në 2022 që pritet të miratohet së shpejti. Raportet e monitorimit po bëhen më solide me analizën e arritjes së treguesve dhe më të shtjelluara nga Qeveria. Janë publikuar të gjitha raportet e progresit të disponueshme. Me kalimin e kohës, vënia në funksion e IPSIS, Sistemit Informatik të Menaxhimit Financiar (AFMIS) pritet të përmirësojë të dhënat në dispozicion të monitorimit.

Strategjitë e diskutuara në këtë kapitull janë të gjitha koherente me përparësitë e politikës kombëtare. Sidoqoftë, kërkohet forcim i kapaciteteve të Kryeministrit për të siguruar cilësinë e politikave. Ekzistojnë modele për hartimin e politikave dhe strategjive, por këto thuhet se përdoren rrallë. Rrjedhimisht, Këshilli i Ministrave ka miratuar politika/strategji pa plane veprimi ose me plane veprimi të pakostuara. Futja e RIA (vlerësimi i ndikimit rregullator) pritet të kontribuojë më tej në harmonizimin dhe përmirësimin e standardeve.

Në bazë të vlerësimit të kryer, strategjia RAP si politika kryesore publike konsiderohet e rëndësishme dhe e besueshme si strategjia sektoriale themelore për këtë Kontratë të Performancës së Reformës Sektoriale.

Politika makroekonomike

Rritja ekonomike e Shqipërisë është ngadalësuar në 2019 në 2.2% pas rritjes së moderuar prej 4.1% në 2018. Zgjerimi i kërkesës së brendshme shtyu rritjen në 2019. Rritja stanjative e partnerëve tregtarë kufizoi eksportet tradicionale, ndërsa eksporti i energjisë pësoi rënie. Eksportet vazhduan ringritjen pas performancës së dobët në T1 2019, dhe u rritën me 10% me bazë vjetore, nxitur veçanërisht nga shërbimet (turizmi) dhe shërbimet e prodhimit. Rritja e importeve u zbut në 3.6% me bazë vjetore, për shkak të importeve më të ulëta të energjisë elektrike. Rritja e formimit të kapitalit fiks bruto vazhdoi të tkurret, me shumë gjasa për shkak të përfundimit të punimeve për projektin e madh ndërtimor të gazsjellësit Trans-Adriatik.

Pas rritjes së ngadalësuar dhe tërmetit shkatërrues në 2019, Shqipëria u godit nga pandemia COVID-19, në mars 2020. Ekonomia parashikohet të tkurret me 4¼% në 2020, për shkak të kufizimeve të brendshme dhe ndërkombëtare që tkurrin konsumin privat dhe turizmin, mbi të cilin Shqipëria fuqimisht mbështetet. Recesioni në BE do të ndikojë edhe në remitancat dhe flukset hyrëse të IHD-ve, si dhe do të ushtrojë presion mbi llogarinë rrjedhëse dhe kursin e këmbimit. Deficiti fiskal pritet të rritet mbi 5% të PBB-së dhe borxhi publik parashikohet të rritet përkohësisht në rreth 75% të PBB-së. Për vitin 2021, rritja e PBB-së pritet të rikthehet në 4¼%, por kjo është e pasigurt sepse varet nga kohëzgjatja e



kufizimeve të udhëtimit dhe qëndrueshmëria e ndërmarrjeve gjatë krizës. Që nga marsi i vitit 2020, kufizimet e brendshme dhe ndërkombëtare për të vënë nën kontroll pandeminë, kanë filluar të tkurrin konsumin privat, investimet dhe eksportet. Konsumi privat dhe investimet parashikohet të bien përkatësisht me 4¹/₄% dhe 7%. Eksportet totale pritet të bien me rreth 25%, kryesisht për shkak se shërbimet e turizmit do të humbin një sezon të tërë në vitin 2020. Eksportet e mallrave pritet të tkurren për shkak të rënies së eksporteve të manufakturës dhe mallrave, ndërsa eksporti i energjisë elektrike parashikohet të mos preket. Pritet rënie e fortë e importeve, sidomos për shërbimet e udhëtimit, që nuk do të jenë në gjendje të kompensojnë plotësisht rënien e eksporteve; eksportet e përgjithshme neto ka të ngjarë të marrin 1/4 pikë përqindje nga rritja. Pjesa e madhe e bujqësisë familjare dhe e prodhimit të energjisë elektrike nuk do të ndikohet nga kriza dhe mund të kufizojnë pak tkurrjen e PBB-së. Manifaktura (prodhimi), ndërtimi dhe shërbimet pritet ta marrin veten gradualisht pas përfundimit të karantinës që parashikohet të ndodhë në maj.

Nga ana e furnizimit, rimëkëmbja e vitit 2019 pasqyron një prodhim të shtuar të minierave, manufakturës dhe shërbimeve, përfshirë ato që lidhen me hotelerinë dhe tregtinë. Prodhimi i energjisë elektrike u rikuperua, por mbeti shumë poshtë niveleve të jashtëzakonshme të vitit 2018. Krijimi i vendeve të punës, paga më të larta dhe kredia konsumatore vazhduan të nxisin konsumin privat që kontribuoi me rreth 2.1 pikë përqindje në rritjen e PBB-së. Ndërkohë, investimet u rritën falë kushteve më të mira të kredisë dhe shpenzimeve të infrastrukturës qeveritare. Punësimi vazhdoi të rritet, ndërsa papunësia arriti një rekord të ulët prej 11.4% në T3 2019. Krijimi i vendeve të punës (për popullatën e moshës 15 vjeç e lart) ishte me 6%, më i fuqishëm në industri (kryesisht manifaktura dhe ndërtimi), i ndjekur nga shërbimet, në veçanti në hoteleri dhe në shërbimet e komunikimit. Shkalla e papunësisë së të rinjve u rrit në 21.4% në T3 2019, por mbeti nën nivelin e vitit 2018. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ishte 69.8% në T3 2019, me normën e pjesëmarrjes së femrave në 62%; gjë që ngushtoi hendekun midis pjesëmarrjes së fuqisë punëtore

meshkuj dhe femra në 15.7 pikë përqindje.

Tkurrrja në vitin 2020 ka të ngjarë të rrisë shkallën e papunësisë me më shumë se 3 pikë përqindjeje me pikun 15%. Rritja e papunësisë dhe rrjetat e dobëta të sigurisë sociale do të frenojnë rimëkëmbjen e konsumit privat në 2021. Shterimi i burimeve financiare të shumë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) pritet të vazhdojë të deprimojë investimet private në 2021. Sidoqoftë, rritja ekonomike vlerësohet të rikthehet në 4¹/₄%, kryesisht për shkak të rimëkëmbjes së turizmit. Për më tepër, projektet publike të rindërtimit që janë gati të fillojnë, mund të stimulojnë sektorin e ndërtimit. Ky projeksion i nënshtrohet një pasigurie thelbësore se si ndërmarrjet do të mbijetojnë në periudhën e krizës. Rreziku drejt trendit rënës vjen kryesisht nga kufizimet e vazhdueshme të udhëtimit, të cilat do të dëmtojnë rimëkëmbjen e turizmit.

Inflacioni ra në krahasim me fundin e 2018, si pasojë e importimit të inflacionit të ulët nga partnerët tregtarë të Shqipërisë dhe forcimit të lekut shqiptar. Në vitin 2019, rritja e të ardhurave fiskale u kufizua nga rritja më e ulët e PBB-së dhe, veçanërisht, nga rritja e pagesave të rimbursimit të TVSH-së. Raporti i të ardhurave ndaj PBB-së ra nga 27.6% e PBB-së në 2018 në vlerën 27.4% në 2019. Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore u rritën lehtë, mbështetur nga paga më të larta dhe përpjekjet për të ulur informalitetin.

Përpjekjet e qeverisë për zyrtarizimin e ekonomisë gjatë viteve të fundit kanë dhënë disa rezultate pozitive në numrin e punonjësve të regjistruar në skemën e sigurimeve shoqërore. Politikat e tregut të punës, të parashikuara në strategjinë kombëtare të punësimit dhe aftësive, për 2014–2020, pritet të gjenerojnë efekte pozitive në uljen e papunësisë, papunësisë së të rinjve dhe ekonomisë informale. Sidoqoftë, Shqipëria ka një bazë relativisht të ngushtë prodhimi, duke rezultuar në një deficit të madh strukturor në bilancin tregtar të mallrave. Kjo kompensohet pjesërisht nga të ardhurat nga turizmi i huaj dhe eksporti i shërbimeve të manufakturës për produkte me pronësi të huaj. Llogaria rrjedhëse gjithashtu përfiton nga një vëllim i madh i dërgesave të emigrantëve. Sidoqoftë, në dritën e përpjekjeve të konsolidimit



fiskal mund të ketë presion mbi anën e shpenzimeve në rast të mungesës së të ardhurave – me synimin që të arrihen objektivat e deficitit.

Pavarësisht nga situata e vështirë për shkak të tërmetit në nëntor 2019, qeveria arriti të zvogëlojë borxhin publik në 66.2% përkundër projeksonit prej 66%. Për shkak të nevojave të larta për financimit, garancive të reja sovraane për sektorin privat dhe rënies së PBB-së, raporti i borxhit publik parashikohet të rritet përkohësisht në rreth 75% të PBB-së në 2020 dhe të pësojë rënie të lehtë në 2021.

Deficiti i përgjithshëm publik ra nga 4.1% në 2015, në 1.5% të PBB-së në 2018, për shkak të shpenzimeve më të ulëta dhe të ardhurave më të larta. Në 2019 u rrit deri në 1.9% të PBB-së, kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve në tremujorin e fundit të vitit 2019, për shkak të tërmetit. Goditja e energjisë dhe kërkesa e ulët e huaj ekspozuan dobësitë e jashtme të vendit. Në përgjigje të tërmetit, qeveria planifikoi një rritje prej 0.6 pikë përqindjeje të deficitit fiskal, në 2.2% të PBB-së në vitin 2020. Masat e mbështetjes financiare të qeverisë në kontekstin e pandemisë, së bashku me rënien e pritur të të ardhurave, parashikohet të rritin deficitin fiskal përkohësisht mbi 5% të PBB-së. Deficiti i llogarisë rrjedhëse është shumë i ndjeshëm ndaj çmimeve të mallrave dhe kushteve të reshjeve, pasi këto të fundit përcaktojnë kryesisht prodhimin e energjisë. Deficiti i llogarisë rrjedhëse u zgjerua nga -6.8% të PBB-së në 2018, në -8% të PBB-së në 2019, kryesisht për shkak të eksporteve të reduktuara ndërsa importet mbajtën të njëjtin nivel me 2018.

Indeksi real-efektiv i kursit të këmbimit u rrit me 9% në fund të vitit 2018, duke reflektuar përshtetshmërinë e mbiçmimit të monedhës shqiptare, ndërsa në 2019 monedha vendase ishte përsëri në nivelet normale. Flukset hyrëse të remitançave mbetën të forta, por regjistruan rënie të lehtë si përqindje e PBB-së nga 5.8% në 2015 në 5.2% të PBB në 2018. Flukset hyrëse të IHD-ve u zbutën nga 8.6% në 7.9%, pasi ndërtimi i dy projekteve të mëdha energjetike është drejt përfundimit, por mbeti i lartë dhe ende financoi pjesën më të madhe të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Në fund të dhjetorit 2019, rezervat ndërkombëtare bruto ishin në 3 360 milionë euro, ose rreth 24.5% e PBB-së.

Treguesit e mjaftueshmërisë së rezervës ishin mbi nivelet kritike, mjaftueshëm për të mbuluar 6.6 muaj të importeve të mallrave dhe shërbimeve dhe 155% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.

Stabiliteti i sektorit financiar u përmirësua, pasi bankat vazhduan të ulnin kreditë me probleme. Sidoqoftë, huadhënia për sektorin e korporatave private mbeti e heshtur dhe vazhdoi me ngulm përdorimi i lartë i monedhës së huaj në tregun e brendshëm. Ligji i ri për Falimentimit ende pret miratimin e akteve nënligjore në zbatim të tij, ndërsa zbatimi i Ligjit për Përmbarrimin Privat, të ndryshuar, pengohet nga mosmarrëveshjet.

Në Programin e Reformave Ekonomike (PRE) 2020–2022, miratuar në janar 2020, para COVID-19, Shqipëria parashikoi që rritja ekonomike të përshtepetohet në 4.1% deri në vitin 2020, bazuar në kërkesën e brendshme private të fortë për shkak të rritjes së punësimit e pagave dhe kushteve të favorshme të huadhënies për familjet. Aktiviteti i investimeve private ishte parashikuar të qëndronte në një nivel të qëndrueshëm prej 17.8% të PBB-së gjatë 2019–2021, pak më e ulët krahasuar me 18.5% të PBB-së në 2018. Kjo situatë pritet të përqendrohet më tej për shkak të pandemisë COVID-19 në vitin 2020, masat shtrënguese të qeverisë, të cilat bllokuan veprimtaritë e shumicës së ndërmarrjeve gjatë mars–maj 2020 dhe rreziqet që shoqërohen me një valë të dytë të mundshme të COVID-19, më vonë në vitin 2020. Eksportet neto pritet të japin vetëm një kontribut minimal në zgjerimin ekonomik. Parashikimi i rritjes duket optimist në dritën e një ambienti të jashtëm të përqendruar, nivelet e ulëta të kreditimit për bizneset dhe dobësitë e vazhdueshme në mjedisin e biznesit.

Në PRE, Shqipëria konfirmoi angazhimin për të ulur borxhin publik nga piku rreth 73% të PBB në 2015, në rreth 65.4% të PBB në 2020; 62.3% e PBB-së në 2021 dhe 62.0% në 2022. Për të arritur këtë ulje, skenari bazë fiskal synon një deficit fiskal në nivelin e 2.2% të PBB-së në 2020; 2.0% në 2021; dhe 1.7% deri në 2022, ndërsa synon një bilanc primar pozitiv. Raporti relativisht i ulët i shpenzimeve publike nuk lejon shkurtime të konsiderueshme të shpenzimeve, gjë që shpjegon pjesërisht ritmin e moderuar të



zvogëlimit të borxhit. Përgjashtimet e shumta nga TVSH-ja, kohët e fundit, do të komplikojë përpjekjet për të zgjeruar bazën e tatimpaguesve dhe për të përmirësuar efikasitetin e mbledhjes së taksave, krahas informalitetit dhe evazionit fiskal në ekonominë formale.

Në vitin 2019, shpenzimet kapitale ishin në nivelin e 4.5% të PBB-së ose 15.2% të shpenzimeve totale krahasuar me 4.8% të PBB-së dhe 16.5% të shpenzimeve totale në 2018. Për periudhën 2020–2022, investimet publike të qeverisë u vlerësuan mesatarisht rreth 4.7% të PBB-së për çdo vit (ose rreth 5.5% e PBB-së nëse përfshihen investimet e qeverisjes vendore). Dobësitë në planifikimin dhe menaxhimin e shpenzimeve kapitale ende ngulmojnë. Në mënyrë që të mbushë hendekun e madh infrastrukturor, qeveria po kërkon të mobilizojë kapitalin privat - kryesisht përmes partneritetit publik-privat (PPP). Shtimi i PPP-ve gjeneron detyrime kontingjente dhe rrjedhimisht rreziqe fiskale, për të cilat kapacitetet monitoruese janë të kufizuara.

Kombinimi i përgjithshëm i politikës makroekonomike ka qenë gjerësisht i përshtatshëm dhe Shqipëria i është përmbajtur rregullave fiskale, kryesisht për të mbajtur raportin e borxhit publik ndaj PBB-së në rënie derisa të arrihet kufiri i 45%, pavarësisht tërmetit të rëndë. Zbatimi i buxhetit dhe MFP-së duhet të forcohen për të shmangur borxhet e prapambetura dhe për të menaxhuar rreziqet fiskale. Rritja e të ardhurave nga taksat mund të ndihmojë në përshpejtimin e arritjes së kufirit prej 45% të borxhit ndaj PBB-së, duke forcuar kështu qëndrueshmërinë e borxhit.

Ndërsa efektet e krizës COVID-19 në ekonominë shqiptare vazhdojnë të thellohen, qeveria synon të rrisë huamarrjen - dhe deficitin buxhetor pritet të rritet në vitin 2020 - në mënyrë që të sigurojë shërbimet bazë dhe të ndihmojë bizneset të mbijetojnë. Sidoqoftë, në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, qeveria është e vendosur të ruajë konsolidimin fiskal. Pas ndryshimit të buxhetit shtetëror në mars, një rishikim i dytë i buxhetit u miratua në prill 2020.

Në tërësi, është plotësuar kërkesa e pranueshmërisë për një politikë makroekonomike të besueshme, relevante dhe të orientuar drejt stabilitetit.

Menaxhimi financiar publik

2019 shënoi vitin e pestë të zbatimit të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike (MFP) dhe planit të veprimit përkatës. Raportet vjetore të monitorimit publikohen në gjuhën shqipe dhe angleze. Në tërësi është shënuar progres, por që u ngadalësua pas tërmetit të nëntorit 2019 dhe situatës me COVID-19 në gjysmën e parë të vitit 2020. Në veçanti, miratimi dhe zbatimi i kuadrit koordinues dhe monitorimi periodik janë vonuar.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) ngriti mekanizmat e konsultimit ndërministror dhe ministror për të kryer rishikimin afatmesëm të strategjisë së reformës MFP 2014–2022 dhe për të zhvilluar dhe konsultuar strategjinë MFP, të rishikuar dhe të zgjeruar, për 2019–2022. Rishikimi afatmesëm i strategjisë MFP u përfundua me një seminar konsultimi në mars 2019, duke përfshirë identifikimin e përparësive që duhen adresuar gjatë periudhës së zgjatur deri në vitin 2022. Këto përfshijnë: menaxhimin e investimeve publike, vlerësimin, përzgjedhjen dhe monitorimin e proceseve për investimet publike; PPP-të dhe koncesionet; analizën e monitorimit, raportimit dhe zbutjes së rreziqeve fiskale; riakumulimin e borxheve në nivelet e qeverisjes vendore dhe qendrore pas shlyerjes së të gjitha borxheve para vitit 2014; përmirësimin e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm; forcimin e standardeve të kontrollit të brendshëm në të gjithë qeverinë, në përputhje me një politikë gjithëpërfshirëse të KBFP-së; aksesin *online* në sistemin e thesarit për të gjitha institucionet buxhetore; dhe krijimin e një shtylle të veçantë për mobilizimin e të ardhurave të brendshme. Strategjia e rishikuar shfaq një zhvendosje nga orientimi në veprim tek orientimi në rezultate dhe produkte, përfshirë këtu edhe treguesit e performancës dhe kostimin.

Në dhjetor 2019, Këshilli i Ministrave miratoi strategjinë MFP, të rishikuar dhe të zgjeruar, për periudhën 2020–2022.

Vlerësimi i fundit i Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjësisë Financiare të vitit 2017 (PEFA) tregon performancë të përzier me 15 nga 31 tregues që pasqyrojnë performancë të fortë dhe 16 tregues performancë të dobët. Krahasimi i përgjithshëm me vlerësimin e mëparshëm në



vitin 2011 tregon preformancë të njëjtë për 16 tregues, përmirësim për 5 tregues dhe rezultat më të ulët në 7 tregues. Nga këto 7 tregues, tri rezultate nuk kishin të bënin me ndryshim në performancë, por me interpretimin tepër optimist të kuadrit në 2011.

Në tërësi, është plotësuar kriteri i pranueshmërisë për një program të besueshëm dhe relevant për të përmirësuar menaxhimin e financave publike.

Transparenca buxhetore dhe mbikëqyrja e buxhetit

Qeveria e Shqipërisë publikoi buxhetin e vitit 2020 (propozimi i buxhetit të ekzekutivit dhe buxheti i miratuar) në kohën e duhur për publikun e gjerë, në faqen e internetit të MFE-së dhe në formë të shtypur në Fletoren Zyrtare. Prandaj, kërkesat bazë konsiderohet se plotësohen. Në tërësi, transparenca e buxhetit është përmirësuar vitet e fundit me zbatimin e reformës MFP, për sa i përket sasisë dhe relevancës së informacionit, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë vendor. Qeveria tani publikon të gjitha dokumentet kryesore buxhetore në një afat kohor në përputhje me standardet ndërkombëtare. Sidoqoftë, raporti i mesit të vitit, i botuar për herë të parë në 2017-ën, përfshin pesë në vend të gjashtë muajve, që është në përputhje me Ligjin Organik të Buxhetit. Nisma BOOST përmirësoi aksesin e publikut në të dhënat e buxhetit dhe MFE-ja ngriti, në bashkëpunim me *Co-Plan*, një portal transparence për Financat Vendore. Një çështje kryesore është niveli i pabarabartë i transparencës në strukturat e qeverisë, çka duhet të adresohet në mënyrë sistematike. Është publikuar raporti i zbatimit të buxhetit 2018, por ka vend për përmirësim në lidhje me raportimin e pasurive shtetërore dhe mundësinë e krahasimit me buxhetin fillestar.

Rezultati më i fundit i Indeksit të Buxhetit të Hapur është 55 (2019) krahasuar me 50 (2017) dhe 38 (2015), duke demonstruar një përmirësim të vazhdueshëm. Sipas PEFA 2017, shumica e treguesve nuk kanë ndryshuar në aspektin e performancës përkundrejt rezultateve tepër optimiste të PEFA 2011, me përjashtim të dokumentacionit buxhetor (PI-5). Raportet mujore të ekzekutimit të buxhetit lëshohen në kohë, por mbulimi dhe klasifikimi i të dhënave nuk lejon krahasimin e drejtpërdrejtë me

buxhetin fillestar, dhe shpenzimet kapen në fazën e pagesës (PI-28). Raportet vjetore financiare dorëzohen për auditim të jashtëm në kohën e duhur, por nuk paraqesin një krahasim midis buxhetit fillestar dhe ekzekutimit aktual, dhe dallimet midis standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare nuk zbulohen (PI-29).

Vëmendja e duhur e Parlamentit dhe ndjekja e rekomandimeve të auditimit (PI-30 dhe PI-31) shfaqin boshllëqe. Ligjvënësi nxjerr rekomandime për veprimet që duhen zbatuar, por nuk i monitoron ato. Dëgjuesat janë publike, me disa përjashtime. Mbulimi i auditimit të jashtëm është i gjerë, por zbatimi i rekomandimeve është i ulët. KLSH-ja zhvilloi një sistem për të ndjekur zbatimin e rekomandimeve i cili pritet të bëhet plotësisht funksional në vitin 2020. Në 2018, KLSH-ja nxori për herë të parë një opinion mbi raportin e ekzekutimit të buxhetit 2017. Anketa e Buxhetit të Hapur (ABH) 2019 e vlerësoi mbikëqyrjen me 65 pikë, pak më e ulët se në vitin 2017 (69 nga 100 pikë); ndërsa mbikëqyrja e auditimit u konsiderua adekuate me 72 pikë dhe mbikëqyrja legjislative pothuajse adekuate me 61 pikë (NB 41–60 pikë është “e kufizuar”). Një rekomandim i ABH-së, në lidhje me këtë, është që një komision legjislativ duhet të shqyrtojë zbatimin e buxhetit brenda vitit dhe raportet me gjetje duhet të publikohen në internet.

Anketa e Buxhetit të Hapur të vitit 2019 vlerëson se Shqipëria ofron pak mundësi për publikun që të angazhohet në procesin e buxhetit, duke e vlerësuar me 7 nga 100 pikë (rritje me 2 pikë nga 2017). Sidoqoftë, mesatarja globale për këtë tregues është vetëm 14 pikë; mesatarja e OECD-së është 23 pikë; rajonin e kryeson Kroacia (22 pikë) dhe Sllovenia (11). Rishikimi i Ligjit Organik të Buxhetit në vitin 2016 përfshiu konsultimin me shoqërinë civile si një kërkesë ligjore për të zyrtarizuar nismat e mëparshme vullnetare. Rezultati i ulët për Shqipërinë vjen kryesisht për shkak të kufizimit të konsultimit publik gjatë procesit të miratimit të buxhetit, sesa gjatë formulimit, zbatimit dhe kontrollit të buxhetit.

Në vitin 2018 u miratua në mjet i ri Planifikimi Financiar për njësitë vendore për PBA-në, si edhe Manuali për Planifikimin Financiar, që u zbatuan në kuadrin e masave për



trajnimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të personelit. Udhëzimi për modelin e ri të PBA-së do të forcojë rolin e saj si instrument për procesin (e përgatitjes së) buxhetit dhe qëllimet e alokimit strategjik të burimeve.

Vlerësimi i Kodit të Transparencës Fiskale të FMN-së, botuar në vitin 2016, vuri në dukje se dhjetë nga 36 parimet e Kodit vlerësohen si “të mira” ose “të përparuara”, dhe 14 parime vlerësohen në nivelin “bazë”. Sidoqoftë, në tetë fusha kërkesat themelore të Kodit “nuk janë përmbushur”. Vlerësimi i Transparencës së FMN-së nuk është përditësuar që nga viti 2016, gjë që nuk pasqyron progresin në dy vitet e fundit.

Shqipëria u vlerësua se ka bërë progres domethënës në Standardet e Nismave të Industrive Nxjerrëse (EITI) siç konfirmohet nga Bordi, më 17 qershor 2019. Vlerësimi i dytë në 2019 tregoi se të gjitha kërkesat tregojnë përmirësim të performancës krahasuar me vlerësimin e parë, me përjashtim të tërësisë së mbledhjes së të ardhurave (# 4.1), e cila u përkeqësua. Objektivi afatgjatë është të arrihet të “Zbulimi i Pronarit Përfitues” deri në vitin 2020.

Shqipëria është pjesë e MONEYVAL, mekanizmi i përhershëm rajonal i monitorimit, që vlerëson pajtueshmërinë dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit (Task-Forca e Veprimit Financiar - standardet FATF). Mangësitë strategjike të sistemit shqiptar, të theksuara në raundin e 5-të të Raportit të Vlerësimit të Ndërsjellë, aktivizuan procesin e listimit të FATF-së, duke e vënë Shqipërinë në një periudhë vëzhgimi njëvjeçare. Më 17 qershor 2019, Parlamenti miratoi një “paketë MONEYVAL” për të adresuar pjesën teknike të rekomandimeve, duke përfshirë ndryshime në katër ligje ekzistuese (procedurat tatimore, regjistrimi i biznesit, financimi i terrorizmit, parandalimi i pastrimit të parave/financimi i terrorizmit) dhe miratimin e një ligji të ri mbi administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Ndër ndryshimet kryesore të bëra janë: detyrimi për bizneset dhe OJF-të që të hapin një llogari bankare, transparenca e përmirësuar në pronarin përfitues të shoqërive tregtare, transpozimi më i shpejtë i sanksioneve të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së,

për ngrirjen e pasurive terroriste, dhe kompetencat e zgjeruara të agjencisë përgjegjëse të pasurive të konfiskuara. Pavarësisht progresit në disa zona, plenarja e MONEYVAL-it vlerësoi progresin e përgjithshëm në zbatimin e rekomandimeve si të pamjaftueshëm dhe Shqipëria u fut në listën gri të FATF-së, në shkurt 2020.

Shqipëria nënshkroi Konventën për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet Tatimore; është anëtare e kornizës gjithëpërfshirëse për BEPS-në; dhe anëtare e forumit global për shkëmbimin e informacionit sipas kërkesës, gjerësisht në përputhje sipas raundit të parë të vlerësimit. Raundi tjetër i vlerësimit është planifikuar për në vitin 2020.

Në tërësi, është plotësuar kërkesa e pranueshmërisë për transparencën dhe mbikëqyrjen buxhetore.

b) Objektivat:

Objektivi i përgjithshëm është të kontribuojë në një sektor publik më të aftë dhe më reagues ndaj nevojave të qytetarëve dhe bizneseve, si edhe të avancojë dhe t'u përgjigjet kërkesave që shtrën procesi i integritetit në BE.

Objektivi specifik është të përmirësohet administrata publike që të bëhet me efikase, llogaridhënëse, transparente, përfshirëse dhe efektive në nivel qendror dhe vendor.

c) Rezultatet e pritshme:

Rezultatet e pritshme janë:

- Përmirësimi i mobilizimit të të ardhurave të brendshme;
- Përmirësimi i kapaciteteve fiskale të njërive të qeverisjes vendore;
- Forcimi i kontroleve mbi alokimet;
- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Përmirësimi i menaxhimit të investimeve publike;
- Rritje e integritetit të institucioneve publike;
- Përmirësim i transparencës dhe aksesit në informacion për qytetarët;
- Përmirësim i kuadrit rregullator dhe kapaciteteve në qeverisjen vendore;
- Përmirësim i dhënies së shërbimit për qytetarët.

d) Aktivitetet kryesore të mbështetjes buxhetore:



Aktivitetet kryesore për të zbatuar paketën e mbështetjes buxhetore janë dialogu i politikave, transfertat financiare, vlerësimi i performancës, raportimi dhe zhvillimi i kapaciteteve:

- angazhimi në dialog lidhur me kushtet dhe prioritetet e reformave të qeverisë, verifikimi i kushteve, objektivave dhe pagimi i mbështetjes buxhetore;

- transferimi i 26 milionë euro vendit përfitues gjatë viteve fiskale 2020, 2021, 2022 dhe 2023, me disbursimet e transheve fikse dhe variabël;

- mbështetje për përforcimin e kapaciteteve institucione të Qeverisë për të zbatuar reformën në Administratën Publike dhe strategjitë që lidhen me të;

- forcimi i koordinimit të donatorëve dhe politikave përmes ndërtimit të kapaciteteve për qeverisje të mirë dhe administrim publik për nivelin qendror dhe vendor, përmes mbështetjes buxhetore si edhe asistencës teknike;

- monitorimi dhe vlerësimi për të ndjekur zbatimin e reformës në administratën publike dhe reformat e tjera që lidhen me të;

- monitorimi periodik i kriterëve të pranueshmërisë të mbështetjes buxhetore.

e) Veprimet plotësuese:

Kjo pjesë e veprimit është pjesërisht vazhdim i Programit të Reformës Sektoriale nën IPA 2014 për të mbështetur reformimin e Menaxhimit të Financave Publike, IPA 2015 për Reformën në Administratën Publike dhe IPA 2016 Mbështetje për luftën kundër korrupsionit. Synon avancimin e reformave në fushat e reformës në administratën publike, menaxhimin e financave publike, si dhe reformat që lidhen me qeverisjen e mirë deri në luftën kundër korrupsionit dhe decentralizimin dhe Shqipërinë Digjitale.

Menaxhimi indirekt me subjekt të besuar

Një pjesë e këtij veprimi mund të zbatohet në menaxhimin indirekt me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP). Ky zbatim përfshin mbështetje të mëtejshme për agjendën e decentralizimit, që do të kontribuojë në arritjen e këtij rezultati të pritshëm: bashki më të forta dhe shërbime të përmirësuara me ofrim të standardizuar të shërbimeve publike.

Kjo pjesë e veprimit është vazhdim i ndërhyrjes IPA 2015, të quajtur Mbështetje për Reformën Territoriale dhe Administrative. UNDP-ja është zgjedhur duke përdorur kriteret e

mëposhtme: i. përvoja dhe funksioni i subjektit për mbështetjen e reformës së decentralizimit; ii. vazhdimësia; ii. ekspertiza teknike, kapacitetet logjistike e menaxhuese, sidomos në nivel vendor; iii. avantazhi krahasues për shkak të sinergjive me aktivitete të tjera në Shqipëri në të cilat subjekti është i përfshirë; iv. ndikimi, rezultatet, efekt i bashkëpunimit me donatorë të tjerë (pasi subjekti ka menaxhuar këtë mekanizëm të partneritetit multidonorë në mbështetje të procesit të decentralizimit që nga viti 2013).

Në rast se subjekti i parashikuar duhet të zëvendësohet, shërbimet e Komisionit mund të zgjedhin një subjekt zëvendësuar duke përdorur të njëjtat kriteret.

Nëse negociatat me subjektin e besuar më lart dështojnë, ajo pjesë e këtij e veprimi mund të zbatohet me menaxhim direkt, në pajtim me modalitetet e zbatimit të përcaktuara në seksionin më poshtë në kontestën e granteve me menaxhim direkt.

Menaxhimi direkt (përqasja e projektit)

Prokurimi

Prokurimi do të kontribuojë në rezultatet më poshtë⁶:

- Përmirësim në hartimin e politikave për qeverisjen e mirë dhe zbatimin e tyre, përfshirë planifikimin e integruar dhe efikas, buxhetin dhe koordinimin e politikave;

- Përmirësim të kapaciteteve të institucioneve buxhetore që të zbatojnë politikën e kontrollit të brendshëm financiar publik;

- Përmirësim të kapaciteteve të bashkive lidhur me qeverisjen sipas standardeve të BE-së dhe ofrimin e shërbimeve publike;

- Përmirësim të pjesëmarrjes publike, shtrirjes së konsultimit publik dhe mekanizmave në nivel kombëtar dhe vendor;

- Përmirësim të transparencës dhe llogaridhënies për zbatimin e reformave përmes institucioneve të pavarura;

- Monitorim të pavarur të kriterëve të pranueshmërisë për mbështetje buxhetore;

- Rritje të vizibilitetit, ndërgjegjësimit dhe pranimit të reformave për qeverisjen e mirë;

⁶ Këto rezultate lidhen me objektivin specifik të përmirësimit të administratës publike që të bëhet më efikase, llogaridhënëse, transparente, përfshirëse dhe efektive në nivel kombëtar dhe vendor.



- Përmirësim të ofrimit të shërbimeve publike të standardizuara në nivel vendor.

Linja buxhetore totale e rezervuar për prokurim është 7 100 000 euro.

Grantet

a) Qëllimet e Grantit:

Granti do të kontribuojë në arritjen e rezultateve të pritshme më poshtë: forcim të bashkive dhe përmirësim të shërbimeve me ofrim të standardizuar të shërbimeve publike. Grantmarrësi do të menaxhojë mbështetjen për bashkitë në formën e nëngranteve.

Thirrja për propozime u shpall më 13 shtator 2019, me një klauzolë pezulluese para miratimit të këtij vendimi. Fillimi i thirrjes për propozime para miratimit të vendimit siguron që asistencë teknike për komunitetet vendore të vihet në dispozicion paraprakisht, ose maksimumi kur mbështetja buxhetore vihet në dispozicion. Kështu, ndërtimi i kapaciteteve për thithjen e fondeve të BE-së mund të fillojë pa vonesa të mëtejshme;

b) Lloji i Aplikantëve të synuar: Që të kualifikohet për një grant, aplikanti duhet të jetë organizatë joqeveritare dhe/ose shoqatë kompetente e autoriteteve nënkombëtare

(rajonale ose vendore), organ publik, ose organ përkatës i mandatuar nga një departament shtetëror i një Shteti Anëtar të BE-së;

c) Dhënia direkt e grantit: N/A;

d) Përfundim nga mos-prapaveprueshmëria e kostove: N/A.

Linja buxhetore e rezervuar për grantet është 2 500 000 euro.

4. Pranueshmëria gjeografike për prokurimin dhe grantet

Pranueshmëria gjeografike, për sa i përket vendit të themelimit, me qëllim pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve, si edhe origjinës së furnizimeve të blera, zbatohet sipas rregullave në aktin bazë dhe në dokumentet kontraktuale përkatëse. Gjithashtu, sipas nenit 10(2) të rregullores (BE) nr. 236/2014, zyrtari përgjegjës autorizues i Komisionit mund të zgjerojë pranueshmërinë gjeografike në raste urgjente apo mungese të produkteve dhe shërbimeve në tregjet e vendeve përkatëse, ose në raste të tjera të argumentuara siç duhet, në të cilat rregullat e pranueshmërisë do ta bënë realizimin e këtij veprimi të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë.

Veprimi 2	Mbështetja e BE-së për pjesëmarrjen në Programet e saj	1 500 000 euro
------------------	---	-----------------------

1. Përshkrimi i veprimit, objektivi, rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

- Përshkrimi i veprimit dhe objektivave

Objektivi i përgjithshëm është: i. të rrisë aftësinë e Shqipërisë që të marrë pjesë efektivisht në BE si anëtare e plotë në të ardhmen; dhe ii. të lidhë ngushtë aktorët e shoqërisë, ekonomisë dhe institucioneve shqiptare me zbatimin e politikave të BE-së në një mënyrë që lehtëson procesin e aderimit të Shqipërisë.

Objektivat specifikë janë: i. të rritë numrin e programeve dhe agjencive të BE-së ku Shqipëria merr pjesë efektivisht; dhe ii. të rritë kapacitetet e Shqipërisë për të marrë pjesë me sukses në Programet dhe Agjencitë e BE-së, si mjet për të promovuar shkëmbimet me Shtetet Anëtare të BE-së, shpërndarjen brenda vendit të njohurive dhe praktikave të mira përkatëse, dhe përafrimin

e mëtejshëm të Shqipërisë me politikat dhe metodat e punës së Bashkimit Evropian.

- Rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

Rezultatet e pritshme të këtij veprimi janë:

- Reduktohen kostot për buxhetin shqiptar dhe rrjedhimisht rritet mbështetja për pjesëmarrjen e aktorëve të interesuar të shoqërisë, ekonomisë dhe institucioneve shqiptare në Programet dhe Agjencitë e BE-së;

- Rritet ekspozimi dhe përvoja e përfituesve shqiptarë në Programet e BE-së.

Treguesit kyç të performancës:

- Numri i programeve për të cilat është lidhur Marrëveshje Ndërkombëtare;

- Numri i kërkesave për pjesëmarrje në Programet e ndryshme të BE-së;

- Numri i kërkesave të suksesshme për pjesëmarrje në Programet e ndryshme të BE-së.

2. Supozimet dhe kushtet



Kushtet e veprimit janë:

Shqipëria duhet të sigurojë jo vetëm bashkëfinancim, por edhe fondet e nevojshme për pagesën e biletës totale të hyrjes, para se të marrë rimbursimin e pjesshëm nga IPA II. Rimbursimi do të paguhet si grant për Fondin Kombëtar Shqiptar.

Zbatimi nga Koordinatori Kombëtar IPA (KKIPA), i një plani veprimi për pjesëmarrjen e ardhshme të Shqipërisë në programet e BE-së, vazhdon të jetë baza për një politikë që shfrytëzon plotësisht programet e ndryshme të BE-së. Kjo politikë duhet të sigurojë veçanërisht koordinimin e duhur midis të gjithë aktorëve institucionalë shqiptarë të përfshirë. Gjithashtu, duhet të garantohet publiciteti i nevojshëm për të tërhequr akademikët, përfaqësuesit e ministrive dhe bashkitë dhe sektorin privat (veçanërisht NVM-të). Ministrinë e linjës dhe agjencitë duhet të programojnë burimet e duhura buxhetore për të garantuar që Pikat Kombëtare të Kontaktit të marrin pjesë në Takimet e Programit/Ditët e Informimit jashtë Shqipërisë.

KKIPA-ja do të monitorojë periodikisht normat e pjesëmarrjes dhe do të raportojë mbi to në kuadrin e komiteteve të monitorimit IPA, si dhe mbi tendencat e bashkëfinancimit dhe mbi mënyrën se si zbatimi i programit ka integruar dimensionet e përfshirjes gjinore dhe sociale (pakicat, personat me aftësi të kufizuara, etj.). KKIPA-ja do të garantojë që të dhënat e ndara sipas gjinisë të mbledhen periodikisht nga përfituesit përfundimtarë për sa i përket pjesëmarrjes në secilin program të BE-së.

Njësia përkatëse menaxhuese e programit do të jetë përgjegjëse për monitorimin e aktiviteteve të vizibilitetit. Zyra KKIPA do të sigurojë që institucioni kombëtar, që merr pjesë në programin përkatës të BE-së, të vendosë kontakte të drejtpërdrejta me Delegacionin e BE-së në mënyrë që të planifikojnë dhe të zbatojnë së bashku veprimet e vizibilitetit, lidhur me zbatimin e programit përkatës të BE-së.

Mosrespektimi i kërkesave më lart mund të rezultojë në rikuperimin e fondeve nga ky

program dhe/ose rialokimin e tyre në financime të ardhshme.

3. Modalitetet e zbatimit

3. a) Menaxhimi indirekt me Shqipërinë

Ky veprim do të zbatohet me menaxhim indirekt me Shqipërinë e cila do të jetë përgjegjëse për realizimin e të gjitha detyrave, lidhur me zbatimin e veprimit. Kjo zgjidhje që është përdorur edhe në programet e veprimit për Shqipërinë në IPA 2014, 2015, 2016 dhe 2018, paraqet avantazhin e harmonizimit të kontributit të BE-së me kontributin kombëtar. Kjo bazohet në përvojën e mëparshme për të garantuar pagimin e biletave të hyrjes.

Strukturat Operuese përgjegjëse për zbatimin e veprimeve janë Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (Zyra e Koordinatorit Kombëtar IPA) dhe Ministrinë (përfshirë agjencitë përkatëse) që përfitojnë nga pjesëmarrja në Programet dhe Agjencitë e BE-së (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Ministria e Kulturës).

Zbatimi konsiston në pagimin nga Fondi Kombëtar i pjesës së kontributit financiar IPA për programet.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në programet e BE-së, përfshirë pagimin e biletës së hyrjes/tarifave të pjesëmarrjes, duhet të respektojë kushtet dhe kriteret e përcaktuara për secilin Program në Marrëveshjen Ndërkombëtare përkatëse. Do të mbahen parasysh normat e bashkëfinancimit nga pjesëmarrja e mëparshme, e cila do të ulet me kalimin e viteve në terma realë ose relativë në raport me parimin e rritjes së autorësisë dhe përgjegjësisë për fondet IPA nga ana e Shqipërisë.

4. Pranueshmëria gjeografike për prokurimin dhe grantet

Pranueshmëria gjeografike për sa i përket vendit të themelimit, me qëllim pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve, si edhe origjinës së furnizimeve të blera zbatohet sipas rregullave në aktin bazë dhe në dokumentet kontraktuale përkatëse

Veprimi 3	Instrumenti i Integritimit në BE	8 300 000 euro
-----------	----------------------------------	----------------



1. Përshkrimi i veprimit, objektivi, rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

- Përshkrimi i veprimit dhe objektive

Objektivi i përgjithshëm i këtij veprimi është të rrisë aftësinë e Shqipërisë që të përmbushë kriteret e *Kopenhagenit* dhe të fillojë bisedimet e anëtarësimit në BE, duke iu referuar veçanërisht RAP-it dhe aspekteve të Qeverisjes (objektiv i përgjithshëm i ndërmjetëm), si dhe të rritë nivelin e gatishmërisë së Shqipërisë për anëtarësim të plotë në BE (objektiv i përgjithshëm afatgjatë).

Objektivat specifike janë: së pari, të rritë efektivitetin e zbatimit të reformave të Shqipërisë që lidhen me aderimin në BE, përfshirë fushat e trajnimit gjyqësor dhe praktikave, të drejtat e njeriut, shëndetin publik, eficiencën e energjisë, shkencën dhe kërkimin shkencor; së dyti, të përmirësojë programimin dhe zbatimin e veprimeve IPA, veçanërisht nëpërmjet miratimit të praktikave për matjen e performancës.

Më konkretisht, instrumenti i integritetit në BE do të ofrojë:

1. Ndërtim institucional për harmonizimin me *acquis* të BE-së dhe forcim të aftësisë për të përmbushur kriteret politike dhe ekonomike:

- Avokati i Popullit: mbështetje për Avokatin e Popullit dhe promovim të të drejtave të njeriut në Shqipëri;

- Instituti i Shëndetit Publik (nën Ministrinë e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale): mbështetje për të përmirësuar organizimin dhe qeverisjen e institutit, për të forcuar kapacitetet e tij për mbledhjen e të dhënave, analizave epidemiologjike dhe monitorimin, si edhe për të përmirësuar reagimin ndaj emergjencave në rastin e sëmundjeve të transmetueshme dhe kërcënimeve ndërshtetërore;

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI, nën të njëjtën Ministri): mbështetje për kapacitetet e Ministrisë dhe AKKSHI-t që të reformojnë ekosistemin e kërkimit shkencor në Shqipëri në pajtim me kërkesat e *acquis* për shkencën dhe kërkimin shkencor;

- Agjencia për Eficiencën e Energjisë nën Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë lidhur me eficiencën e energjisë.

2. Ndërtim kapacitetesh për nëpunësit civile të Administratës Publike (nga të cilët të paktën 30% dhe mundësisht 50% femra), përfshirë

trajnimet/stazhet në administratat e Shteteve Anëtare të BE-së dhe skemat e bursave (qelizat rinore).

3. Mbështetje për Avokaturën e Shtetit që të sjellë praktikat gjyqësore në pajtim me praktikat më të mira të BE-së dhe standardet për të drejtat e njeriut, zbatimin e KEDNJ-së dhe dispozitave të Kartës së BE-së, dhe trajnimin për përgatitjen e çështjeve dhe arbitrazhin (përfshirë shkëmbimet mes kolegësh/studentësh, trajnimet dhe vizitat studimore të justifikuara, sipas rastit).

4. Mbështetje për Shkollën e Magjistraturës përmes shkëmbimeve të personelit akademik dhe studentëve.

5. Instrumenti që mbështet sipas nevojës: a) programimin/përgatitjen dhe zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e veprimeve IPA nën menaxhim direkt dhe indirekt, përfshirë aspektet e komunikimit dhe vizibilitetit, me vëmendje të veçantë për promovimin e praktikave të matjes së performancës⁷; mbështetje për veprimet e nevojshme për të zhvilluar dhe zbatuar reformat, strategjitë dhe planet e veprimit, përfshirë fushat e mbështetura nga kontratat e performancës së reformës sektoriale (SRPC); hartimin e studimeve përgatitore; sigurimin e furnizimeve për të plotësuar nevojat materiale të identifikuar në raportet dhe dokumentet përkatëse lidhur me integrimin në BE; b) përgatitjen e dokumenteve dhe studimeve të lidhura me anëtarësimin në BE, për të plotësuar nevojat e identifikuar në raportet lidhur me anëtarësimin në BE, përfshirë raportet vjetore të vendeve, konkluzionet e Komitetit të MSA-së, Strategjinë e Zgjerimit dhe tekstet përkatëse.

- Rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

Rezultatet (produktet) e pritshme të veprimit janë:

1. Personeli i institucioneve përkatëse trajnohet plotësisht se si të ushtrojnë detyrat e tyre (rezultati i korrespondon Aktivitetit 1).

2. Trajnimet dhe stazhet realizohen, skema e bursave zbatohet (rezultati i korrespondon Aktivitetit 2).

⁷ Siç rekomandohet në udhëzimet e DG NEAR për lidhjen e Planifikimit/Programimit, Monitorimit dhe Vlerësimit.



3. Personeli i Avokaturës së Shtetit trajnohet plotësisht se si të ushtrojnë detyrat e tyre (rezultati i korrespondon Aktivitetit 3).

4. Shkëmbimet e personelit akademik dhe studentëve realizohen (rezultati i korrespondon Aktivitetit 4).

5. Grupet e synuara trajnohen, dokumentet dhe studimet hartohen, si dhe furnizimet e ofruara (rezultati i korrespondon Aktivitetit 5).

Treguesit kyç të performancës:

- Përqindja e Zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian;

- Dorëzimi i një raporti vjetor për zbatimin e IPA II ku treguesit përdoren sistematikisht, me të gjitha të dhënat e disponueshme (edhe për veprime të tjera nga Kontratat e Reformave Sektoriale).

2. Supozimet dhe kushtet

Edhe pse nuk parashikohen risqe madhore, lidhur me zbatimin e këtij Veprimi, një sërë supozimesh duhet të mbahen parasysh:

- Angazhimi i vazhdueshëm i autoriteteve shqiptare në procesin e aderimit në BE;

- Zbatimi i strategjisë ndërsektoriale RAP dhe i programeve të reformave për MFP-në; dhe

- Zhvillimi dhe hartimi i dokumenteve të politikave dhe programeve lidhur me procesin e reformave për aderim në BE.

Këto kushte duhet të zbatohen: KKIPA-ja kërket të disponojë burime adekuate njerëzore dhe financiare që të realizojë detyrat e veta sipas standardit të kërkuar me masë të lartë proaktiviteti. Kjo verifikohet në kontekstin e monitorimit periodik të aktiviteteve të projektit. Sa u përket veprimeve me menaxhim indirekt me Shqipërinë, Zyra Mbështetëse e ZKA-së dhe Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit duhet të kenë burime të mjaftueshme që të realizojnë detyrat e tyre siç përcaktohen në Marrëveshjen Kuadër IPA II.

Mosrespektimi i këtyre kërkesave mund të çojë në kthim të parave nën këtë program ose/dhe në rialokim për fondet e ardhshme.

3. Modalitetet e zbatimit

3. a) Menaxhimi indirekt me Shqipërinë

Një pjesë e këtij veprimi do të zbatohet me menaxhim indirekt me Shqipërinë (Menaxhim Indirekt me Vendin Përfutues) që do të jetë përgjegjëse për realizimin e të gjitha detyrave lidhur me zbatimin e veprimit.

Strukturat Operuese përgjegjëse për zbatimin e veprimeve janë: a) Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit (NjQFK); b) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në rolin e Koordinatorit Kombëtar IPA; dhe c) Avokati i Popullit, Instituti i Shëndetit Publik (nën Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale), Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI nën të njëjtën Ministri), Agjencia për Eficiencën e Energjisë (nën Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë), administratat që kanë lidhje me aktivitetin “Ndërtimi i kapaciteteve për nëpunësit civilë” dhe Avokatura e Shtetit, të cilët do të jenë përfutuesit kryesorë të aktiviteteve 1, 2 dhe 3. Këto aktivitete do të kontribuojnë përkatësisht në rezultatet 1, 2 dhe 3.

Vendi përfutues është përgjegjës për kontraktimin, zbatimin, informimin dhe vizibilitetin, monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve IPA II, si edhe për vlerësimin e tyre kurdo që duhet, në pajtim me parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar, me qëllim që të garantohet ligjshmëria dhe rregullsia e shpenzimeve të bëra për zbatimin e programit. Ky zbatim përfshin shpalljen e katër apo më shumë procedurave për kontrata binjakëzimi apo binjakëzimi të lehtë nga ana e Njesisë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit (NjQFK) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

3. b) Menaxhimi direkt (qasja e projektit)

Prokurimi

Prokurimi do të kontribuojë në rezultatin 5.

Linja buxhetore totale e rezervuar për prokurimin është 4 850 000 euro.

Granti (binjakëzimi)

a) Qëllimi i grantit: Të rritë efektivitetin e zbatimit të reformave të Shqipërisë që lidhen me aderimin në BE, sidomos në fushën e trajnimit gjyqësor, duke kontribuar kështu në rezultatin 4;

b) Lloji i aplikantëve të synuar: Administratat e Shteteve Anëtare të BE-së ose organet e mandatuar prej tyre.

Linja buxhetore totale e rezervuar për grantet është 1 000 000 euro.

Pranueshmëria gjeografike për prokurimin dhe grantet

Pranueshmëria gjeografike për sa i përket vendit të themelimit, me qëllim pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve, si



edhe origjinës së furnizimeve të blera zbatohet sipas rregullave në aktin bazë dhe në dokumentet kontraktuale përkatëse. Sipas nenit 10(2), të rregullores (BE) nr. 236/2014, zyrtari përgjegjës autorizues i Komisionit mund të zgjerojë pranueshmërinë gjeografike në raste urgjente apo mungese të produkteve dhe shërbimeve në tregjet e

vendëve përkatëse, ose në raste të tjera të argumentuara siç duhet në të cilat rregullat e pranueshmërisë do ta bënë realizimin e këtij veprimi të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë.

Sektori	Shteti i së Drejtës dhe të Drejtat Themelore	19 400 000 euro
Veprimi 4	BE-ja për Shtetin e së Drejtës	5 000 000 euro

1. Përshkrimi i veprimit, objektivi, rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

- Përshkrimi i veprimit dhe objektivave

Objektivi i përgjithshëm është të kontribuojë në forcimin e shtetit të së drejtës.

Objektivat specifikë janë: i. forcimi i kapaciteteve të Policisë së Shtetit (PSH), Prokurorisë së Përgjithshme (PP), Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit (SPAK) dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe agjencive përkatëse që të ofrojnë besim, siguri dhe mjedis të sigurt për qytetarët shqiptarë; dhe ii. të përmirësojë kapacitetet e institucioneve të pavarura të drejtësisë.

- Rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

Rezultatet (produktet) e pritshme të veprimit janë:

1. Përmirësohet performanca dhe kapacitetet e hetimit, procedimit dhe vendimeve përfundimtare nga SPAK-u, BKH-ja, PSH-ja, PP-ja dhe gjykatave, si edhe organeve të tjera ligjzbatuese, autoriteteve mbikëqyrëse dhe subjekteve raportuese;

2. Përmirësohen kapacitetet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) që të zbatojnë praktikën dhe rregullat standarde, në përputhje me standardet e BE-së dhe praktikën më të larta lidhur me zhvillimin e karrierës, efikasitetin, menaxhimin e gjykatave, pavarësinë e gjyqtarëve dhe inspektimit.

Treguesit kyç të performancës:

- Numri i hetimeve, aktakuzave dhe dënimeve përfundimtare bazuar në përdorimin e mjeteve për hetime proaktive bazuar në informacion sekret (inteligjencë), lidhur me krimin e organizuar, trafikun e drogës dhe korrupsionin, procedimet dhe dënimet përfundimtare;

- Numri i emërimeve, ngritjeve në detyrë dhe vlerësimeve të realizuara në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira të BE-së;

- Numri i hetimeve të realizuara me konkluzione përfundimtare.

2. Supozimet dhe kushtet

Supozimet për këtë veprim janë: i. stabiliteti politik dhe ekonomik i Shqipërisë dhe rajonit qëndron në të njëjtin nivel; ii. sigurohet financim i mjaftueshëm kombëtar për agjencitë ligjzbatuese, prokurorët dhe reformën në drejtësi; iii. krijohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Byroja Kombëtare; iv. sigurohet bashkëpunim dhe koordinim efektiv ndërmjet të gjitha institucioneve përkatëse në Shqipëri; dhe v. numri i inspektorëve rritet mbi bazën e procedurës së re të rekrutimit.

Kushtet e veprimit janë:

Komisioni Drejtues i Sektorit të Drejtësisë dhe Komisioni Drejtues i Sektorit të Punëve të Brendshme realizojnë të paktën dy takime për zbatimin e reformave sektoriale dhe sfidat kyçe dhe finalizojnë konkluzionet operacionale përkatëse në vitin 2020.

Vendet vakante në Sektorët e Koordinimit IPA në Ministrinë e Brendshme plotësohen në momentin e fillimit të projektit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe policia e Shtetit do të ngrenë kapacitetet TI duke plotësuar të gjitha vendet vakante para fillimit të projektit.

Secili institucion përfitues cakton një person përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e veprimeve pasi nënshkruhet Marrëveshja e Financimit dhe ofron ambiente pune të mjaftueshme për zbatimin e veprimit.

Mosrespektimi i kërkesave më lart mund të rezultojë në rikuperimin e fondeve nga ky program



dhe/ose rialokimin e tyre në financime të ardhshme.

3. Modalitetet e zbatimit

3. a) Menaxhim indirekt me organizatën e një Shteti Anëtar, agjenci e një vendi donator si palë e tretë, ose organizatë ndërkombëtare

Ky veprim mund të zbatohet me menaxhim indirekt me një subjekt që përzgjidhet nga shërbimet e Komisionit në bazë të këtyre kriterëve: i. mandati i subjektit të besuar që mbulon natyrën e veprimit; ii. përvoja e subjektit potencial në veçanti në kontekstin e Bashkimit Evropian, si dhe në Shqipëri apo në Ballkanin Perëndimor; iii. kapacitet operacionale/ekspertiza teknike, si edhe kapacitetet logjistike e menaxhuese; iv. ndikimi, rezultatet, efekti 'levë' i bashkëpunimit me subjekte/donatorë të tjerë, që mbulon edhe efektivitetin e delegimit të detyrave, të përfshira në Shqipëri apo në Ballkanin Perëndimor; v. kosto të reduktuara transaksionesh; vi. transparenca dhe mungesa e konfliktit të interesit; dhe viii. preferohet (jo kriter i detyrueshëm): kapaciteti i subjektit për bashkëfinancim të mundshëm.

Zbatimi nga subjekti(et) do të kontribuojë në arritjen e rezultatit 1 dhe rezultatit 2.

Në rast se subjekti i parashikuar duhet të zëvendësohet, shërbimet e Komisionit mund të zgjedhin një subjekt zëvendësues duke përdorur të njëjtat kriterë.

Nëse negociatat me subjektin e besuar më lart dështojnë, ajo pjesë e këtij veprimi mund të

zbatohet me menaxhim direkt, në pajtim me modalitetet e zbatimit të përcaktuara në seksionin (3)(b).

3. b) Menaxhimi direkt (përqasja e projektit)

Prokurimi:

Siç përmendet më lart, nëse në menaxhimin indirekt negociatat me subjektin(et) më lart dështojnë, veprimi mund të zbatohet me menaxhim direkt dhe prokurimi mund të përdoret potencialisht për një linjë buxhetore deri në 5 000 000 euro.

4. Pranueshmëria gjeografike për prokurimin dhe grantet

Pranueshmëria gjeografike për sa i përket vendit të themelimit me qëllim pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve, si edhe origjinës së furnizimeve të blera zbatohet sipas rregullave në aktin bazë dhe në dokumentet kontraktuale përkatëse.

Gjithashtu, sipas nenit 10(2), të rregullores (BE) nr. 236/2014, zyrtari përgjegjës autorizues i Komisionit mund të zgjerojë pranueshmërinë gjeografike në raste urgjente apo mungese të produkteve dhe shërbimeve në tregjet e vendeve përkatëse, ose në raste të tjera të argumentuara siç duhet, në të cilat rregullat e pranueshmërisë do ta bënë realizimin e këtij veprimi të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë.

Veprimi 5	BE-ja për të Drejtat e Pronës	5 700 000 euro
-----------	-------------------------------	----------------

1. Përshkrimi i veprimit, objektivi, rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

- Përshkrimi i veprimit dhe objektive

Objektivi i përgjithshëm është të kontribuojë në forcimin e mbrojtjes së të drejtës së pronës në Shqipëri dhe kapaciteteve të Shqipërisë që të garantojë në praktikë të drejtën e pronësisë, si një nga të drejtat themelore të njeriut, përmes një sistemi të rregulluar dhe të harmonizuar të pasurive të paluajtshme, i cili ofron tituj pronësie të qartë dhe të sigurt për të gjithë.

Objektivi specifik është zhvillimi i një tregu dinamik të tokës përmes ngritjes së një kuadri të qartë për të drejta e pronës në Shqipëri.

- Rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

Rezultatet e pritshme të këtij veprimi janë:

1. Sistemi Qendror i Menaxhimit të Integruar të Tokës ideohet dhe zhvillohet duke mundësuar procedura pune të rimodeluara.

2. Cilësia e të dhënave përmirësohet: të drejtat hapësinore dhe ligjore të pronës dhe të dhënat e menaxhimit të tokës korrigjohen, përditësohen dhe bëhen publike.

3. Kuadri institucional i reformuar bëhet funksional.

4. Të dhënat (hapësinore dhe ligjore) për të drejtat e pronës dhe menaxhimin e tokës



digjitalizohen dhe përditësohen vetëm në mënyrë digjitale.

Treguesit kyç të performancës:

- Numri i bazave të të dhënave për tokën dhe pronën që harmonizohen dhe integrohen në një sistem qendror;

- Numri i njësive shtetërore që kanë akses në Sistemin Qendror të Informacionit të Integruar për Tokën;

- Përqindja e parcelave me të dhëna të pasakta lidhur me të drejtat e pronës;

- Të dhënat e korrigjuara mund të gjenden përmes gjeoportalit kombëtar;

- Finalizohet kalimi në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës nga 3 institucionet pararendëse;

- Numri i zyrtarëve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që trajnohen;

- Numri i ditëve që nevojitet për përpunimin e regjistrimit të pronës;

- Njësia specifike për finalizimin e regjistrimeve fillestare sipas metodologjive të projektit bëhet funksionale dhe ndërton kapacitetet e veta;

- Numri i zonave kadastrale ku të dhënat janë plotësisht të digjitalizuara (skanim dhe gjeoreferencë).

2. Supozimet dhe kushtet

Supozimet për këtë veprim janë: i. Qeveria shqiptare vijon angazhimin në reformën e të drejtave të pronësisë; ii. Qeveria miraton ndryshimet institucionale të planifikuara; iii. institutet pjesëmarrëse angazhohen plotësisht në proceset e menaxhimit të ndryshimit; iv. institutet janë të disponueshëm për përpunimin/zbatimin e ndryshimeve dhe për trajnimet; v. të gjitha njësitë shtetërore përkatëse miratojnë procesin e unifikimit të procesit dhe mbështesin hapat e integritetit të sistemeve; vi. të gjitha njësitë shtetërore përkatëse miratojnë procesin e digjitalizimit/skanimit dhe mbështesin hapat e integritetit; vii. miratohen instrumentet e ekzekutimit ligjor për mirëmbajtje ekskluzive digjitale; viii. metodologjitë dhe teknologjitë pranohen dhe miratohen nga institutet pjesëmarrëse; dhe ix. procesi i korrigjimit të të dhënave miratohet plotësisht nga niveli qendror dhe vendor.

Kushtet e veprimit janë që Qeveria shqiptare:

- realizon angazhimin për të përmbushur detyrimet e veta në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe konventave deri në fund të zbatimit të projektit;

- në fillim të zbatimit të projektit, të angazhohet të sigurojë infrastrukturën, mjediset dhe personelin pjesëmarrës të nevojshëm për zbatimin e projektit;

- gjatë të gjithë zbatimit siguron një kanal komunikimi të përhershëm dhe të qartë, si edhe strukturë vendimmarrjeje për çështjet e projektit; dhe siguron që komunikimi dhe përgjigjja e vendimmarrjes të jenë në kohën e duhur, pa vonesa;

- siguron që ndryshimet e nevojshme në legjislacionin përkatës (përfshirë aktet nënligjore, sipas rastit) të hartohen dhe kur është nevoja të rishikohen për të mundësuar zbatimin e anës teknike të reformës, p.sh.: ekzekutimin për përdorimin e bazës qendrore të të dhënave, vetëm për përditësimet digjitale për mirëmbajtjen e të dhënave juridike dhe hapësimore, duke pasur parasysh, sipas rastit, opinionet dhe rekomandimet e dhëna nga organizatat ndërkombëtare përkatëse;

- angazhohet plotësisht që të hartojë metodologji dhe procedura sipas standardeve ndërkombëtare dhe siguron zbatimin e kërkuar;

- harton një plan kundër korrupsionit në fushën e të drejtave të pronës gjatë dy viteve të para të zbatimit;

- konfirmon një mekanizëm për konsultim dhe vlerësim të legjislacionit (përfshirë aktet nënligjore) në fushën e pronësisë (plus të gjithë rekrutimin ligjor për të) para se të fillojë zbatimin e programit;

- finalizon strukturimin e nevojshëm bazë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (personeli, baza ligjore, ambientet, pikat e kontaktit, etj.) para se të fillojë zbatimin e programit; dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës emëron një Drejtues Programi të përhershëm, me tagra vendimmarrëse, për zbatimin e mbështetjes dhe bashkëpunon me Delegacionin e BE-së dhe me ekipin mbështetës për të drejtat e pronësisë.

Mosrespektimi i kërkesave më lart mund të rezultojë në rikuperimin e fondeve nga ky program dhe/ose rialokimin e tyre në financime të ardhshme.

3. Modalitetet e zbatimit

3. a) Menaxhim direkt (qasja e projektit)

Prokurimi:

Prokurimi do të kontribuojë në arritjen e të gjitha rezultateve të pritshme të veprimit siç përshkruhen më lart.

Linja buxhetore totale e rezervuar për prokurim është 5 700 000 euro.



Si pjesë e kushteve të zbatimit, Qeveria shqiptare do të ofrojë si më poshtë: i. mjedisin teknik, përfshirë serverin qendror dhe infrastrukturën TI të përdoruesit fundor (përfshirë harduerë dhe softuerë të operimit), rrjetin e komunikimit (me shpejtësi të mjaftueshme të intranet, internet); ii. pajisje zyre të nevojshme; iii. hapësira për zyra që i nevojiten projektit (p.sh.: për pajisjet dhe ekipet e projektit të skanimit dhe digjitalizimit); iv. mirëmbajtje afatgjatë për bazën e të dhënave dhe sistemin informatik të integruar për token pas mbylljes së asistencës.

4. Pranueshmëria gjeografike për prokurimin dhe grantet

Pranueshmëria gjeografike për sa i përket vendit të themelimit, me qëllim pjesëmarrjen në

procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve, si edhe origjinës së furnizimeve të blera zbatohet sipas rregullave në aktin bazë dhe në dokumentet kontraktuale përkatëse.

Gjithashtu, sipas nenit 10(2), të rregullores (BE) nr. 236/2014, zyrtari përgjegjës autorizues i Komisionit mund të zgjerojë pranueshmërinë gjeografike në raste urgjente apo mungese të produkteve dhe shërbimeve në tregjet e vendeve përkatëse, ose në raste të tjera të argumentuara siç duhet, në të cilat rregullat e pranueshmërisë do ta bënë realizimin e këtij veprimi të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë.

Veprimi 6	Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM): Mbështetje për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri – Faza II	8 700 000 euro
-----------	---	----------------

1. Përshkrimi i Veprimit, objektivat, rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

- Përshkrimi i veprimit dhe objektivate

Objektivi i përgjithshëm është harmonizimi i sistemit shqiptar të drejtësisë me *acquis* të BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Objektivi specifik i veprimit (rezultati) është i trefishtë: rritja e cilësisë profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve; reduktimi i ndikimit të krimit të organizuar, politikës dhe korrupsionit në dhënien e drejtësisë; si dhe rritja e integritetit dhe llogaridhënies së institucioneve të gjyqësorit.

- Rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

Rezultatet e pritshme të veprimit janë:

- Organet e vettingut monitorohen siç duhet dhe në kohë nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM), që të zbatojnë procesin e rivlerësimit.

Treguesi kyç i performancës:

- Gjyqtarët dhe prokurorët shqiptarë që janë vetuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

2. Supozimet dhe kushtet

Supozimet për këtë veprim janë:

- Projekti nuk pengohet nga zhvillime të jashtme (p.sh. kriza ekonomike ose shoqërore) dhe Shqipëria po mbështet financiarisht

institucionet e Vettingut;

- Organet ndihmëse bashkëpunojnë me vullnet me organet e vettingut dhe ONM-në, si edhe japin informacion faktik dhe të vërtetë, si dhe në kohën e duhur;

- Plotësimi i personelit ndërkombëtar dhe vendas (përfshirë drejtuesin e ekipit) dhe vënia e tyre në funksion (d.m.th. ambiente pune të mjaftueshme) gjatë të gjithë ciklit të projektit.

Kushti i veprimit është që grupet e interesit të vazhdojnë të ofrojnë bashkëpunim me ONM-në, Faza II, për zbulimin e informacionit, si edhe hapësira pune të mjaftueshme për zbatimin e veprimit.

3. Modalitetet e zbatimit

3. a) Menaxhim indirekt me organizatën e një Shteti Anëtar, agjenci e një vendi donator si palë e tretë, ose organizatë ndërkombëtare

Ky veprim mund të zbatohet me menaxhim indirekt me Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA), për të vazhduar zbatimin e projektit të ONM-së të financuar nga Programi Vjetor i Veprimit 2018 për Shqipërinë, pa shkaktuar një përçarje të madhe të operacionit. Përmes aktiviteteve të saj të shumta në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor, me përvojën në bashkëpunimin e deleguar me BE-në dhe zbatimin aktual të mbështetjes për ONM-në,



ADA ka fituar ekspertizë shumë të fortë për këtë operacion specifik. Natyra e veprimit, forcimi i funksionit të vetingut, justifikon nevojën që organi i një Shteti Anëtar të BE-së të marrë autorësinë, si një aspekt i rëndësishëm i këtij misioni specifik. Ky zbatim përfshin ofrimin e mbështetjes për Operacionin e pavarur Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM). Rezultati i pritshëm është që rivlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të rritet nga ONM-ja. Treguesi kryesor i performancës do të masë numrin e çështjeve të rivlerësuara dhe të monitoruara nga ONM-ja.

Subjekti është zgjedhur në bazë të këtyre kritereve:

i. Përvoja dhe ekspertiza solide e ADA-s në të gjithë botën në sektorin e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut dhe migracionit (një nga 7 sektorët ku ADA është e angazhuar); ii. menaxhimi dhe kapaciteti financiar i fortë (përfshirë alokimin e bashkëfinancimit të konsiderueshëm për këtë projekt); iii. ekspertiza e fortë në menaxhimin e kontratave të mëdha duke përfshirë kontratat e financuara nga BE-ja; iv. përvoja e fortë në qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut dhe dialogun e politikave; v. përvoja e gjatë në Shqipëri (ku ADA është e pranishme që prej 27 vjetësh); vi. përvoja e fortë në Shqipëri në fushën e përgjithshme të çështjeve të qeverisë dhe shoqërisë civile, vii. kapaciteti për të

gjeneruar ndikim të fortë, rezultate, efekt përforcues nga bashkëpunimi me subjekte/donatorë/partnerë zbatues përfshirë vendet anëtare të BE-së; dhe viii. kostot e reduktuara për transaksionet, pasi përzgjedhja e ADA-s mundëson mbajtjen e personelit që është aktualisht i punësuar në bazë të kontratës së grantit me Ministrinë Austriake të Drejtësisë, nën Veprimin 4 të Programit Vjetor të Veprimit të IPA 2016 (Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit në mbështetje të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve; IPA/2016/038-717), duke garantuar kështu vazhdimësinë dhe rrjedhimisht autorësinë e Shteteve Anëtare të BE-së në Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit.

Nëse negociatat me subjektin e besuar më lart dështojnë, ajo pjesë e këtij e veprimi mund të zbatohet me menaxhim direkt, në pajtim me modalitetet e zbatimit të përcaktuara në seksionin (3)(b).

3. b) Menaxhimi direkt (qasja e projektit) Prokurimi:

Siç përmendet më lart, nëse në menaxhimin indirekt negociatat me subjektin(et) më lart dështojnë, veprimi mund të zbatohet me menaxhim direkt dhe prokurimi mund të përdoret potencialisht për një linjë buxhetore deri në 8 700 000 euro.

Sektori	Konkurrueshmëria, Novacioni, Bujqësia Dhe Zhvillimi Rural	26 000 000 euro
Veprimi 7	BE-ja për Rimëkëmbjen Ekonomike	26 000 000 euro

1. Përshkrimi i veprimit, objektivi, rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

- Përshkrimi i veprimit dhe objektive

Objektivi i përgjithshëm është zbutja e pasojave ekonomike dhe sociale të pandemisë COVID-19 në Shqipëri.

Objektivi specifik është të sigurohet: 1. Reduktimi i efekteve makroekonomike dhe përçarjeve në ekonomi; si dhe 2. Forcimi i qëndrueshmërisë së bizneseve dhe 'rrjetës së sigurisë' për të papunët në planin afatshkurtër deri afatgjatë.

- Rezultatet e pritshme dhe treguesit kyç të performancës

Rezultatet e pritshme të veprimit janë:

1. Efektet makroekonomike dhe përçarjet në ekonomi reduktohen.

1.1Ekonomia informale/*cash*-i reduktohet.

1.2Mobilizimi i të ardhurave të brendshme rritet.

2. Qëndrueshmëria e bizneseve dhe 'rrjeta e sigurisë' për të papunët forcohen në planin afatshkurtër deri afatgjatë.

2.1Miratohet Programi i Tregut Aktiv të Punës në mbështetje të të vetëpunësuarve dhe të papunëve.

2.2Bizneset mbështeten me likuiditet/akses në financim.

Treguesit kyç të performancës:

- Të ardhurat si % të PBB-së;

- Konsumi privat si % e PBB-së;



- Investimet private/publike si % e PBB-së;
- Shkalla e papunësisë;
- Numri i bizneseve aktive.

2. Supozimet dhe kushtet

Supozimet për veprimin janë:

- S'ka paketa të tjera reforme gjatë 202;
- Finalizimi i strategjisë për të ardhurat

afatmesme (SAA) me qëllim parashikueshmërinë e politikave tatimore;

- Publikimi i detyrimeve shtetërore ekzistuese, të reja dhe të shlyera nga qeverisja qendrore dhe vendore, në kohë brenda tremujorit pasues;

S'ka kushte për këtë veprim (veç kushteve të përgjithshme për disbursimin e të gjitha transheve).

3. Modalitetet e zbatimit

3. a) Menaxhimi direkt përmes Mbështetjes Buxhetore

a) Pranueshmëria për mbështetje buxhetore

Politika Publike

Politikat që nxiten nga ky program mbështetjeje buxhetore shprehen si në paketën e qeverisë shqiptare për përballimin e COVID-19, ashtu edhe në rekomandimet e politikave të Programit të Reformës Ekonomike. Në kuadrin e reformës strukturore “Mjedisi i biznesit dhe reduktimi i ekonomisë informale”, Qeveria është e angazhuar për të përmirësuar financimin e NMVM-ve (masa nr. 9 e reformës), e cila nga ana tjetër do të rrisë kontributin e tyre në rritjen ekonomike dhe për të promovuar përdorimin intensiv të instrumenteve paguese pa *cash*, që të reduktohet ekonomia informale (masa nr. 10 e reformës). Analiza dhe dialogu i politikave do të përfshijnë veprime dhe reforma për të mundësuar mjedisin e biznesit përtej përgjigjes afatshkurtër ndaj COVID-19, në mbështetje të arritjes së objektivave specifike. Një pjesë tjetër e rëndësishme e kuadrit të politikave është paketa e asistencës makrofinanciare (AMF) prej 3 miliardë euro⁸, nga BE-ja për 10 vendet e zgjerimit dhe fqinjësisë, për t'i ndihmuar në kufizimin e pasojave ekonomike të pandemisë COVID-19. Alokimi i miratuar i huas 180 milionë euro për Shqipërinë. Mbështetja buxhetore e BE-së për rimëkëmbjen ekonomike lidhet me AMF-në pasi përforcon fushat e përzgjedhura përmes

treguesve plotësues dhe shkon përtej afatit të MFA-së.

Shqipëria ka treguar përkushtim për vlerat themelore. Sidoqoftë, çështjet më poshtë kërkojnë dialog dhe monitorim periodik: reforma në sistemin e drejtësisë, reforma zgjedhore dhe reforma në administratën publike.

Politika makroekonomike

Shih seksionin për pranueshmërinë e mbështetjes buxhetore për Veprimin 1;

Menaxhimi financiar publik

Po aty.

Transparenca buxhetore dhe mbikëqyrja e buxhetit

Po aty.

b) Objektivat

Objektivat specifike janë: i. reduktimi i efekteve makroekonomike dhe përçarjeve në ekonomi; dhe ii. forcimi i qëndrueshmërisë së bizneseve dhe ‘rrjetës së sigurisë’ për personat e papunë në planin afatshkurtër deri afatgjatë.

c) Rezultatet e pritshme

Rezultatet e pritshme janë:

- Reduktimi i ekonomisë informale/*cash*-it;
- Rritja e mobilizimit të të ardhurave të brendshme;
- Miratimi i Programit për Tregun Aktiv të Punës që mbështet të vetëpunësuarit dhe të papunët;
- Bizneset mbështeten me likuiditet/akses në financim.

d) Aktivitetet kryesore të mbështetjes buxhetore

Aktivitetet kryesore për të zbatuar paketën e mbështetjes buxhetore janë dialogu i politikave, transfertat financiare, vlerësimi i performancës, raportimi dhe zhvillimi i kapaciteteve:

- Angazhimi në dialog lidhur me kushtet dhe prioritetet e reformave të qeverisë, verifikimi i kushteve, objektivave dhe pagimi i mbështetjes buxhetore;

- Transferimi i 26 milionë euro vendit përfitues, gjatë viteve fiskale 2020 dhe 2021, me disbursimet e transheve fikse dhe variabël;

- Monitorim periodik i kritereve të pranueshmërisë për mbështetjen buxhetore.

⁸ Vendimi (BE) 2020/701, i Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 maj 2020, për dhënien e asistencës financiare për partnerët e zgjerimit dhe fqinjësisë në kontekstin e pandemisë COVID-19.



3. Buxheti

3.1 TABELA INDIKATIVE E BUXHETIT – PROGRAMI VJETOR I VEPRIMIT PËR SHQIPËRINË PËR 2020

		Menaxhimi indirekt		Menaxhimi direkt	Kontributi total i BE-së (euro)	Kontributi i Përfituesit IPA-II ose një tjetër pale të tretë (euro)	Totali (euro)
		me përfituesin IPA II	me subjektin e besuar				
		Kontributi i BE-së (euro)	Kontributi i BE-së (euro)	Kontributi i BE-së (euro)			
Objektivi 1	01. Demokracia dhe qeverisja	3 950 000	2 500 000	51 450 000	57 900 000	1 121 991	59 021 991
	Veprimi 1: BE-ja për Qeverisjen e Mirë	0	2 500 000	45 600 000	48 100 000	194 444	48 294 444
	Veprimi 2: Mbështetja e BE-së për pjesëmarrje në Programet dhe Agjencitë e BE-së	1 500 000	0	0	1 500 000	927 547	2 427 547
	Veprimi 3: Instrumenti i Integrimit në BE	2 450 000	0	5 850 000	8 300 000	0	8 300 000
	02. Shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore	0	13 700 000	5 700 000	19 400 000	1 000 000	20 400 000
	Veprimi 4: BE-ja për Shtetin e Së Drejtës	0	5 000 000	0	5 000 000	0	5 000 000
	Veprimi 5: BE-ja për të Drejtat e Pronësisë	0	0	5 700 000	5 700 000	0	5 700 000
	Veprimi 6: Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM): Mbështetje për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri – Faza II	0	8 700 000	0	8 700 000	1 000 000	9 700 000
Objektivi 2	06. Konkurrueshmëria dhe novacioni	0	0	26 000 000	26 000 000	0	26 000 000
	Veprimi 7: BE-ja për Rimëkëmbjen Ekonomike	0	0	26 000 000	26 000 000	0	26 000 000
TOTALI		3 950 000	16 200 000	83 150 000	103 300 000	2 121 991	105 421 991



4. Modalitetet e monitorimit të performancës

Si pjesë e kuadrit për matjen e performancës, Komisioni monitoron dhe vlerëson progresin drejt arritjes së objektivave specifike të përcaktuara në Rregulloren IPA II, mbi bazën e treguesve të matshëm, të paracaktuar, të qartë dhe transparentë. Raportet e progresit, të specifikuar në nenin 4, të Rregullores IPA II, merren si pikë referimi në vlerësimin e rezultateve të asistencës IPA II.

Komisioni do të mbledhë të dhëna për performancën (procesi, treguesit e produkteve dhe rezultateve) nga të gjitha burimet, të cilat do të agregohen dhe do të analizohen për të ndjekur progresit e bërë përkundër objektivave dhe synimeve për secilin veprim të këtij programi, si dhe për Dokumentin Indikativ të Strategjisë.

Në kontekstin specifik të menaxhimit indirekt nga përfituesit e IPA II, Koordinatorët Kombëtarë të IPA-s (KKIPA) do të mbledhin informacion mbi realizimin e veprimeve dhe programeve (procesi, treguesit e produkteve dhe rezultate) dhe do të koordinojnë mbledhjen dhe përgatitjen e treguesve që merren nga burime kombëtare.

Progresi i përgjithshëm monitorohet me mjetet e mëposhtme: a) Sistemi i Monitorimit të Orientuar nga Rezultatet (ROM); b) Monitorimi i vetë përfituesve të IPA II; c) vetëmonitorimi i kryer nga Delegacionet e BE-së; d) monitorimi i përbashkët nga Komisioni Evropian (DG NEAR) dhe Përfituesit IPA II, ku pajtueshmëria, koherenca, efektiviteti, efikasiteti dhe koordinimi, në zbatimin e asistencës financiare, do të monitorohen periodikisht nga një Komitet Monitorimi IPA II, me mbështetjen e Komiteteve të Monitorimit Sektoriale, të cilët do të sigurojnë proces monitorimi në nivel sektori.

5. Vlerësimi

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e veprimit, vlerësimet përfundimtare dhe/ose *ex-post*-et për këtë veprim ose komponentët e tij do të kryhen përmes konsulentëve të pavarur të kontraktuar prej Komisionit.

Një vlerësim përfundimtar dhe/ose *ex-post* do të kryhet për qëllime llogaridhënieje dhe mësimi në nivele të ndryshme (përfshirë rishikimin e politikave), duke marrë parasysh veçanërisht zbatimin e mbështetjes buxhetore për përfshirjen sociale dhe zbatimin e mbështetjes për ekonomi qarkulluese.

Komisioni informon partnerin zbatues të paktën një muaj para për datat e parashikuara për misionet vlerësuese. Partneri zbatues bashkëpunon në mënyrë efikase dhe efektive me ekspertët e vlerësimit, dhe ndër të tjera u siguron atyre të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si dhe akses në mjediset dhe aktivitetet e projektit.

Raportet e vlerësimit i vihen në dispozicion përfituesit IPA II dhe grupeve të interesit. Partneri zbatues dhe Komisioni analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, sipas rastit, në marrëveshje me përfituesin e IPA II, të vendosin së bashku për veprimet vijuese që të ndërmerren dhe çdo modifikim të nevojshëm, duke përfshirë edhe riorientimin e projektit, nëse është e nevojshme.

INSTRUMENTI PËR ASISTENCËN E PARAANËTARËSIMIT (IPA II) 2014–2020

SHTOJCA IA MBËSHTETJA BUXHETORE E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT TË PROGRAMIT VJETOR TË VEPRIMIT PËR SHQIPËRINË, PËR VITIN 2020, SHQIPËRIA BE-ja PËR QEVERISJEN E MIRË

PËRMBLEDHJA E VEPRIMIT

Objekti i përgjithshëm është të kontribuojë për ta bërë sektorin publik më të aftë dhe më reagues ndaj nevojave të qytetarëve dhe bizneseve, si edhe të avancojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të proceseve të integritetit në BE. Gjithashtu, synon të përmirësojë administratën publike që të bëhet më efikase, llogaridhënie, transparente, gjithëpërfshirëse dhe efektive në nivel kombëtar dhe vendor. Rezultatet kyçe përfshijnë përmirësimin e mobilizimit të të ardhurave të brendshme, kapaciteteve të njësive të qeverisjes vendore, buxhetimit dhe koordinimit; forcimit të kontrollit të angazhimeve financiare dhe reduktimit të detyrimeve ndaj bizneseve, përmirësimin të menaxhimit të burimeve njerëzore, forcimit të menaxhimit të investimeve publike, rritjes së integritetit të institucioneve publike, rritjes së transparencës dhe aksesit në informacion për qytetarët, dhe përmirësimin të cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.



MARRËVESHJA E FINANCIMIT IPA II – SHTOJCA II “BE-ja PËR QEVERISJEN E MIRË”

Identifikimi i Veprimit			
Titulli i Programit të Veprimit	Programi i Veprimit Vjetor për Shqipërinë për vitin 2020		
Titulli i Veprimit	BE-ja për Qeverisjen e Mirë		
Identifikimi i Veprimit	IPA 2020/042-914.01/AL/BE për Qeverisjen e Mirë		
Informacion Sektorial			
Sektori IPA II	Demokracia dhe Qeverisja e Mirë		
Sektor DAC	15110 Politika e sektorit publik menaxhimi administrativ		
Buxheti			
Kostoja totale	48 294 444 euro		
Kontributi i BE-së	48 100 000 euro		
Menaxhimi dhe Zbatimi			
Metoda e zbatimit	Menaxhim Direkt (Mbështetje Buxhetore Sektoriale, aktivitete plotësuese) dhe/ose indirekt (për aktivitetet plotësuese).		
Menaxhim direkt: Delegacioni i BE-së	Delegacioni i BE-së në Shqipëri		
Menaxhim indirekt: Autoritet kombëtar ose tjetër organ zbatues	Organizatë Ndërkombëtare ose agjenci e një Shteti Anëtar		
Përgjegjësitë e zbatimit	Kryeministria; Departamenti i Administratës Publike; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Brendshme dhe Bashkitë e Shqipërisë.		
Vendndodhja			
Zona që përfiton nga Veprimi	Shqipëria.		
Afati			
Afati për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit me përfituesin IPA II	Jo më vonë se 31 dhjetor 2021.		
Afati për lidhjen e marrëveshjeve të delegimit me menaxhim indirekt	Jo më vonë se 31 dhjetor 2021.		
Afati për lidhjen e marrëveshjeve të prokurimit dhe grantit	3 vjet pas datës së lidhjes së Marrëveshjes së Financimit, përveç rasteve të renditura në nenin 189(2) të Rregullores Financiare.		
Afati për zbatimin operacional	6 vjet pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit.		
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit (data kur ky program duhet të mbyllet)	12 vjet pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit.		
Objektivat e politikave/treguesit (formulari DAC)			
Objekti i përgjithshëm i politikave	I pasynuar	Objektiv i rëndësishëm	Objektiv kryesor
Zhvillimi i pjesëmarrjes/qeverisja e mirë	☐	☐	☒
Ndihma ndaj mjedisit	☒	☐	☐
Barazia gjinore (përfshirë Gratë në Zhvillim)	☐	☒	☐
Zhvillimi i tregtisë	☒	☐	☐
Shëndeti riprodhues, amësor, i të sapolindurve e fëmijëve	☒	☐	☐
Treguesit e Konventës së RIO-s	I pasynuar	Objektiv i rëndësishëm	Objektiv kryesor
Diversiteti biologjik	☒	☐	☐
Lufta ndaj shkretimit	☒	☐	☐
Zbutja e ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
Treguesit e brendshëm			
Migrimi	☒	☐	☐
Përballimi i COVID-it	☒	☐	☐



LISTA E SHKURTIMEVE

AK	Antikorrupsion/Lufta kundër Korrupsionit
ADISA	Ajencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara në Shqipëri
AFM IS	Sistemi Shqiptar i Menaxhimit të Informacionit Financiar
DG NEAR	Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit
DAP	Departamenti i Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
HRMIS	Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti i Paraanëtarësimit
GMIP	Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave
SIPI	Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar
ISP	Dokumenti Indikativ i Strategjisë
TI	Teknologjia e Informacionit
TKP	Tregues Kyç i Performancës
QV	Qeverisja Vendore
NjQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
KKIPA	Koordinatori Kombëtar i IPA-s
KDI	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
SKZhI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
IBH	Indeksi i Buxhetit të Hapur
RAP	Reforma në Administratën Publike
PEFA	Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënia Financiare
MFP	Menaxhimi Financiar Publik
KBFP	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
PPP	Partneritet Publik-Privat
SIGMA	Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

1. Përshkrimi i veprimit

1.1 Objektivat/rezultatet

Objektivi i përgjithshëm është të kontribuojë për ta bërë sektorin publik më të aftë dhe më reagues ndaj nevojave të qytetarëve dhe bizneseve, si edhe të avancojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të proceseve të integritetit në BE. **Ndikimi** do të matet përmes efektivitetit të qeverisë, barrës së rregullimit shtetëror dhe cilësisë rregullore.

Objektivi specifik është të përmirësojë administratën publike që të bëhet më efikase, llogaridhënëse, transparente, gjithëpërfshirëse dhe efektive në nivel kombëtar dhe vendor. Kjo listë indikative me treguesit e **rezultateve** përfshin: paanshmërinë dhe efikasitetin e procedurave administrative; transparencën; konsultimin publik; mbikëqyrjen buxhetore; ofrimin e shërbimeve me

në qendër qytetarin; si edhe aksesueshmërinë në shërbimet publike.

Treguesit indikativë për të matur **rezultatet e induktuara** përfshijnë: raportin taksa/PBB; të ardhurat vendore; stoku i detyrimeve të prapambetura; niveli i automatizimit për gjenerimin e listëpagesave/borderove nga sistemi informatik i menaxhimit të burimeve njerëzore (HRMIS) dhe pagimin e pagave; niveli i aplikimit për procedurat e menaxhimit të investimeve publike; numri i institucioneve që zbatojnë plane vendore antikorrupsioni dhe integriteti; numri i institucioneve që zbatojnë programet e transparencës; harmonizimi i kuadrit rregullator sektorial me funksionet e qeverisjes vendore; numri i shërbimeve elektronike dhe shkalla e kënaqësisë së përdoruesve. Treguesit indikativë për të matur



rezultatet direkte përmes mbështetjes plotësuese përfshijnë një sërë ministrish linje që mbështeten gjatë hartimit dhe monitorimit të politikave dhe strategjive; numri i ministrive të linjës dhe bashkive që mbështeten për të përmirësuar kontrollin e brendshëm financiar publik (KBFP); numri i bashkive dhe shërbimeve me ofrim të standardizuar të shërbimeve publike; pikëzimi i indeksit të buxhetit të hapur (IBH) për konsultimin publik; numri i diskutimeve/aktiviteteve të zhvilluara nga/me institucionet e pavarura; numri i vlerësimeve të pavarura të zbatimit të reformës; si edhe ndërgjegjësimi dhe shkalla e pranimit që kanë grupet e interesit, të brendshme dhe të jashtme.

1.2 Aktivitetet kryesore

1.2.1 Mbështetja buxhetore

Në **nivelin e inputeve**, ndërhyrja fokusohet në këto aspekte:

- Transferimi i transheve fikse dhe variabël përkundër kushteve dhe objektivave sipas shtojcave 1 dhe 2.

- Dialogu periodik për politikën, me qëllim forcimin e zbatimit të reformave në mënyrë gjithëpërfshirëse, llogaridhënëse, transparente, efikase dhe efektive.

- Fokusi në forcimin e koordinimit sektorial, monitorimit sektorial, raportimit dhe vlerësimit.

- Asistenca teknike në mbështetje të zbatimit të reformave, duke përmirësuar ofrimin e shërbimeve në nivel vendor, duke forcuar komunikimin dhe ndërgjegjësimin, monitorimin periodik, si dhe shqyrtimin e përputhshmërisë së progresit të reformave.

- Granti(et) në mbështetje të ofrimit të shërbimeve në nivel vendor.

1.2.2 Mbështetja plotësuese

Asistenca plotësuese parashikohet të përfshijë: i. ndërtim kapacitesh për planifikim politikash, buxhetim, monitorim dhe vlerësim zbatimi, si edhe mbështetje për institucionet e pavarura që të përmirësojnë transparencën dhe mbikëqyrjen; përmirësim të qeverisjes pjesëmarrëse dhe dialogut qytetar lidhur me konsultimin publik dhe zbatimin e reformave; mbështetje për menaxhimin e granteve të parashikuara për bashkitë; ii. monitorim të pavarur të mbështetjes buxhetore përmes misioneve të shqyrtimit të përputhshmërisë; auditin dhe vlerësimin; iii. komunikimin dhe vizibilitetin për të rritur ndërgjegjësimin e grupeve të interesit të brendshme dhe të jashtme - dhe për të synuar

mesazhet e politikave në fushat e qeverisjes së mirë në nivel qendror dhe vendor; iv. grantin(et) për një organizatë joqeveritare, shoqatë kompetente e autoriteteve rajonale, organ publik apo organ i mandatuara nga një departament qeveritar i një Shteti Anëtar të BE-së. Përfituesi i grantit do të menaxhojë mbështetjen për bashkitë në formën e nëngranteve në fushat si p.sh.: krijimi i vendeve të punës dhe zhvillimi ekonomik vendor, rinia, arsimi, shëndeti, furnizimi me ujë dhe infrastruktura vendore bazë; dhe v. UNDP-së do t'i besohet zbatimi i mëtejshëm i mbështetjes për Reformën Administrativo-Territoriale si vazhdimësi e angazhimit nën IPA 2015. Kjo do të synojë forcimin e bashkive dhe përmirësimin e shërbimeve përmes ofrimit të standardizuar të shërbimeve publike.

Rezultatet e pritshme të mbështetjes/asistencës plotësuese përfshijnë përforcimin e formulimit dhe zbatimit të politikave duke ndjekur parimet e qeverisjes së mirë. Kjo do të përfshijë planifikim të integruar dhe efikas, buxhetim dhe koordinim të politikave; përmirësim të kapaciteteve të institucioneve buxhetore në zbatimin e kontrollit të brendshëm financiar publik; përmirësim të kapaciteteve të bashkive, lidhur me qeverisjen sipas standardeve të BE-së dhe ofrimin e shërbimeve publike; përmirësim të pjesëmarrjes publike dhe shtrirjes dhe mekanizmave të konsultimit publik në nivel qendror dhe vendor; përmirësim të transparencës dhe llogaridhënies për zbatimin e reformave përmes institucioneve të pavarura; monitorim të pavarur të kriterëve për përfitimin e mbështetjes buxhetore; rritje të vizibilitetit, ndërgjegjësimit dhe pranimit të reformave të qeverisjes së mirë, si edhe rritje e ofrimit të shërbimeve publike të standardizuara në nivel vendor.

1.3 Logjika e ndërhyrjes

Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë reforma ambicioze për të përmirësuar Qeverisjen e Mirë, duke trajtuar një gamë të gjerë problematikash të ndërlikuara, në fusha si: Reforma në Administratën Publike (RAP), Menaxhimi Financiar Publik (MFP), Lufta Kundër Korrupsionit (AK), decentralizimi dhe digjitalizimi. Këto strategji sektoriale dhe plane veprimi u rishikuan dhe u zgjeruan deri në vitin 2022, me përjashtim të strategjisë së digjitalizimit e cila pret miratimin. Mësimet e nxjerra nga programet e mbështetjes



buxhetore për MFP-në, RAP-in dhe AK-n, të gjitha këto pranë përfundimit, hapën rrugën për masat ndjekëse për të forcuar më tej zbatimin e reformave. Mbështetja për këtë sektor është veçanërisht e rëndësishme, pasi masat imediate të përballimit të tërmetit në nëntor 2019 dhe pandemisë globale COVID-19 devijuan vëmendjen nga reformat, çka pritet të rezultojë në vonesa dhe/ose ndryshim të rezultateve në të ardhmen e afërt.

Ndërhyrja mbështet trajtimin e këtyre çështjeve kyçe: i. Shqipëria duhet të përmirësojë mobilizimin e të ardhurave të brendshme, me qëllim që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve publike dhe të reduktojë raportin e borxhit publik ndaj PBB-së, siç parashikohet në rregullat fiskale. Objektivat për realizimin e të ardhurave dhe masat përkatëse pritet të përcaktohen në një strategji afatmesme për të ardhurat; ii. Kapacitetet fiskale të njëjësive të qeverisjes vendore (NjQV) duhet të përmirësohen që të zbatojnë plotësisht Ligjin për Financat Vendore (2017), që parashikon rritje të financimeve për bashkitë në mënyrë që të përmbushin funksionet e shtuara të NjQV-ve. Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore, si edhe konsideratat buxhetore për taksat e ndara do të rritin jo vetëm hapësirën fiskale, por edhe autonominë fiskale të NjQV-ve dhe kjo rrjedhimisht do të shkojë direkt në dobi të qytetarëve, sepse mundëson rritje të ofrimit të shërbimeve dhe investimeve sipas diskrecionit të NjQV-ve në konsultim me qytetarët e tyre; iii. Rishfaqja e detyrimeve të prapambetura është simptomë e planifikimit të dobët dhe kontrollit joefektiv të alokimeve, të cilat duhet të forcohen paralelisht me llogaridhënien e Zyrtarëve Autorizues. Problematika e përsëritur me detyrimet e prapambetura të rimbursimit të TVSH-së (tatimi mbi vlerën e shtuar) minon klimën e biznesit dhe besimin te qeveria; iv. Menaxhimi i burimeve njerëzore duhet të përmirësohet me synimin që të ndërtohet një menaxhim transparent, i drejtë dhe më efikas i shërbimit civil, duke kontribuar në një administratë publike më profesionale dhe të depolitizuar. Panorama e qartë e numrit, pozicioneve dhe borderove të nëpunësve civilë është jo vetëm themeli i një administrate publike moderne, por edhe pikënisja për luftën kundër korrupsionit dhe për një MFP të shëndoshë; v. Menaxhimi i investimeve publike duhet të forcohet me qëllim që të kapërcehet fragmentimi ekzistues i

vendimmarrjes, integrimi *ad hoc* i projekteve që nuk janë në linjë me strategjitë sektoriale të miratuara, numri i lartë i propozimeve të pakërkuara për partneritete publik-privat (PPP) dhe kapacitetet monitoruese të kufizuara të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE). Për më tepër, përmirësimi i vlerësimit të risqeve para nënshkrimit të kontratave dhe monitorimi më pas i PPP-ve do të mbështetë kosto-efektivitetin, por do të lejojë edhe zbutje më të mirë të risqeve; vi. Integriteti i institucioneve publike mund të rritet përmes planeve të integritetit, të cilat përbëjnë kuadrin konceptual për politikën dhe masat që synojnë të parandalojnë shkeljen e integritetit nga zyrtarët publikë dhe të monitorojnë efektin e masave të zbatuara në institucionet publike. Planet e integritetit mund të përfshijnë fusha specifike të cenueshme nga korrupsioni, etikën dhe integritetin personal, si edhe një instrument për vlerësimin e riskut. Si institucionet publike edhe bashkitë do të hartojnë planet e integritetit bazuar në udhëzimet që po përgatiten nga Ministria e Drejtësisë; vii. Transparenca dhe aksesimi në informacion duhet të përmirësohen. Dy herë në vit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron programet e transparencës së institucioneve, informacionin e parashikuar në Ligjin për Të Drejtën e Informimit dhe që regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve të jenë të përditësuar. Është përgatitur një regjistër qendror për kërkesat dhe përgjigjet, në mënyrë që të harmonizohet mbledhja e ankesave. Kjo do të garantojë efikasitetin e Komisionerit dhe do të përmirësojë transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike; viii. Kuadri rregullator dhe kapacitetet e qeverisjes vendore mund të përmirësohen duke zbatuar të ashtuquajturën “matricë të kompetencave”, një udhërrëfyes për secilin sektor, me rekomandime për të trajtuar boshllëqet dhe mbivendosjet e identifikuar. Kjo matricë bazohet në një shqyrtim tërësor të legjislacionit (me mbështetjen e BE-së), lidhur me rolin e tre niveleve të qeverisë në zbatimin e funksioneve specifike të NjQV-ve; ix. Një nga funksionet kryesore të Shtetit është që si administrata qendrore shtetërore ashtu edhe NjQV-të të ofrojnë shërbime cilësore dhe në kohë për qytetarët dhe bizneset. Në përpjekje për të ulur korrupsionin dhe për të përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien, një numër në rritje i këtyre shërbimeve do të ofrohen në mënyrë

elektronike dhe/ose të standardizuar nga zyrat pritëse në mbarë vendin.

Për sa u përket inputeve, transferimi i fondeve të mbështetjes buxhetore do t'i mundësojnë qeverisë të përmirësojë kapacitetet financiare për zbatimin e strategjive në fushën e qeverisjes së mirë. Dialogu periodik i politikave dhe fokusi në përmirësimin e koordinimit sektorial do të kontribuojnë, ndër të tjera, në përmirësimin e ndjekjes së zbatimit të politikave dhe në përmirësimin e monitorimit, raportimit dhe vlerësimit sektorial. Asistenca teknike mbështet zbatimin e reformave, përmirëson ofrimin e shërbimeve në nivel vendor, forcon komunikimin dhe ndërgjegjësimin, nxit monitorimin periodik dhe mundëson shqyrtime përputhshmërie të pavarura të progresit të reformave. Komponenti i grantit mbështet ofrimin e shërbimeve dhe forcon qeverisjen e mirë në nivel vendor.

Për sa u përket rezultateve, pritët që rezultatet direkte dhe të induktuara të mbështesin administratën publike që të bëhet më efikase, llogaridhënëse, transparente, gjithëpërfshirëse dhe efektive në nivel qendror dhe vendor. Ndikimi pritët të përmirësojë pikëzimin për efektivitetin e qeverisë, barrën e rregullimit shtetëror dhe cilësinë e rregullatore.

2. Zbatimi

2.1 Arsytimi për fondet e alokuara si mbështetje buxhetore

Fondet e alokuara për komponentin 'mbështetja buxhetore' janë **36 milionë euro** dhe për mbështetjen plotësuese janë **12 milionë euro**. Këto shuma bazohen në kombinimin e këtyre kritereve: a) kostimi i strategjive; b) hendeku i financimit; c) niveli i vlerësuar i financimit kombëtar që është mjaftueshëm nxitës për të mbështetur reformat; dhe d) mësimet e nxjerra nga programet e mëparshme dhe aktuale në fushën e qeverisjes së mirë.

2.2 Kriteret për disbursimin e mbështetjes buxhetore

a) Kushtet e përgjithshme për disbursimin e të gjitha transheve janë si vijon:

- Progresi i kënaqshëm në zbatimin e Strategjisë së Reformës në Administratën Publike dhe vijimësia e besueshmërisë dhe relevancës së saj;

- Ruajtja e një politike makroekonomike të besueshme, relevante dhe të orientuar drejt

stabilitetit, ose progresi i bërë drejt rivendosjes së balancave kyçe;

- Progresi i kënaqshëm në zbatimin e reformave për përmirësimin e menaxhimit financiar publik, përfshirë mobilizimin e të ardhurave të brendshme, si edhe vijimin e relevancës dhe besueshmërisë së programit të reformave;

- Progresi i kënaqshëm në ofrimin për publikun të informacionit buxhetor të shëndoshë, tërësor dhe në kohë.

b) Kushti specifik që duhet të plotësohet para disbursimit të transhit fiks të parë është miratimi i strategjive sektoriale dhe planeve të veprimit të paktën deri në vitin 2022 për RAP-in, MFP-në, Antikorrupsionin, Agjendën Digjitale dhe Decentralizimin.

Objektivat dhe treguesit e performancës që zbatohen për disbursimet vlejné për të gjithë kohëzgjatjen e programit. Megjithatë, në rrethana të justifikuara siç duhet, nëpërmjet Koordinatorit Kombëtar IPA (KKIPA), Zv. Kryeministri mund t'i dorëzojë Komisionit një kërkesë për ndryshimin e objektivave dhe treguesve. Ndryshimet e miratuara për këto objektivat dhe tregues mund të autorizohen me shkëmbim letrash mes dy palëve.

Në rast përkeqësimi thelbësor të vlerave bazë, disbursimet e mbështetjes buxhetore mund të pezullohen formalisht, të pezullohen përkohësisht, të reduktohen ose të anulohen, sipas dispozitave përkatëse të marrëveshjes së financimit.

2.3 Detajet e mbështetjes buxhetore

Shuma e mbështetjes buxhetore (36 milionë euro) ndahet në një trans fiks (5 milionë euro) sapo të nënshkruhet marrëveshja e financimit dhe në një transh variabël (8 milionë euro) në vitin 1, si edhe dy transhe fikse të barabarta në vitet 2 dhe 3 (nga 2 milionë euro) dhe një pjesë variabël (9.5 milionë euro).

Mbështetja buxhetore është mbështetje direkte e pasynuar që i jepet Thesarit kombëtar. Transferat në euro mund të depozitohen në euro ose të disbursohen në lek. Disbursimet në lek do të bëhen sipas kursit të këmbimit që përcaktojnë dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së Financimit. Pas marrjes së pagesës, MFE-ja duhet të dorëzojë evidenca dokumentare që konfirmojnë regjistrimin e fondeve në llogarinë e thesarit kombëtar dhe kursin e këmbimit, sipas rastit.



2.4 Struktura organizative dhe përgjegjësitë

Funksioni kryesor i Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) për qeverisjen e mirë dhe administratën publike është të orientojë dhe të koordinojë institucionet e përfshira në këtë sektor. GMIP-ja synon të garantojë vendimmarrje të informuar për politikën, bashkëpunim dhe përdorim të një kuadri bazuar në rezultate, gjatë përgatitjes dhe zbatimit të reformave kryesore qeveritare dhe planeve të veprimit të tyre, si edhe të mbështetë dialogun periodik dhe ndërveprimin me partnerët për zhvillim dhe integrim.

Aktorët institucionalë kryesorë të përfshirë në procesin e menaxhimit, zbatimit dhe mbikëqyrjes së reformave dhe masave përmes GMIP-së dhe fushave përkatëse janë Kryeministria, MFE-ja, Departamenti i Administratës Publike (DAP) dhe institucione të tjera kyçe, ku bëjnë pjesë institucionet e pavarura si: Kontrolli i Lartë i Shtetit, INSTAT-i, Kuvendi, përfaqësues nga Agjencia Kombëtare për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe bashkitë. Zv.kryeministri garanton lidhshmërinë politike për procesin e reformave në Qeverisjen e Mirë dhe Administratën Publike. Në nivel teknik, Drejtoria e Zhvillimit dhe Qeverisjes së Mirë pranë Kryeministrit shërben si sekretariat teknik për kontrollin e cilësisë dhe rishikimin afatmesëm të strategjive, si edhe për zbatimin dhe monitorimin e reformave në linjë me prioritetet e qeverisë.

Gjithashtu, BE-ja ka platforma dialogu politik, politikash dhe operacional për RAP-in, MFP-në, antikorrupsionin, decentralizimin dhe agjendën digjitale me Shqipërinë, në kuadrin e takimeve që mbajnë Nënkomitetet përkatëse të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, si edhe Grupi i Posaçëm për RAP-in. Këto takime mundësojnë diskutime mbi sfidat në nivele të ndryshme në një mënyrë plotësuese: i. dialogu i politikave për zhvillimet ligjore dhe institucionale si pjesë e procesit të integritetit në BE, realizohet mes BE-së dhe Shqipërisë, në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit; ii. diskutimet për zbatimin e strategjive sektoriale realizohen përmes GMIP-së, si edhe në Grupin e Posaçëm për RAP-in, si dhe gjithnjë e më shumë në takimet e nënkomiteteve në linjë me përpjekjet për integrimin e RAP-it.

2.5 Monitorimi dhe raportimi i performancës

Monitorimi i përditshëm teknik dhe financiar i zbatimit të këtij veprimi do të jetë një proces i vazhdueshëm dhe pjesë e përgjegjësisë të partnerit zbatues. Për këtë qëllim, partneri zbatues do të ngrejë një sistem monitorimi permanent të brendshëm, teknik dhe financiar për veprimin, si edhe do të përgatitë raporte progresi periodike (të paktën vjetore) dhe raporte përfundimtare. Secili raport do të japë një panoramë të qartë të zbatimit të masës, vështirësive të hasura, ndryshimeve të bëra, si edhe masën e arritjes së rezultateve, të matur sipas treguesve përkatës duke përdorur si referencë listën e treguesve të rezultateve. Raporti do të shtjellohet në mënyrë të tillë që të lejojë monitorim të mjeteve të parashikuara dhe të përdorura, si edhe të detajeve të buxhetit për veprimin. Raporti përfundimtar në formë përshkruese dhe financiare do të përfshijë të gjithë periudhën e zbatimit të masës.

Në nivel kombëtar, zbatimi i strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale do të monitorohet përmes sistemit të planifikimit të integruar të Qeverisë. SPI-ja përmban një sistem vlerësimi të performancës bazuar në rezultate, i cili u referohet synimeve të politikave dhe objektivave të programeve. SPI koordinohet nga Kryeministria. SPI-ja është një komplet parimesh operuese që garanton se planifikimi, buxhetimi dhe monitorimi i politikave qeveritare të jenë të ndërlidhura dhe të funksionojnë me efikasitet. Sistemi orienton procesin e buxhetimit afatmesëm dhe vjetor, duke ofruar objektivat e politikave që përmbajnë udhëzimet e MFE-së mbi përgatitjen e buxhetit nga të gjitha ministritë dhe agjencitë. Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e reformave, rezultatet dhe treguesit kryhet në kuadrin e GMIP-së për Qeverisjen e Mirë dhe RAP-in, si edhe Grupet Tematike me mbështetjen e Sekretariatit të GMIP-së për Qeverisjen e Mirë dhe Administratën Publike. Raportet vjetore përgatiten nga ministria udhëheqëse në secilin sektor.

Në nivel vendor, njësitë e vlerësimit të performancës ende nuk janë ngritur. Aktualisht, njësitë e BE-së në NjQV-të mbledhin të dhënat dhe ia dorëzojnë Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. Sidoqoftë, këto të dhëna janë të kufizuara, sepse tregojnë vetëm performancën e bashkive, lidhur me çështjet e integritetit në BE. I pari raport hartëzimi i këtij lloji



është hartuar në prill 2018⁹, me ndihmën e projektit “Bashkitë për Evropën” financuar nga BE-ja.

Për zbatimin e asistencës plotësuese, takimet e komiteteve drejtuese përkatëse garantojnë monitorim dhe raportim periodik të asistencës. GMIP-ja për Qeverisjen e Mirë dhe RAP-in shërben edhe si komitet monitorimi sektorial IPA për demokracinë dhe qeverisjen, me qëllim monitorimin e mbështetjes së BE-së për këtë sektor, në pajtim me nenin 53 të Marrëveshjes Kuadër IPA II.

Komisioni mund të realizojë vizita monitorimi shitesë të projektit, qoftë përmes personelit të vet, ashtu edhe përmes konsulentëve të pavarur të pajtuar direkt nga Komisioni për monitorim të pavarur (apo të rekrutuar nga agjenti përgjegjës i kontraktuar nga Komisioni për zbatimin e monitorimeve të tilla). Monitorimet realizohen sipas udhëzimeve të DG NEAR për ndërlidhjen mes planifikimit/programimit, monitorimit dhe vlerësimit¹⁰.

2.6 Vlerësimi dhe auditimi

Vlerësimet e komponentit ‘mbështetja buxhetore’ duhet të harmonizohen me vlerësime të ngjashme të mbështetjeve të tjera buxhetore për qëllime llogaridhënieje dhe nxjerrje mësimesh në nivele të ndryshme (edhe për rishikim të politikave) dhe të kryhen nga konsulentë të pavarur.

Për mbështetjen plotësuese, Komisioni mund të kryejë edhe vlerësime të jashtme përmes konsulentëve të pavarur, si më poshtë:

- a) mundësisht një mision vlerësimi afatmesëm;
- b) një vlerësim përfundimtar, në fillim të fazës së mbylljes;
- c) mundësisht një vlerësim pas mbylljes (*ex-post*).

Për mbështetjen plotësuese, auditimet duhet të ndjekin dispozitat e përcaktuara në kushtet kontraktuale të përgjithshme dhe të veçanta.

Komisioni duhet të informojë partnerin zbatues, të paktën 1 muaj paraprakisht nga data e parashikuar, për misionet e vlerësimit. Partneri zbatues duhet të bashkëpunojë me efektivitet dhe efikasitet me ekspertët vlerësues, si edhe t’u vërë në dispozicion, ndër të tjera, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm dhe akses në mjediset dhe aktivitetet e projektit.

Raportet e vlerësimit duhet t’i vihen në dispozicion përfituesit IPA II dhe grupeve kryesore të interesit. Partneri zbatues dhe Komisioni duhet të analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, sipas rastit, në mirëkuptim me vendin partner, vendosin bashkërisht masat ndjekëse që duhen marrë dhe ndonjë modifikim të nevojshëm, përfshirë edhe riorientimin e projektit nëse është e nevojshme.

Fondet për masat vlerësuese mbulohen nga kjo masë.

⁹ <http://www.bpe.al/al/publikime>.

¹⁰ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/tenders/monitoring-and-evaluation_cs.

**LIDHJA 1: PËRZGJEDHJA INDIKATIVE E TREGUESVE TË REZULTATEVE**

Inputet, rezultatet direkte dhe të induktuara dhe të gjithë treguesit, objektivat dhe situata fillestare të përfshira në listën e treguesve të rezultatit janë indikative dhe mund të përditësohen gjatë zbatimit të veprimit pa një ndryshim në vendimin e financimit. Tabela me listën indikative të treguesve të rezultatit do të zgjerohet gjatë kohëzgjatjes së veprimit: kolona të reja do të shtohen për objektivat e ndërmjetëm, kur është e përshtatshme për qëllime raportimi për arritjen e rezultateve të matura nga treguesit.¹

	Logjika e ndërhyrjes	Treguesit	Vlerat bazë	Objektivi 2021	Objektivi 2023	Burimet dhe mjetet e verifikimit
Objektivi i përgjithshëm: Ndikimi	Të kontribuojë për ta bërë sektorin publik më të aftë dhe më reagues ndaj nevojave të qytetarëve dhe bizneseve si edhe të avancojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të proceseve të integritetit në BE.	Mesatarja e: Efektivitetit të Qeverisë, Barrës së Rregullimit Shtetëror dhe Cilësisë Rregullatore (<i>sipas DSI</i>)*	59.57 (2016) Renditja 2017-2018: 75/137 me pikëzimin 4.18 (1-7 maksimal)	63.19 (<i>sipas DSI</i>)	Përmirësim i mëtejshëm	Banka Botërore, Forumi Ekonomik Botëror
Objektivat specifike: Rezultatet	Të përmirësojë administratën publike që të bëhet më efektive, llogaridhënëse, transparente, gjithëpërfshirëse dhe efektive në nivel kombëtar dhe vendor.	Pikëzimi për: Paanshmërinë dhe efikasitetin e procedurave administrative Transparencën Konsultimin publik Mbikëqyrjen buxhetore Ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin Aksesueshmëria e shërbimeve publike	4/5 (SIGMA, 2017) 50/100 (VBH, 2017) 2/100 (VBH, 2017) 69/100 (VBH, 2017) 3/5 (SIGMA, 2017) 2/5 (SIGMA, 2017)	Ruajtje/ritje pikëzimi Rritje pikëzimi Rritje pikëzimi Rritje pikëzimi Ruajtje/ritje pikëzimi Rritje pikëzimi	Rritje pikëzimi	SIGMA, Vrojtimi i Buxhetit të Hapur
Rezultatet e induktuara	1. Përmirësimi i mobilizimit të të ardhurave të brendshme	Raporti taksa/PBB (<i>TKP 5, MFP</i>)	27.3% (2018)	27.5% Miratimi i Strategjisë Afatmesme për Të Ardhurat	Rritja e raportit taksa/PBB sipas SAA	MFE, INSTAT, FMN, SAA

¹ Rekomandohet përdorimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë, kur është e mundur.



	Logjika e ndërhyrjes	Treguesit	Vlerat bazë	Objektivi 2021	Objektivi 2023	Burimet dhe mjetet e verifikimit
	2. Përmirësimi i kapaciteteve fiskale të njësive të qeverisjes vendore	Përqindja e të ardhurave vendore, përfshirë ato që gjenerohen nga taksat e ndara të planifikuara / totalit të të ardhurave vendore (përfshirë një pjesë të tatimit mbi të ardhurat dhe grantit të pakushtëzuar) <i>Objektivi i Strategjisë së Decentralizimit II.1</i>	42% (2018)	43% NjQV-të marrin një pjesë të TAP dhe të paktën 8% të taksës mbi rentën minerare Transferrat e pakushtëzuara rriten me të paktën 0.05% (800 milion lekë) në vit	45 % (44 % in 2021) Rritja e të ardhurave të NjQV-ve Transferrat e pakushtëzuara rriten me të paktën 0.05% (800 milion lekë) çdo vit Reduktohet hendeku mes funksioneve të veta dhe burimeve financiare	MFE
	3. Forcimi i kontrollit mbi alokimet	Stoku i detyrimeve të prapambetura (Qeverisja qendrore dhe vendore, TVSH,) <i>(TKP 14, MFP)</i> % e stokut të shpenzimeve të prapambetura ndaj totalit të shpenzimeve <i>(2.VI, MFP)</i>	2018: 30 miliard lekë (FMN) LG: 13.7% (6.8 miliard lekë/ 49.6 miliard lekë në 2018)	Reduktimi i detyrimeve të prapambetura QV: 7.6% (4.2 miliard lekë / 54.8 miliard lekë)	S'ka më detyrime të prapambetura lidhur me shpenzimet dhe rimbursimin e TVSH-së QV: <1%	MFE, FMN Misionet e Monitorimit pas Programit
	4. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore	Rritje e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të akumuluar lidhur me ankimet e nëpunësve civilë. Niveli i automatizimit për gjenerimin e listëpagesave/borderove nga HRMIS dhe pagimin e pagave përmes AGFIS. <i>(RAP 2018-2020, Aktiviteti 6.3)</i>	Ekzekutimi i totalit të vendimeve të akumuluar në 2018: 62.8% në 2018; 48.2% në 2017; 36.71% në 2016. Asnjë lidhje mes AGFIS dhe HRMIS; HRMIS gjeneron listëpagesa/bordero për 89 institucione të administratës shtetërore (2018)	Ekzekutimi i totalit të vendimeve të akumuluar: 10% më shumë se viti pararendës <i>(të dhënat për vitin 2019 nuk janë ende të disponueshme)</i>	Pagesa automatike (AGFIS) nga HRMIS të listëpagesave/borderove për të gjitha institucionet shtetërore dhe të pavarura si dhe NjQV-të	DAP, HRMIS
	5. Përmirësimi i menaxhimit të investimeve publike	Niveli i aplikimit për procedurat e menaxhimit të investimeve publike	Procedurat MIP të miratuara në 2018 nuk ndiqen plotësisht; proceset e përzgjedhjes dhe vlerësimit janë të fragmentuara (PPP-të, NSPP, PBA)	Zbatim i plotë i procedurave MIP dhe PPP me funksion aksesit online të MFE në ministrinë pilot	Zbatim i plotë i procedurave MIP dhe PPP pavarësisht modaliteteve të financimit/zbatimit	MFE, FMN
	6. Rritje e integritetit të institucioneve publike	Numri i ministrive që zbatojnë Plane Integriteti sipas Strategjisë AK <i>(A.9, AK)</i> Numri i bashkive që zbatojnë plane vendore AK dhe plane vendore integriteti sipas Strategjisë AK <i>(A.11.a, AK)</i>	MD nuk ka publikuar asnjë model për planin e integritetit në nivel qendror (2019) MB nuk ka hartuar asnjë udhëzim për bashkitë (2019) Star2 përgatiti modelin e planit të integritetit në nivel bashkie(2019)	10 ministri zbatojnë planet e integritetit. 10 bashki hartojnë dhe miratojnë planet vendore të integritetit	Të gjitha ministrinë zbatojnë planet e integritetit Të paktën 26 bashki zbatojnë planet vendore të integritetit	MD, MB



	Logjika e ndërhyrjes	Treguesit	Vlerat bazë	Objektivi 2021	Objektivi 2023	Burimet dhe mjetet e verifikimit
	7. Transparenca e aktivitetit të Shtetit dhe aksesit në informacion për qytetarët	Numri i institucioneve që zbatuan korrekt programet e transparencës (AI, AK) Numri i institucioneve që përdorin regjistrin qendror për kërkesa dhe përgjigje (AI, AK)	189 institucione publike zbatuan programet e transparencës (2019) 30 institucione publike po përdorin regjistrin qendror (2019)	50% më shumë institucione zbatojnë programet e transparencës 54 institucione publike përdorin sistemin	Të gjitha institucionet publike zbatojnë programet e transparencës 122 institucione publike përdorin sistemin	Komisioneri për Të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e Të Dhënave Personale
	8. Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe kapaciteteve në qeverisjen vendore	Harmonizimi i kuadrit rregullator sektorial me funksionet e qeverisjes vendore	0% e masave në Raportin e Matricës së Kompetencave janë rishikuar dhe miratuar (2018)	25% e akteve nënligjore të përcaktuara në Raportin e Matricës së Kompetencave rishikohen dhe miratohen	70% e akteve nënligjore të përcaktuara në Raportin e Matricës së Kompetencave rishikohen dhe miratohen	Raporti i AMVV/MB
	9. Përmirësimi i dhënies së shërbimeve ndaj qytetarëve	Numri i shërbimeve elektronike funksionale (A.3, AK) Numri i shërbimeve të integruara që ofron ADISA dhe zyrat me një ndalesë nëpër bashki (RAP, 5.a) % e qytetarëve që përdorin zyrat me një ndalesë të ADISA-s dhe bashkive që janë të kënaqur me shërbimet që marrin	591 me nivel automatizimi 3 ose 4 (e-Albania, 2018) 2018: 367 (ADISA) 2018: 65% të kënaqur ose shumë të kënaqur (vrojtimi i Bankës Botërore) 2018: 70 shërbime ofrohen nga zyrat me një ndalesë nëpër bashki	20% rritje krahasuar me vlerën bazë Hapen të gjitha zyrat me një ndalesë nëpër bashki	80% e qytetarëve që përdorin shërbimet e zyrave me një ndalesë të ADISA-s dhe bashkive janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet që marrin	AKSHI, DAP, ADISA, MB, AMVV
Rezultatet direkte	Përmirësimi i hapësirës financiare për zbatimin e objektivave që lidhen me Qeverisjen e Mirë	% e transheve disbursuar në kohë dhe në shumën e përcaktuar në Kontratën e Performancës së Reformës Sektoriale (KPRS)	E pazbatueshme	30% e disbursimeve të SPRC sipas planit	100% e disbursimeve të KPRS sipas planit	Raportet e disbursimit KPRS
	Vijimi i dialogut të politikave me Qeverinë e Shqipërisë për zbatimin e strategjive lidhur me Qeverisjen e Mirë	Numri i dialogëve teknike/strategjive të politikave të nivelit të lartë, ku diskutohet dhe analizohet zbatimi	GMIP rifilloi në tetor 2018 Takimi GMIP në prill 2019; nuk pati takim të GP RAP, disa takime të posaçme (2018)	Të paktën 2 takime teknike dhe 2 takime strategjike në vit për monitorimin dhe zbatimin e reformave	Të paktën 4 takime teknike dhe 2 strategjike Të paktën 2 takime me OShC-të për monitorimin dhe zbatimin e reformave	Raportet vjetore për strategjitë lidhur me Qeverisjen e Mirë, Raporti Vjetor për Shqipërinë Raportet e Përfutshmërisë
	Forcimi i sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit për zbatimin e strategjive	Masa/shkalla në të cilën bëhet vlerësimi vjetor i progresit	Raportet monitorimi për zbatimin e strategjive sektoriale (përfshirë RAP me fokus të aktivitetet (2018); disa sektorë zhvendosen te raportimi i rezultateve (MFP dhe RAP, 2019)	Raportet vjetore të monitorimit fokusohen te treguesit, përfshirë analizën dhe rekomandimet	Monitorimi financiar dhe teknik i zbatimit të strategjive sipas SIPI-t	Raportet monitorimi



	Logjika e ndërhyrjes	Treguesit	Vlerat bazë	Objektivi 2021	Objektivi 2023	Burimet dhe mjetet e verifikimit
	Forcimi i kapaciteteve për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të strategjive	Cilësia e monitorimit dhe raportimit qeveritar	2/5 (SIGMA, 2017)	Rritje	Rritje	SIGMA, raportet e projektit të asistencës teknike
Rezultatet direkte (asistenca plotësuese)	Përmirësimi i formulimit dhe zbatimit të politikave për qeverisjen e mirë, përfshirë planifikim, buxhetim dhe koordinim politikash të integruara dhe efikase	Numri i ministrive të linjës që mbështeten që të hartojnë dhe të monitorojnë politikën dhe strategjitë	Udhëzimet për hartim dhe kostim strategjish janë miratuar, por nuk zbatohen në mënyrë uniforme nga të gjitha institucionet shtetërore; ende nuk ka një pasues të SKZHI II 2015-2020	Strategji të reja hartohen sipas strategjisë së re kombëtare të zhvillimit, në përputhje me modelin e Kryeministrit, përfshirë plane veprimi të kostuara	AFMIS PBA përgatitja e buxhetit lidhet me hartimin dhe analizën e politikave SIPI	MFE, Kryeministria, SIGMA
	Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve buxhetore që të zbatojnë politikën KBFP	Numri i ministrive të linjës dhe bashkive të mbështetura	Dokumenti i politikës KBFP nuk është finalizuar ende	Miratohet dokumenti i politikës KBFP	Politika KBFP zbatohet nga institucionet buxhetore	MFE
	Përmirësimi i kapaciteteve të bashkive për qeverisjen sipas standardeve të BE-së dhe ofrimin e shërbimeve publike	Numri i bashkive dhe shërbimeve që ofrohen me shërbime publike të standardizuara	Nuk ka	Hartohet lista e standardeve minimale kombëtare për shërbimet që prekin qeverisjen vendore	Miratohet lista dhe hartohen të paktën 50% e standardeve minimale	MB
	Përmirësimi i pjesëmarrjes publike dhe i mbulimit dhe mekanizmave të konsultimit publik në nivel kombëtar dhe vendor	Pikëzimi i Indeksit të Buxhetit të Hapur për konsultimin publik	2/100 (VBH, 2017)	Rritje e pikëzimit	Rritje e pikëzimit	Vrojtimi i Buxhetit të Hapur
	Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies për zbatimin e reformave përmes institucioneve të pavarura	Numri i aktiviteteve/diskutimeve që mbahen nga ose me institucionet e pavarura, p.sh. Kuvendi, për zbatimin dhe monitorimin e reformave	Nuk ka monitorim dhe raportim të qëndrueshëm për zbatimin e reformave nga institucionet e pavarura	Mbështetje për disa institucione të pavarura të përgjegdhura	Rritja e numrit të aktiviteteve / diskutimeve nga ose me institucionet e pavarura	Institucionet e pavarura të mbështetura përmes Asistencës Teknike
	Monitorimi i pavarur i kriterëve të përfitueshmërisë së mbështetjes buxhetore	Numri i vlerësimeve të pavarura për zbatimin e reformës përpunueshmërisë me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përfitueshmërisë së kontratës së performancës së reformës sektoriale që realizohen	E pazbatueshme	Misione të ndërmjetme dhe përfundimtare, si dhe raportet me vlerësimin e situatës dhe rekomandimet	Misione të ndërmjetme dhe përfundimtare, si dhe raportet me vlerësimin e situatës dhe rekomandimet	Raportet e vlerësimit



	Logjika e ndërhyrjes	Treguesit	Vlerat bazë	Objektivi 2021	Objektivi 2023	Burimet dhe mjetet e verifikimit
	Përmirësimi i vizibilitetit, ndërgjegjësimit dhe pranimit të reformave për Qeverisjen e Mirë	Ndërgjegjësimi dhe normat e pranimit nga grupet e interesit të brendshme dhe të jashtme	Ndërgjegjësimi për: Mbështetjen e BE-së për sektorin e shërbimit civil: 35% Reformën e Qeverisjes Vendore: 38% Mbështetjen e BE-së për reformën e QV-së: 32% Mbështetja e BE-së për institucionet shtetërore: 36% Disponueshmëria e shërbimeve online: 19% Disponueshmëria e Zyrave me një Ndalesë: 16% Masat AK të Qeverisë: 49% Fushatat Anti-korrupsion: 37% Mbështetja e BE-së për reformën AK: 46%	Aktivitetet e komunikimit dhe ndërgjegjësimit	Përmirësim i normave të ndërgjegjësimit për pjesëmarrësit në vrojtime me kampionë	Vrojtimi bazë për reformën në administratën publike në Shqipëri, qershor 2018, Vrojtimi i komunikimit në fillim dhe në fund të programit
	Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike të standardizuara në nivel vendor	Numri i bashkive dhe shërbimeve me ofrim të standardizuar të shërbimeve publike	70 shërbime nga zyrat me një ndalesë nëpër bashki në 2019	Rritja me të paktën 20% e shërbimeve që ofrojnë zyrat me një ndalesë nëpër bashki	Të paktën 252 njësi administrative dhe 50 bashki ofrojnë shërbime publike në zyrat me një ndalesë	STAR 3 hartëzimi i qeverisjes vendore

LISTA E SHTOJCAVE

1. Treguesit e performancës që përdoren për disbursimet
2. Modalitetet dhe kalendari i disbursimit
3. Aktivitetet plotësuese



SHTOJCA 1: Treguesit e performancës që përdoren për disbursimet

Treguesi 1:

Programi:

Objekti:

Veprimi:

Departamenti përgjegjës

Përmirësimi i mobilizimit të të ardhurave të brendshme

Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike

MFP: Menaxhim efektiv, efikas dhe transparent i të ardhurave tatimore

Veprimet MFP lidhur me administrimin tatimor sipas planit të veprimit

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Përshkrimi i Treguesit

Lloji i treguesit:

Njësia matëse:

Shpeshësia e matjes:

Situata fillestare:

Sasior

Përqindja e llogaritur bazuar në Lek

Vjetore

Stoku i borxheve dhe mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara: 74% (2019), 63% (2018), 204% (2017, influencuar nga efektet e ligjit të amnistisë; 51% (2016), 39% (2015)

Zhvillimi dhe cilësia e treguesit

Metoda e mbledhjes së të dhënave:

Departamenti përgjegjës për mbledhjen:

Metoda e llogaritjes:

Mjetet e interpretimit

Limitet e njohura dhe trendi:

Mjetet e interpretimit:

Mbledhje administrative

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Thesari;

Raporti llogaritet duke pjesëtuar shumën totale të borxheve të mbledhura në vitin N me shumën totale të detyrimeve tatimore të prapambetura në vitin N.

SAA nuk është hartuar ende, pa strategji të qartë dhe plan veprimi për përmirësimin e politikave tatimore dhe administrimit tatimor.

Raporti detyrimeve tatimore të mbledhura në vitin N kundrejt detyrimeve tatimore të papaguara është tregues i efikasitetit të administratës tatimore në mbledhjen e të ardhurave dhe ka ndikim direkt te realizimi i të ardhurave tatimore në një vit të caktuar.

Kalendari i dokumentimit

Data e realizimit:

T1 2021: DPT dorëzon informacion për taksat e mbledhura në 2020 kundrejt totalit të detyrimeve tatimore të papaguara në 2020.

T1 2022: DPT dorëzon informacion për taksat e mbledhura në 2021 kundrejt totalit të detyrimeve tatimore të papaguara në 2021.

T1 2023: DPT dorëzon informacion për taksat e mbledhura në 2022 kundrejt totalit të detyrimeve tatimore të papaguara në 2022.

Komente

Strategjia MFP 2019-2022 po rishikohet pas krizës COVID-19; pritet të finalizohet në fillim të T4 2020.

**Treguesi 2:***Programi:**Objekti:**Veprimi:***Përmirësimi i kapaciteteve fiskale të njësisë të qeverisjes vendore**

Strategjia MFP dhe Strategjia Kombëtare ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore

Rritjen e të ardhurave vendore për të plotësuar nevojat financiare për ofrimin e shërbimeve vendore.

Përmirësimi i kapaciteteve financiare të NJQV-ve dhe reduktimi i hendekut ekzistues mes funksioneve të veta dhe burimeve financiare, duke rritur nivelin e granteve të pakushtëzuara për të përballuar financimin e funksioneve të reja transferuar me ligjin për vetëqeverisjen vendore dhe zbatimin e TAP; konkretisht zbatimin e plotë të germën (ç), neni 25 "Të ardhurat nga taksat e ndara" të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe rritja e transfertës së pakushtëzuar me të paktën 0.02% me bazë vjetore.

Drejtoria e Financave Vendore, MFE

*Departamenti përgjegjës***Përshkrimi i Treguesit***Lloji i treguesit:*

Sasior

Njësia matëse:

Përqindje

Shpeshtësia e matjes:

Vjetore

Situata fillestare:

nga 838 milion lekë (2% e TAP në 2019), 0 transferohen te NJQV-të. 1% e PBB-së është transfertë e pakushtëzuar për NJQV-të (2019)

Zhvillimi dhe cilësia e treguesit*Metoda e mbledhjes së të dhënave:*

Treguesit fiskalë të MFE

Departamenti përgjegjës për mbledhjen:

Drejtoria e Financave Vendore, MFE

Metoda e llogaritjes:

Përqindja e TAP-it dhe përqindja e transfertave të pakushtëzuara që u derdhen NJQV-ve në një vit të caktuar

Mjetet e interpretimit*Limitet e njohura dhe trendi:*

Të dhënat bazohen në Treguesit Fiskalë të publikuar në Dokumentin e Buxhetit Vjetor në fazën e planifikimit si dhe treguesit makroekonomikë të rishikuar nga MFE. Plani për 2020 është që 1% e Tatimit mbi Të Ardhurat Personale të shkojë për NJQV-të. Vlera minimale e rënë dakord për transfertat e pakushtëzuara është 1% e PBB-së. Është marrë parasysh mundësia e ngadalësimit ekonomik dhe reduktimit të PBB-së, duke vendosur vlerën minimale për transfertat e pakushtëzuara, që nuk mund të jetë më pak se vlera e transferuar në vitin pararendës.

Mjetet e interpretimit:

Zbatimi i plotë TAP, rritja e përqindjes së transfertave të pakushtëzuara do të kontribuojë në më shumë të ardhura për NJQV-të, çka vetë do të kontribuojë në rritje të autonomisë financiare dhe më shumë burime për zbatimin e funksioneve të NJQV-ve. Hendeku mes funksioneve të veta dhe burimeve financiare do të reduktohet duke grumbulluar rreth 700 milion ALL nga TAP në secilin prej tri viteve, si edhe nga rritja e granteve të pakushtëzuara me 0.02% në vitet 2 dhe 3.

Kalendari i dokumentimit*Data e realizimit:*

T1 2021: MFE ia dorëzon Buxhetin Vjetor 2021 Kuvendit; Fletorja Zyrtare.

T1 2022: MFE ia dorëzon Buxhetin Vjetor 2022 Kuvendit; Fletorja Zyrtare.

T1 2023: MFE ia dorëzon Buxhetin Vjetor 2023 Kuvendit; Fletorja Zyrtare.

Komente

Vlerësimi duhet të mbajë parasysh çdo rishikim potencial të buxhetit gjatë vitit, bazuar në rishikimin afatmesëm të buxhetit të zbatuar. Çdo ndryshim në treguesit makroekonomikë fiskalë duhet të konsultohet mbi baza tremujore.

**Treguesi 3:***Programi:**Objekti:**Veprimi:**Departamenti përgjegjës***Forcimi i kontrollit mbi alokimet**

Strategjia e Menaxhimit Financiar Publik

Objekti 4 – Ekzekutimi efikas i buxhetit

Masat lidhur me reduktimin e detyrimeve ndaj biznesit

MFE: Thesari, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Buxhetit, NjQV

Përshkrimi i Treguesit*Lloji i treguesit:**Njësia matëse:**Shpeshhtësia e matjes:**Situata fillestare:*

Sasiore

Përqindja e llogaritur bazuar në lekun shqiptar (ALL)

Vjetore / Tremujore

Totali i detyrimeve të qeverisjes qendrore si % shpenzimeve totale të qeverisjes qendrore në 2019: 4.5%; 2018: 5.4%; Renditja PEFA në 2017 ishte B (<6%): 4.3%

Zhvillimi dhe cilësia e treguesit*Metoda e mbledhjes së të dhënave:**Departamenti përgjegjës për mbledhjen:**Metoda e llogaritjes:*

Vrojtim, mbledhje administrative, të dhënat e thesarit

Thesari, Drejtoria e Buxhetit, NjQV

Stoku i detyrimeve të prapambetura (të gjitha detyrimet e qeverisjes qendrore dhe detyrimet me rimbursimin e TVSH-së që nga muaji dhjetor i vitit N pjesëtuar me shpenzimet totale të qeverisjes qendrore në vitin N.

Mjetet e interpretimit*Limitet e njohura dhe trendi:**Mjetet e interpretimit:*

Raportimi për detyrimet e prapambetura bazohet te kontributet që dorëzojnë ministrinë e linjës dhe NjQV-të. Sidoqoftë, kjo po adresohet për të mundësuar raporte direkt nga sistemi .

Kontrollet mbi alokimet, sidomos alokimet shumëvjeçare, ende nuk janë efektive. Përmirësimet në efektivitetin e llogaridhënies së zyrtarëve autorizues dhe zyrtarëve nënautorizues, si edhe sisteme më të forta që duhet të rezultojnë në reduktim të akumulimit të detyrimeve lidhur me shpenzimet.

Kalendari i dokumentimit*Data e realizimit:*

T1 2021: MFE raporton shpenzimet totale për 2020; detyrimet e prapambetura në nivelin e qeverisjes qendrore dhe vendore, vendimet gjyqësore, detyrimet me rimbursimin e TVSH-së të krijuara dhe të shlyera gjatë janar-dhjetor 2020.

T1 2022: MFE raporton shpenzimet totale për 2021; detyrimet e prapambetura në nivelin e qeverisjes qendrore dhe vendore, vendimet gjyqësore, detyrimet me rimbursimin e TVSH-së të krijuara dhe të shlyera gjatë janar-dhjetor 2021.

T1 2023: MFE raporton shpenzimet totale për 2022; detyrimet e prapambetura në nivelin e qeverisjes qendrore dhe vendore, vendimet gjyqësore, detyrimet me rimbursimin e TVSH-së të krijuara dhe të shlyera gjatë janar-dhjetor 2022.

Komente

Strategjia MFP 2019-2022 po rishikohet pas krizës COVID-19; pritet të finalizohet në fillim të T4 2020.

**Treguesi 4:***Programi:**Objekti:**Veprimi:**Departamenti përgjegjës***Përshkrimi i Treguesit***Lloji i treguesit:**Njësia matëse:**Shpeshtësia e matjes:**Situata fillestare:***Zhvillimi dhe cilësia e treguesit***Metoda e mbledhjes së të dhënave:* Mbledhje administrative*Departamenti përgjegjës për mbledhjen:* DAP dhe MFE*Metoda e llogaritjes:***Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore**

Strategjia RAP – Fusha: Shërbimi Civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Përmirësimi i kapaciteteve për zbatimin e legjisllacionit të shërbimit civil dhe lehtësimi i procedurave të ekzekutimit

Aktivitetet përkatëse të Planit të Veprimit të Strategjisë RAP

Departamenti i Administratës Publike (DAP), MFE

Sasior

Përqindje

Vjetore

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë të akumuluar lidhur me ankimet e nëpunësve civilë: 66.5% (2019); 62.8% (2018); 48.2% (2017)

Mjetet e interpretimit*Limitet e njohura dhe trendi:**Mjetet e interpretimit:*

në pritje të ekzekutimit për të cilat ka një vendim gjyqësor të formës së prerë.

E pazbatueshme

Për Vitin 1: Ilustron masën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë lidhur me ankimet e nëpunësve civilë. Akumulimi nënkupton çështjet

Për Vitet 2 dhe 3: Institucionet e administratës shtetërore përfshijnë të gjitha institucionet nën varësinë e Kryeministrit, të gjitha ministratë e linjës dhe institucionet e tyre të varësisë (qoftë sipas Ligjit për Nëpunësin Civil dhe ato sipas Kodit të Punës).

Kalendari i dokumentimit*Data e realizimit:*

T1 2021: DAP paraqet listën e plotë të çështjeve nga janari 2014 deri në fund të 2020 dhe listën e çështjeve për të cilat vendimet gjyqësore janë ekzekutuar nga fundi i 2013 deri në fund të 2020;

DAP paraqet listën e të gjithë institucioneve të administratës shtetërore në dhjetor 2020; raporton numrin e institucioneve të administratës shtetërore që gjenerojnë bordero përmes HRMIS në dhjetor 2020.

T1 2022: DAP paraqet listën e të gjithë institucioneve të administratës shtetërore në dhjetor 2021; DAP dhe MFE raportojnë numrin e institucioneve të administratës shtetërore dhe NjQV-ve që gjenerojnë raporte bordero përmes HRMIS dhe që paguajnë automatikisht përmes AGFIS.

T1 2023: DAP paraqet listën e të gjithë institucioneve të administratës shtetërore në dhjetor 2022; DAP dhe MFE raportojnë numrin e institucioneve të administratës shtetërore dhe NjQV-ve që gjenerojnë raporte bordero përmes HRMIS dhe që paguajnë automatikisht përmes AGFIS.

Komente

E pazbatueshme

**Treguesi 5:***Programi:**Objekti:**Veprimi:**Departamenti përgjegjës***Përmirësimi i menaxhimit të investimeve publike**

Strategjia e Menaxhimit Financiar Publik

Zbatimi efikas i projekteve të mëdha të investimeve në përputhje me burimet financiare ekzistuese dhe kapacitetet zbatuese ekzistuese.

Veprimet lidhur me menaxhimin e investimeve publike sipas planit të veprimit

MFE: Drejtoria e Buxhetit, Njësia e Menaxhimit të Investimeve Publike (MIP), Njësia e Koncesioneve

Përshkrimi i Treguesit*Lloji i treguesit:**Njësia matëse:**Shpeshhtësia e matjes:**Situata fillestare:*

Sasior

E pazbatueshme

Vjetore

Situata fillestare: Raporti mes kontratave të monitoruara nga MFE dhe totalit të kontratave të nënshkruara (PPP dhe Koncesione: 10.3% (23 nga 224; 2019); 2.29% (5 nga 218; 2018); 1.38% (3 nga 216; 2017).

Zhvillimi dhe cilësia e treguesit*Metoda e mbledhjes së të dhënave:**Departamenti përgjegjës për mbledhjen:**Metoda e llogaritjes:*

Mbledhje administrative

Drejtoria e Buxhetit, MFE

I_{SPP} matet si raporti i projekteve të investimeve që përmban PBA që reflektojnë prioritetet strategjike (I_{SPP}) të qeverisë të paraqitur në SKZhl dhe strategjitë sektoriale/ndërsektoriale, përkundër totalit të projekteve të investimeve që përmban PBA. Strategjia MFP parashikon llogaritjen e këtij Treguesi bazuar në vlerësimin e pesë ministrive të linjës (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit) dhe nëntë programe kyçe të PBA (Rrugët, Ujësjellës-Kanalizimet, Kujdesi Parësor, Kujdesi Dytësor, Arsimi Parësor (përfshirë parashkollorin), Arsimi Dytësor, Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Vaditjes, Zhvillimi Rural, Programi i Mbrojtjes së Mjedisit). V_{SPP} është raporti mes totalit të projekteve të propozuar bazuar në prioritetet strategjike, përkundër totalit të buxhetit të investimeve kapitale. Monitorimi i PPP-ve dhe Koncesioneve, plani për 2019 është 8.14% (18 nga 221), përfshirë të gjitha kontratat.

Mjetet e interpretimit*Limitet e njohura dhe trendi:**Mjetet e interpretimit:**Për shkak të krizës së COVID-19*, treguesit e Strategjisë MFP ka shumë gjasa të ndryshohen.Investimet publike duhet të jenë plotësisht në linjë me prioritetet e qeverisë përcaktuar në politikat kombëtare dhe sektoriale, sesa bazuar në vendime *ad hoc*. MFE duhet të forcojë rolin për miratimin dhe monitorimin e kontratave PPP/Koncesionare si dhe të zgjerojë objektin aktual. Raportimi tërësor MIP për publikun rrit transparencën, përmirëson menaxhimin e riskut dhe mbështet vlerën e parasë. "Tërësor" (apo gjithëpërfshirës) nënkupton raportim financiar dhe teknik bazuar në vlerësimet individuale të secilit projekt/program investimi publik që përfshin PPP-të dhe koncesionet.**Kalendari i dokumentimit***Data e realizimit:*

T1 2022: MFE publikon një raport tërësor për kontratat PPP dhe Koncesionet.

T1 2023: MFE publikon një raport tërësor për Menaxhimin e Investimeve Publike (përfshirë PPP-të dhe koncesionet).

Komente

Strategjia MFP 2019-2022 po rishikohet pas krizës COVID-19; pritet të finalizohet në fillim të T4 2020.

**Treguesi 6:***Programi:**Objektivi:**Veprimi:**Departamenti përgjegjës***Përshkrimi i Treguesit***Lloji i treguesit:**Njësia matëse:**Shpeshtësia e matjes:**Situata fillestare:***Integriteti i institucioneve publike**

Strategjia RAP dhe Strategjia ndërsektorale kundër Korrupsionit

RAP: Objektivi 5 (Shërbime publike të përmirësuara, të aksesueshme, dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin e etikës në ofrimin e shërbimeve publike), Objektivi 10 (Rritja e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë);

AK: Objektivi A9 (Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë) dhe A.11 (Miratimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore)

AK: Aktiviteti A.9.3 (Hartimi/Miratimi/Zbatimi i planeve të integritetit nga të gjitha institucionet), A.11.3 (Miratimi i planeve vendore të integritetit nga bashkitë)

Ministria e Drejtësisë (Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit - KKKK), Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV).

Sasior

Numër absolut

Vjetore

Është miratuar Metodologjia për Vlerësimin e Riskut të Integritetit si edhe Plani i Integritetit i Ministrisë së Drejtësisë (2020). Udhëzimet nuk janë hartuar ose nuk u janë dërguar bashkive ende (2019). Sidoqoftë, 6 bashki kanë hartuar dhe miratuar një plan vendor integriteti.

Zhvillimi dhe cilësia e treguesit*Metoda e mbledhjes së të dhënave:**Departamenti përgjegjës për mbledhjen:* Ministria e Drejtësisë (Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit) dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.*Metoda e llogaritjes:*

Numra absolutë

Mjetet e interpretimit*Limitet e njohura dhe trendi:**Mjetet e interpretimit:*

E pazbatueshme

Performanca do të matet sipas një metodologjie të paracaktuar si pjesë e raportimit të ecurisë së strategjisë anti-korrupsion, duke matur sa është rritur numri total i planeve të integritetit të miratuara dhe të publikuara, si edhe numri total i masave të planifikuara që zbatohen në një vit të caktuar. Zbatimi i masave në një vit të caktuar konsiderohet i kënaqshëm nëse zbatohen të paktën 51% e masave të parashikuara për atë vit. Janë 11 ministri dhe 61 NjQV.

Kalendari i dokumentimit*Data e realizimit:*

T1 2021: KKKK raporton për zbatimin e planeve të integritetit nga ministrinë; AMVV raporton për miratimin dhe publikimin e planeve vendore të integritetit nga bashkitë.

T1 2022: KKKK raporton për zbatimin e planeve të integritetit nga ministrinë; AMVV raporton për zbatimin e planeve vendore të integritetit nga bashkitë.

T1 2023: AMVV raporton për zbatimin e planeve vendore të integritetit nga bashkitë.

Komente

Në kuadrin e Strategjisë RAP, është hartuar një Manual Etike për ofrimin e shërbimeve publike përmes sporteleve të shërbimit.

**Treguesi 7:****Programi:****Veprimi:****Departamenti përgjegjës****Përshkrimi i Treguesit****Lloji i treguesit:****Njësia matëse:****Shpeshësia e matjes:****Situata fillestare:****Transparenca e veprimtarisë shtetërore dhe aksesit në informacion për qytetarët**

Strategjia ndërsektoriale kundër Korrupsionit, Strategjia ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike.

Objektivi A1 (Rritja e transparencës së veprimtarisë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion)

RAP: Aktiviteti 11.1 (Vënia në zbatim e programit institucional të transparencës nga autoritetet publike), Aktiviteti 11.2 (Përdorimi i mjeteve TIK për të rritur transparencën e veprimtarisë së administratës); AK: Aktiviteti A.1.1 (Zbatimi i plotë i Programeve të Transparencës dhe rritja e numrit të institucioneve qendrore që e zbatojnë), Aktiviteti A.1.2 (Zbatimi i plotë i programeve të transparencës dhe rritja e numrit të institucioneve të qeverisjes vendore që e zbatojnë), Aktiviteti A.1.3 (Krijimi i regjistrit qendror për kërkesat dhe përgjigjet).

Komisioneri për Të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e Të Dhënave Personale (KDI)

Sasior

Numër

Vjetore

Në vitin 2019, nga 471 institucione publike, (a) 246 institucione publike publikuan programin e transparencës. Nga këto 246, (b) 236 emëruan një koordinator për të drejtën e informimit. Nga këto 236, (c) 189 publikuan regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve dhe kështu zbatuan saktë programin e transparencës (hapat 'a' deri 'c'). 30 institucione publike po përdorin regjistrin qendror TI.

Zhvillimi dhe cilësia e treguesit**Metoda e mbledhjes së të dhënave:** Mbledhje administrative (raporte vjetore)**Departamenti përgjegjës për mbledhjen:** KDI**Metoda e llogaritjes:**

Numra absolutë

Mjetet e interpretimit**Limitet e njohura dhe trendi:**

Objektivi i parashikuar për 2020 për Treguesin A.1.a të Pasaportës së Treguesit të Strategjisë ndërsektoriale kundër Korrupsionit është 50% rritje krahasuar me 2019. Objektivi i parashikuar për 2020 për Treguesin A.1.b të Pasaportës së Treguesit të Strategjisë ndërsektoriale kundër Korrupsionit është rritje me 80% të institucioneve krahasuar me 2019 (përfshirë të gjitha Ministrinë dhe institucionet e pavarura).

Mjetet e interpretimit:

Treguesi do të matë numrin total të institucioneve që zbatojnë saktë programet e transparencës (A.1.a) si edhe përdorimin operacional të regjistrit qendror për kërkesat dhe përgjigjet ndaj ankesave (A.1.b). Janë 419 institucione qendrore dhe vendore që duhet të zbatojnë programet e transparencës dhe të përdorin sistemin. Zbatimi i saktë i programeve të transparencës nënkupton publikimin e programit të transparencës, emërimin e një koordinatori për të drejtën e informimit dhe publikimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Raportet e progresit të PQH (Partneriteti i Qeverisë së Hapur) dhe vlerësimet për Shqipërinë.

Kalendari i dokumentimit**Data e realizimit:**

T1 2021: KDI dorëzon raportin vjetor.

T1 2022: KDI dorëzon raportin vjetor.

T1 2023: KDI dorëzon raportin vjetor.

Komente

Sipas llogaritjeve të KDI në prill 2019, duhen të paktën tre vjet (nëse ekzistojnë fondet) për të instaluar sistemin në të gjitha institucionet dhe për të ofruar trajnimet. Objektivat e parashikuar në Pasaportën e Treguesit të Strategjisë RAP fokusohen te numri i ankesave të depozituara dhe % e rekomandimeve të zbatuara.

**Treguesi 8:****Programi:****Objektivi:****Veprimi:****Departamenti përgjegjës****Përshkrimi i Treguesit****Lloji i treguesit:****Njësia matëse:****Shpeshhtësia e matjes:****Situata fillestare:****Forcimi i parimeve RAP në nivel vendor**

Strategjia RAP dhe Strategjia Kombëtare ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore

Shkallë e lartë harmonizimi e kuadrit rregullator sektorial me funksionet e qeverisjes vendore dhe përkufizimin/zbatimin e standardeve minimale kombëtare që prekin qeverisjen vendore (bashkë me shërbimet që mbulon Programi i Përfshirjes Sociale i IPA 2019)

Masat që adresojnë hendeqet dhe mbivendosjet lidhur me caktimin e qartë të përgjegjësisë ndërmjet autoriteteve qendrore dhe vendore në një sërë sektorësh, përfshirë arsimin parauniversitar dhe kopshtet; shërbimet sociale; barazinë gjinore; kujdesin shëndetësor parësor; menaxhimin e pyjeve dhe kullotave; sipas Urdhrit të Kryeministrit miratuar pas rekomandimeve nga studimi "Matrica e Kompetencave". Përcaktimi dhe zbatimi i standardeve minimale kombëtare që prekin qeverisjen vendore (bashkë me shërbimet që mbulon Programi i Përfshirjes Sociale i IPA 2019).

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Ministria e Brendshme

Sasior

Përqindje

Vjetore

Urdhri i Kryeministrit nr. 1010, date 03.07.2019 zbatuar në masën 70% në qershor 2020.

Zhvillimi dhe cilësia e treguesit**Metoda e mbledhjes së të dhënave:**

Dokumente administrative; masa të propozuara që janë diskutuar në Këshillin Konsultativ dhe miratuar nga institucionet përkatëse; Fletorja Zyrtare

Departamenti përgjegjës për mbledhjen Këshilli Konsultativ/Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore**Metoda e llogaritjes:**

Numri i akteve të miratuara prej institucioneve përkatëse

Mjetet e interpretimit**Limitet e njohura dhe trendi:****Mjetet e interpretimit:**

E pazbatueshme

Lista e masave që kanë marrë Këshilli i Ministrave dhe Ministritë e Linjës përmes miratimit formal të ligjeve, akteve nënligjore dhe/ose rregulloreve. "Harmonizimi" nënkupton ndryshimet në ligje, akte nënligjore dhe/ose rregullore në nivel sektorial, që të jenë plotësisht në përputhje me dispozitat e Ligjit Organik për Qeverisjen Vendore për sa u përket kompetencave.

Kalendari i dokumentimit**Data e realizimit:**

T1 2021: Të dhënat në Q4 2020; Raporti Vjetor i AMVV/MB

T1 2022: Të dhënat në T4 2021; Raporti Vjetor i AMVV/MB

T1 2023: Të dhënat në T4 2022; Raporti Vjetor i AMVV/MB

Komente

E pazbatueshme

**Treguesi 9:***Programi:**Objekti:**Veprimi:**Departamenti përgjegjës***Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët**

Strategjia RAP – Axbenda Dixhitale, Strategjia Kombëtare ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore

Organizimi dhe funksionimi i administratës publike; Procedurat administrative dhe mbikëqyrja

Aktivitetet përkatëse të Planit të Veprimit të Strategjisë RAP, rritja e kapaciteteve administrative të bashkive për të garantuar shërbime më të mira dhe më efektive (si nga qeverisja qendrore, edhe në sferën e NjQV-ve) për qytetarët përmes ngritjes së zyrave të integruara me një ndalesë në mbarë Shqipërinë ADISA, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, MB.

Përshkrimi i Treguesit*Lloji i treguesit:*

Sasior, cilësor

Njësia matëse:

Përqindje

Shpeshësia e matjes:

Vjetor

Situata fillestare:

2019: 9 bashki kanë qendra shërbimi ADISA; 2018: 65% të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet publike (vrojimi i Bankës Botërore); 2016: 51% të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet publike (Anketa Kombëtare)

Zhvillimi dhe cilësia e treguesit*Metoda e mbledhjes së të dhënave:*

Mbledhje administrative; anketa e realizuar nga ADISA (metodologjia e vet)

Departamenti përgjegjës për mbledhjen:

DAP, ADISA, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore; MB.

Metoda e llogaritjes:

2020 dhe 2021: Numri absolut i bashkive; 2022: Shkalla e kënaqësisë = përqindja e shumës së pjesëmarrësve të kënaqur plus pjesëmarrës shumë të kënaqur pjesëtuar me numrin total të pjesëmarrësve në anketë

Mjetet e interpretimit*Limitet e njohura dhe trendi:*

E pazbatueshme

*Mjetet e interpretimit:*Strategjia RAP, Treguesi 5.a tregon numrin e shërbimeve që ofron ADISA. Strategjia RAP, Treguesi 5.b tregon numrin e zyrave me një ndalesë të ngritura në NjQV-të. Shërbimet elektronike do të ofrohen në <https://e-albania.al/>**Kalendari i dokumentimit***Data e realizimit:*

T1 2021: ADISA paraqet qendrat e shërbimeve të ADISA duke treguar vendndodhjen e tyre.

T1 2022: ADISA paraqet qendrat e shërbimeve të ADISA duke treguar vendndodhjen e tyre.

T1 2023: ADISA dhe MB/AMVV paraqesin raportin për rezultatet e Anketës Kombëtare të Kënaqësisë.

Komente

Objekti për 2022 mund të duhet të rishikohet në varësi të rezultateve të një tjetër Ankete Kombëtare të Kënaqësisë në ose para 2021.



SHTOJCA 2: Modalitetet dhe kalendari i disbursimit

Kjo shtojcë trajton katër fusha kryesore sipas kontekstit sektorial të vendit/ndërrhyrjes: (1) përgjegjësitë; (2) kalendari indikativ i disbursimit; (3) kushtet e përgjithshme për disbursimin e secilit transh; (4) kushtet e veçanta për disbursimin e secilit transh.

1. Përgjegjësitë

Bazuar në kushtet e disbursimit të përcaktuara në Marrëveshjen e Financimit, KKIPA do t'i dërgojë Komisionit Evropian një kërkesë zyrtare për disbursimin e çdo transhi sipas kalendarit në Tabelën A më poshtë. Kërkesa duhet të përfshijë: (i) analizën e plotë dhe argumentimin për pagimin e fondeve duke i bashkëngjitur dokumentet mbështetëse; (ii) një formular me informacion financiar, të nënshkruar siç duhet, që lehtëson kryerjen e pagesave korresponduese.

2. Kalendari indikativ i disbursimit

Tabela A: Kalendari indikativ i disbursimit

Viti fiskal i vendit	Viti 0	Viti 1				Viti 2				Viti 3				
Lloji i transhit	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	Total
Transhi fiks	5			-				2				2		9
Transhi variabël				8				9.5				9.5		27
Total	5			8				11.5				11.5		36

3. Kushtet e përgjithshme për disbursimin e secilit transh

Kushtet e përgjithshme më poshtë për disbursimin e secilit transh janë të zbatueshme për të gjitha transhet; dhe të gjitha kërkesat për disbursim transhi duhet të shoqërohen me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e përshtatshëm.

Tabela B: Kushtet e përgjithshme për disbursimin e transheve

Fusha	Kushtet	Burimi i verifikimit
Politika Publike	Progresi i kënaqshëm në zbatimin e Strategjisë së Reformës në Administratën Publike dhe vijimësia e besueshmërisë dhe relevancës së saj	Raportet e progresit vjetor të Strategjisë RAP (prill, vjetore, N+1) Raportet e progresit vjetor të zbatimit të Strategjive të Decentralizimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Shqipëria Dixhitale Grupi i Posaçëm RAP si pjesë e SAA (vjetor)
Stabiliteti Makroekonomik	Ruajtja e një politike makroekonomike të besueshme, relevante dhe të orientuar drejt stabilitetit, ose progresi i bërë drejt rivendosjes së balancave kyçe	Raportet vjetore të qeverisë (prill, vjetore, N+1) Raportet e FMN, Bankës Botërore, BE (vjetore dhe <i>ad hoc</i>) Vlerësimi i DG ECFIN për programin e reformave ekonomike të



		Shqipërisë, PRE (vjetor) MSA, Nënkomiteti për Çështjet Ekonomike dhe Financiare (vjetor)
Menaxhimi Financiar Publik	Progresi i kënaqshëm në zbatimin e reformave për përmirësimin e menaxhimit financiar publik, përfshirë mobilizimin e të ardhurave të brendshme, si edhe vijimin e relevancës dhe besueshmërisë së programit të reformave	Raporte progresi vjetore për zbatimin e strategjisë së MFP (Prill, vjetore, N+1) FMN, Banka Botërore, EU MFP-raportime të lidhura (vjetore dhe ad hoc) PAR gupe të posaçme si pjesë SAA (vjetore)
Transparenca buxhetore	Progresi i kënaqshëm në ofrimin për publikun të informacionit buxhetor të shëndoshë, tërësor dhe në kohë	Raportet e progresit vjetor për zbatimin e Strategjisë MFP (prill, vjetore, N+1) Printimet dhe faqet e internetit zyrtare të Qeverisë (në vijimësi) Vlerësimet e palëve të treta, p.sh. Indeksi i Buxhetit të Hapur dy herë në vit)

4. Kushtet e veçanta për disbursimin e transheve

Kushtet e veçanta për disbursimin të përcaktuar në Tabelat C dhe D janë të zbatueshme për disbursimin e një transhi specifik. Kërkesat për disbursim transhi duhet të shoqërohen me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e përshtatshëm për kushtet e veçanta.

Tabela C: Kushtet e veçanta për disbursimin e transheve

Transhi	Shuma	Data indikative e kërkesës për disbursim (muaj/vit)	Data indikative e disbursimit (muaj/vit)	Kushtet/kriteret/aktivitetet për disbursim	Burimi i verifikimit përfshirë kohën ose disponueshmërinë e të dhënave (nëse ka)
Transhi variabël i parë	5 milionë €	Nëntor 2020	Dhjetor 2020	Miratimi i strategjive sektoriale dhe planeve të veprimt deri në fund të 2022 për PAR, MFP, AK, Axiendën dixhitale dhe Decentralizimin.	Fletorja Zyrtare, vendimet e Këshillit të Ministrave, faqet e internetit të qeverisë

Kushtet e disbursimit për transhin variabël janë caktuar për vitin e parë dhe mund të ndryshohen.



5. Llogaritja e transhit variabël

Treguesit e performancës të paraqitur në Tabelën D dhe të përshkruar hollësisht në Shtojcën 1 zbatohen për llogaritjen e përqindjes/pjesës së transheve variabël që do të disbursohen. Kriteret për disbursimin e transheve duhet të shoqërohen me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e përshtatshëm lidhur me treguesit e performancës.

- Specifiko metodën për pikëzimin e secilit tregues

Secili Tregues Performance vlerësohet me 1 nëse objektivi arrihet, me 0.5 nëse objektivi arrihet pjesërisht (kërkesat për këtë specifikohen për secilin Tregues në Tabelën D) ose 0 nëse objektivi nuk arrihet.

Nëse në Tabelën D përcaktohet "pro-rata", Treguesi i Performancës vlerësohet saktësisht nga 0% në 100% sipas masës ekzakte të realizimit të objektivit. Nuk mund të kalojë 100%. Përveç kur parashikohet ndryshe, pagesat bëhen vetëm kur objektivi arrihet mbi realizimin e pjesshëm, sipas formulës më poshtë:

- $$[(\text{Arritja aktuale} - \text{objektivi minimal i pjesshëm}) / (\text{objektivi i plotë} - \text{objektivi minimal i pjesshëm}) \times 0.5] + 0.5 \text{ për objektivat që synojnë rritje të vlerës së Treguesit (d.m.th. trend rritës)}$$
- $$[(\text{Objektivi minimal i pjesshëm} - \text{arritja aktuale}) / (\text{objektivi minimal i pjesshëm} - \text{objektivi i plotë}) \times 0.5] + 0.5 \text{ për objektivat që synojnë reduktimin e vlerës së Treguesit (d.m.th. trend rënës)}$$

Përveç vlerësimeve të jashtme të parashikuara, mund të realizohen edhe verifikime të të dhënave për të hedhur dritë mbi vendimet e disbursimit.

- Specifiko natyrën e Situatës fillestare

Nëse specifikohet, Situata fillestare evoluon sipas performancës në secilin vit pasues. Kjo do të thotë që rezultatet e arritura në vitin N për programin, bëhen efektivisht Situatë fillestare përkundër së cilës vlerësohet performanca e vitit N+1.

Në rastet kur objektivi për vitin N+1 është arritur që në vitin N, duhet të vendoset një objektivi i arritshëm për vitin N+1 mbi bazën e Situatës Fillestare të re (viti N).

- Specifiko metodën për agregimin e pikëzimeve për të përcaktuar disbursimin e transhit variabël

Pasi secili Tregues vlerësohet dhe i atribuohet një pikëzim performance, shuma e transhit variabël që disbursohet do të përcaktohet duke mbledhur këto pikëzime sipas peshave përkatëse të indikatorëve referuar Tabelës D.

Në raste përjashtimore ku ngjarje të jashtëzakonshme ose rrethana të paparashikuara pengojnë përmbushjen e objektivave të miratuar, mund të anashkalohet ose neutralizohet një kusht i treguesit. Në këtë rast, shuma përkatëse transferohet në transhin e radhës ose rialokohet në treguesit e tjerë të të njëjtit transh. Raste të tilla duhet t'i kërkojnë Komisionit Evropian nga Zv.Kryeministri përmes KKIPA dhe autorizohen nga i pari me shkëmbim të letrave ndërmjet dy palëve.

Në raste përjashtimore dhe të arsyetuara siç duhet, marrëveshjet e financimit mund të lejojnë rivlerësim të disa objektivave të papërmbushur në vitin pasardhës (kundrejt objektivit fillestar), nëse ka një trend pozitiv dhe Qeveria nuk e arrin objektivin për shkak të goditjeve/tronditjeve të jashtme. Rastet e tilla duhet të specifikohen në dokumentacionin e treguesit.

- Specifikoni destinacionin e fondeve të padisbursuara përkundër transheve variabël

Pasi kryhet disbursimi, fondet që i korrespondojnë përqindjes së transhit variabël që nuk është disbursuar transferohen për transhin tjetër, rialokohen në tregues të tjerë të të njëjtit transh ose riprogramohen si mbështetje plotëse nëse kjo transfertë është kërkuar dhe miratuar në pajtim me dispozitat më lart. Në të gjitha rastet e tjera, fondet që i korrespondojnë përqindjes së transhit variabël që nuk është disbursuar, digjen.



Tabela D: Transhi Variabël

Kontrata e Reformës Sektoriale "BE-ja për Qeverisjen e Mirë"			
Kësti Variabël i Parë Arritja: fundi i 2020 Vlerësimi: në T2 2021	Kësti Variabël i Dytë Arritja: fundi i 2021 Vlerësimi: në T2 2022	Kësti Variabël i Tretë Arritja: fundi i 2022 Vlerësimi: në T2 2023	Pesha
1 – Përmirësimi i mobilizimit të të ardhurave të brendshme			
Objektivi 1.1: E pazbatueshme	Objektivi 1.2: Raporti i detyrimeve tatimore të mbledhura në 2021 kundrejt totalit të detyrimeve tatimore të prapambetura > 62%	Objektivi 1.3 Raporti i detyrimeve tatimore të mbledhura në 2022 kundrejt totalit të detyrimeve tatimore të prapambetura > 65%	Viti 1: E pazbatueshme Viti 2: 1/9 Viti 3: 1/9
<u>Situata fillestare</u> : Stoku i detyrimeve dhe mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara: 74% (2019), 63% (2018), 204% (2017, ndikuar nga efektet e ligjit për faljen e detyrimeve; 51% (2016), 39% (2015)			
<u>Burimi i verifikimit</u> : E pazbatueshme	<u>Burimi i verifikimit</u> : DPT dhe MFE	<u>Burimi i verifikimit</u> : MFE dhe NjQV-të	
<u>Realizim i pjesshëm</u> : E pazbatueshme	<u>Realizim i pjesshëm</u> : Proporcionale me përqindjen e detyrimeve tatimore të mbledhura në 2021 kundrejt totalit të detyrimeve tatimore të prapambetura > 60%	<u>Realizim i pjesshëm</u> : Proporcionale me përqindjen e detyrimeve tatimore të mbledhura në 2021 kundrejt totalit të detyrimeve tatimore të prapambetura > 63.5%	
2 – Përmirësimi i kapaciteteve fiskale të njërive të qeverisjes vendore			
Objektivi: Zbatimi i Ligjit për Tatimit mbi Të Ardhurat Personale (2% shkon për NjQV-të)	Objektivi 2.2: Zbatimi i Ligjit TAP vazhdon dhe rritje e transfertës së pakushtëzuar si % e PBB-së jo më pak se 0.02% mbi minimumin ligjor 1%, ku transfertat e pakushtëzuara duhet të jenë të paktën sa viti pararendës	Objektivi 2.3: Zbatimi i Ligjit TAP vazhdon dhe rritje e transfertës së pakushtëzuar si % e PBB-së jo më pak se 0.02% krahasuar me 2021	Viti 1: 1/7 Viti 2: 1/9 Viti 3: 1/9
<u>Situata fillestare</u> : nga 838 milionë lekë (2% e TAP në 2019), 0 transferohen te NjQV-të. 1% e PBB është transfertë e pakushtëzuar për NjQV-të (2019)			
<u>Burimi i verifikimit</u> : MFE (DLF)	<u>Burimi i verifikimit</u> : MFE (DLF)	<u>Burimi i verifikimit</u> : MFE (DLF)	
<u>Realizim i pjesshëm</u> : E pazbatueshme	<u>Realizim i pjesshëm</u> : E pazbatueshme	<u>Realizim i pjesshëm</u> : E pazbatueshme	
3 – Forcimi i kontrolleve mbi alokimet			
Objektivi 3.1 Borxhi ndaj bizneseve si % e shpenzime totale në 2020 nën 4%	Objektivi 3.2 Borxhi ndaj bizneseve si % e shpenzime totale në 2021 nën 3%	Objektivi 3.3 Borxhi ndaj bizneseve si % e shpenzime totale në 2022 nën 2%	Viti 1: 1/7 Viti 2: 1/9 Viti 3: 1/9
<u>Situata fillestare</u> : Borxhi qeveritar ndaj bizneseve si % e shpenzimeve totale të qeverisjes qendrore në 2019: 4.5%; 2018: 5.4%; Vlerësimi PEFA në 2017 ishte B (<6%): 4.3%			
<u>Burimi i verifikimit</u> : MFE (DPT)	<u>Burimi i verifikimit</u> : MFE (DPT)	<u>Burimi i verifikimit</u> : MFE (DPT)	



Kontrata e Reformës Sektoriale "BE-ja për Qeverisjen e Mirë"			
Kësti Variabël i Parë Arritja: fundi i 2020 Vlerësimi: në T2 2021	Kësti Variabël i Dytë Arritja: fundi i 2021 Vlerësimi: në T2 2022	Kësti Variabël i Tretë Arritja: fundi i 2022 Vlerësimi: në T2 2023	Pesha
<u>Realizim i pjesshëm:</u> Pagesë proporcionale për më pak se 5%	<u>Realizim i pjesshëm:</u> Pagesë proporcionale për më pak se 3.5%	<u>Realizim i pjesshëm:</u> Pagesë proporcionale për më pak se 2.5%	
4 – Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore			
Objektivi 4.1: Të paktën 73% ekzekutim i vendimeve gjyqësore përfundimtare të prapambetura krahasuar me ankesat e nëpunësve civilë	Objektivi 4.2: Pagat (borderoja) gjenerohet nga HRMIS dhe paguhen automatikisht përmes AGFIS për të paktën 75% të institucioneve të administratës shtetërore	Objektivi 4.3: Pagat (borderoja) gjenerohet nga HRMIS dhe paguhen automatikisht përmes AGFIS për të gjitha institucionet e administratës shtetërore	Viti 1: 1/7 Viti 2: 1/9 Viti 3: 1/9
<u>Situata fillestare:</u> Ekzekutim i vendimeve gjyqësore përfundimtare të prapambetura krahasuar me ankesat e nëpunësve civilë: 66.5% (2019); 62.8% (2018); 48.2% (2017) Asnjë lidhje mes AGFIS dhe HRMIS; s'ka sistem automatik për pagimin e borderosë; HRMIS gjeneron raporte borderoje për 120 institucione të administratës shtetërore në fund të 2019. Në 2019, ishin 209 institucione të administratës shtetërore (pa përfshirë degët dhe njësitë e shërbimit direkt).			
<u>Burimi i verifikimit:</u> DAP	<u>Burimi i verifikimit:</u> DAP, MFE	<u>Burimi i verifikimit:</u> DAP, MFE	
<u>Realizim i pjesshëm:</u> Pagesë proporcionale për realizimin mbi 70% të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore përfundimtare të prapambetura lidhur me ankesat e nëpunësve civilë	<u>Realizim i pjesshëm:</u> Pagesë proporcionale nëse pagat (borderoja) gjenerohet nga HRMIS dhe paguhen automatikisht përmes AGFIS për të paktën 50% të institucioneve të administratës shtetërore	<u>Realizim i pjesshëm:</u> Pagesë proporcionale nëse pagat (borderoja) gjenerohet nga HRMIS dhe paguhen automatikisht përmes AGFIS për të paktën 85% të institucioneve të administratës shtetërore (Kjo përbën normë realizimi 50%)	
5 – Përmirësimi i menaxhimit të investimeve publike			
Objektivi 5.1: E pazbatueshme	Objektivi 5.2: Raporti i kontratave të monitoruara nga MFE kundrejt totalit të kontratave të nënshkruara (PPP dhe Koncesione) është të paktën 15%	Objektivi 5.3: Raporti tërësor për të gjitha investimet publike (përfshirë PPP-të dhe Koncesionet) publikohet	Viti 1: E pazbatueshme Viti 2: 1/9 Viti 3: 1/9
<u>Situata fillestare:</u> Raporti i kontratave të monitoruara nga MFE kundrejt totalit të kontratave të nënshkruara (PPP dhe Koncesione): 10.3% (23 nga 224; 2019); 2.29% (5 nga 218; 2018); 1.38% (3 nga 216; 2017) Udhëzim MIP (VKM nr. 185, "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike) miratuar në mars 2018 parashikon procedura të hollësishme që rregullojnë procesin e vlerësimit, priorizimit dhe monitorimit të projekteve të investimeve publike; Moduli MIP i parashikuar në AFMIS ende nuk është bërë funksional; nuk publikohet raport tërësor për MIP.			



Kontrata e Reformës Sektoriale "BE-ja për Qeverisjen e Mirë"			
Kësti Variabël i Parë Arritja: fundi i 2020 Vlerësimi: në T2 2021	Kësti Variabël i Dytë Arritja: fundi i 2021 Vlerësimi: në T2 2022	Kësti Variabël i Tretë Arritja: fundi i 2022 Vlerësimi: në T2 2023	Pesha
Burimi i verifikimit: Buxheti i MFE dhe zbatimi, politika e Kryeministrit, politikat sektoriale	Burimi i verifikimit: Raporti i MFE	Burimi i verifikimit: faqja e internetit e MFE (DMIP)	
Realizim i pjesshëm: E pazbatueshme	Realizim i pjesshëm: Pagesë proporcionale për realizim të objektivit të paktën 50%	Realizim i pjesshëm: Raporti tërësor për të gjitha investimet publike (PPP-të dhe Koncesionet) përgatitet (Kjo përbën normë realizimi 50%)	
6 – Integriteti i institucioneve publike			
Objektivi 6.1: 6 bashki kanë zbatuar plan vendor integriteti	Objektivi 6.2: Të gjitha ministratë kanë miratuar plan integriteti dhe të paktën 4 bashki shtesë kanë zbatuar plan vendor integriteti, krahasuar me 2020	Objektivi 6.3: Të paktën 6 bashki kanë zbatuar plan integriteti dhe të paktën 10 bashki shtesë kanë zbatuar plan vendor integriteti, krahasuar me 2021	Viti 1: 1/7 Viti 2: 1/9 Viti 3: 1/9
<u>Situata fillestare:</u> Është miratuar Metodologjia për Vlerësimin e Rreziqeve ndaj Integritetit dhe Pani i Integritetit i Ministrisë së Drejtësisë (2020). Udhëzimet nuk janë hartuar ose nuk u janë dërguar bashkive ende (2019). Por, 6 bashki hartuan dhe miratuan një plan vendor integriteti.			
Burimi i verifikimit: raport vjetor i Strategjisë Anti-korrupsion, raporti i AMVV	Burimi i verifikimit: raport vjetor i Strategjisë Anti-korrupsion, raporti i AMVV	Burimi i verifikimit: raport vjetor i Strategjisë Anti-korrupsion, raporti i AMVV	
Realizim i pjesshëm: Të paktën 3 bashki kanë zbatuar një plan vendor integriteti (Kjo përbën normë realizimi 50%)	Realizim i pjesshëm: Të paktën 75% e ministrave kanë miratuar një plan integriteti dhe të paktën 3 bashki shtesë kanë zbatuar një plan vendor integriteti, krahasuar me 2020 (Kjo përbën normë realizimi 50%)	Realizim i pjesshëm: Të paktën 4 ministri kanë zbatuar një plan integriteti dhe të paktën 7 bashki shtesë kanë zbatuar një plan vendor integriteti, krahasuar me 2021 (Kjo përbën normë realizimi 50%)	
7 – Transparenca e aktivitetit shkencor dhe aksesit në informacion për qytetarët			
Objektivi 7.1: Të paktën 44 institucione shtesë zbatojnë me korrektësi programet e transparencës, krahasuar me 2019	Objektivi 7.2: Të paktën 35 institucione shtesë përdorin regjistrin/sistemin IT të kërkesave dhe përgjigjeve për ankesat, krahasuar me 2020	Objektivi 7.3: Të paktën 122 institucione përdorin regjistrin/sistemin TI të kërkesave dhe përgjigjeve për ankesat	Viti 1: 1/7 Viti 2: 1/9 Viti 3: 1/9
<u>Situata fillestare:</u> Në 2019, nga 417 institucione publike, (a) 246 institucione publike publikuan programin e transparencës. Nga këto 246, (b) 236 caktuan një koordinator për të drejtën e informimit. Nga këto 236, (c) 189 publikuan regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve dhe kështu zbatuan me korrektësi programin e transparencës (hapat a deri c). 30 institucione publike po përdorin regjistrin qendror/sistemin TI. Në 2018, regjistri qendror u ngrit dhe u miratua me VKM.			
Burimi i verifikimit: IDP (Raport vjetor)	Burimi i verifikimit: IDP (Raport vjetor)	Burimi i verifikimit: IDP (Raport vjetor)	
Realizim i pjesshëm: Të paktën 22 institucione	Realizim i pjesshëm: Të paktën 25 institucione	Realizim i pjesshëm: Të paktën 100	



Kontrata e Reformës Sektoriale "BE-ja për Qeverisjen e Mirë"			
Kësti Variabël i Parë Arritja: fundi i 2020 Vlerësimi: në T2 2021	Kësti Variabël i Dytë Arritja: fundi i 2021 Vlerësimi: në T2 2022	Kësti Variabël i Tretë Arritja: fundi i 2022 Vlerësimi: në T2 2023	Pesha
shtesë zbatojnë me korrektësi programet e transparencës, krahasuar me 2019 (Kjo përbën normë realizimi 50%)	shtesë përdorin regjistrin/sistemin TI për ankesat, krahasuar me 2020 (Kjo përbën normë realizimi 50%)	institucione përdorin regjistrin/sistemin TI të kërkesave dhe përgjigjeve për ankesa, (Kjo përbën normë realizimi 50%)	
8 – Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe kapaciteteve në nivel vendor			
Objektivi 8.1: 90% e masave të Urdhrit të Kryeministrit nr. 1010, datë 3.7.2019 janë rishikuar dhe harmonizuar	Objektivi 8.2: Të paktën 50% e masave të "Matricës së Kompetencave për Vetëqeverisjen Vendore" që nuk janë në Urdhrin e Kryeministrit nr. 1010, datë 3.7.2019 janë rishikuar dhe harmonizuar	Objektivi 8.3: Lista e standardeve kombëtare bazë për shërbimet që prekin qeverisjen vendore miratohen dhe të paktën 50% e standardeve hartohen	Viti 1: 1/7 Viti 2: 1/9 Viti 3: 1/9
Situata fillestare: Urdhri i Kryeministrit nr. 1010, datë 3.7.2019 zbatohet me 70% deri në qershor 2020.			
Burimi i verifikimit: Raporti i KK/AMVV; Fletorja Zyrtare	Burimi i verifikimit: Raporti i KK/AMVV; Fletorja Zyrtare	Burimi i verifikimit: Raporti i KK/AMVV; Fletorja Zyrtare	
Realizim i pjesshëm: Harmonizohet të paktën 80% (Kjo përbën normë realizimi 50%)	Realizim i pjesshëm: Harmonizohet të paktën 30% (Kjo përbën normë realizimi 50%)	Realizim i pjesshëm: Lista miratohet dhe hartimi arrihet për të paktën 30% (Kjo përbën normë realizimi 50%)	
9 – Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët			
Objektivi 9.1: Qytetarët kanë akses në qendrat e shërbimit ADISA në të paktën 18 bashki	Objektivi 9.2: Qytetarët kanë akses në qendrat e shërbimit ADISA në të paktën 21 bashki	Objektivi 9.3: Të paktën 80% e qytetarëve që përdorin qendrat e shërbimit ADISA janë të kënaqur me shërbimin e marrë	Viti 1: 1/7 Viti 2: 1/9 Viti 3: 1/9
Situata fillestare: 2019: 9 bashki kanë qendra shërbimi ADISA; 2018: 65% të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet publike (anketa/vrojtimi i Bankës Botërore); 2016: 51% të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet publike (Anketa Kombëtare)			
Burimi i verifikimit: DAP (Treguesit e Strategjisë RAP, pasaporta 5.a) dhe AKSHI.	Burimi i verifikimit: DAP (Treguesit e Strategjisë RAP, pasaporta 5.b) dhe AKSHI.	Burimi i verifikimit: Vrojtmet e ADISA-s	
Realizim i pjesshëm: Nëse qytetarët kanë akses në qendrat e shërbimit ADISA në të paktën 16 bashki (Kjo përbën normë realizimi 50%)	Realizim i pjesshëm: Të paktën 50% i objektivit ADISA arrihet krahasuar me numrin e bashkive me qendra shërbimi të aksesueshme nga fundi i 2020 (Kjo përbën normë realizimi 50%)	Realizim i pjesshëm: Proporcionale (pro-rata) nëse të paktën 70% që përdorin shërbimet ADISA janë të kënaqur me shërbimet që marrin	

**SHTOJCA 3: Aktivitetet plotësuese: ndarja buxhetore indikative dhe panifikimi për procedurat e kontraktimit**

MODALITETET E ZBATIMIT	BUXHETI (€)		AFATI	
	Total	Kontributi i BE-së	Shpallja e procedurës	Nënshkrimi i kontratës ⁴
PROKURIMI				
Kontratë(a) shërbimi për asistencë teknike dhe ndërtim kapacitetesh	6 100 000	6 100 000	T4 2020	T2 2021 - T4 2021
FWC për monitorimin e jashtëm	500 000	500 000	T4 2020	T1 2021
FWC për komunikimin dhe vizibilitetin	500 000	500 000	T4 2020	T1 2021
GRANTE				
Thirrja(e) për propozime për grante – të paktën një kontratë	2 694 444 ^{*)}	2 500 000	T3 2019	T4 2020
MENAXHIM INDIREKT me subjekt të besuar	2 500 000	2 500 000	Q3 2020	Q4 2020
TOTAL	12 294 444	12 100 000		

*) Kjo shumë është llogaritur bazuar në supozimin se komponenti i nën-grantit, financuar nga BE do të jetë 70% e grantit të financuar nga BE prej 2.5 milionë Euro (0.70 *2 500 000 = 1 750 000 Euro), dhe ky kontribut bashkëfinancues i qeverisë qendrore tek komponenti i nën-grantit do të jetë i barabartë me të paktën 10% të totalit të komponentit të nën-grantit. Kontributi bashkëfinancues i qeverisë qendrore tek komponenti i nën-grantit do të jetë të paktën EUR 194 444, emërtuar 10% e 1 944 444 (1 750 000 + 194 444 = 1 944 444). Pra një total prej 2 500 000 Euro e kontributit të BE dhe një shumë indikative prej 194 444 bashkëfinancimi kombëtar.

⁴ Data indikative për nënshkrimin e kontratës.



INSTRUMENTI PËR ASISTENCËN E PARAAANËTARËSIMIT (IPA II)
2014–2020

SHTOJCA IA BIS

MBËSHTETJA BUXHETORE E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT TË PROGRAMIN
VJETOR TË VEPRIMIT PËR SHQIPËRINË, PËR VITIN 2020

Shqipëria
BE-ja për Rimëkëmbjen Ekonomike

Përmbledhje e Veprimit: Kontratë Performance në Reformimin e Sektorit.

Objekti i përgjithshëm: Zbutja e ndikimit të krizës së COVID-19 në Shqipëri.

Objektivat specifikë: i. reduktimi i efekteve makroekonomike dhe përçarjet në ekonomi; ii. aksesit në ndihmë ekonomike për bizneset vulnerabël dhe personat e papunë.

Identifikimi i Veprimit			
Titulli i Programit të Veprimit	Programi Kombëtar Vjetor i Veprimit për Shqipërinë për vitin 2020.		
Titulli i Veprimit	BE-ja për Rimëkëmbjen Ekonomike në përgjigje të COVID-19.		
Identifikimi i Veprimit	IPA 2020/042-915/AL/BE për Rimëkëmbjen Ekonomike.		
Informacion Sektorial			
Sektori IPA II	Demokracia dhe Qeverisja.		
Sektor DAC	15142 Politikat Makroekonomike.		
Buxheti			
Kostoja totale	26 000 000 euro.		
Kontributi i BE-së	26 000 000 euro.		
Linja(t) e buxhetit	BGUE-B2020-22.020102-C1-NEAR DELALB.		
Menaxhimi dhe Zbatimi			
Metoda e zbatimit	Mbështetje Buxhetore Direkte: Kontratë Performance në Reformimin e Sektorit.		
Menaxhimi direkt: Delegacioni i BE-së	Shqipëria.		
Përgjegjësitë e zbatimit	Zv.Ministrja e Financave, znj. Adela Xhemali; Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE); Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT); Ministri i Shtetit për Koordinimin e Përballimit të COVID-19; Kryeministria; Banka e Shqipërisë (BSh).		
Vendndodhja			
Zona që përfiton nga Veprimi	Shqipëria.		
Afati			
Afati për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit me përfituesin IPA II	Jo më vonë se data 31 dhjetor 2021.		
Afati për lidhjen e marrëveshjeve të prokurimit dhe grantit	3 vjet pas datës së lidhjes së Marrëveshjes së Financimit, përveç rasteve të renditura në nenin 189(2) të Rregullores Financiare.		
Afati për zbatimin operacional	6 vjet pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit.		
Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit (data kur ky program duhet të mbyllet)	12 vjet pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit.		
Objektivat e politikave/treguesit (formulari DAC)			
Objekti i përgjithshëm i politikave	I pasynuar	Objektiv i rëndësishëm	Objektiv kryesor
Zhvillimi i pjesëmarrjes/qeverisja e mirë	☐	☒	☐
Ndihma ndaj mjedisit	☒	☐	☐
Barazia gjinore (përfshirë Gratë në Zhvillim)	☐	☒	☐
Zhvillimi i tregtisë	☐	☒	☐



Shëndeti riprodhues, amëzor, i të sapolindurve e fëmijëve	☒	☐	☐
Treguesit e Konventës së RIO-s	I pasynuar	Objektiv i rëndësishëm	Objektiv kryesor
Diversiteti biologjik	☒	☐	☐
Lufta ndaj shkretimit	☒	☐	☐
Zbutja e ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	☒	☐	☐
Treguesit e brendshëm			
Migrimi	☒	☐	☐
Përballimi i COVID-it	☐	☐	☒

PËRSHKRIMI I VEPRIMIT

Objektivat/rezultatet

Objekti i përgjithshëm është zbutja e ndikimit të krizës së COVID-19 në Shqipëri.

Objektivat specifikë janë të dyfishtë: i. reduktimi i efekteve makroekonomike dhe përçarjeve në ekonomi; dhe ii. akses në ndihmë ekonomike për bizneset vulnerabël dhe personat e papunë, që në vetvete do të forcojë qëndrueshmërinë e bizneseve dhe ‘rrjetën e sigurisë’ për personat e papunë në planin afatshkurtër deri afatgjatë.

Treguesit e rezultateve renditen në një listë indikative për të matur progresin në realizimin e objektivave specifikë përfshijnë: të ardhurat si: % të PBB-së; konsumin privat si % e PBB-së; investimet publike dhe private si % të PBB-së; shkallën e papunësisë; dhe numrin e bizneseve aktive.

Këto objektiva pritet të realizohen nëpërmjet rezultateve të induktuara si: reduktimi i ekonomisë informale dhe *cash-it*; rritja e mobilizimit të të ardhurave të brendshme (DRM); miratimi i programit për tregun aktiv të punës (PTAP) që mbështet të vetëpunësuarit dhe të papunët; si edhe mbështetja e bizneseve me likuiditet/akses në financim. Lista indikative e treguesve për matjen e këtyre rezultateve përfshin numrin e transaksioneve me kartë në pagesat me pakicë, numri i bizneseve që zbatojnë sistemin e ri të faturimit elektronik, publikimin e Strategjisë Afatmesme për të Ardhurat (SAA) për konsultim publik, detyrimet e prapambetura kundrejt shpenzimeve dhe detyrimet e TVSH-së së pa rimbursuar, numrin e të papunëve të punësuar nëpërmjet PTAP-së (përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë) dhe numrin e bizneseve që përfitojnë nga rimbursimi i shpenzimeve për zbatimin e protokollit të kuq të masave shëndetësore kundër COVID-19.

Zinxhiri i rezultateve			Treguesi	Burimi i të dhënave
Ndikimi	Ndikimi (objekti i përgjithshëm)	Zbutja e ndikimit të krizës së COVID-19 në Shqipëri.	Rritja e PBB-së.	MFE-ja, INSTAT-i, BSh-ja.
Rezultate(t)	Rezultati 1 (objekti i specifik)	1. Reduktimi i efekteve makroekonomike dhe përçarjeve të ekonomisë.	a) Të ardhurat si % e PBB-së; b) Konsumi privat si % e PBB-së.	MFE-ja, INSTAT-i, DPT-ja.
	Rezultati 2 (objekti i specifik)	2. Forcimi i qëndrueshmërisë së bizneseve dhe ‘rrjetës së sigurisë’ për personat e papunë në planin afatshkurtër deri afatgjatë.	a) Shkalla e papunësisë; b) Numri i bizneseve aktive.	MFE-ja, INSTAT-i, DPT-ja, Bizneset vendase.
Rezultate(t) të induktuara	Rezultati i induktuar lidhur me Rezultat 1	1.1 Reduktohet ekonomia informale/ <i>cash-i</i>	a) Numri i pagesave me kartë në blerjet me pakicë; b) Bizneset që zbatojnë sistemin e ri të faturimit elektronik.	MFE-ja, DPT-ja, BSh-ja, Shoqata Shqiptare e Bankave, INSTAT-i,



Zinxhiri i rezultateve			Treguesi	Burimi i të dhënave
				AKShI.
Rezultati i induktuar lidhur me Rezultatin 1	1.2 Mobilizimi i të ardhurave të brendshme rritet		a) Konsultimi publik i Strategjisë afatmesme për të ardhurat (SAA); b) Detyrimet e prapambetura kundrejt shpenzimeve; c) Detyrimet rimbursim TVSH-je.	MFE-ja, DPT-ja, Thesari.
Rezultati i induktuar lidhur me Rezultatin 2	2.1 Programi për tregun aktiv të punës (PTAP) miratohet për të mbështetur të vetëpunësuarit dhe të papunët		Numri i të papunëve të punësuar nëpërmjet Programit për Tregun Aktiv të Punës.	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, MFE-ja, DPT-ja.
Rezultati i induktuar lidhur me Rezultatin 2	2.2 Bizneset mbështeten me likuiditet/akses në financim		a) Numri i bizneseve që përfitojnë nga rimbursimi i shpenzimeve për zbatimin e protokollit të kuq të masave shëndetësore kundër COVID-19.	MFE-ja, BSh-ja,

Aktivitetet kryesore

Mbështetja buxhetore

Inputet e nevojshme për të mundësuar rezultate direkte janë financimi, dialogu i politikave ndërmjet institucioneve publike shqiptare dhe BE-së, si edhe kushtet e disbursimit. Transferimi i fondeve të mbështetjes buxhetore do t'i mundësojë qeverisë që të reduktojë përçarjet e ekonomisë dhe efektet që pandemia shkaktoi në kushtet makroekonomike.

Mundësitë që pritet t'i përmirësohen Shqipërisë si pasojë direkte e fondeve të mbështetjes buxhetore janë krijimi i hapësirës fiskale në situatën e krizës së COVID-19, nëpërmjet transferimit të fondeve, rritje të parashikueshmërisë së fondeve, reduktim të kostove të transaksioneve, dialog politikash të koordinuar, si edhe përmirësim të monitorimit të reformave.

Mbështetja plotësuese

Për shkak të natyrës afatshkurtër të programit, nuk parashikohet mbështetje plotësuese për mbështetjen buxhetore të propozuar.

Logjika e ndërhyrjes

Kriza e COVID-19 pati ndikim negativ të PBB-ja dhe shkaktoi rritje të papunësisë dhe humbje të të ardhurave informale. Sektorët më të goditur janë turizmi dhe manufaktura që priteshin të gjeneronin rritje dhe më shumë mundësi punësimi. Konsumi privat shënoi rënie drastike, ku të vetëpunësuarit, të

punësuarit dhe punësuarit informalë iu shtuan numrit të shqiptarëve pa përfitime të përshtatshme papunësie dhe me mbrojtje sociale të kufizuar.

Qeveria shqiptare e përballoi krizën e COVID-19 me një përqasje të përshkallëzuar: me një paketë fillestare që fokusohej te nevojat imediate të grupeve vulnerabël, nevojat mjekësore të sektorit shëndetësor, disa kategori të punësuarish në sektorin privat dhe të vetëpunësuar, si edhe një hua sovranë për bizneset e mëdha që kishin nevojë për likuiditet që të paguanin pagat e punëtorëve. Paketa e dytë trajtoi një kategori më të madhe punëtorësh të sektorit privat dhe nevojat për likuiditet për operacionet e biznesit.

Në këtë kontekst, masat në nivelin e inputeve synuan reduktimin e ekonomisë informale dhe *cash-it*, mbështetjen e të vetëpunësuarve dhe të papunëve, si edhe injektimin e likuiditetit te bizneset e prekura, të cilat do të çojnë në rezultatin e forcimit të “qëndrueshmërisë së bizneseve dhe ‘rrjetës së sigurisë’ për të papunët në planin afatshkurtër deri afatgjatë”. Ky rezultat do të ketë ndikim në zbutjen e përçarjeve ekonomike dhe sociale që shkaktoi pandemia COVID-19. Gjithashtu, reduktimi i detyrimeve të prapambetura të rimbursimit të TVSH-së do të përmirësojë jo vetëm klimën e biznesit dhe besimin te qeveria, por edhe fluksin e parasë së bizneseve në këtë periudhë tronditjesh.

Në nivelin makroekonomik, tërmeti i viti 2019, kriza e COVID-19 dhe masat përballuese të Qeverisë shkaktuan përçarje në rritjen ekonomike dhe në konsolidimin fiskal. Defiçiti fiskal pritet të rritet, për shkak të rishikimeve të buxhetit dhe huave ndërkombëtare për të përballuar nevojën urgjente për balancën e pagesave. Supozimi është që masat për të përmirësuar klimën e biznesit dhe të investimeve, si dhe për të stabilizuar mobilizimin e të ardhurave të brendshme do të mbështetnin stabilitetin makroekonomik në planin afatmesëm. Në veçanti, publikimi i SAA-së për konsultim publik dhe reduktimi i detyrimeve të prapambetura do të kontribuojnë në zbutjen e efekteve negative makroekonomike të shkaktuara nga COVID-19.

Logjika e ndërhyrjes bazohet në këto supozime kryesore: i. s'ka më paketa reformash gjatë vitit 2020; ii. finalizimi i SAA-së do të rritë parashikueshmërinë e politikave tatimore; dhe iii. publikimin e likuidimit të detyrimeve ekzistuese dhe të reja në nivel qendror dhe vendor në kohën e duhur brenda tremujorit pasues.

Zbatimi

Arsyetimi për fondet e alokuara si mbështetje buxhetore

Fondet e alokuara për komponentin 'mbështetja buxhetore' janë 26 milionë euro. Kjo shumë bazohet në parashikimet më të fundit të ndikimit fiskal që pati kriza, edhe pse në rrethana shumë të paparashikueshme që mund të rezultojë në tkurrje të të ardhurave dhe shpenzime shtesë. Në pesë muajt e parë të vitit 2020, të ardhurat e realizuara ishin 7% (ose 67 milionë euro) poshtë planit. Premisat për pjesën tjetër të vitit 2020 janë për një recesion të përgjithshëm në marzhin 5% të PBB-së.

Kriteret për disbursimin e mbështetjes buxhetore

a) Kushtet e përgjithshme për disbursimin e të gjitha transheve janë si vijon:

- Progresi i kënaqshëm në zbatimin e paketës anti-COVID-¹¹ dhe rekomandimeve të politikës së Programit të Reformave Ekonomike (PRE) posaçërisht për përballimin e COVID-19 dhe vijimësia e besueshmërisë dhe relevancës së saj;

- Ruajtja e një politike makroekonomike të besueshme, relevante dhe të orientuar drejt

stabilitetit ose progresi i bërë drejt rivendosjes së balancave kyçe;

- Progresi i kënaqshëm në zbatimin e reformave për përmirësimin e menaxhimit financiar publik, duke përfshirë mobilizimin e të ardhurave të brendshme, si edhe vijimin e relevancës dhe besueshmërisë së programit të reformave;

Progresi i kënaqshëm për sa i përket ofrimit për publikun të informacionit buxhetor të qëndrueshëm, tërësor dhe në kohë;

b) Disbursimi i transhit variabël bazohet në kriteret e përcaktuara në shtojcën 2 "Modalitetet dhe kalendar i disbursimit".

Objektivat dhe treguesit e performancës që zbatohen për këtë transh zbatohen për të gjithë kohëzgjatjen e programit. Megjithatë, në rrethana të justifikuara siç duhet, Koordinatori Kombëtar IPA (KKIPA) mund t'i dorëzojë Komisionit një kërkesë për ndryshimin e objektivave dhe treguesve. Ndryshimet e miratuara për këto objektiva dhe tregues mund të autorizohen me shkëmbim letrash ndërmjet dy palëve.

Në rast përkeqësimi thelbësor të vlerave bazë, disbursimet e mbështetjes buxhetore mund të pezullohen formalisht, të pezullohen përkohësisht, të reduktohen ose të anulohen sipas dispozitave përkatëse të marrëveshjes së financimit.

Detajet e mbështetjes buxhetore

Komponenti 'mbështetja buxhetore' konsiston në një trans fikse (10 milionë euro) që pritet të disbursohet në tremujorin IV, të vitit 2020, sapo të nënshkruhet marrëveshja e financimit, me kusht që të përmbushen kriteret; ndërsa në gjysmën e dytë të vitit 2021 do të disbursohet një trans fikse (3 milionë euro) dhe një trans variabël (13 milionë euro).

Mbështetja buxhetore është mbështetje direkte e pasynuar që i jepet Thesarit Kombëtar. Kreditimi i transfertave në euro që disbursohen në lekun shqiptar (LEK) do të bëhet sipas kursit të këmbimit që përcaktojnë dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së Financimit.

Struktura organizative dhe përgjegjësitë

Për qëllimet e këtij programi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të jetë përgjegjëse për raportin periodik, lidhur me treguesit e përcaktuar në logjikën e ndërhyrjes. Po kjo Ministri është përgjegjëse për raportimin, lidhur me paketat e tjera të ndihmës si p.sh. Asistenca Makrofinanciare.

¹¹ Nr. 6, datë 21.3.2020, VKM-ja nr. 254, datë 27.3.2020, VKM-ja nr. 277 datë 6.4.2020; akti nr. 15, datë 15.4.2020, VKM-ja nr. 305, datë 16.4.2020 (e ndryshuar me VKM-në nr. 13, datë 22.4.2020 dhe datë 28.4.2020).



Ministri i Shtetit për Rindërtimin, post ky i krijuar pas tërmetit të nëntorit 2019, është i ngarkuar me koordinimin e masave të përballimit të COVID-19, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe palët e tjera të interesuara.

Monitorimi dhe raportimi i performancës

Monitorimi i përditshëm teknik dhe financiar i zbatimit të këtij veprimi do të jetë një proces i vazhdueshëm dhe pjesë e përgjegjësisë të partnerit zbatues. Për këtë qëllim, partneri zbatues do të ngrejë një sistem monitorimi permanent të brendshëm, teknik dhe financiar për veprimin, si edhe do të përgatitë raporte progresi periodike (të paktën vjetore) dhe raporte përfundimtare. Secili raport do të japë një panoramë të qartë të zbatimit të masës, vështirësive të hasura, ndryshimeve të bëra, si edhe masën e arritjes së rezultateve, të matur sipas treguesve përkatës, duke përdorur si referencë listën e treguesve të rezultateve. Raporti do të shtjellohet në mënyrë që të lejojë monitorim të mjeteve të parashikuara dhe të përdorura, si edhe të detajeve të buxhetit për veprimin. Raporti përfundimtar në formë përshkruese dhe financiare do të përfshijë të gjithë periudhën e zbatimit të masës.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të ofrojë të gjitha të dhënat e nevojshme për të vlerësuar progresin kundrejt treguesve, siç përcaktohet në logjikën e ndërhyrjes, çdo tremujor nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Financimit. Këto të dhëna do të shërbejnë për rishikimet e programit dhe do të përdoren si bazë për të vlerësuar kushtet e disbursimit. Komisioni mundet që me nismë të vet të realizojë misione të pavarura për shqyrtimin e përputhshmërisë, në mënyrë që të vlerësojë besueshmërinë e informacionit të përdorur për disbursimin.

Komisioni mund të realizojë vizita monitorimi shtesë të projektit, qoftë nëpërmjet personelit të vet, ashtu edhe nëpërmjet konsulentëve të pavarur, të pajtuar drejtpërdrejt nga Komisioni për monitorim të pavarur (apo të rekrutuar nga agjenti përgjegjës i kontraktuar nga Komisioni për zbatimin e monitorimeve të tilla).

Vlerësimi dhe auditimi

Bazuar në natyrën e veprimit, nuk do të kryhen vlerësime të ndara për këtë veprim apo për komponentët e tij.

Në rast se nuk parashikohet realizimi i një vlerësimi, Komisioni mundet që gjatë zbatimit të ndërmarrë një vlerësim të tillë për arsye të justifikuar siç duhet, ose me vendim të vet ose me nismën e partnerit.

Komisioni duhet të informojë partnerin zbatues të paktën 2 muaj para nga data e parashikuar për misionet e vlerësimit. Partneri zbatues duhet të bashkëpunojë me efektivitet dhe efikasitet me ekspertët vlerësues, si edhe t'u vërë në dispozicion, ndër të tjera, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, dhe akses në mjediset dhe aktivitetet e projektit.

Raportet e vlerësimit duhet t'i vihen në dispozicion përfituesit IPA dhe grupeve kyçe të interesit. Partneri zbatues dhe Komisioni duhet të analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, sipas rastit, në mirëkuptim me përfituesin IPA II, vendosin bashkërisht masat ndjekëse që duhen marrë dhe ndonjë modifikim të nevojshëm, duke përfshirë edhe riorientimin e projektit nëse është e nevojshme.

Lista e shtojcave

1. Treguesit e performancës që përdoren për disbursimet
2. Modalitetet dhe kalendari i disbursimit

**SHTOJCA 1: Treguesit e Performancës që përdoren për disbursimet**

Treguesi nr. 1:	Numri i pagesave me kartë në blerjet me pakicë (1.1.1)
Politika:	Programi i Reformave Ekonomike; Ligji i miratuar për sistemet e pagesave
Objektivi:	Reduktimi i transaksioneve në <i>cash</i> dhe i ekonomisë informale
Departamenti	BSh; bankat e nivelit të dytë, institucionet e reja jobankare që do të liçencohen sipas Ligjit të ri për Sistemet e Pagesave
Lloji i treguesit:	Sasior: rritja e pagesave me kartë në blerjen me pakicë
Njësia matëse:	Numri i transaksioneve pa <i>cash</i> (pagesat me kartë në blerjet me pakicë)
Metoda e llogaritjes:	Numri i shërbimeve bankare shtëpiake dhe pagesat me kartë në blerjet me pakicë. Proporcionale: deri 50% të objektivit të plotë: 0; Mbi 50% të objektivit të plotë: proporcionale sipas formulës: $\text{Pagesa proporcionale} = (\text{Objektivi i arritur} / \text{Objektivin e plotë}) \times \text{pagesën e plotë}$ Arritja e plotë është 1.0; Arritja e pjesshme është midis 0.5 deri 1.0.
Segregimi:	E pazbatueshme
Metoda e mbledhjes së të dhënave:	Të dhënat administrative (Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave)
Shpeshtësia e matjes:	Tremujore
Departamentet përgjegjëse:	Departamenti i sistemeve të pagesave; departamenti i stabilitetit financiar në Bankën e Shqipërisë; Shoqata Shqiptare e Bankave
Data e realizimit:	<u>T3 2021</u> : Të dhënat nga fillimi i T1 2020 deri fundi i T2 2021
Limitet dhe trendi:	Pengesat ndaj aksesit në shërbimet financiare për personat e kategorive vulnerabël dhe pakicat.
Mjetet e interpretimit:	Mat rritjen e përdorimit të metodave të avancuara të pagesave me kartë në përputhje me hartimin e legjislacionit për sistemet e pagesave
Ndryshimi në metodologji	E pazbatueshme
Situata fillestare	2019: 8 079 409 transaksione
Objektivat	Objektivi Vjetor 1: Pagesat me kartë në blerjet me pakicë rriten me 30% deri në fund të qershorit 2021 (nga fundi i T2 2021) Objektivi i pjesshëm Vjetor 1: Proporcionale nën 50% të objektivit të plotë: 0. Mbi 50% të objektivit të plotë: proporcionale.



Treguesi nr. 2:	Numri i bizneseve që zbatojnë sistemin e ri të faturimit elektronik (segretim sipas kategorive të biznesit, xhiros dhe llojit të transaksionit) (1.1.2)
Politika:	“Strategjia e Administratës Tatimore 2017-2021”, e miratuar nga Drejtoria e Hetimit Tatimor (DPT), Vendimi nr. 8, datë 07.12.2016 i Komitetit të Reformave. Aty referohet Plani i Veprimit i FATF (Task Forca e Aksionit Financiar), masat e të cilit do të zbatohen deri në tetor 2021 për të mundësuar heqjen e Shqipërisë nga "lista gri" e FATF-së).
Objektivi:	Trajtimi i ekonomisë informale dhe reduktimi i përdorimit të <i>cash</i> -it
Departamenti:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Lloji i treguesit:	Sasior
Njësia matëse:	Numri
Metoda e llogaritjes:	Numri i bizneseve që zbatojnë faturën elektronike B2B deri në fund të gushtit 2021 Arritja e plotë është 1.0; Arritja e pjesshme është midis 0.5 deri 1.0.
Segregimi:	p.sh. sipas gjinisë, zonës gjeografike apo grupeve të popullatës
Metoda e mbledhjes së të dhënave:	Të dhëna administrative (INSTAT, MFE, AKShI)
Shpeshtësia e matjes:	Mujore/tremujore
Departamentet përgjegjëse:	Drejtoria e Hetimit Tatimor (DPT); AKShI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit)
Data e realizimit:	Deri 15 tetor 2021; të dhënat nga 1 korriku 2021 deri 31 gushti 2021 për kategorinë B2B
Limitet dhe trendi:	E pazbatueshme
Mjetet e interpretimit:	Treguesi që mat numrin e bizneseve (shiko më lart kategoritë) që zbatuan sistemin e faturimit elektronik B2B, që është praktikë e konsoliduar siç është certifikuar nga DPT dhe AKShI. Ligji përkatës parashikon afatin kur fillon zbatimi real i sistemit të faturimit elektronik për secilën kategori biznesi, në varësi të xhiros dhe llojit të transaksionit: B2B – 1 gusht 2021
Ndryshimi në metodologji:	E pazbatueshme
Situata fillestare	Korrik 2020: bizneset që zbatojnë faturën elektronike B2B: zero
Objektivat	Objektivi Vjetor 1: Numri i bizneseve që lëshojnë faturë elektronike B2B deri në fund të gushtit 2021: 10 000 biznese. Objektivi i pjesshëm Vjetor 1: Nën 50% të objektivit të plotë: 0. Mbi 50% të objektivit të plotë: proporcionale.



Treguesi nr. 3:	Publikimi i SAA për konsultim publik (1.2.1)
Politika:	Hartimi i Strategjisë Afatmesme për të Ardhurat (SAA) ishte objektiv i PRE 2019
Objektivi:	Rritja e mobilizimit të të ardhurave të brendshme
Departamenti:	MFE, DPT
Lloji i treguesit:	Sasior
Njësia matëse:	E pazbatueshme
Metoda e llogaritjes:	Shuma e plotë paguhet pasi publikohet SAA për konsultim publik në T2 2021 Arritja e plotë është 1.0; Arritja e pjesshme: E pazbatueshme
Segregimi:	E pazbatueshme
Metoda e mbledhjes së të dhënave:	Publikimi në faqen zyrtare të internetit për konsultim publik
Shpeshtësia e matjes:	Në momentin kur dorëzohet kërkesa për pagesë
Departamentet përgjegjëse:	MFE
Data e realizimit:	T3 2021: Publikimi i referencave dhe/ose raporteve të konsultimit publik mbi SAA
Limitet dhe trendi:	E pazbatueshme
Mjetet e interpretimit:	Hartimi i SAA-së pritet të rritë në mënyrë strategjike përqindjen e të ardhurave në PBB, duke përfshirë luftën ndaj informalitetit dhe evazionit fiskal. Shqipëria ka raport të ardhurash tatimore 25.4% të PBB, që është i ulët krahasuar me rajonin, kryesisht prej mbledhjes joefikase të tatimeve, erozionin e bazës tatimpaguese dhe ekonomisë së madhe informale. Rritja e të ardhurave tatimore do të ndihmojë në rindërtimin e amortizuesve fiskalë dhe në forcimin e qëndrueshmërisë së borxhit. SAA do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave; udhërrëfyesi për zbatimin e tij do të miratohet me vendim të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.
Ndryshimi në metodologji:	E pazbatueshme
Situata fillestare:	Projekt-SAA po rishikohet për të reflektuar ndikimet e COVID-19
Objektivat:	Objektivi Vjetor 1: SA publikohet për konsultim publik deri maksimumi T2 2021 për pagesë të plotë. Nuk ka arritje të pjesshme.



Treguesi nr. 4:	Numri i punëtorëve informalë të larguar nga puna përshkak të COVID-19 që ripunësohen nëpërmjet Programit të Tregut Aktiv të Punës 2 (2.1.1)
Politika:	Programi i Tregut Aktiv të Punës (PTAP); PRE 2020-2022 (Masa nr. 9 për reduktimin e ekonomisë informale)
Objektivi:	Mbështetja e punëtorëve informalë të larguar nga puna që vetëdeklarojnë statusin e tyre (të punësuar para pandemisë COVID-19 por që janë të panjohur për autoritetet tatimore)
Departamenti përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)
Lloji i treguesit:	Sasior
Njësia matëse:	Numri i përfituesve të ndarë sipas gjinisë dhe etnisë.
Metoda e llogaritjes:	Numri i përfituesve të regjistruar në programin PTAP 2 duke u regjistruar me AKPA-n. Arritja e plotë është 1.0; Arritja e pjesshme: proporcionale nga 0.5 deri 1.0
Segregimi:	E pazbatueshme
Metoda e mbledhjes së të dhënave:	Të dhëna administrative (Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive)
Shpeshtësia e matjes:	Tremujore
Departamentet përgjegjëse:	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
Data e realizimit:	T3 2021: Numri i përfituesve të ndarë sipas gjinisë, pakicës dhe vulnerabilitetit nga data 1 tetor 2020 deri 30 qershor 2021
Limitet dhe trendi:	Kjo masë është e para e llojit të vet. AKPA nuk kishte zbatuar kurrë një masë që synon punëtorët informalë, ndërsa interesimi për këtë masë është i vështirë të parashikohet.
Mjetet e interpretimit:	Mat numrin e punëtorëve informalë të vetëdeklaruar që largohen nga puna për shkak të karantinës nga Covid-19, të cilët regjistrohet në masën PTAP 2 duke u regjistruar në AKPA.
Ndryshimi në metodologji:	E pazbatueshme
Situata fillestare:	0 (Zero) nga shtatori 2020
Objektivat	Objektivi Vjetor 1: 1 500 përfitues. Objektivi i pjesshëm Vjetor 1: Nën 50% të objektivit të plotë: 0. Mbi 50% të objektivit të plotë: proporcionale.



Treguesi nr. 5:	Numri i bizneseve që përfitojnë nga rimbursimi i shpenzimeve (maska, dezinfektues, etj.) për zbatimin e protokollit të kuq të masave shëndetësore kundër COVID-19 siç është miratuar nga Institucionet Shëndetësore (2.2.1)
Politika:	Po përgatitet me objektivin e 1 000 bizneseve, në përputhje me dialogun e politikës në proces
Objektivi:	Lehtësimi i rrezikut të likuiditetit për bizneset e manufakturës që duhej të përballonin kosto për shkak të Protokollëve të Kuq ndaj COVID-19.
Departamenti:	MFE; BSh
Lloji i treguesit:	Sasior
Njësia matëse:	Numri i përfituesve të ndarë sipas gjinisë, etnisë dhe madhësisë së kompanisë (mikro/NVME/e madhe)
Metoda e llogaritjes:	Numri i bizneseve që përfitojnë nga rimbursimi (i plotë ose i pjesshëm) i kostove lidhur me respektimin e protokolleve të kuqe ndaj COVID-19. Arritja e plotë është 1.0; Arritja e pjesshme: proporcionale nga 0.5 deri 1.0
Segregimi:	E pazbatueshme
Metoda e mbledhjes së të dhënave:	Të dhëna administrative
Shpeshtësia e matjes:	Sasior
Departamentet përgjegjëse:	MFE
Data e realizimit:	<u>T1 2021</u> ; Numri i bizneseve të ndara sipas madhësisë për vitin 2020; (4 nëntor 2020 – 31 dhjetor 2020)
Limitet dhe trendi:	Qeveria përcakton kriteret që duhet të plotësojnë përfituesit që të marrin rimbursimin. Ky tregues merr parasysh vetëm rimbursimet (faktike ose kreditim tatimor) lidhur me këtë masë.
Mjetet e interpretimit:	Mat numrin e bizneseve që marrin rimbursim të plotë ose të pjesshëm në çfarëdo forme (direkt në llogarinë bankare ose si kreditim tatimor) për shpenzimet që kanë bërë për zbatimin e protokolleve të kuqe ndaj Covid-19 gjatë vitit 2020.
Ndryshim në metodologji:	E pazbatueshme
Situata fillestare:	0 (zero) që nga 1 nëntori 2020
Objektivat	Objektivi Vjetor 1: 1 000 biznese. Objektivi i pjesshëm Vjetor 1: Nën 50% të objektivit të plotë: 0. Mbi 50% të objektivit të plotë: proporcionale.



SHTOJCA 2: MODALITETET DHE KALENDARI I DISBURSIMIT

Kjo shtojcë trajton katër fusha kryesore sipas kontekstit sektorial të vendit/ndërhyrjes: (1) përgjegjësitë; (2) kalendari indikativ i disbursimit; (3) kushtet e përgjithshme për disbursimin e secilit transh; (4) kushtet e veçanta për disbursimin e secilit transh.

1. Përgjegjësitë

Bazuar në kushtet e disbursimit të përcaktuara në Marrëveshjen e Financimit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do t'i dërgojë Komisionit Evropian një kërkesë zyrtare për disbursimin e çdo transhi sipas kalendarit në Tabelën A më poshtë. Kërkesa duhet të përfshijë: (i) analizën e plotë dhe argumentimin për pagimin e fondeve duke i bashkëlidhur dokumentet mbështetëse; (ii) një formular me informacion financiar, të nënshkruar siç duhet, i cili lehtëson kryerjen e pagesave korresponduese.

2. Kalendari indikativ i disbursimit

Tabela A: Kalendari indikativ i disbursimit

Viti fiskal i Shqipërisë	2020				2021				
Lloji i transhit	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	Totali
Transhi fiks				10				3	13
Transhi variabël								13	13
Totali				10				16	26



3. Kushtet e përgjithshme për disbursimin e secilit transh

Kushtet e përgjithshme më poshtë për disbursimin e secilit transh janë të zbatueshme për të gjitha transhet; dhe të gjitha kërkesat për disbursim transhi duhet të shoqërohen me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e përshtatshëm.

Tabela B: Kushtet e përgjithshme për disbursimin e transheve

Fusha	Kushtet	Burimi i verifikimit
Politika Publike	Progresi i kënaqshëm në zbatimin e paketës anti-COVID ² dhe rekomandimeve të politikës së Programit të Reformave Ekonomike (PRE) posaçërisht për përballimin e COVID-19 dhe vijimësia e besueshmërisë dhe relevancës së saj.	Raportet e Qeverisë së Shqipërisë (vjetore ose të posaçme)
Stabiliteti Makroekonomik	Ruajtja e një politike makroekonomike të besueshme, relevante dhe të orientuar drejt stabilitetit ose progresi i bërë drejt rivendosjes së balancave kyçe.	Raportet vjetore të Qeverisë së Shqipërisë (prill, vjetore, N+1) FMN, Banka Botërore, Raportet e BE-së (vjetore dhe të posaçme) Vlerësimi i DG ECFIN të programit të reformave ekonomike të Shqipërisë, PRE (vjetor) Nënkomiteti i MSA-së për Çështjet Ekonomike dhe Financiare (vjetor)
Menaxhimi Financiar Publik	Progresi i kënaqshëm në zbatimin e reformave për përmirësimin e menaxhimit financiar publik, përfshirë mobilizimin e të ardhurave të brendshme, si edhe vijimin e relevancës dhe besueshmërisë së programit të reformave.	Raportet vjetore të progresit për zbatimin e Strategjisë MFP (prill, vjetore, N+1) FMN, Banka Botërore, Raportet MFP të BE-së (vjetore dhe të posaçme) Grupi i Posaçëm i RAP si pjesë e SAA (vjetor)
Transparenca Buxhetore	Progresi i kënaqshëm për sa i përket ofrimit për publikun të informacionit buxhetor të shëndoshë, tërësor dhe në kohë.	Raporti vjetor i MFE-së (prill, vjetor, N+1) Printimet zyrtare dhe faqet e internetit të Qeverisë (në vijimësi) Vlerësime të palëve të treta, p.sh. Indeksi i Buxhetit të Hapur (çdo dy vjet)

² Akti Nr. 6 datë 21.03.2020, VKM Nr. 254 datë 27.03.2020, VKM Nr. 277 datë 06.04.2020; Akti Nr. 15 datë 15.04.2020, VKM Nr. 305 datë 16.04.2020 (i ndryshuar me VKM-në Nr. 13, datë 22.4.2020 dhe 28.04.2020)



4. Modalitetet për llogaritjen dhe disbursimin e transhit variabël

Përveçse kur specifikohet ndryshe, treguesi i performancës maksimal është 1 kur objektivi arrihet plotësisht, 0.5 kur arrihet pjesërisht (kriteret përcaktohen për secilin tregues në Tabelën C) ose 0 nëse objektivi nuk arrihet.

Nëse shkruhet "*proporcionale*" në Tabelën C, treguesi i performancës vlerësohet saktësisht nga 0% në 100%, sipas masës së saktë të arritjes së objektivit. Nuk mund të tejkalojë 100%. Pagesat bëhen vetëm kur arritjet janë mbi objektivin e pjesshëm.

Për objektivat sasiorë, nuk përfitohet disbursim kur progresi është nën 50% të objektivit. Progresi mbi 50% të objektivit të përcaktuar rezulton në pagesë proporcionale sipas masës së arritjes.

- Specifiko metodën për pikëzimin e secilit tregues

Pasi vlerësohet secili tregues dhe një pikëzim performance i atribuohet secilit, shuma e transhit variabël që do të disbursohet përcaktohet duke shtuar ato pikëzime sipas peshës specifike që treguesit kanë në Tabelën C.

Në raste përjashtimore dhe/ose të justifikuara si duhet, p.sh. ku ngjarje të papritura, tronditje të jashtme ose rrethana të paparashikuara e bëjnë treguesin ose objektivin jorelevant, treguesi i transhit mund të anashkalohet ose neutralizohet. Në këtë rast, shuma përkatëse rialokohet te treguesit e tjerë të transhit variabël në të njëjtin vit ose transferohet në transhin e radhës vitin pasardhës. Mund të vendoset që treguesi të rivlerësohet vitin pasardhës përkundër objektivin fillestar nëse ka një trend pozitiv dhe nëse autoritetet nuk e arrijnë objektivin për shkak të faktorëve përtej kontrollit të tyre. Raste të tilla duhet të kërkohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet KKIPA-s te Komisioni Evropian dhe mund të autorizohen nga ky i fundit nëpërmjet shkëmbimit të letrave ndërmjet dy palëve.

Treguesit e performancës të përcaktuar në Tabelën C dhe të përshkruar hollësisht në Shtojcën 1 zbatohen për llogaritjen e përqindjes së transheve variabël që do të disbursohen. Kërkesat për disbursimin e transheve duhet të shoqërohen me informacionin dhe dokumentacionin e përshtatshëm lidhur me treguesit e performancës.



Tabela C: Transhi Variabël

Kontrata e Përballimit të BE-së për Rimëkëmbjen Ekonomike në përgjigje të COVID-19	
Transhi Variabël	Pesha
Arritja: mujore/tremujore siç përcaktohet në secilin tregues; Vlerësimi: deri T3 2021	
1 – Treguesi: numri i pagesave me kartë në blerjet me pakicë	
<u>Objektivi</u> : Pagesat me kartë në blerjet me pakicë rriten me 30% deri në qershor 2021	22 %
<u>Situata fillestare</u> : 2019: 8 079 409 transaksione	
<u>Burimi i verifikimit</u> : raportet tremujore të MFE, DPT, BSh, Shoqata Shqiptare e Bankave, INSTAT, AKShI.	
<u>Realizim i pjesshëm</u> : Proporcional <u>Nën 50% të objektivit të plotë</u> : 0 (zero) <u>Mbi 50% të objektivit të plotë</u> : proporcionale sipas formulës: Pagesa Proporcionale = (Objektivi i Arritur / Objektivin e Plotë) x Pagesën e Plotë	
2 – Treguesi: Bizneset që zbatohen sistemin e ri të faturimit elektronik	
<u>Objektivi</u> : Numri i bizneseve që zbatojnë faturimin elektronik për B2B deri në fund të gushtit 2021: 10 000 biznese – të dhëna të ndara sipas gjinisë, zonës gjeografike ose grupeve të popullatës	22%
<u>Situata fillestare</u> : korrik 2020 – bizneset që zbatojnë faturimin elektronik B2B : zero	
<u>Burimi i verifikimit</u> : raportet mujore/tremujore të MFE, Drejtoria e Hetimit Tatimor (DPT); AKShI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), INSTAT.	
<u>Realizim i pjesshëm</u> : Proporcional <u>Nën 50% të Objektivit të Plotë</u> : 0 (zero) <u>Mbi 50% të Objektivit të Plotë</u> : proporcionale sipas formulës: Pagesa Proporcionale = (Objektivi i Arritur / Objektivin e Plotë) x Pagesën e Plotë	
3 – Treguesi: Publikimi i SAA për konsultim publik	
<u>Objektivi</u> : SAA publikohet për konsultim publik në T2 2021	12%
<u>Situata fillestare</u> : Projekt-SAA po rishikohet për të reflektuar ndikimet e COVID-19	
<u>Burimi i verifikimit</u> : publikimi në faqen e internetit: https://ëëë.konsultimipublik.gov.al/	
<u>Realizim i pjesshëm</u> : E pazbatueshme	
4- Treguesi: Numri i punëtorëve informalë të larguar nga puna për shkak të COVID-19 që ripunësohen nëpërmjet Programit të Tregut Aktiv të Punës	



Kontrata e Përballimit të BE-së për Rimëkëmbjen Ekonomike në përgjigje të COVID-19	
Transhi Variabël	Pesha
Arritja: mujore/tremujore siç përcaktohet në secilin tregues; Vlerësimi: deri T3 2021	
Target: 1 500 përfitues – të dhëna të ndara sipas gjinisë, pakicës dhe vulnerabilitetit	22%
Situata fillestare: 0 (Zero)	
Burimi i verifikimit: Raportet tremujore të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, MFE, DPT.	
Realizim i pjesshëm: Proporcional	
Nën 50% të Objektivin të Plotë: 0 (zero)	
Mbi 50% të Objektivit të Plotë: proporcionale sipas formulës: Pagesa Proporcionale = (Objektivi i Arritur / Objektivin e Plotë) x Pagesën e Plotë	
5- Treguesi: Numri i bizneseve që përfitojnë nga rimbursimi i shpenzimeve (maska, dezinfektues, etj.) për zbatimin e protokollit të kuq të masave shëndetësore kundër COVID-19 siç është miratuar nga Institucionet Shëndetësore	
Objektivi: 1 000 biznese – të ndara sipas madhësisë	22%
Situata fillestare: 0 (zero)	
Burimi i verifikimit: Raportet tremujore nga MFE, BSH	
Realizim i pjesshëm: Proporcional	
Nën 50% të Objektivit të Plotë: 0 (zero)	
Mbi 50% të objektivit të plotë: proporcionale sipas formulës: Pagesa Proporcionale = (Objektivi i Arritur / Objektivin e Plotë) x Pagesën e Plotë	



SHTOJCA III MODELI I RAPORTIT VJETOR

Periudha e mbuluar nga raporti:

1/1/20XX-31/12/20XX

Raporti i publikuar më XX/XX/20XX

Raport vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II nën menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga [vendi] të paraqitur nga Koordinatori Kombëtar IPA

I. Përmbledhje Ekzekutive

1. Referenca për objektivat e dokumenteve strategjike të vendit dhe një pasqyrë e përmbledhur e sfidave në sektorë.

2. Përfshirja në programim.

3. Marrëdhëniet me Komisionin Evropian.

4. Problemet e hasura në përmbushjen e kushteve të kërkuara për zbatim dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë, masat e ngjashme të marra/planifikuara, rekomandimet për veprime të mëtejshme.

5. Çështjet përkatëse që rrjedhin nga pjesëmarrja e përfuturit nga IPA II në komitetin monitorues të IPA-s dhe në komitetet monitoruese sektoriale (përfshirë Komitetin e Përbashkët Monitorues për CBC/BNK (bashkëpunimi ndër-kufitar), nëse ka.

6. Përfshirja në aksionet Shumëvendëshe dhe çështjet që lidhen me to.

7. Aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit, mësimet e nxjerra & ndjekja e rekomandimeve.

8. Aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit.

9. Koordinimi i donatorëve.

Në rastin e menaxhimit të tërthortë, përmbledhja ekzekutive duhet të mbulojë gjithashtu:

10. Zbatimin e përgjithshëm të asistencës IPA nën menaxhimin e tërthortë (maks. një faqe).

11. Problemet kryesore horizontale të ndeshura gjatë zbatimit të asistencës IPA dhe masat vijuese të marra/planifikuara (maks. gjysmë faqe).

12. Rekomandimet për veprime të mëtejshme (maks. gjysmë faqe).

13. Auditimet - konstatimet kryesore dhe rekomandimet, si dhe masat korrigjuese të marra.

II. Të dhënat për sektor

Titulli i sektorit¹²: [Transporti]

Pjesa narrative/treguese: përmbledhja për sektor, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

1. Përfshirja në programim.

2. Përmbledhje e rezultateve në lëvizjen drejt një qasjeje të përsosur sektoriale (d.m.th. objektivat e arritura sipas udhëzuesit të sektorit në dokumentin e planifikimit të Sektorit).

3. Koordinimi me instrumente të tjera dhe/ose donatorë/IFN në sektor.

4. Ndikimi i veprimeve të IPA II brenda sektorit për zhvillimin e kapaciteteve përkatëse kombëtare administrative në sektor, planifikim strategjik dhe buxhetim.

Në menaxhimin e tërthortë duhet të përfshihet gjithashtu informacioni i mëposhtëm:

5. Struktura(t) operuese në funksionim dhe ndryshimet që lidhen me to, nëse është e nevojshme: [Ministria e Transportit].

6. Të dhëna mbi zbatimin e programeve në sektor.

7. Arritjet kryesore në sektor.

8. Çdo problem i rëndësishëm që haset në zbatimin e detyrave të besuara p.sh. vonesat në kontraktim, dhe masat vijuese të marra/planifikuara.

9. Rekomandime për masat e mëtejshme.

10. Aktivitetet e zbatuara për monitorimin dhe vlerësimin, auditimet – konstatimet kryesore & mësimet e nxjerra, rekomandimet, ndjekja dhe masat korrigjuese të marra.

Titulli i sektorit: Bashkëpunimi Ndër-Kufitar¹³

1. Përfshirja në programim sipas rastit.

2. Progresi i bërë në zbatimin e programit të CBC/BNK-së dhe veçanërisht në arritjen e objektiveve specifike për prioritetet tematike (duke përfshirë elementet cilësore dhe sasiore që tregojnë progresin në lidhje me objektivat).

3. Një përmbledhje e problemeve të hasura në zbatimin e programit të BNK-së dhe të gjitha masat korrigjuese të marra, si dhe rekomandimet për masa të mëtejshme korrigjuese.

¹² Sipas sektorëve në Dokumentet Strategjike indikative.

¹³ Për Bashkëpunimin Ndër-kufitar kërkohet raportim specifik



4. Monitorimi, duke përfshirë marrëveshjet për mbledhjen e të dhënave dhe kur është e zbatueshme, aktivitetet e vlerësimit.

5. Aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit.

6. Koordinimi me vendin partner.

Në menaxhimin e tërthortë duhet të përfshihet edhe informacioni i mëposhtëm:

1. Strukturat operuese në funksion dhe ndryshimet që lidhen me to, nëse është e rëndësishme.

2. Çdo problem i rëndësishëm i hasur në zbatimin e detyrave të besuara, p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat vijuese të marra/planifikuara.

3. Rekomandimet për veprime të mëtejshme.

4. Auditimet e zbatuara – konstatimet kryesore & rekomandime dhe masat korrigjuese të marra.

II a. Treguesit e performancës në [p.sh. Transport] sektorin që mbulon menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë:

Treguesit¹⁴ për program

Marrëveshja e Financimit/referenca ¹⁵ e Programit	Treguesi për sektor [Transport]	Burimi	Pikënisja	Arritjet e rëndësishme (2017)	Objektivi (2020)	Vlera (2014 ¹⁶)
Programi i vendit 2014	Shkurtimi i kohës mesatare të udhëtimit të pasagjerëve ndërmjet qendrave të mëdha urbane me anë të mënyrës së transportit.					
Programi shumëvjeçar 2014-20xx	Kosto të reduktuara transporti për njësi prodhimi.					

II b. Përmbledhje e nivelit të aksionit për sektor [p.sh. Transport]

Marrëveshja e Financimit / referenca e Programit	Aksioni/Veprimi	Gjendja aktuale/Progresi për aksion të veçantë (p.sh. Termat e Referencës në përgatitje, tenderi i nisur, kontraktuar, në zbatim, i përfunduar)	Arritjet kryesore dhe vlerësimi i tyre	Probleme të rëndësishme të hasura në zbatimin e detyrave të besuara dhe masat e marra/planifikuara për kapërcimin e tyre	Zhvillimet që ndikojnë në procesin e zbatimit në të ardhmen	Rekomandime për masa të mëtejshme korrigjuese
[programi i vendit 2014]	Elektrifikimi i linjës hekurudhore nga xxx në kufirin me xxx	P.sh. Kontratë Shërbimi për përgatitjen e Termave të Referencës për kontratën e punimeve të nënsbëruar dhe në zbatim, tender për kontratën e punimeve që do të fillojnë në tremujorin e dytë të vitit 2015.		P.sh. Kontratë Shërbimi për përgatitjen e Termave të Referencës sepse kontrata e punimeve u vonua, ndërsa procedura e negociimit dështoi dhe duhet të rifillonte.	P.sh. ndryshimi i të drejtës vendase, si dhe qasja me zbatimin e paketës së katërt të Hekurudhave	

¹⁴ Këta duhet të jenë kryesisht rezultate, si dhe tregues të prodhimit përkatës të përzgjedhur.

¹⁵

¹⁶ Numri i kolonave të përshtatshme për të gjitha vitet, nga 2014-ta deri në vitin e periudhës së raportimit. Vlerat duhet të jenë kumulative.



Në menaxhimin e tërthortë duhet të parashikohen edhe shtojcat e mëposhtme:

Shtojca 1

Përmbledhje e funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit (duke përfshirë ndryshimet në strukturën institucionale) (maks. një faqe).

Transparenca, vizibiliteti, aktivitetet e informimit dhe komunikimit në përputhje me MK-në (marrëveshja kuadër, maks. një faqe).

Shtojca 2

Histori suksesi (Shënim. kjo pjesë mund të përdoret për raportin vjetor të asistencës financiare të përgatitur nga Komisioni Evropian).

Shtojca 3

Plani vjetor i prokurimit.

Për menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë duhet të parashikohen gjithashtu shtojcat e mëposhtme:

Shtojca 4

Udhëzuesi për qasjen e sektorit – arritjet (duke theksuar nëse janë përmbushur apo jo objektivat e planifikuara).

[illegible]

Raporti financiar i përfituesit IPA II (*)

Referenca e Programit	Numri i kontratës së Marrëveshjes së Financimit	Buxheti i Programit Kontribut i BE	Veprimtaritë vendore të kontratës					Balancat Bankare
			Shuma e Përgjithshme e Kontraktuar	Shuma e Përgjithshme e Çliruar pas përfundimit	Shuma e Përgjithshme e Disbursuar	Kostot e Përgjithshme të Përcaktuara	Totali i Para-Financimeve të Hapura	Gjithsej
1	2	3	4	5	6	7	8	9
NP2010	2010/123-456							

Page | 3026



Shtojca IV(b): Raporti Vjetor Financiar - kontributet e BE për programe të veçanta

Raporti financiar i përfituesit IPA II (*)

Referenca e Programit	Numri i kontratës së Marrëveshjes së Financimit	Buxheti i Programit Kontribut i BE-së	Veprimtaritë vendore të kontratës								
			Shuma e përgjithshme e kontraktuar	Shuma e kontraktuar %	Shuma të pa shpenzuara deri në mbyllje të	% pashpenzuara	Totali i disbursuar	% e disbursuar	Totali i Kostove të njohura	% e kostove	% Para-Financimeve
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
NP2010	2010/123-456			6/4*100%		6/4*100%		8/4*100%		10/4*100%	12/4*100%
Nën Programi											
Veprimi											

(*) 15 shkurt

Shtojca IV (d) - parashikimi i pagesave

Referenca e Programit	Parashikimet e Planifikuara të Disbursimeve (Shtoni vite sipas nevojës)												
	Parashikimi i Disbursimeve Mujore (Viti 1)												Gjithsej Viti 1
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
NP2010													0
CBC AA/BB 2010													0



SHTOJCA V E MARRËVESHJES SË
FINANCIMIT
SPECIFIKIMET MINIMALE TË SISTEMIT
TË KONTABILITETIT RRITËS

Sistemi i kontabilitetit të përfituesit IPA II duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

1. Të pasqyrojë strukturën organizative të vënë në funksionim për sistemet e kontrollit të brendshëm, të përshtatura për kryerjen e detyrave. Në veçanti, para autorizimit të një operacioni, të gjitha aspektet (si ato operacionale dhe financiare) e operacionit duhet të verifikohen nga anëtarë të stafit dhe jo nga personi që ka nisur operacionin. Personi që merret me procesin e verifikimit nuk mund të jetë nën varësinë e iniciuesit të transaksionit.

2. Të përfshijë gjurmën e auditimit për të gjitha transaksionet dhe ndryshimet (amendimet).

3. Të ketë sigurinë e duhur fizike dhe elektronike, duke përfshirë sistemet mbështetëse dhe ato të rikuperimit.

4. Sistemi i kontabilitetit duhet të mbajë të paktën informacionet e mëposhtme për kontratat lokale të menaxhuara sipas secilit program:

a) Referenca e kontratës;

b) Vlera e kontratës, duke përfshirë çdo ndryshim;

c) Datat e nënshkrimit të kontratës (nga të dyja palët);

d) Data për fillimin e zbatimit të kontratës.

Kjo datë jepet përveç datës së nënshkrimit të kontratës dhe mund të ndryshojë prej saj, si në rastin kur data për fillimin e punimeve të kontratës jepet pas nënshkrimit të kontratës me anë të një Urdhri Administrativ;

e) Data për përfundimin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë çdo ndryshim;

Kjo është data e fundit kur mund të krijohen kosto të pranueshme. Kjo datë nuk përfshin asnjë periudhë garancie apo kohën e lejuar për përgatitjen e raportit nga kontraktuesi;

f) Totali i paguar (me para në dorë) me kontratë;

g) Parafinancimi i paguar me kontratë.

Njohja e shprehur dhe regjistrimi në pasqyrën financiare të parafinancimit të kërkuar me kontratë;

h) Kostot e pranuar – të drejtpërdrejta (me kontratë).

Njohja e qartë e koston si pagesë e shpenzimeve të vitit. Disa pagesa do të mbulojnë direkt

shpenzimet që janë kryer. Nuk përfshihet parafinancimi. Pagesat mund të jenë përfundimtare kur parafinancimi është shlyer ose mund të jenë pagesa të përkohshme kur parafinancimi është shlyer ose kur kontrata nuk përfshin dispozitën e parafinancimit;

i) Kostot e pranuar – indirekte (me kontratë).

Njohja e qartë e koston si pagesë e shpenzimeve të vitit. Disa fatura apo pasqyra shpenzimesh të paraqitura nga kontraktuesi apo përfituesi i grantit do të kenë lidhje me kostot që janë mbuluar nga parafinancimi i paguar më parë gjatë periudhës së zbatimit të kontratës apo marrëveshjes së grantit. Në këto raste pagesa e kryer do të jetë më e vogël se kostoja e raportuar. Ajo mund të jetë edhe zero, nëse e gjithë kostoja mbulohet nga parafinancimi (me siguri ajo do të jetë zero nëse kostot e raportuara janë të pamjaftueshme për të thithur parafinancimin dhe për bilancin e pashfrytëzuar të parafinancimit nxirret një urdhër rikuperimi). Në të gjitha këto raste, sistemi duhet të regjistrojë vlerën e plotë të koston së pranueshme të raportuar si shpenzime për vitin dhe të reduktojë bilancin e parafinancimit nga shuma e koston së kompensuar kundrejt parafinancimit, kur përcakton shumën që do të paguhet;

j) Urdhra rikuperimi për të reduktuar parafinancimin (me kontratë);

Pranimi i reduktimit të parafinancimit në pasqyrën financiare pas rikuperimit të parafinancimit të pashfrytëzuar.

k) Urdhra rikuperimi për të reduktuar koston (me kontratë).

Kur një rikuperim është bërë kundrejt koston së pranuar më parë – mundësisht pas një hetimi për mashtrim. Në raste të tilla koston e regjistruara për vitin duhet të ulen, nëse kostoja është pranuar në të njëjtin vit si rikuperim pasues, ose të ardhurat duhet të regjistrohen kur kostoja është pranuar në një vit më herët se ato të rikuperimit;

l) Data e faturës së furnizuesit për çdo faturë apo dokument tjetër të shoqëruar me një raport financiar që mundësojnë koston e pranuar;

m) Të dhëna në kontekstin e rikuperimit për koston e papranueshme dhe rikuperimet.



DEKRET
Nr. 13457, datë 4.2.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 3/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë, për vitin 2020, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 5/2022

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË HUAS NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA
E FINANCIVE DHE EKONOMISË
(HUAMARRËSI), DHE AGJENCISË
FRANCEZE PËR ZHVILLIM, PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT “POLITIKA
PËR MBËSHTETJEN E REFORMËS NË
SEKTORIN ENERGJETIK NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe

Agjencisë Franceze për Zhvillim, për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.1.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13459, datë 4.2.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE AFD NR. CAL 1004 01 Z
MARRËVESHJE E LINJËS SË KREDISË
SË DISPONUESHME,
DATË 12.11.2021, NDËRMJET *AGENCE FRANÇAISE DE DEVELOPPEMENT*
(HUADHËNËSI) DHE REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË (HUAMARRËSI),
PËR HUAN E BAZUAR NË POLITIKA
PËR MBËSHTETJEN E REFORMËS SË
SEKTORIT TË ENERGJISË NË SHQIPËRI

TABELA E LËNDËS
1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI
1.1 Përkufizime
1.2 Interpretimi
2. LINJA E KREDISË, QËLLIMI DHE
KUSHTET E PËRDORIMIT
2.1 Linja e kredisë
2.2 Qëllimi
2.3 Mungesa e përgjegjësisë
2.4 Kushtet pararendëse
3. DISBURSIMI I FONDEVE
3.1 Shumat e disbursimit
3.2 Kërkesa e disbursimit
3.3 Plotësimi i pagesës
3.4 Mekanizmi i pagesës
4. INTERESI
4.1 Norma e interesit
4.2 Llogaritja dhe pagesa e interesit
4.3 Pagesa e vonuar dhe kamatëvonesa
4.4 Komunikimi i normave të interesit
4.5 Norma efektive globale (*Taux Effectif Global*)



5. NDRYSHIMI I LLOGARITJES SË INTERESIT

5.1 Çrregullimi i tregut

5.2 Zëvendësimi i normës referuese

6. TARIFAT

6.1 Tarifat e angazhimit

6.2 Tarifa e vlerësimit

7. SHLYERJA

8. PARAPAGIMI DHE ANULIMI

8.1 Parapagimi vullnetar

8.2 Parapagimi i detyrueshëm

8.3 Anulimi nga Huamarrësi

8.4 Anulimi nga Huadhënësi

8.5 Kufizimet

9. DETYRIMET PËR PAGESA SHITESË

9.1 Kostot dhe shpenzimet

9.2 Dëmshpërblimi i anulimit

9.3 Dëmshpërblimi i parapagimit

9.4 Taksat dhe tatimet

9.5 Dëmshpërblimi valutor

9.6 Datat e caktuara

10. PËRFAQËSIME DHE GARANCI

10.1 Kompetenca dhe autoriteti

10.2 Vlefshmëria dhe pranimi i provave

10.3 Detyrimet e zbatueshme

10.4 Mospasja e taksave të depozitimit dhe pullës

10.5 Transferimi i fondeve

10.6 Mospasja e konfliktit me detyrimet e tjera

10.7 Ligji rregullues dhe zbatimi

10.8 Mungesa e mospërmbushjes së detyrimeve

10.9 Mungesa e informacionit keqinformues

10.10 Renditja *pari passu*

10.11 Origjina e fondeve, Aktet e korrupsionit, mashtrimi dhe praktikatat kundër konkurrencës

10.12 Mungesa e ndikimit material negativ

11. ZOTIMET

11.1 Pajtueshmëria me ligjet, rregulloret dhe detyrimet

11.2 Autorizimet

11.3 Zbatimi dhe ruajtja e programit

11.4 Përgjegjësia mjedisore dhe sociale

11.5 Renditja *pari passu*

11.6 Inspektimet

11.7 Vlerësimi i Programit

11.8 Zbatimi i Programit

11.9 Origjina e fondeve, mungesa e akteve të korrupsionit, mashtrimit dhe praktikave kundër konkurrencës

12. ZOTIMI I INFORMACIONIT

12.1 Informacioni financiar

12.2 Zbatimi i programit

12.3 Raporti i monitorimit

12.4 Bashkëfinancimi

12.5 Informacion shtesë

13. RASTET E MOSPËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE

13.1 Rastet e Mospërmbushjes së detyrimeve

13.2 Përshpejtimi

13.3 Njoftimi i rastit të mospërmbushjes së detyrimeve

14. ADMINISTRIMI I LINJËS SË KREDISË

14.1 Pagesat

14.2 Konfiskimi

14.3 Ditët e punës

14.4 Monedha e pagesës

14.5 Marrëveshja e numërimit të ditëve

14.6 Vendi i pagesës

14.7 Ndërprerja e sistemeve të pagesës

15. TË NDRYSHME

15.1 Gjuha

15.2 Vërtetime dhe përcaktime

15.3 Pavlefshmëria e pjesshme

15.4 Mosheqja dorë

15.5 Caktimi

15.6 Efekti ligjor

15.7 Marrëveshja e plotë

15.9 Konfidencialiteti – Zbulimi i informacionit

15.10 Kufizimi

15.11 Vështirësia

16. NJOFTIMET

16.1 Me shkrim dhe adresa

16.2 Dorëzimi

16.3 Komunikimet elektronike

17. LIGJI RREGULLUES, ZBATIMI DHE ZGJEDHJA E VENDBANIMIT

17.1 Ligji rregullues

17.2 Arbitrazhi

17.3 Procesi i njoftimit

18. KOHËZGJATJA

SKEDULI 1A – PËRKUFIZIME

SKEDULI 1B – INTERPRETIMI

SKEDULI 2 – PËRSHKRIMI I

PROGRAMIT

SKEDULI 3A – PLANI I FINANCIMIT

SKEDULI 3B – SKEMA E MONITORIMIT

SKEDULI 4 – KUSHTET PARARENDËSE

SKEDULI 5A – FORMULARI I KËRKESËS SË DISBURSIMIT



SKEDULI 5B – FORMULARI I
KONFIRMIMIT TË DISBURSIMIT DHE TË
NORMËS

SKEDULI 5C – FORMULARI I KËRKESËS
SË KONVERTIMIT TË NORMËS

SKEDULI 5D – FORMULARI I
KONFIRMIMIT TË KONVERTIMIT TË
NORMËS

SKEDULI 6 – INFORMACIONI QË
MUND TË PUBLIKOHET NË FAQEN E
INTERNETIT TË QEVERISË FRANCEZE
DHE TË HUADHËNËSIT

SKEDULI 7 – PLANI I ANGAZHIMIT
MJEDISOR DHE SOCIAL

MARRËVESHJE E LINJËS SË
KREDISË SË DISPONUESHME
NDËRMJET

1. REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

të përfaqësuar nga ministri i Financave dhe
Ekonomisë, znj. Delina Ibrahimaj, i cili është
autorizuar sipas rregullave për nënshkrimin e kësaj
Marrëveshjeje (Huamarrësi)

dhe

2. *AGENCE FRANCAISE DE
DEVELOPPEMENT*, një subjekt publik francez i
rregulluar nga ligji francez, me zyrë të regjistruar në
adresën: 5, Rue Roland Barthes, 75598 Paris Cedex
12, France (Francë), regjistruar në Regjistrin
Tregtar dhe të Shoqërive Tregtare të Parisit me
numër 775 665 599, përfaqësuar nga z. Dominique
Hautbergue, në cilësinë e tij si drejtor për Rajonin e
Ballkanit, i autorizuar sipas rregullave për të
nënshkruar këtë Marrëveshje,

(“AFD-ja” ose “Huadhënësi”);

(në vijim të referuara si “Palët” dhe secila si
“Pala”).

Duke pasur parasysh se:

A. Huamarrësi synon të zbatojë një program që
konsiston në një Hua për Politikën për Mbështetjen
e Reformës së Sektorit të Energjisë së Shqipërisë
(Programi), siç përshkruhet më tej në skedulin 2
(*Përshkrimi i programit*);

B. Huamarrësi i ka kërkuar Huadhënësit të
vendosë në dispozicion një linjë kredie, për qëllime
të mbështetjes së Programit;

C. Në përputhje me rezolutën nr. C20191200 të
Komitetit të Shteteve të Huaja të AFD-së, datë 18
dhjetor 2019, Huadhënësi ka rënë dakord për t'i
vënë në dispozicion Huamarrësit linjën e kredisë në

bazë të termave dhe të kushteve të përcaktuar në
këtë Marrëveshje,

si rrjedhojë, palët kanë rënë dakord si më
poshtë:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIMI

1.1 Përkufizime

Fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha në
këtë Marrëveshje (përfshirë ato në përshkrimet më
lart dhe në skedule) kanë kuptimin që u jepen në
skedulin 1A (*Përkufizime*), përveç nëse parashikohet
ndryshe në këtë Marrëveshje.

1.2 Interpretimi

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë
Marrëveshje interpretohen në zbatim të dispozitave
të skedulit 1B (*Interpretimi*), përveç kur rezulton
qëllim i kundërt.

2. LINJA E KREDISË, QËLLIMI DHE KUSHTET E PËRDORIMIT

2.1 Linja e kredisë

Në bazë të kushteve të kësaj Marrëveshjeje,
Huadhënësi vë në dispozicion të Huamarrësit një
Linjë Kredie në shumën maksimale totale prej
pesëdhjetë milionë eurosh (50,000,000 euro).

2.2 Qëllimi

Qëllimi i Linjës së Kredisë është financimi i
buxhetit të Huamarrësit, si mbështetje për
realizimin e Programit, siç përshkruhet në skedulin
2 (*Përshkrimi i Programit*), në përputhje me Planin e
Financimit të përshkruar në skedulin 3A (*Plani i
Financimit*) dhe Grafikun e Monitorimit të
përshkruar në skedulin 3B (*Skema e Monitorimit*).

2.3 Mungesa e Përgjegjësisë

Huadhënësi nuk mban përgjegjësi për
përdorimin e ndonjë shumë të marrë hua që nuk
është në përputhje me dispozitat e kësaj
Marrëveshjeje.

2.4 Kushtet Pararendëse

a) Jo më vonë se Data e Nënshkrimit,
Huamarrësi duhet t'i sigurojë Huadhënësit të gjitha
dokumentet e parashikuara në pjesën I të skedulit 4
(*Kushtet Pararendëse*).

b) Nuk do t'i dërgohet Huadhënësit një kërkesë
për Disbursim, përveç:

në rastin e Disbursimit të parë dhe unik,
Huadhënësi ka marrë të gjitha dokumentet e
renditura në pjesën II të skedulit 4 (*Kushtet
Pararendëse*) dhe ka njoftuar Huamarrësin se këto
dokumente janë të pranueshme në formë dhe në
përmbajtje;



në datën e Kërkesës për Disbursim dhe në Datën e propozuar për Disbursim për Disbursimin përkatës, nuk ka ndodhur asnjë Rast për Ndërprerjen e Sistemeve të Pagesave dhe kushtet e përcaktuara në këtë marrëveshje janë përmbushur, duke përfshirë:

1. Nuk vazhdon dhe nuk do të shkaktohet një Rast i Mospërmbushjes së Detyrimeve nga Disbursimi i propozuar;

2. Kërkesa për Disbursim është bërë në përputhje me kushtet e klauzolës 3.2 (*Kërkesa për Disbursim*);

3. Çdo përfaqësim i dhënë nga Huamarrësi në lidhje me klauzolën 10 (*Përfaqësim dhe garanci*) është i vërtetë.

3. DISBURSIMI I FONDEVE

3.1 Shuma e Disbursimit

Linja e kredisë do të vihet në dispozicion të Huamarrësit gjatë Periudhës së Angazhimit/Disponueshmërisë, në një Disbursim.

Shuma e Disbursimit të propozuar do të jetë të minimalisht pesëdhjetë milionë euro (50,000,000 euro) ose një shumë e barabartë me Kreditë e Disponueshme, nëse kjo shumë është më e ulët se pesëdhjetë milionë euro (50,000,000 euro).

3.2 Kërkesa për Disbursim

Me kusht që kushtet e përcaktuara në klauzolën 2.4(b) (*Kushtet Pararendëse*) të jenë përmbushur, Huamarrësi mund të tërheqë Linjën e Kredisë përmes dorëzimit të Huadhënësi të një Kërkesë Disbursimi të plotësuar sipas rregullave. Kërkesa për Disbursim do të dorëzohet nga Huamarrësi te drejtori i zyrës së AFD-së, në adresën e specifikuar në klauzolën 16.1 (*Me shkrim dhe adresë*).

Kërkesa për Disbursim është e pakthyeshme dhe do të konsiderohet se është plotësuar sipas rregullave, nëse:

a) Kërkesa për Disbursim është kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin 5A (*Formulari i Kërkesës për Disbursim*);

b) Kërkesa për Disbursim është marrë nga Huadhënësi të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) Ditë Pune para Afatit për Disbursim;

c) Data e Disbursimit të propozuar është një Ditë Pune që bie brenda Periudhës së Angazhimit/Disponueshmërisë;

d) shumën e Disbursimit është në përputhje me klauzolën 3.1 (*Shumat e Disbursimit*); dhe

e) të gjitha dokumentet e përcaktuara në pjesën I dhe/ose II të skedulit 4 (*Kushtet Pararendëset*) për

qëllime të Disbursimit i janë bashkëlidhur Kërkesës për Disbursim, janë në përputhje me listën e lartpërmendur dhe me kërkesat e klauzolës 3.4 (*Mekanizmi i Pagesave*), dhe janë të pranueshme në formë dhe përmbajtje për Huadhënësin.

3.3 Plotësimi i pagesës

Në bazë të klauzolës 14.7 (*Ndërprerja e Sistemeve të Pagesave*), nëse janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara në klauzolën 2.4 (*Kushtet Pararendëse*) të kësaj Marrëveshjeje, Huadhënësi do t'i vërë në dispozicion Huamarrësit disbursimin e kërkuar jo më vonë se në Datën e Disbursimit.

Huadhënësi duhet t'i sigurojë Huamarrësit një letër konfirmimi të Disbursimit kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin 5B (*Formulari i konfirmimit të disbursimit dhe normës*).

3.4 Mekanizmi i Pagesës

Shuma e Disbursimit paguhet në llogarinë e Huamarrësit apo ndonjë llogari tjetër, detajet e së cilës i njoftohen Huadhënësit, sipas rregullave nga Huamarrësi.

4. INTERESI

4.1 Norma e interesit

4.1.1 Përzgjedhja e Normës së Interesit

Për Disbursimin, Huamarrësi mund të zgjedhë një Normë Fikse Interesi ose një Normë Interesi të ndryshueshme, e cila zbatohet për shumën e përcaktuar në Kërkesën përkatëse për Disbursim, duke përcaktuar Normën e zgjedhur të Interesit, d.m.th., fikse apo të ndryshueshme, në Kërkesën për Disbursim të dorëzuar te Huadhënësi, kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin 5C (*Formulari i Kërkesës së Konvertimit të Normës*), në bazë të kushteve të mëposhtme:

a) Norma e Ndryshueshme e Interesit

Me kusht që shumën e Disbursimit të kërkuar të jetë në përputhje me klauzolën 3.1 (*Shuma e Disbursimit*), Huamarrësi mund të zgjedhë një normë interesi të ndryshueshme, e cila do të jetë norma e përqindjes në vit, duke qenë totali i:

- EURIBOR-it 6-mujor ose, sipas rastit, Standardi i Zëvendësimit plus çdo Marzh Përshtatjeje, siç përcaktohet në përputhje me dispozitat e klauzolës 5 (*ndryshimi i llogaritjes së interesit*) të Marrëveshjes; dhe

- Marzhit.

Pavarësisht nga sa më sipër, nëse Periudha e parë e Interesit është më e shkurtër se 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) ditë, EURIBOR-i i zbatueshëm do të jetë:



- EURIBOR 1-mujor ose, sipas rastit, Standardi i Zëvendësimit plus çdo Marzh Përshtatjeje, siç përcaktohet në përputhje me dispozitat e Klauzolës 5 (*ndryshimi i llogaritjes së interesit*) të Marrëveshjes, nëse Periudha e parë e Interesit është më e shkurtër se gjashtëdhjetë (60) ditë; ose

- EURIBOR 3-mujor ose, sipas rastit, Standardi i Zëvendësimit plus çdo Marzh Përshtatjeje, siç përcaktohet në përputhje me dispozitat e klauzolës 5 (*Ndryshimi i llogaritjes së interesit*) të Marrëveshjes, nëse Periudha e parë e Interesit është ndërmjet 60 (gjashtëdhjetë) ditë dhe 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) ditë.

b) Norma Fikse e Interesit

Me kusht që shuma e Disbursimit të kërkuar të jetë në përputhje me klauzolën 3.1 (*Shuma e Disbursimit*), Huamarrësi mund të zgjedhë një Normë fikse Interesi për këtë Disbursim. Norma fikse e Interesit do të jetë Norma Fikse Referuese e rritur ose e ulur, sipas çdo luhatjeje të Normës së Indeksit nga Data e Nënshkrimit deri në Datën e Caktimit të Normës përkatëse.

Huamarrësi mund të specifikojë në Kërkesën e Disbursimit një shumë maksimale për Normën fikse të Interesit. Nëse Norma fikse e Interesit, e llogaritur në Datën e Përcaktimit të Normës, tejkalon shumën maksimale për Normën fikse të Interesit të përcaktuar në Kërkesën përkatëse të Disbursimit, kjo Kërkesë Disbursimi do të anulohet dhe shuma e Disbursimit e përcaktuar në Kërkesën e anuluar të Disbursimit do t'i kreditohet Kredisë së Disponueshme.

4.1.2 Norma Minimale e Interesit

Norma e Interesit e përcaktuar në përputhje me klauzolën 4.1.1 (*Përzgjedhja e Normës së Interesit*), pavarësisht alternativës së zgjedhur, nuk do të jetë më pak se 0.25% (zero pikë njëzet e pesë për qind) në vit, pavarësisht ndonjë rënieje të Normës së Interesit.

4.1.3 Konvertimi nga një Normë e ndryshueshme Interesi në një Norma Fikse Interesi

Norma e Ndryshueshme e Interesit e zbatueshme për Disbursimin do të konvertohet në një Norma Fikse Interesi, në përputhje me kushtet e përcaktuara më poshtë.

a) Konvertimi i Normës me kërkesë të Huamarrësit

Huamarrësi mund t'i kërkojë në çdo kohë Huadhënësit të konvertojë Normën e ndryshueshme të Interesit të zbatuar për

Disbursimin në një Normë Fikse Interesi, me kusht që shuma e Disbursimit të jetë në përputhje me klauzolën 3.1 (*Shuma e Disbursimit*).

Për këtë qëllim, Huamarrësi do t'i dërgojë Huadhënësit një Kërkesë Konvertimi të Normës, kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin 5C (*Formulari i Kërkesës së Konvertimit të Normës*). Huamarrësi mund të specifikojë në Letrën e Konvertimit të Normës një shumë maksimale për Normën fikse të Interesit. Në rast se Norma fikse e Interesit e llogaritur në Datë e Përcaktimit të Normës e kalon shumën maksimale për Normën fikse të Interesit të specifikuar nga Huamarrësi në Kërkesën e Konvertimit të Normës, kjo Kërkesë Konvertimi e Normës do të anulohet automatikisht.

Norma fikse e Interesit do të jetë efektive 2 (dy) Ditë Pune pas Datës së Përcaktimit të Normës.

b) Mekanizmi i Konvertimit të Normës

Norma fikse e Interesit e zbatuar për Disbursimin/et përkatëse përcaktohet në përputhje me klauzolën 4.1.1(ii) (*Norma fikse e Interesit*) më sipër, në Data e Përcaktimit të Normës të referuar në nënparagrafin (i)

Huadhënësi duhet t'i dërgojë Huamarrësit një letër konfirmimi të Konvertimit të Normës, kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin 5D (*Formulari i Konfirmimit të Konvertimit të Normës*).

Konvertimi i normës është përfundimtar dhe pa kosto.

4.2 Llogaritja dhe pagesa e interesit

Huamarrësi paguan interesin e llogaritur për Disbursimin/et në secilën Datë të Pagesës.

Shuma e interesit që do të paguhet nga Huamarrësi në Datës përkatëse të Pagesës dhe për një Periudhë të caktuar Interesi do të jetë e barabartë me shumën e çdo interesi të papaguar nga Huamarrësi mbi shumën e Principalit të Papaguar, në lidhje me secilin Disbursim. Interesi i Huamarrësit në lidhje me secilën Disbursim, llogaritet në bazë të:

i. Principalit të Papaguar nga Huamarrësi lidhur me Disbursimin përkatës, siç është në Datën e Pagesës së mëparshme ose në rastin e Periudhës së parë të Interesit, në Datën e Disbursimit korrespondues;

ii. numrit të saktë të ditëve gjatë Periudhës përkatëse të Interesit mbi bazë viti me 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditë; dhe



ii. Normës së zbatueshme të Interesit të përcaktuar në përputhje me dispozitat e klauzolës 4.1 (*Norma e Interesit*).

4.3 Pagesa e vonuar dhe kamatëvonesa

a) Pagesa e vonuar dhe kamatëvonesa për të gjitha shumat e papaguara (me përjashtim të interesit)

Nëse Huamarrësi nuk paguan shumën që duhet t'i paguajë Huadhënësit, sipas kësaj Marrëveshjeje (qoftë pagesa e principalit, ndonjë Dëmshpërblim Parapagimi, tarifa apo shpenzime të rastit të çfarëdo lloji, përveç për ndonjë interes të papaguar të vonuar) në datën e caktuar, interesi do të jetë për shumën e vonuar, në masën e lejuar me ligj, nga data e afatit deri në datën e pagesës aktuale (si para edhe pas vendimit të arbitrazhit, nëse ka) në Normën e Interesit të zbatueshëm për Periudhën aktuale të Interesit (kamatëvonesa) të rritur me 3.5% (tre pikë pesë për qind) (interesi i pagesës së vonuar). Asnjë njoftim paraprak zyrtar nga Huadhënësi nuk është i nevojshëm.

b) Pagesa e vonuar dhe kamatëvonesa për interesin e papaguar që u ka kaluar afati.

Interesi që nuk është paguar në afatin e caktuar do të ketë kamatë, në masën që e lejon ligji, në Normën e Interesit të zbatueshëm për Periudhën vijuese të Interesit (kamatëvonesa), shtuar me tre pikë pesë për qind (3.5%) (interesi për pagesën e vonuar), në masën që ky interes ka qenë i kërkuar dhe i pagueshëm për të paktën 1 (një) vit. Asnjë njoftim paraprak zyrtar nga Huadhënësi nuk është i nevojshëm.

Huamarrësi paguan çdo interes të papaguar sipas kësaj klauzole 4.3 (*Pagesat e vonuara dhe kamatëvonesa*) menjëherë pas kërkesës së Huadhënësit ose në çdo Datë të Pagesës pas datës së caktuar për pagesën e pashlyer.

c) Marrja e çdo pagese të interesit të pagesës së vonuar ose kamatëvonesës nga Huadhënësi nuk nënkupton as dhënien e ndonjë shtyrjeje të pagesës për Huamarrësin dhe as nuk vepron si heqje dorë prej të drejtave që Huadhënësi ka sipas kësaj Marrëveshjeje.

4.4 Komunikimi i Normave të Interesit

Huadhënësi njofton menjëherë Huamarrësin për përcaktimin e çdo Norme Interesi në përputhje me këtë Marrëveshjeje.

4.5 Norma Efektive Globale (*Taux Effectif Global*)

Me qëllim respektimin e neneve L. 314-1 deri L. 314-5 dhe R. 314-1 e vijuese të Kodit Francez të Konsumatorit dhe L. 313-4 të Kodit Monetar dhe Financiar francez, Huadhënësi informon Huamarrësin dhe Huamarrësi pranon që norma efektive globale (*Taux Effectif Global*) e zbatueshme për linjën e kredisë mund të vlerësohet me një normë vjetore prej një pikë gjashtëdhjetë për qind (1.60%) mbi bazë viti prej 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh dhe një Periudhë Interesi prej 6 (gjashtë) muajsh, në bazë të sa më poshtë:

a) normat e mësipërme jepen vetëm për qëllime informimi;

b) normat e mësipërme llogariten mbi bazën që:

a. Disbursimit i Linjës së Kredisë është i plotë në Datën e Nënshkrimit;

b. asnjë Disbursim i vënë në dispozicion të Huamarrësit nuk ka interes mbi normën e ndryshueshme; dhe

c. norma fikse për kohëzgjatjen e linjës së kredisë duhet të jetë e barabartë me 1.46% (një pikë dyzet e gjashtë për qind);

c) normat e mësipërme marrin parasysh komisionet dhe kostot që do të paguheshin nga Huamarrësi, sipas kësaj Marrëveshjeje, duke supozuar se këto komisione dhe kosto do të mbeten fikse dhe do të zbatohen deri në skadimin e afatit të kësaj Marrëveshjeje.

5. NDRYSHIMI NË LLOGARITJEN E INTERESIT

5.1 Çrregullimi i Tregut

a) Nëse një Çrregullim Tregu ndikon në tregun ndërbankar në Eurozonë dhe është e pamundur:

i. për Normën fikse të interesit, për të përcaktuar Normën fikse të Interesit të zbatueshme për një Disbursim; ose

ii. për Normën e ndryshueshme të Interesit, për të përcaktuar EURIBOR-in e zbatueshëm për Periudhën përkatëse të Interesit,

Huamarrësi do të informojë Huamarrësin.

b) Kur ndodh një rast i përshkruar në paragrafin (a) më lart, Norma e zbatueshme e Interesit, sipas rastit, për Disbursimin përkatës ose për Periudhën përkatëse të Interesit, do të jetë shuma e:

i. Marzhit; dhe

ii. normës së përqindjes në vit që i korrespondon kostos së Huadhënësit për financimin e Disbursimit/eve përkatëse nga cilido burim që mund të zgjedhë në mënyrë të arsyeshme.



Kjo Normë do t'i njoftohet Huamarrësit sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast, para: 1. Disbursimit për Normën fikse të Interesit; ose 2. Datës së Pagesës për interesin e pagueshëm për këtë Periudhë Interesi për Normën e ndryshueshme të Interesit.

5.2 Zëvendësimi i Normës Referuese

5.2.1 Përkufizime:

“Organ Përkatës Emërues” nënkupton çdo bankë qendrore, rregullator, mbikëqyrës ose grup pune ose komitet i sponsorizuar apo i kryesuar nga ose i ngritur me kërkesë të secilit prej tyre.

“Rast i Zëvendësimit të Normës Referuese të Zbatueshme” nënkupton secilin nga rastet apo një seri rastesh të mëposhtme:

a) përcaktimi, metodologjia, formula apo mjetet e përcaktimit të Normës Referuese të Zbatueshme kanë ndryshuar materialisht;

b) është miratuar një ligj apo rregullore, që ndalon përdorimin e Normës Referuese të Zbatueshme, e cila është përcaktuar, për të shmangur dyshimet që ndodhja e këtij rasti nuk do të përbëjë një rast parapagimi të detyrueshëm;

c) administratori i Normës Referuese ose mbikëqyrësi i saj shpall publikisht:

i. që ka ndërprerë ose do të ndërpresë së ofruari Normën Referuese përgjithmonë ose për një kohë të pacaktuar dhe, në atë kohë nuk është emëruar publikisht asnjë administrator pasues për të vijuar ofrimin e asaj Norme Referuese;

ii. që Norma Referuese është ndërprerë ose do të pushojë së publikuari në mënyrë të përhershme ose të papërcaktuar; ose

iii. që Norma Referuese nuk mund të përdoret më (qoftë aktualisht apo në të ardhmen);

d) është bërë një njoftim publik për falimentimin e administratorit të asaj Norme Referuese ose për procedura të tjetra falimentimi kundër tij dhe në atë kohë asnjë administrator pasues nuk është emëruar publikisht për të vijuar ofrimin e asaj Norme Referuese; ose

e) sipas mendimit të Huadhënësit, Norma Referuese nuk përdoret më në një sërë transaksionesh financiare të krahasueshme.

“Normë Referuese” nënkupton EURIBOR-in ose pas zëvendësimit të kësaj norme nga një Standard Zëvendësues, Standardin Zëvendësues.

“Datë e Zëvendësimit të Normës Referuese” nënkupton:

- në lidhje me rastet e përmendura në pikat (a), (d) dhe (e) të përkufizimit të mësipërm të Rastit të Zëvendësimit të Normës, datën kur Huadhënësi ka njohuri për zhvillimin e këtij rasti, dhe

- në lidhje me rastet e referuara në pikat (b) dhe (c) të përkufizimit të mësipërm të Rastit të Zëvendësimit të Normës Referuese, datën pas së cilës ndalohet përdorimi i Normës Referuese ose datën kur administratori i Normës Referuese, në mënyrë të përhershme ose të papërcaktuar pushon së ofruari Normën Referuese ose datën pas së cilës Norma Referuese nuk mund të përdoret.

5.2.2 Secila palë pranon dhe bie dakord në interes të Palës tjetër se nëse ndodh një Rast Zëvendësimi i Normës Referuese dhe me qëllim që të ruhet balanca ekonomike e kësaj Marrëveshjeje, Huadhënësi mund të zëvendësojë Normën Referuese me një normë tjetër (“Standardi Zëvendësues”) e cila mund të përfshijë marzhin e përshtatjes, me qëllim që të shmanget çdo transferim i vlerës ekonomike midis palëve (nëse ka) (Marzhi i Përshtatjes) dhe Huadhënësi do të caktojë datën nga e cila Standardi Zëvendësues dhe, nëse ka, Marzhi i Përshtatjes do të zëvendësojë Normën Referuese dhe çdo ndryshim tjetër të Marrëveshjes, të nevojshëm si rezultat i zëvendësimit të Normës Referuese nga Standardi Zëvendësues.

5.2.3 Përcaktimi i Standardit Zëvendësues dhe ndryshimet e nevojshme bëhen me mirëbesim dhe duke marrë parasysh: i. rekomandimet e çdo Organi Përkatës Emërues; ose ii. rekomandimet e administratorit të Normës Referuese; ose iii. zgjidhjen e industrisë të rekomanduar nga shoqatat profesionale në sektorin bankar; ose iv. praktikën e tregut të zbatuar në një sërë transaksionesh financiare të krahasueshme në datën e zëvendësimit.

5.2.4 Në rast të zëvendësimit të Normës Referuese, Huadhënësi do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për termat dhe kushtet e zëvendësimit për zëvendësimin e Normës Referuese me Standardin e Zëvendësimit, i cili do të jetë i zbatueshëm për Periudhat e Interesit, duke filluar të paktën dy Ditë Pune pas Datës së Zëvendësimit të Normës Referuese.

5.2.5 Dispozitat e klauzolës 5.2 (*Zëvendësimi i Normës Referuese*) do të kenë përparësi ndaj dispozitave të klauzolës 5.1 (*Çrregullimi i Tregut*).



6. TARIFAT

6.1 Tarifat e Angazhimit

Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit një tarifë angazhimi prej 0,25% (zero pikë njëzet e pesë për qind) në vit. Tarifat e angazhimit do të fillojnë të llogariten 9 (nëntë) muaj pas Datës së Nënshkrimit.

Tarifa e angazhimit llogaritet sipas shkallës së përcaktuar më sipër për shumën e Kredisë së Disponueshme të llogaritur për numrin aktual të ditëve të kaluara, shtuar me shumën e secilit Disbursim që do të vihet në dispozicion nga Huadhënësi, në përputhje me çdo Kërkesë të mbetur pezull për Disbursim.

Tarifa e parë e angazhimit llogaritet për periudhën: i. që fillon 9 (nëntë) muaj pas Datës së Nënshkrimit (përfshirë) deri në ii. menjëherë pas Datës së Pagesës (përfshirë). Taksat pasuese të angazhimit llogariten për periudhat që fillojnë menjëherë pas Datës së Pagesës (përfshirë) dhe përfundojnë në Datën e ardhshme të Pagesës (përfshirë).

Tarifa e llogaritur e angazhimit do të paguhet: i. në çdo Datë të Pagesës, brenda Periudhës së Disponueshmërisë; ii. në Datën e Pagesës pas ditës së fundit të Periudhës së Disbursimit; dhe iii. në rast se Kredia e Disponueshme anulohet plotësisht, në Datën e Pagesës që pason datën e hyrjes në fuqi të këtij anulimi.

6.2 Tarifa e Vlerësimit

Brenda 6 (gjashtë) muajsh pas Datës së Nënshkrimit dhe para Disbursimit të parë ose brenda një muaji pas Hyrjes në Fuqi, cilado nga datat e lartpërmendura bie më vonë, Huamarrësi duhet t'i paguajë Huadhënësit një tarifë vlerësimi prej 0,75% (zero pikë shtatëdhjetë e pesë për qind), e llogaritur për shumën maksimale të Linjës së Kredisë.

7. SHLYERJA

Pas skadimit të Periudhës pas datës së caktuar, Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit Shumën e Principalit të Linjës së Kredisë në 18 (tetëmbëdhjetë) këste gjashtëmujore, që janë të kërkueshëm dhe të pagueshëm në secilën Datë të Pagesës.

Kësti i parë do të jetë i kërkueshëm dhe i pagueshëm më 31 janar 2025 dhe kësti i fundit do të jetë i kërkueshëm dhe i pagueshëm më 31 korrik 2033.

Në fund të Periudhës së Disbursimit, Huadhënësi duhet t'i dorëzojë Huamarrësit një

skedul amortizimi, në lidhje me linjën e kredisë që merr parasysh, nëse është e zbatueshme, çdo anulim të mundshëm të Linjës së Kredisë sipas klauzolës 8.3 (Anulimi nga Huamarrësi) dhe/ose 8.4 (Anulimi nga Huadhënësi).

8. PARAPAGIMI DHE ANULIMI

8.1 Parapagimi vullnetar

Huamarrësi nuk ka të drejtë të kryejë parapagimin e plotë ose të pjesshëm të Kredisë para skadimit të afatit shtatëdhjetë e dy (72-mujor) shtatëdhjetëmujor që fillon nga Data e Nënshkrimit.

Huamarrësi, nga data e përmendur në paragrafin e mëparshëm, mund të kryejë parapagimin e plotë ose të pjesshëm të Linjës së Kredisë, në përputhje me kushtet e mëposhtme:

d) Huamarrësi do të njoftojë Huadhënësin për qëllimin e tij për të parapaguar, me një njoftim me shkrim dhe të parevokueshëm jo më pak se 30 (tridhjetë) Ditë Pune para datës së parashikuar të parapagimit;

e) shuma që do të parapaguhet është e barabartë me një ose me disa këste në principal;

f) Data e Pagesës së parashikuar do të jetë një Datë Page;

g) parapagimi do të kryhet së bashku me pagesën e interesit të llogaritur, çdo tarifë, dëmshpërblim dhe kosto përkatëse, në lidhje me shumën e parapaguar, siç parashikohet në këtë Marrëveshje;

h) nuk ka shumë të pashlyer; dhe

Në datën e pagesës në të cilën kryhet parapagimi, Huamarrësi do të paguajë shumën e plotë të Dëmshpërblimeve të Parapagimit, që pritet dhe është e pagueshme sipas klauzolës 9.3 (*Dëmshpërblimi i Parapagimit*).

8.2 Parapagimi i detyrueshëm

Huamarrësi parapaguan menjëherë të gjithë ose një pjesë të linjës së kredisë pas marrjes së njoftimit nga Huadhënësi që informon Huamarrësin për cilindo nga rastet në vijim:

a) Paligjshmëria: bëhet e paligjshme për Huadhënësin sipas ligjit të tij në fuqi që të kryejë cilindo nga detyrimet e tij të parashikuara me këtë Marrëveshje apo të financojë apo ruajë linjën e kredisë;

b) Mospërmbushja e detyrimeve: Huadhënësi deklaron një Rast të Mospërmbushjes së Detyrimeve në pajtim me klauzolën 13 (*Raste të Mospërmbushjes së Detyrimeve*);



Në rast të secilit prej rasteve të specifikuara në paragrafët (a) dhe (b) më lart, Huadhënësi ka të drejtën, pasi e ka njoftuar me shkrim Huamarrësin, që të ushtrojë të drejtat e tij si kreditor, në mënyrën e përcaktuar në paragrafin (b) të klauzolës 13.2 (*Përshejtimi*).

8.3 Anulimi nga Huamarrësi

Huamarrësi mund të anulojë të gjithë ose ndonjë pjesë të Kredisë së Disponueshme, përpara Afatit të Fundit për Disbursim, duke i dhënë Huadhënësit njoftim paraprak prej tre (3) Ditësh Pune.

Pas marrjes së këtij njoftimi për anulim, Huadhënësi anulon shumën e njoftuar nga Huamarrësi, me kusht që shpenzimet e arsyeshme lidhur me zbatimin e programit, siç përcaktohet në Planin e Financimit, të mbulohen në mënyrë të kënaqshme për Huadhënësin, përveç në rast se Programi ndërpritet nga Huamarrësi.

8.4 Anulimi nga Huadhënësi

Kredia e Disponueshme anulohet menjëherë pas dorëzimit të një njoftimi të Huamarrësi, i cili është menjëherë efektiv, nëse:

a) Kredia e Disponueshme nuk është e barabartë me zero në Afatin për Disbursim;

b) Disbursimi nuk ka ndodhur deri në datën e skadimit të Afatit për Disbursimin;

c) ka ndodhur dhe po vijon një Rast i Mospërmbushjes së Detyrimeve; ose

d) ka ndodhur një rast i referuar në klauzolën 8.2 (*Parapagimi i Detyrueshëm*);

përveç kur, në rastin e paragrafëve (a) dhe (b) të kësaj klauzole 8.4 (*Anulimi nga Huadhënësi*), Palët kanë rënë dakord me shkrim që të shtojnë Afatin e Disbursimit apo afatin për Disbursimin e parë në bazë të kushteve të reja financiare që do të zbatohen për Disbursimin sipas Kredisë së Disponueshme.

8.5 Kufizime

a) Çdo njoftim parapagimi ose anulimi i bërë nga një Palë në përputhje me këtë klauzolë 8 (*Parapagimi dhe Anulimi*) është i pakthyeshëm dhe përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, një njoftim i tillë do të specifikojë datën apo datat në të cilën do të bëhet parapagimi ose anulimi përkatës, si dhe shumën e parapagimit ose anulimit.

b) Huamarrësi nuk do të parapagujë ose anulojë të gjithë ose një pjesë të Linjës së Kredisë

përveç në kohën dhe në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë Marrëveshje.

c) Çdo parapagim sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet së bashku me pagesën e i. interesit të llogaritur për shumën e parapagimit, ii. tarifave të papaguara dhe iii. Dëmshpërblimin e Parapagimit të referuar në klauzolën 9.3 (*Dëmshpërblimi i parapagimit*) më poshtë.

d) Çdo shumë e parapagimit do të zbatohet kundrejt kësteve të mbetura në rendin e anasjelltë të maturimit.

e) Huamarrësi nuk mund të rimarrë hua të gjithë apo ndonjë pjesë të Linjës së Kredisë që është parapaguar apo anuluar.

9. DETYRIME PËR PAGESA SHITESË

9.1 Kostot dhe shpenzimet

9.1.1 Huamarrësi i rimbursos Huadhënësit të gjitha kostot dhe shpenzimet (përfshirë tarifat ligjore) e bëra prej tij, në lidhje me zbatimin apo ruajtjen e të drejtave të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

9.1.2 Huamarrësi paguan drejtpërdrejt ose, nëse është e zbatueshme, i rimbursos Huadhënësit në rast të një paradhënieje të bërë nga Huadhënësi, shumën e të gjitha kostove dhe shpenzimeve në lidhje me transferimin e fondeve, ose për llogari të Huamarrësit, nga Parisi në çdo vend tjetër për të cilin është rënë dakord me Huadhënësin, si dhe çdo tarifë transferimi dhe shpenzim në lidhje me pagesën e të gjitha shumave që duhen paguar sipas Linjës së Kredisë.

9.2 Dëmshpërblimi i Anulimit

Nëse Linja e Kredisë anulohet plotësisht ose pjesërisht në përputhje me kushtet e klauzolës 8.3 (*Anulimi nga Huamarrësi*) dhe/ose 8.4 (*Anulimi nga Huadhënësi*) paragrafët (a), (b) dhe (c), Huamarrësi paguan një dëmshpërblim anulimi të llogaritur në 2.50% (dy pikë pesëdhjetë për qind) të shumës së anuluar të Linjës së Kredisë.

Çdo dëmshpërblim anulimi pritët dhe është i pagueshëm në Datën e Pagesës menjëherë pas anulimit të të gjithë ose një pjese të linjës së kredisë.

9.3 Dëmshpërblimi i Parapagimit

Për shkak të ndonjë humbjeje të pësuar nga Huadhënësi si rezultat i parapagimit të të gjithë ose ndonjë pjese të Linjës së Kredisë, në përputhje me klauzolën 8.1 (*Parapagimi vullnetar*) ose 8.2 (*Parapagimi i detyrueshëm*), Huamarrësi i paguan Huadhënësit një dëmshpërblim që është i barabartë me shumën e përgjithshme të:



- Dëmshpërblimit Kompensues të Parapagimit; dhe

- çdo kostoje që lind nga ndërprerja e çdo transaksioni mbrojtës interesi të vendosur nga Huadhënësi në lidhje me shumën e parapaguar.

9.4 Taksat dhe tatimet

9.4.1 Kostot e regjistrimit

Nëse është e zbatueshme, Huamarrësi paguan drejtpërdrejt ose rimbursion Huadhënësin në rast të një paradhënieje të bërë nga Huadhënësi, kostot e të gjitha detyrimeve të pullës, regjistrimit dhe tatime të tjera të ngjashme, që duhet të paguhet lidhur me Marrëveshjen, si dhe çdo ndryshim të mundshëm të saj sipas ligjit shqiptar.

9.4.2 Tatimi i Mbajtur në Burim

Huamarrësi merr përsipër që të gjitha pagesat që i bëhen Huadhënësit, sipas kësaj Marrëveshjeje, të jenë të lira nga çdo Tatim i Mbajtur në Burim.

Nëse Tatimi i Mbajtur në Burim kërkohet me ligj, Huamarrësi merr përsipër t'i shtojë shumës së kësaj pagese një shumë shtesë për të mbuluar këtë tatim që e lë Huamarrësin me një shumë të barabartë me pagesën e cila do të ishte e kërkueshme, nëse nuk do të ishte kërkuar Tatimi i Mbajtur në Burim.

Huamarrësi do t'i rimbursojë Huadhënësit të gjitha shpenzimet dhe/ose Taksat për llogarinë e Huamarrësit të cilat janë paguar nga Huadhënësi (nëse është e zbatueshme), me përjashtim të ndonjë Takse që duhet paguar në Francë.

9.5 Dëmshpërblimi Valutor

Nëse shuma që duhet të paguajë Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë urdhri, gjykimi apo vendimi të dhënë apo të bërë në lidhje me një shumë të tillë, duhet të konvertohet nga monedha në të cilën kjo shumë është e pagueshme në një monedhë tjetër, me qëllim të:

i. bërjes ose dorëzimit të një kërkesë ose prove kundër Huamarrësit; ose

ii. marrjes ose zbatimit të një urdhri, gjykimi ose vendimi në lidhje me një procedurë gjyqësore ose arbitrazhi,

Huamarrësi do ta dëmshpërblejë Huadhënësin për dhe brenda 3 (tri) Ditësh Pune nga kërkesa e Huadhënësit dhe sipas ligjit, do t'i paguajë Huadhënësit shumën e çdo kostoje, humbjeje apo përgjegjësie që rrjedh nga ose si rezultat i konvertimit, duke përfshirë çdo mospërputhje ndërmjet: A. kursit të këmbimit të përdorur për konvertimin e shumës përkatëse nga monedha e

parë në të dytën; dhe B. kursit ose kurseve të këmbimit të disponueshëm për Huadhënësin në kohën e marrjes së kësaj shume. Ky detyrim për dëmshpërblim të Huadhënësit është i pavarur nga çdo detyrim tjetër i Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë që mund të ketë në çfarëdo juridiksioni për të paguar ndonjë shumë që duhet paguar, sipas kësaj Marrëveshjeje, në një monedhë ose njësi monedhe, të ndryshme nga ajo në të cilën është shprehur se do të paguhet.

9.6 Datat e caktuara

Çdo dëmshpërblim apo rimbursim që i paguhet Huadhënësit nga Huamarrësi sipas kësaj klauzole 9 (*Detyrime për pagesa shtesë*) pritet dhe është i pagueshëm në Datën e Pagesës menjëherë pas rrethanave të cilat kanë shkaktuar këtë dëmshpërblim apo rimbursim përkatës.

Pavarësisht nga sa më sipër, çdo dëmshpërblim që duhet të paguhet në lidhje me një parapagim sipas klauzolës 9.3 (*Dëmshpërblimi i Parapagimit*) është i kërkueshëm dhe i pagueshëm në datën e pagesës përkatëse.

10. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

Të gjitha përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë klauzolë 10 (*Përfaqësimet dhe garancitë*) janë bërë nga Huamarrësi në interes të Huadhënësit në Datën e Nënshkrimit. Të gjitha përfaqësimet dhe garancitë në këtë klauzolë 10 (*Përfaqësimet dhe Garancitë*) konsiderohen, gjithashtu, të jenë bërë nga Huamarrësi në Datën e Hyrjes në Fuqi, në datën kur të gjitha kushtet pararendëse të renditura në pjesën III të skedulit 4 (*Kushtet Pararendëse*) të jenë plotësuar, në datën e çdo Kërkesë për Disbursim, në çdo Datë Disbursimi dhe në çdo Datë Pagese, përveç përsëritjes së përfaqësimeve në Klauzolën 10.9 (*Mungesa e informacionit keqinformues*), që duhet të bëhen nga Huamarrësi, në lidhje me informacionin e dhënë nga Huamarrësi që nga data kur është bërë përfaqësimi.

10.1 Kompetenca dhe autoriteti

Huamarrësi ka kompetencë të lidhë këtë Marrëveshje dhe të kryejë të gjitha detyrimet e parashikuara. Huamarrësi ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar lidhjen e saj.

10.2 Vlefshmëria dhe pranueshmëria me prova

Të gjitha autorizimet që kërkohen për ta bërë këtë Marrëveshje të pranueshme me prova në



gjykatat kompetente të Huamarrësit apo në procedurën e arbitrazhit, siç është përcaktuar në klauzolën 17 (*Ligji rregullues, zbatimi dhe zgjedhja e vendbanimit*), do të jenë marrë në datën e hyrjes në Fuqi dhe do të jenë në fuqi dhe efekt të plotë dhe asnjë rrethanë nuk do të çojë në revokim, mosrinovim apo modifikim, në tërësi apo pjesërisht, të këtyre autorizimeve.

10.3 Detyrimet e zbatueshme

Detyrimet e shprehura për t'u ndërmarrë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje janë në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme për Huamarrësin në juridiksionin e tij dhe janë detyrime ligjore, të vlefshme dhe të zbatueshme, të cilat janë efektive në përputhje me kushtet e tyre të shkruara.

10.4 Mospasja e taksave të depozitimit ose pullës

Sipas ligjeve të juridiksionit të themelimit të Huamarrësit, nuk është e nevojshme që kjo Marrëveshje të regjistrohet, protokollohet apo të listohet në ndonjë gjykatë ose autoritet tjetër në atë juridiksion apo që të paguhet ndonjë pullë, regjistrim apo tatim për ose në lidhje me këtë Marrëveshje apo me transaksionet e parashikuara në të.

10.5 Transferimi i fondeve

Të gjitha shumat që duhen paguar nga Huamarrësi për Huadhënësin, sipas kësaj Marrëveshjeje, qoftë si principal apo interes, interes pagese të vonuar, Dëmshpërblim Parapagimi, kosto dhe shpenzime të rastit apo çdo shumë tjetër konvertohen dhe transferohen lirisht.

Ky përfaqësim do të mbetet në fuqi dhe efekt të plotë deri në shlyerjen e plotë të të gjitha shumave të kërkueshme për Huadhënësin. Në rast se datat e shlyerjes së Linjës së Kredisë zgjaten nga Huadhënësi, asnjë konfirmim i mëtejshëm i këtij përfaqësimi nuk do të jetë i nevojshëm.

Huamarrësi duhet të ketë euro të nevojshme për të respektuar këtë përfaqësim në kohën e duhur.

10.6 Mospasja konflikt me detyrime të tjera

Hyrja në dhe kryerja nga ana e Huamarrësit e transaksioneve të parashikuara nga kjo Marrëveshje nuk bien ndesh me asnjë ligj apo rregullore të brendshme apo të jashtme që zbatohet për të, dokumentet e saj kushtetuese (apo ndonjë dokument të ngjashëm) apo çfarëdo marrëveshjeje apo instrumenti detyrues për Huamarrësin apo që ndikon në cilindo prej aseteve të tij.

10.7 Ligji Rregullues dhe Zbatimi

a) Zgjedhja e ligjit francez si ligji rregullues i kësaj Marrëveshjeje do të njihet dhe zbatohet nga gjykatat dhe tribunatet e arbitrazhit në juridiksionin e Huamarrësit.

b) Çdo vendim i marrë në lidhje me këtë Marrëveshje në një gjykatë franceze ose çdo vendim i dhënë nga një gjykatë arbitrazhi do të njihet dhe zbatohet në juridiksionin e themelimit të Huamarrësit.

10.8 Mungesa e Mospërmbushjes së Detyrimeve. Asnjë Rast i Mospërmbushjes së Detyrimeve nuk është në vijim e sipër dhe as nuk mund të ndodhë në mënyrë të arsyeshme.

Asnjë shkelje e Huamarrësit nuk është në vijim në lidhje me ndonjë marrëveshje tjetër detyruese të tij apo që ndikon në secilin prej aseteve të tij, e cila ka ose në mënyrë të arsyeshme mund të ketë Ndikim Negativ Material.

10.9 Mungesa e informacionit keqinformues

Të gjitha informacionet dhe dokumentet që i janë dhënë Huadhënësit nga Huamarrësi kanë qenë të vërteta, të sakta dhe të përditësuara në datën kur janë dhënë ose, nëse është e nevojshme, në datën kur janë deklaruar për t'u dhënë dhe nuk janë ndryshuar, revokuar, anuluar apo rinovuar, sipas afateve të rishikuara, dhe nuk janë keqinformuese në asnjë aspekt material, si pasojë e shmangies, paraqitjes së rrethanave të reja apo zbulimit apo moszbulimit të ndonjë informacioni.

10.10 Renditja *pari passu*

Detyrimet për pagesë të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje renditen të paktën *pari passu* në të drejtën e pagesës me të gjitha detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhme të pasiguruara dhe të pakonsoliduara.

10.11 Origjina e fondeve, aktet e korrupsionit, mashtrimit dhe praktikave kundër konkurrencës

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton, se:

të gjitha fondet e investuara në Program janë nga buxheti i shtetit ose nga Bashkë financuesi;

Programi nuk jep shkak për asnjë Akt Korrupsioni, Mashtrimi ose Praktike Kundër Konkurrencës.

10.12 Mungesa e Ndikimit Negativ Material

Huamarrësi paraqet dhe garanton se nuk ka ndodhur dhe nuk mund të ndodhë asnjë rast apo rrethanë e cila mund të ketë ndonjë Ndikim Material Negativ.



11. ZOTIMET

Zotimet në këtë klauzolë 11 (*Zotimet*) hyjnë në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe mbeten në fuqi dhe efekt të plotë për aq kohë sa shuma është e papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje.

11.1 Përputhshmëria me Ligjet, Rregulloret dhe Detyrimet

Huamarrësi duhet të jetë në përputhje

a) në të gjitha aspektet, me të gjitha ligjet dhe rregulloret të cilave u nënshtrohet ai dhe/ose Programi, veçanërisht në lidhje me të gjitha ligjet e zbatueshme të prokurimit, mbrojtjes së mjedisit, sigurisë dhe punës dhe

b) me të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

11.2 Autorizimet

Huamarrësi menjëherë do të sigurojë, pajtohet me dhe do të bëjë gjithçka të nevojshme për të ruajtur në fuqi dhe efekt të plotë çdo Autorizim të kërkuar, sipas një ligji ose rregulloreje të zbatueshme për t'i mundësuar atij përmbushjen e detyrimeve, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe për të garantuar ligjshmërinë, vlefshmërinë, zbatimin dhe pranueshmërinë e tyre me prova.

11.3 Zbatimi dhe Ruajtja e Programit

Huamarrësi do të:

zbatojë Programin, në përputhje me parimet e përgjithshme të pranura të sigurisë dhe standardet teknike në fuqi; dhe

mbajë asetet e Programit, në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe në kushte të mira operimi dhe mirëmbajtjeje dhe do t'i përdorë këto asetë, në përputhje me qëllimin e tyre dhe të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

11.4 Përgjegjësia Mjedisore dhe Sociale

11.4.1 Zbatimi i masave mjedisore dhe sociale

Në mënyrë që të promovohet zhvillimi i qëndrueshëm, Palët bien dakord se është e nevojshme të nxitet zbatimi i standardeve të njohura ndërkombëtare mjedisore dhe të punës, duke përfshirë konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës ("ILO") dhe ligjet ndërkombëtare për mjedisin dhe rregullat e zbatueshme në juridiksionin e Huamarrësit.

11.4.2 Menaxhimi i ankesave mjedisore dhe sociale

a) Huamarrësi: i. konfirmon se ka marrë një kopje të Procedurave të Menaxhimit të Ankimimit ES dhe ka pranuar kushtet e tyre, në veçanti, lidhur me veprimet që mund të ndërmerren nga

Huadhënësi në rast se një palë e tretë ka ankesa; dhe ii. pranon që Procedurat e Menaxhimit të Mosmarrëveshjeve ES kanë, si ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit, të njëjtën efekt kontraktual të detyrueshëm si kjo Marrëveshje.

b) Huamarrësi autorizon shprehimisht Huadhënësin që t'u japë Ekspertëve (siç është përcaktuar në Procedurat e Menaxhimit të Mosmarrëveshjeve ES) dhe Palëve të përfshira në auditimin e pajtueshmërisë dhe/ose në procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, dokumentet e Projektit në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale të nevojshme për trajtimin e Mosmarrëveshjes Mjedisore dhe Sociale (siç është përkufizuar në Procedurat e Menaxhimit të Mosmarrëveshjeve ES), duke përfshirë, pa kufizim, ato të renditura në skedulën 7 (*Lista joshtruese e dokumenteve mjedisore dhe sociale, të cilat Huamarrësi lejon të zbulohen në lidhje me Procedurat e Menaxhimit të Mosmarrëveshjeve ES*).

11.5 Renditja *pari passu*

Huamarrësi merr përsipër: i. të garantojë që detyrimet e tij të pagesës, sipas kësaj Marrëveshjeje, renditen dhe do të renditen në çdo kohë të paktën *pari passu* në të drejtën e pagesës me të gjitha detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhme të pasiguruara dhe të pakonsoliduara; ii. të mos japë renditje të mëparshme ose garanci për asnjë huadhënës tjetër, përveç nëse të njëjtat renditje apo garanci jepen nga Huamarrësi në favor të Huadhënësit, nëse këtë e kërkon Huadhënësi.

11.6 Inspektimet

Me anë të kësaj, Huamarrësi autorizon Huadhënësin dhe përfaqësuesit e tij për të kryer inspektime çdo vit, qëllimi i të cilave do të jetë vlerësimi i zbatimit të Programit [dhe i Skemës së Monitorimit] mbi aspekte teknike, financiare dhe institucionale.

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, do të bashkëpunojë dhe do t'u ofrojë të gjithë ndihmën dhe informacionet e arsyeshme Huadhënësit dhe përfaqësuesve të tij gjatë kryerjes së inspektimeve të tilla, koha dhe formati i të cilave do të përcaktohet nga Huadhënësi në konsultim me Huamarrësin.

11.7 Vlerësimi i Programit

Huamarrësi pranon se Huadhënësi mund të kryejë ose të prokurorë që një palë e tretë të kryejë në emër të tij, një vlerësim të Programit. Ky vlerësim do të përdoret për të përgatitur një raport



ecurie, që përfshin informacione mbi Programin, të tilla si shumën totale dhe kohëzgjatjen e Linjës së Kredisë, objektivat e Programit, rezultatet e pritshme dhe reale të Programit, vlerësimin e rëndësisë, efikasitetit, ndikimit dhe qëndrueshmërisë së tij. Huamarrësi bie dakord me publikimin e këtij raporti ecurie, në veçanti, në faqen e internetit të Huadhënësit.

11.8 Zbatimi i Programit

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë:

garanton që çdo person, grup apo subjekt që merr pjesë në zbatimin e Programit të mos jetë i shënuar në Listën e Sanksioneve Financiare (duke përfshirë veçanërisht luftën kundër financimit të terrorizmit); dhe

nuk financon asnjë furnizim apo sektor që i nënshtrohet një Embargoje nga Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian apo Franca.

11.9 Origjina e fondeve, Mungesa e Akteve të Korrupsionit, Mashtrimit dhe Praktikave Kundër Konkurrencës

Huamarrësi merr përsipër:

i. të bëjë përpjekjet maksimale që fondet, përveç atyre me origjinë shtetërore, të përdorura për zbatimin e Programit, të mos jenë me Origjinë të Paligjshme;

ii. të garantojë që Programi nuk përbën shkak për asnjë Akt Korrupsioni, Mashtrimi ose Praktike Kundër Konkurrencës;

iii. sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë Akt Korrupsioni, Mashtrimi apo Praktike kundër Konkurrencës, të informojë Huadhënësin pa vonesë;

iv. në rastin e përmendur në paragrafin (iii) më sipër ose me kërkesë të Huadhënësit, nëse Huadhënësi dyshon se veprimet apo praktikat e përmendura në paragrafin (iii) kanë ndodhur, ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme për të përmirësuar situatën në një mënyrë të pranueshme për Huadhënësin dhe brenda periudhës kohore të përcaktuar nga Huadhënësi; dhe

v. të njoftojë Huadhënësin pa vonesë, nëse ka dijeni për ndonjë informacion që çon në dyshimin e ndonjë Origjine të Paligjshme të ndonjë fondi të përdorur për zbatimin e Programit.

12. Zotimet e Informacionit

Zotimet në këtë klauzolë 12 (*Zotimet e Informacionit*) hyjnë në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe mbeten në fuqi dhe efekt të plotë për aq

kohë sa shumta është e pashlyer sipas kësaj Marrëveshjeje.

12.1 Informacioni Financiar

Huamarrësi duhet t'i japë Huadhënësit çdo informacion që Huadhënësi mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me borxhin e jashtëm dhe të brendshëm të Huamarrësit, si dhe statusin e ndonjë kredie të garantuar.

12.2 Zbatimi i Programit

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, duhet t'i japë Huadhënësit, menjëherë pas kërkesës së Huadhënësit, çdo informacion apo dokument mbështetës, lidhur me Programin dhe zbatimin e skemës së Monitorimit.

12.3 Raporti i Monitorimit

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, do t'i japë Huadhënësit:

a) Deri në Datën e Përfundimit të Programit, brenda 1 (një) muaji pas fundit të secilit tremujor, një raport monitorimi, në lidhje me zbatimin e Programit gjatë vitit të kaluar;

b) Brenda 1 (një) muaji pas Datës së Përfundimit të Programit, raportin që përmbledh zbatimin teknik dhe buxhetor të Programit.

12.4 Bashkëfinancimi

Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Huadhënësin për çdo anulim (të plotë apo të pjesshëm) ose çdo parapagim nga një Bashkëfinancues.

12.5 Informacioni Shtesë

Huamarrësi i dorëzon Huadhënësit:

a) menjëherë pas marrjes dijeni të tyre, detajet e çdo rasti apo rrethane që është apo mund të jetë një Rast i Mospërmbushjes së Detyrimeve apo që ka ose mund të ketë një Ndikim Material Negativ, natyrën e një rasti të tillë dhe të gjitha veprimet e ndërmarra apo që do të ndërmerren për ta korrigjuar atë (nëse ka);

b) menjëherë, detajet e çdo vendimi ose rasti që mund të ndikojë në organizimin, përfundimin apo funksionimin e Programit;

c) dëshmi të ndjekjes së Vlerësimit të Sistemit Mjedisor dhe Social (ESSA) që do të kryhet nga Huadhënësi;

d) informacion mbi ndryshimin e Planit të Financimit.



13. RASTET E MOSPËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE

13.1 Rastet e Mospërmbushjes së Detyrimeve

Çdo rast apo rrethanë e përcaktuar në këtë klauzolë 13.1 (*Rastet e Mospërmbushjes së Detyrimeve*) është një Rast i Mospërmbushjes së Detyrimeve.

a) Moskryerja e Pagesës

Huamarrësi nuk paguan në datën e duhur çdo shumë që duhet paguar sipas kësaj Marrëveshjeje, në mënyrën që kërkohej sipas kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, pa cenuar klauzolën 4.3 (*Pagesat me vonesë dhe kamatëvonesa*), nuk do të ndodhë asnjë Rast i Mospërmbushjes së Detyrimeve, sipas këtij paragrafi (a), nëse një pagesë e tillë është kryer plotësisht nga Huamarrësi, brenda 5 (pesë) Ditësh Pune nga data e kërkueshme.

b) Zotimet dhe Detyrimet

Huamarrësi nuk përmbush asnjë kusht të Marrëveshjes, duke përfshirë, pa kufizim, të gjitha zotimet që ka dhënë në përfundim me klauzolën 11 (*Zotimet*) dhe klauzolën 12 (*Zotimet e Informacionit*).

Përveç zotimeve të dhëna sipas klauzolës 11.4 (*Përgjegjësia Mjedisore dhe Sociale*), klauzolës 11.8 (*Zbatimi i Programit*) dhe 11.9 (*Origjina e fondeve, mungesa e akteve të korrupsionit, mashtrimit ose praktikës kundër konkurrencës*), në lidhje me të cilat nuk lejohet periudhë pas datës së kërkueshme, gjatë së cilës pagesa mund të bëhet pa gjobë, asnjë Rast i Mospërmbushjes së Detyrimeve nuk do të ndodhë sipas këtij paragrafi (b), nëse mospërmbushja mund të korrigjohet dhe shmanget brenda 5 (pesë) Ditësh Pune më herët nga: A. Data e njoftimit të Huadhënësit për mospërmbushjen e Huamarrësit; B. Huamarrësi merr dijeni për shkeljen, ose brenda afatit kohor të përcaktuar nga Huadhënësi në rastin e përmendur në nënparagrafin (iv) të klauzolës 11.9 (*Origjina e Fondeve, Mungesa e Akteve të Korrupsionit, Mashtrimit ose Praktikës Kundër-Konkurrencës*).

c) Keqpërfaqësimi

Një përfaqësim ose garanci e bërë nga Huamarrësi në Marrëveshje, duke përfshirë klauzolën 10 (*Përfaqësimi dhe garancitë*) apo në çfarëdo dokumenti të dorëzuar nga ose në emër të Huamarrësit, sipas apo në lidhje me Marrëveshjen, është e pasaktë ose keqinformuese, kur është bërë apo gjykuar se është bërë.

d) Mospërmbushja e Tërthortë e Detyrimeve:

a) Në bazë të paragrafit (b), çdo Borxh financiar i Huamarrësit nuk paguhet në datën e tij të caktuar ose, nëse është e zbatueshme, brenda çdo periudhe

pas datës së kërkueshme gjatë së cilës pagesa mund të bëhet pa gjobë, në përfundim me dokumentacionin përkatës.

b) Një kreditor ka anuluar apo ka pezulluar angazhimin e tij ndaj Huamarrësit, në përfundim me çdo Borxh Financiar, ose ka deklaruar Borxhin Financiar të kërkueshëm dhe të pagueshëm para maturimit të tij të caktuar, ose ka kërkuar parapagimin të plotë të Borxhit Financiar, në secilin rast, si rezultat i një Rasti të Mospërmbushjes së Detyrimeve ose dispozite që ka efekt të ngjashëm (cilado qoftë e përshkruar), në përfundim me dokumentacionin përkatës.

c) Asnjë Rast i Mospërmbushjes së Detyrimeve nuk do të ndodhë sipas kësaj klauzole 13.1(d) (*Mospërmbushja e Tërthortë e Detyrimeve*) nëse shumat përkatëse e Borxhit Financiar ose angazhimi për Borxhin Financiar, sipas paragrafëve (i) dhe (ii) është më pak se 30,000,000 euro (tridhjetë milionë euro) (ose ekuivalenti i tij në ndonjë valutë tjetër).

e) Paligjshmëria

Është ose bëhet e paligjshme që Huamarrësi të kryejë të gjitha detyrimet e tij, sipas kësaj Marrëveshjeje.

f) Ndryshimi Negativ Material

Ndodh apo mund të ndodhë ndonjë rast (përfshirë një ndryshim në situatën politike të vendit të Huamarrësit) apo ndonjë masë që sipas opinionit të Huadhënësit, mund të ketë një Ndikim Negativ Material.

g) Tërheqja ose pezullimi i Programit

Ndodh ndonjë nga rastet e mëposhtme:

a) Huamarrësi tërhiqet nga Programi;

b) zbatimi i Programit pezullohet nga Huamarrësi për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj; ose

h) Autorizimet

Çdo Autorizim i nevojshëm për Huamarrësin për të kryer apo përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje apo të kërkuar gjatë rrjedhës së zakonshme të Programit, nuk merret brenda afatit të kërkuar ose anulohet ose bëhet i pavlefshëm ose ndryshe përfundon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë.

i) Gjykimet, aktvendimet ose vendimet të cilat kanë Ndikim Material Negativ

Ndodh ose mund të ndodhë ndonjë vendim gjykatë apo arbitrazhi ose vendim gjyqësor ose administrativ që prek Huamarrësin ka ose në mënyrë të arsyeshme, sipas mendimit të



Huadhënësit, mund të ketë një Ndikim Material Negativ, ndodh ose mund të ndodhë.

j) Pezullimi i konvertimit të lirë dhe i transferimit të lirë

Nuk lejohet konvertimi i lirë dhe transferimi i lirë i ndonjë shume që duhet paguar nga Huamarrësi, sipas kësaj Marrëveshjeje ose çdo Linjë tjetër Kredie, që ofrohet nga Huadhënësi për Huamarrësin apo ndonjë huamarrës tjetër në juridiksionin e Huamarrësit.

13.2 Përsheptimi

Në çdo kohë, pas ndodhjes së një Rasti të Mospërbushjes së Detyrimeve, Huadhënësi, pa dërguar një kërkesë zyrtare ose pa filluar ndonjë procedim gjyqësor ose jashtëgjyqësor, me anë të një njoftimi me shkrim për Huamarrësin, mund:

a) të anulojë Linjën e Kredisë së Disponueshme; dhe/ose

b) të deklarojë se e gjithë apo një pjesë e Linjës së Kredisë, së bashku me ndonjë interes të llogaritur apo të papaguar dhe të gjitha shumat e tjera të paguara, sipas kësaj Marrëveshjeje, janë menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme.

Pa cenuar sa më sipër, në rast se një Rast i Mospërbushjes së Detyrimeve ndodh siç është përcaktuar në klauzolën 13.1 (*Rastet e Mospërbushjes së Detyrimeve*), Huadhënësi rezervon të drejtën që, pas njoftimit me shkrim për Huamarrësin: i. të pezullojë ose shtyjë Disbursimin, sipas Linjës së Kredisë; dhe/ose ii. të pezullojë finalizimin e marrëveshjeve në lidhje me ofertat e tjera financiare të mundshme, të cilat Huadhënësi ia ka njoftuar Huamarrësit; dhe/ose iii. të pezullojë ose shtyjë çfarëdo Disbursimi, sipas ndonjë marrëveshjeje huaje të lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit.

Nëse ndonjë Disbursim shtyhet apo pezullohet nga një Bashkëfinancues, sipas një marrëveshjeje ndërmjet Bashkëfinancuesit dhe Huamarrësit, Huadhënësi rezervon të drejtën për shtyrjen ose pezullimin e Disbursimeve sipas Linjës së Kredisë.

13.3 Njoftimi i një Rasti të Mospërbushjes së Detyrimeve

Në përputhje me klauzolën 12.5 (*Informacione Shtesë*), Huamarrësi njofton Huadhënësin menjëherë sapo të ketë dijeni për një rast i cili është ose mund të jetë një Rast i Mospërbushjes së Detyrimeve dhe informon Huadhënësin për të gjitha masat e parashikuara nga Huamarrësi për ta rregulluar atë.

14. MENAXHIMI I LINJËS SË KREDISË

14.1 Pagesat

Të gjitha pagesat e marra nga Huadhënësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen për pagimin e shpenzimeve, tarifave, interesit, shumës së principalit ose çdo shume tjetër të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, në rendin e mëposhtëm:

1. shpenzimet dhe kostot e rastit;
2. tarifat;
3. interesi për pagesat e vonuara dhe kamatëvonesa;
4. interesi i llogaritur;
5. shlyerjet e principalit.

Çdo pagesë e marrë nga Huamarrësi do të zbatohet fillimisht për apo ndaj çdo pagesë të shumave, të cilat janë të kërkueshme dhe të pagueshme, sipas Linjës së Kredisë ose sipas kredive të tjera të dhëna nga Huadhënësi për Huamarrësin, nëse është në interes të Huadhënësit për t'i zbatuar këto shuma për kreditë e tjera të tilla, në rendin e përcaktuar më lart.

14.2. Konfiskimi

Pa miratimin paraprak të Huamarrësit, Huadhënësi, në çdo kohë, mund të konfiskojë detyrimet e pritshme dhe të pagueshme nga Huamarrësi kundrejt çdo shume që mbahet nga Huadhënësi në emër të Huamarrësit apo ndonjë detyrim të pritshëm dhe të pagueshëm të zotëruar nga Huadhënësi për Huamarrësin. Nëse detyrimet janë në monedha të ndryshme, Huadhënësi mund të konvertojë secilin detyrim në kursin mbizotërues të këmbimit për qëllime të konfiskimit.

Të gjitha pagesat e kryera nga Huamarrësi, sipas Marrëveshjes do të llogariten dhe bëhen pa konfiskim. Huamarrësi ndalohet të mbajë ndonjë konfiskim nga pagesat kundrejt ndonjë të drejte, përveç nëse këto të drejta njihen me vendim të formës së prerë.

14.3 Ditët e Punës

Nëse pagesa është e kërkueshme në një ditë që nuk është Ditë Pune, data e caktuar për atë pagesë do të jetë Dita e ardhshme e Punës, nëse Dita e ardhshme e Punës është në të njëjtin muaj kalendarik, ose Dita e mëparshme të Punës, nëse Dita e ardhshme e Punës nuk është në të njëjtin muaj kalendarik.

Gjatë çdo shtyrjeje të Datës së Pagesës për një shumë principal apo të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje, interesi do të paguhet për atë shumë



gjatë periudhës së shtyrjes në normën e zbatueshme në Datën fillestare të Pagesës.

14.4 Monedha e pagesës

Monedha e çdo shume të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje është euroja.

14.5 Marrëveshja në fuqi e numërimit të ditëve

Çdo interes, tarifë apo shpenzim i llogarit, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të llogaritet në bazë të numrit aktual të ditëve të kaluara dhe një viti prej 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditësh, në pajtim me praktikat e tregut ndërbankar evropian.

14.6 Vendi i pagesës

a) Çdo fond që do të transferohet nga Huadhënësi për Huamarrësin, sipas Linjës së Kredisë do të paguhet në llogarinë bankare të Huamarrësit në Bankën e Shqipërisë, siç do të njoftohet nga Huamarrësi për Huadhënësin.

b) Çdo pagesë që duhet të bëhet nga Huamarrësi për Huadhënësin, do të paguhet në datën e duhur jo më vonë se ora 11:00 (ora e Parisit), në llogarinë bankare të mëposhtme:

Kodi RIB: 30001 00064 00000040235 03

Kodi IBAN: FR76 3000 1000 6400 0000 4023 503

Kodi SWIFT (BIC) Banque de France: BDFEFRPPCCT,

të hapur nga Huadhënësi në *Banque de France* (selia qendrore/dega kryesore) në Paris ose në ndonjë llogari tjetër të njoftuar nga Huadhënësi për Huamarrësin.

c) Huamarrësi duhet të kërkojë nga banka përgjegjëse për transferimin e çfarëdo shume të Huadhënësi që të japë informacionet e mëposhtme në çdo mesazh të transferimit telegrafik, në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe në rendin e përcaktuar më poshtë (numrat i referohen SWIFT MT 202 dhe protokollit 103):

- Porositësi: Emri, adresa, numri i llogarisë bankare (fusha 50);

- Banka e Porositësit: emri dhe adresa (fusha 52);

- Referenca: emri i huamarrësit, emri i Programit, numri i referencës së Marrëveshjes (fusha 70).

d) Të gjitha pagesat e kryera nga Huamarrësi duhet të jenë në përputhje me këtë klauzolë 14.6 (*Vendi i pagesës*), në mënyrë që detyrimi përkatës i pagesës të konsiderohet i shlyer në tërësi.

14.7 Ndërprerja e sistemeve të pagesave

Nëse Huadhënësi vendos (në diskrecionin e vet) se ka ndodhur një Rast Ndërprerjeje e Sistemit të Pagesave ose Huamarrësi njofton Huadhënësin se ka ndodhur një Rast i Ndërprerjes së Sistemit të Pagesave, Huadhënësi:

a) mund, dhe nëse kërkohet nga Huamarrësi, hyn në diskutime me Huamarrësin për të rënë dakord për çfarëdo ndryshimi të operimit dhe menaxhimit të linjës së kredisë që huadhënësi mund ta çmojë të nevojshëm në këto rrethana;

b) nuk është i detyruar të hyjë në bisedime me Huamarrësin në lidhje me ndryshimet e përmendura në paragrafin (a), nëse sipas mendimit të tij, nuk është e mundur që të veprohet kështu, sipas rrethanave dhe në çdo rast nuk ka detyrim të pajtohet për ndryshimet e tilla; dhe

c) nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë kosto, humbje ose detyrim, që shkaktohet si rezultat i marrjes ose mosmarrjes së ndonjë veprimi, në përputhje me këtë nen 14.7 (*Ndërprerja e Sistemit të Pagesave*).

15. TË NDRYSHME

15.1 Gjuha

Gjuha e kësaj marrëveshjeje është gjuha angleze. Nëse kjo marrëveshje përkthehet në një gjuhë tjetër, versioni i gjuhës angleze do të ketë përparësi në rast të ndonjë interpretimi kontradiktor apo në rast të një mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve.

Të gjitha njoftimet e dhëna apo dokumentet e paraqitura, në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje apo në lidhje me të, do të jenë në gjuhën angleze.

Kreditori mund të kërkojë që një njoftim ose dokument i dhënë, në bazë të ose në lidhje me këtë marrëveshje, e cila nuk është në gjuhën angleze, të shoqërohet me përkthimin e vërtetuar në gjuhën angleze. Në këtë rast, përkthimi në gjuhën angleze ka përparësi, përveç nëse dokumenti është një dokument statutor i një shoqërie, tekst ligjor apo dokument tjetër zyrtar.

15.2 Certifikimet dhe përcaktimet

Në çdo procedim gjyqësor ose arbitrazh, që rrjedh nga ose që ka lidhje me këtë Marrëveshje, shënimet e bëra në llogaritë e mbajtura nga Huadhënësi janë dëshmi *prima facie* të çështjeve me të cilat janë të lidhura.

Çdo certifikim apo përcaktim i Huadhënësit të një norme apo shume, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jetë, në mungesë të gabimit të dukshëm, provë përfundimtare e çështjeve me të cilat lidhet.



15.3 Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse, në çdo kohë, një kusht i kësaj Marrëveshjeje është apo bëhet i paligjshëm, i pavlefshëm apo i pazbatueshëm, as vlefshmëria, ligjshmëria dhe as zbatimi i dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje nuk do të preket apo dëmtohet.

15.4 Mosheqja dorë nga të drejtat

Mosushtrimi apo vonesa e ushtrimit nga ana e Huadhënësit, të ndonjë të drejte sipas Marrëveshjes, nuk do të veprojë si heqje dorë nga kjo e drejtë.

Ushtrimi i pjesshëm i të gjitha të drejtave nuk pengon ushtrimin e mëtejshëm të kësaj të drejte apo ushtrimin e ndonjë të drejte apo mjeti tjetër juridik sipas ligjit në fuqi.

Të drejtat dhe mjetet juridike të palëve, sipas kësaj marrëveshjeje, janë kumulative dhe jopërfshijëse për çfarëdo të drejte dhe mjeti juridik, sipas ligjit në fuqi.

15.5 Caktimi

Huamarrësi nuk mund të caktojë apo transferojë në asnjë mënyrë të gjitha apo ndonjë prej të drejtave dhe detyrimeve të tij sipas kësaj marrëveshjeje.

Huadhënësi mund të caktojë ose transferojë ndonjërin prej të drejtave ose detyrimeve të tij sipas kësaj marrëveshjeje tek: i. cilido filial ose ent/subjekt i të njëjtit grup si Huadhënësi; ose ii. ndonjë institucion tjetër financiar; ose iii. ndonjë subjekt tjetër, me kusht që të jetë i themeluar, me seli apo i vendosur në Bashkimin Evropian dhe mund të hyjë në cilëndo marrëveshje nënpjesëmarrëse lidhur me të.

Huadhënësi i jep informacione paraprake huamarrësit mbi këtë caktim ose transferim.

15.6 Efekti ligjor

Skedulet e vendosura si shtojca të kësaj Marrëveshjeje dhe përcaktimet e saj kanë efekt të njëjtë ligjor.

15.7 Marrëveshja e plotë

Që nga data e nënshkrimit, kjo marrëveshje përfaqëson marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve, në lidhje me çështjet e parashtruara këtu, dhe zëvendëson të gjitha dokumentet, marrëveshjet ose mirëkuptimet e mëparshme, të cilat mund të jenë shkëmbyer ose komunikuar si pjesë e negociatave, në lidhje me këtë marrëveshje.

15.8 Ndryshimet

Çdo ndryshim në këtë Marrëveshje duhet të bëhet me shkrim. Huamarrësi përfaqëson dhe garanton, se:

a) Ministri i Ekonomisë dhe Financave është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim, i cili duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave; dhe

b) Ndryshimet në këtë marrëveshje që prekin vetëm periudhën e disponueshmërisë, nuk do të kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave.

15.9 Konfidencialiteti – Zbulimi i informacioneve

a) Huamarrësi nuk duhet të zbulojë përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje për ndonjë palë të tretë pa pëlqimin paraprak të huadhënësit, përveç ndonjë personi të cilit huamarrësi ka detyrim t'ia zbulojë sipas ndonjë ligji, rregulloreje ose vendimi gjyqësor të zbatueshëm. Huamarrësi mund ta publikojë këtë marrëveshje në Fletoren Zyrtare, nëse kërkohet sipas ligjit në fuqi dhe akteve nënligjore për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

b) Pavarësisht nga ndonjë marrëveshje ekzistuese për konfidencialitetin, huadhënësi mund të zbulojë ndonjë informacion ose dokument, në lidhje me Programin, për: i. audituesit, ekspertët, agjencitë vlerësuese, këshilltarët ligjorë ose organet mbikëqyrëse; ii. çdo person ose subjekt të cilit huadhënësi mund t'i caktojë ose t'i transferojë të gjitha ose një pjesë të të drejtave ose detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes; dhe iii. çdo person ose ent/subjekt, me qëllim marrjen e masave mbrojtëse ose ruajtjen e të drejtave të huadhënësit sipas Marrëveshjes.

c) Gjithashtu, Huadhënësi mund:

a) të shkëmbejë me Republikën franceze për publikim në faqen e internetit të qeverisë franceze, në pajtim me çdo kërkesë të Iniciativës për Transparencë Ndërkombëtare; dhe

b) të publikojë në faqen e internetit të huadhënësit;

Informacione që lidhen me Programin dhe financimin e tij, siç është renditur në skedulin 6 (*Informacione që mund të publikohen në faqen e internetit të Qeverisë Franceze dhe në faqen e huadhënësit*).

15.10 Kufizimet

Parashkrimi i çdo pretendimi, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jetë 10 (dhjetë) vjet, përveç kërkesës për interes që duhet paguar në bazë të kësaj marrëveshjeje.



15.11 Vështirësitë

Secila palë, me anë të kësaj marrëveshjeje, pranon se dispozitat e nenit 1195 të Kodit Civil Francez nuk do të zbatohen për të, në lidhje me detyrimet e saj sipas Marrëveshjes dhe nuk do të ketë të drejtë për ndonjë pretendim, sipas nenit 1195 të Kodit Civil Francez.

16. Njoftimet

16.1 Me shkrim dhe me adresa

Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim tjetër, që duhet dhënë apo bërë në lidhje me këtë marrëveshje, do të jepet apo bëhet me shkrim dhe, përveç nëse është shënuar ndryshe, mund të jepet ose të bëhet me *email* ose me letër të dërguar nga zyra postare, në adresën dhe numrin e palës përkatëse, të dhënë më poshtë:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Telefon: 00 35 54 22 84 05

Email: sekretariamin@financa.gov.al

Në vëmendje të: Ministrit të Financave dhe Ekonomisë

Për Huadhënësin:

AFD - Zyra Rajonale e Ballkanit**Perëndimor**

Adresa: Zmaj Jovina, 11, Belgrade

11. 000 Serbi

Telefon: + 381 11 78 58 830

Email: adfbalkans@afd.fr

Në vëmendje të: Dominique Hautbergue

Me një kopje për:

AFD – Zyra Qendrore e Parisit

Adresa: 5, Rue Roland Barthes – 75598 Paris

Cedex 12, France

Telefon: + 33 1 53 44 31 31

Në vëmendje të: Drejtorit Departamentit të Evropës, Lindjes së Mesme dhe Azisë ose adresë tjetër, numër faksi, departament apo zyrtar, siç njëra Palë i njofton Palës tjetër.

16.2 Dorëzimi

Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim i bërë apo dokument i dërguar nga njëra palë tek pala tjetër lidhur me këtë marrëveshje do të jetë i efektshëm:

a) nëse dërgohet me *email*, kur konfirmohet marrja e tij; dhe

b) nëse dërgohet përmes letrës në zyrën postare, kur dorëzohet në adresën e duhur dhe, kur një

person ose departament i veçantë është specifikuar si pjesë e detajeve të adresës së parashikuar, sipas nenit 16.1 (*Me shkrim dhe adresa*), nëse njoftimi, kërkesa ose komunikimi i është drejtuar atij personi ose departamenti.

16.3 Komunikimet elektronike

a) Çdo komunikim i bërë nga një person me një tjetër nën ose në lidhje me këtë marrëveshje, mund të bëhet me anë të postës elektronike ose me mjete të tjera elektronike, nëse palët:

a. dakord se përveç dhe deri në njoftimin për të kundërtën, kjo do të jetë forma e pranuar e komunikimit;

b. njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim për adresën e tyre elektronike dhe/ose çdo informacion tjetër që kërkohet për të mundësuar dërgimin dhe marrjen e informacionit në këtë mënyrë; dhe

c. njoftojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim të adresës së tyre apo çdo informacion tjetër të tillë të ofruar prej tyre;

b) çdo komunikim elektronik i bërë ndërmjet palëve do të jetë në fuqi vetëm kur të pranohet në një formë të lexueshme.

17. LIGJI RREGULLUES, ZBATIMI DHE ZGJEDHJA E VENDBANIMIT

17.1 Ligji i zbatueshëm

Ligji francez është ligji i zbatueshëm i kësaj Marrëveshjeje.

17.2 Arbitrazhi

Çdo mosmarrëveshje që rrjedh ose në lidhje me këtë marrëveshje do të referohet dhe përfundimisht do të zgjidhet nëpërmjet arbitrazhit sipas rregullave të Pajtimit dhe të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, të zbatueshme në datën e fillimit të procedurës së arbitrazhit nga një apo më shumë arbitra që do të emërohen në përputhje me këto rregulla.

Selia e arbitrazhit është Parisi dhe gjuha e arbitrazhit është gjuha angleze.

Kjo dispozitë e arbitrazhit mbetet në fuqi dhe efekt të plotë, nëse kjo Marrëveshje shpallet e pavlefshme ose ndërpritet ose pas skadimit të kësaj Marrëveshjeje. Detyrimet kontraktuale të palëve, sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk pezullohen nëse një palë fillon procedura ligjore kundër palës tjetër.

Palët bien dakord shprehimisht se me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, huamarrësi në mënyrë të pakthyeshme heq dorë nga të gjitha të drejtat e imunitetit, përveç siç është parashikuar në paragrafin në vijim, në lidhje me juridiksionin ose



ekzekutimin në të cilin do të mund të mbështetej ndryshe.

Huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet në lidhje me:

a) “ambientet e misionit”, të tashme apo të ardhshme, siç është përcaktuar në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar në 1961, “mjediset konsullore” të tashme apo të ardhshme siç është përcaktuar në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar më 1963-shin ose që ndryshe përdoren nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë;

b) çdo pasuri të paluajtshme që ndodhet në Shqipëri, sipas nenit 3, paragrafi 1–3 i ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme shtetërore”.

c) çdo fond monetar dhe/ose shumë që do të paguhet për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka në kuadër të traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve publike ndërkombëtare të nënshkruara prej saj në cilësinë e Shërbimit të së Drejtës Ndërkombëtare Publike.

17.3 Njoftimi i procesit

Pa cenuar ndonjë ligj të zbatueshëm, për qëllime të dorëzimit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, në lidhje me ndonjë veprim apo procedurë të përmendur më sipër,

Dorëzimi i dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore ndaj huamarrësit do të kryhet në përputhje me “Konventën e Hagës të 15 nëntorit 1965, mbi Dorëzimin jashtë Vendit të Dokumenteve Gjyqësore dhe Jashtëgjyqësore në Çështjet Civile apo Tregtare”. Autoriteti emërues për këtë dorëzim është Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, nr. 6, Tiranë, Shqipëri.

Huadhënësi zgjedh adresën “AFD SIEGE” të vendosur në klauzolën 16 (*Njoftimet*) për njoftim të procesit.

18. KOHËZGJATJA

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe mbetet në fuqi dhe efekt të plotë për aq kohë sa shuma është e papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje.

Pavarësisht nga sa më sipër, detyrimet sipas klauzolës 15.9 (*Konfidencialiteti – Zbulimi i informacioneve*) do të jenë dhe do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh pas Datës së Pagesës së fundit; dispozitat e klauzolës 11.4.2 (*Menaxhimi i ankesave mjedisore dhe sociale*) do të vazhdojnë të kenë efekt për aq kohë sa çdo ankesë e paraqitur në kuadër të procedurave të menaxhimit të ankesave të ES është ende në proces dhe në monitorim.

Bërë në 2 (dy) kopje origjinale, në Tiranë (Republika e Shqipërisë), më 12 nëntor 2021.

HUAMARRËSI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Përfaqësuar nga:

Emri: Znj. Delina Ibrahimaj

Pozicioni: MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

HUADHËNËSI

AGENCE FRANÇAISE DE DÉVELOPPEMENT

Përfaqësuar nga: Emri: Znj. Cecile Couprie

Pozicioni: DREJTOR RAJONAL PËR EUROAZINË

Bashkë nënshkruesi, shkëlqesia e saj, znj. Elisabeth Barsacq, Ambasador i Francës



SKEDULI 1A – PËRKUFIZIMET

“Akt korrupsioni”	nënkupton secilin sa më poshtë: a) aktin e premtimit, ofrimit ose dhënies, drejtpërdrejt ose tërthorazi, zyrtarit publik ose cilitdo person që drejton ose punon, në çfarëdo cilësie, për një njësi të sektorit privat, avantazh të paarsyeshëm të çfarëdo natyre, për vetë personin ose për ndonjë person ose subjekt tjetër, në mënyrë që ky person të veprojë ose pengohet të veprojë në shkelje të detyrimeve ligjore, kontraktuese ose profesionale dhe që shkakton ndikim në veprimet e tij ose të saj apo të një personi ose subjekti tjetër; ose b) aktin e zyrtarit publik ose të çdo personi që drejton ose punon në çfarëdo cilësie, për një njësi të sektorit privat, duke përmendur ose duke pranuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një avantazh të palejueshëm të çfarëdo natyre, për vetë personin ose për ndonjë person ose subjekt tjetër, në mënyrë që ky person të veprojë ose pengohet të veprojë në shkelje të detyrimeve ligjore, kontraktuese ose profesionale dhe që shkakton ndikim në veprimet e tij ose të saj apo të një personi ose subjekti tjetër.
“Marrëveshje”	nënkupton këtë marrëveshje për linjën e kredisë së disponueshme, përfshirë edhe përshkrimet e saj, skedulet dhe, nëse është rasti, çdo ndryshim të kësaj Marrëveshjeje të bërë me shkrim.
“Praktikat kundër konkurrencës”	nënkupton: a) çdo veprim të bashkërenduar ose të nënkuptuar që ka si objekt dhe/ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës së drejtë në një treg, përfshirë pa kufizime, kur synon të: i. kufizojë qasjen në treg ose ushtrimin e lirë të konkurrencës nga shoqëritë e tjera; ii. parandalojë vendosjen e çmimeve nga pjesa e lirë e tregjeve, duke favorizuar artificialisht rritjen ose uljen e çmimeve të tilla; iii. kufizojë ose kontrollojë çdo prodhim, tregje, investime ose përparim teknik; apo iv. ndajë tregjet apo burimet e furnizimit; b) çdo keqpërdorim i një shoqërie ose grupi shoqërisht, me pozitë dominuese brenda një tregu vendës ose në një pjesë të konsiderueshme të tij; ose c) çdo ofertë ose e caktim të padrejtë çmimesh që ka si objekt dhe/ose pasojë të saj eliminimin nga një treg, ose parandalimin e një shoqërie ose të një prej produkteve të saj nga hyrja në treg.
“Buxhet Vjetor i Shtetit”	nënkupton buxhetin vjetor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar sipas ligjit përkatës të buxhetit vjetor të shtetit dhe të miratuar në mënyrë të rregullt nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
“Autorizim/e”	nënkupton çdo autorizim, miratim, vendim, leje, licencë, përjashtim, dorëzim, noterizim ose regjistrim, ose çdo përjashtim aty, i marrë ose i siguruar nga një autoritet, qoftë i dhënë me anë të një akti, ose i konsideruar i dhënë, nëse nuk është marrë ndonjë përgjigje brenda afatit të caktuar kohor.
“Autoritet/e”	nënkupton çdo qeveri ose person juridik, departament ose komision që ushtron të drejtën e posaçme publike ose çdo administratë, gjykatë, agjenci ose shtet, ose çdo njësi qeveritare, administrative, tatimore ose gjyqësore.
“Periudhë e Disponueshme”	nënkupton periudha nga dhe përfshirë datën e nënshkrimit deri në afatin e fundit të Disbursimit.
“Kredi e Disponueshme”	nënkupton, në çdo kohë të caktuar, shumën maksimale të principalit të specifikuar në pikën 2.1 (Linja e Kredisë,) pa: i. Shumën e përgjithshme të ndonjë Disbursimi të tërhequr nga Huamarrësi; ii. Shumën e ndonjë Disbursimi që do të kryhet në përputhje me ndonjë Kërkesë Disbursimi të mbetur pezull; dhe iii. çdo pjesë e Linjës së Kredisë, e cila është anuluar sipas klauzolës 8.3 (<i>Anulimi nga huamarrësi</i>) dhe/ose 8.4 (<i>Anulimi nga buadhbënësi</i>).
“Ditë Pune”	nënkupton një ditë (ndryshe nga e shtuna apo e diela) në të cilën bankat janë të hapura për biznesin e përgjithshëm në Paris dhe që është një Ditë TARGET (Sistem Pagese Transfertash Ekspres me Shlyerje Bruto Automatike Transevropiane në Kohë Reale), në rast se një Disbursim duhet të kryhet në atë ditë.
“E vërtetuar”	nënkupton çdo kopje, fotokopje ose kopje tjetër e dokumentit original, vërtetimet



	nga çdo person i autorizuar sipas rregullave, në përputhje me kopjen, fotokopjen ose duplikatën e dokumentit original.
“Bashkëfinancues”	nënkupton bashkëfinancuesi/t e Programit: KfW për një shumë (të njohur ose të parashikuar) prej njëqind milionë euro (100,000,000 euro).
“Bashkëfinancim”	nënkupton së bashku dhe veçmas, çdo bashkëfinancim të tillë.
“Afat i fundit për Disbursim”	nënkupton 30 nëntor 2022, datën pas së cilës nuk mund të ketë Disbursim të mëtejshëm.
“Disbursim”	nënkupton një disbursim të të gjithë ose një pjesë të Linjës së Kredisë të vënë në dispozicion nga huadhënësi për huamarrësin, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në pikën 3 (<i>Disbursimi i fondeve</i>) ose shumën e principalit të pashlyer të këtij Disbursimi, e cila mbetet e detyrueshme dhe e pagueshme në një kohë të caktuar.
“Datë Disbursimi”	nënkupton datën kur një Disbursim vihet në dispozicion nga huadhënësi.
“Periudhë Disbursimi”	nënkupton periudhën e datës së Disbursimit të parë deri në dhe duke përfshirë datën e parë nga datat në vijim: a) Datën kur kredia në dispozicion është e barabartë me zero; b) Afatin e fundit për Disbursim.
“Kërkesë Disbursimi”	nënkupton një kërkesë kryesisht në formën e përcaktuar në skedulën 5A (<i>Formulari i Kërkesës për Disbursim</i>).
“Embargo”	nënkupton çdo sanksion të natyrës tregtare, që synon të ndalojë çfarëdo importi dhe/ose eksporti (furnizim, shitje ose transferim) të një apo disa mallrave, produkteve ose shërbimeve që shkojnë dhe/ose vijnë nga një vend për një periudhë të caktuar, siç është publikuar dhe ndryshuar herë pas here nga Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Franca.
“Datë e Hyrjes në Fuqi”	data e cila bie 15 ditë pas botimit të ligjit për ratifikimin e kësaj Marrëveshjeje në Fletoren Zyrtare.
“Procedurat e Menaxhimit të Mosmarrëveshjeve ES”	nënkupton kushtet kontraktuale të përfshira në procedurat e Menaxhimit të Mosmarrëveshjeve Mjedisore dhe Sociale që janë në dispozicion në faqen e internetit, me ndryshime herë pas here.
“Vlerësim i Sistemit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (ESSA)”	nënkupton vlerësimin gjithëpërfshirës të sistemeve qeveritare për menaxhimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale.
“EURIBOR”	nënkupton normën ndërbankare të zbatueshme për euron për çdo depozitë në euro për një periudhë të krahasueshme me periudhën e interesit të Disbursimit përkatës, siç përcaktohet nga Instituti Evropian i Tregjeve të Parasë (EMMI), ose çdo pasues i tij në orën 11:00 të mëngjesit në Bruksel, 2 (dy) ditë pune para ditës së parë të periudhës së interesit.
“Euro ose EUR”	nënkupton monedhën e vetme të vendeve anëtare të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar Evropian, duke përfshirë Francën dhe ka tender ligjor në këto vende anëtare.
“Rast i Mospërmbushjes së Detyrimeve”	nënkupton çdo rast apo rrethanë të përcaktuar në nenin 13.1 (<i>Rast i Mospërmbushjes së Detyrimeve</i>).
“Linjë Kredie”	nënkupton linjën e kredisë së disponueshme të vënë në dispozicion nga huadhënësi për huamarrësin, në pajtim me këtë marrëveshje deri në shumën maksimale të principalit të përcaktuar në pikën 2.1 (<i>Linja e Kredisë</i>).
“Borxh financiar”	nënkupton çdo borxh financiar të huamarrësit dhe, në lidhje me: c) të gjitha paratë e marra hua mbi baza afatshkurtra, afatmesme apo afatgjata; d) çdo shumë të rritur sipas emetimit të obligacioneve, notave, debitimeve, aksioneve të kredisë ose instrumenteve të ngjashme; e) të gjitha fondet e marra sipas një transaksioni tjetër (përfshirë çdo marrëveshje të shitjes ose blerjes) që ka efektin tregtar të huamarrjes; f) çdo detyrim të mundshëm të pagesës që rezulton nga garancia, obligacioni ose cilido instrument tjetër.



Listë e Sanksioneve financiare	nënkupton listën e personave, grupeve ose subjekteve që u nënshtrohen sanksioneve financiare nga Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe/ose Franca. Vetëm për qëllime informuese dhe për lehtësinë e huamarrësit, i cili mund të mbështetet në to, referencat e mëposhtme ose faqet e mëposhtme të internetit: Për listat e mbajtura nga Kombet e Bashkuara mund të konsultohet faqja e mëposhtme e internetit: https://www.un.org/sc/suborg/fr/sanctions/un-sc-consolidated-list Për listat e mbajtura nga Bashkimi Evropian mund të konsultohet faqja e mëposhtme e internetit: https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/8442/consolidated-list-sanctions_fr Për listat e mbajtura nga Franca mund të konsultohet faqja e mëposhtme e internetit: http://www.tresor.economie.gouv.fr/4248 Dispositif-National-de-Gel-Terroriste
“Plan Financimi”	nënkupton planin financiar të Programit, i cili është bashkëlidhur si skeduli 3 (PLANI I Financimit).
“Normë Fikse Referuese”	nënkupton 1.46% (një pikë dyzet e gjashtë për qind) në vit. NFR është norma e llogaritur në bazë të kurbës së rendimentit të tregut të këmbimit të Normës së interesit të euros kundrejt EURIBOR-it 6-mujor + marzhin, e llogaritur maksimumi 10 ditë para datës së nënshkrimit dhe të përcaktuar në bazë të maturimit dhe të periudhës gjatë së cilës pagesa e kredisë bëhet pa gjorbë.
“Mashttrim”	nënkupton çdo praktikë të padrejtë (veprime ose mosveprime), që synon të çorientojnë të tjerët, të fshehë elemente prej tyre ose të tradhetojë ose zhvlerësojë miratimin e tij/saj, të anashkalojë kërkesat ligjore ose rregullore dhe/ose të shkelë rregullat dhe procedurat e brendshme të huamarrësit apo palës së tretë, në mënyrë që të arrihet një përfitim jo i ligjshëm.
“Mashttime kundër interesave financiare të Komunitetit Evropian”	nënkupton çdo veprim apo shmangie të qëllimshme për të dëmtuar buxhetin e Bashkimit Evropian dhe që përfshin: i. përdorimin apo paraqitjen e deklaratave apo dokumenteve të paplota, të pasakta apo të rreme, që ka për efekt keqpërdorimin ose mbajtjen e gabuar të fondeve ose reduktimin e paligjshëm të burimeve të buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian; ii. moszbulimin e informacioneve me të njëjtin efekt; dhe iii. shpërdorimin e fondeve të tilla për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat këto fonde janë dhënë fillimisht.
“Periudhë gjatë së cilës pagesat kryhen pa gjorbë”	nënkupton periudhën nga data e nënshkrimit deri në dhe duke përfshirë datën që është 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj pas kësaj date, gjatë së cilës nuk paguhet për kthimin e principalit sipas linjës së kredisë.
Origjinë e paligjshme	nënkupton fondet e realizuara nëpërmjet: i. Kryerjes së çfarëdo shkeljeje të ndërlidhur, siç është përcaktuar në Fjalorin e Rekomandimeve FATF 40: http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/Recommandations_GAFI.pdf a) b) çdo akt korrupsioni; ose c) mashtrimet kundër interesave financiare të Komunitetit Evropian.
“Indeks”	nënkupton indeksin e përditshëm të TEC 10, normën e maturimit dhjetëvjeçar, të shfaqur në baza ditore në faqen përkatëse të kuotimit të institucionit financiar referues apo të ndonjë indksi tjetër, i cili mund të zëvendësojë TEC 10-ditor. Në datën e nënshkrimit, Norma e Indeksit në 4 nëntor 2021, është zero pikë gjashtëmbëdhjetë për qind (0.16%) në vit.
“Periudhë/a interesi”	nënkupton çdo periudhë nga data e pagesës (përfshirë) deri në datën e ardhshme të pagesës (përfshirë). Për çdo Disbursim në kuadër të linjës së kredisë, periudha e parë e interesit do të fillojë në datën e Disbursimit (përfshirë) dhe do të përfundojë në datën tjetër të pagesës (përfshirë). “Normë interesi” nënkupton normën e interesit të shprehur si përqindje dhe të përcaktuar në përputhje me nenin 4.1 (Norma e interesit).
“Ligje të Republikës së Shqipërisë”	nënkupton Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe çdo akt të zbatueshëm normativ të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë,



	por pa u kufizuar në çdo akt, ligj, urdhëresë, dekret apo ligj apo rregullore tjetër të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe efekt në çdo kohë dhe me ndryshime herë pas here për sa kohë zbatohet kjo marrëveshje.
“Marzh”	nënkupton 1.35% (një pikë tridhjetë e pesë për qind) në vit.
“Rast i çorientimit të tregut”	nënkupton ndodhjen e njërit prej rasteve vijuese: i. EURIBOR nuk është përcaktuar nga Instituti Evropian i Tregjeve të Parave (EMMI) ose nga çdo pasues i tij, në orën 11:00 në Bruksel, 2 (dy) ditë pune para ditës së parë të periudhës përkatëse të interesit; ose ii. para mbylljes së veprimtarisë së tregut përkatës ndërbankar, 2 (dy) ditë pune para ditës së parë të periudhës përkatëse të interesit, Huamarrësi merr njoftim nga huadhënësi, se: i. kostoja për huadhënësin e burimeve të barabarta në tregun përkatës ndërbankar do të ishte më e lartë se EURIBOR-i për periudhën përkatëse të interesit; ose ii. nuk mundet ose nuk do të jetë në gjendje të sigurojë burime bashkërenduese në tregun përkatës ndërbankar gjatë rrjedhës së zakonshme të punës për të financuar Disbursimin përkatës për periudhën përkatëse kohore.
“Ndikim Negativ Material”	nënkupton ndikim material dhe negativ, në: a) Program, në masën që do të rrezikonte zbatimin dhe funksionimin e programit, në përputhje me këtë marrëveshje; b) biznes, asete, gjendjen financiare të huamarrësit apo aftësinë e tij për të kryer detyrimet e tij, sipas kësaj Marrëveshjeje; c) vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj marrëveshjeje; ose d) çdo të drejtë apo mjet kompensimi të huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje.
“Skemë monitorimi”	nënkupton skemën e bashkëlidhur si skeduli 3B, që rendit treguesit e rënë dakord midis palëve për të monitoruar zbatimin e Programit.
“Principal i Pashlyer”	nënkupton, në lidhje me ndonjë Disbursim, shumën e pashlyer të principalit në lidhje me këtë Disbursim, që i korrespondon shumës së Disbursimit të paguar nga huamarrësi, pa shumën e kësteve të principalit të shlyer nga huamarrësi për huadhënësin për këtë Disbursim.
“Datë e pagesave”	nënkupton datat 31 janar dhe 31 korrik të çdo viti.
“Rast i Ndërprerjes së Sistemit të Pagesave”	nënkupton ndonjërin nga sa më poshtë ose të dyja: a) ndërprerja materiale në sistemet e pagesave apo të komunikimit ose në tregjet financiare që janë, në secilin rast, të nevojshme që të operojnë në mënyrë që pagesat të kryhen në lidhje me Linjën e Kredisë (ose ndryshe me qëllim që transaksionet e parashikuara nga kjo marrëveshje të kryhen), me kusht që ndërprerja të mos jetë shkaktuar nga, dhe është jashtë kontrollit të ndonjërës prej palëve, apo b) zhvillim tjetër i çdo ngjarjeje, e cila rezulton në ndërprerje (të natyrës teknike ose që ka lidhje me sistemin) të thesarit ose operacioneve të pagesave të një Pale që parandalon atë ose ndonjë palë tjetër: i. nga kryerja e detyrimeve të saj të pagesës sipas kësaj marrëveshjeje; ose ii. nga komunikimi me palët e tjera në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, dhe e cila (në secilin rast) nuk është shkaktuar nga dhe është jashtë kontrollit të njërës palë.
“Dëmshpërblim Kompensues i Parapagimit”	nënkupton dëmshpërblimin e llogaritur, duke aplikuar përqindjen vijuese në shumën e linjës së kredisë që paguhet paraprakisht: - nëse shlyerja kryhet para 2-vjetorit (përjashtuar) të datës së nënshkrimit: 2.5% (dy pikë pesë për qind); - nëse shlyerja kryhet ndërmjet përvjetorit të 2-të (përfshirë) dhe përvjetorit të 5-të të datës së nënshkrimit: 1.5% (një pikë pesë për qind); - nëse shlyerja kryhet ndërmjet përvjetorit të 5-të (përfshirë) dhe atij të 7-të (përjashtuar) të datës së nënshkrimit: 1% (një për qind); - nëse shlyerja kryhet para përvjetorit të 7-të (përfshirë) të datës së nënshkrimit: 0.5% (zero pikë pesë për qind).
“Program”	nënkupton Programin, siç është përshkruar në skedulën 2 (<i>Përshkrimi i programit</i>).
“Datë e përfundimit të	nënkupton datën e përfundimit teknik të Programit, e cila pritet të jetë muaji dhjetor i



programit	vitit 2022.
“Zyrtar publik”	nënkupton: i. funksionar legjislativ, ekzekutiv, administrativ ose gjyqësor i emëruar ose i zgjedhur, që shërben në mënyrë të përhershme ose ndryshe, të paguar ose të papaguar, pavarësisht nga grada; ose ii. çdo person tjetër të caktuar si zyrtar publik, sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë; dhe iii. çdo person tjetër që ushtron funksion publik, duke përfshirë një agjenci apo organizatë publike ose që ofron shërbim publik.
“Konvertim i Normës”	nënkupton konvertimin e normës së ndryshueshme, që zbatohet për të gjithë ose një pjesë të linjës së kredisë në një normë fikse, në pajtim me klauzolën 4.1 (<i>Norma e interesit</i>).
“Kërkesë për Konvertim të Normës”	nënkupton një kërkesë nga huamarrësi, kryesisht sipas formularit bashkëlidhur si skeduli 5C (<i>Formulari i Konvertimit të Normës</i>)
“Datë e Përcaktimit të Normës”	nënkupton: a) në lidhje me çdo periudhë interesi për të cilën duhet të përcaktohet norma e interesit: i. të mërkurën e parë (ose nëse kjo datë nuk është ditë pune, menjëherë pas Ditës së Punës) pas datës së marrjes nga ana e huadhënësit të kërkesës për Disbursimit, me kusht që kjo datë të jetë të paktën 2 (dy) Ditë të plota Pune para të mërkurës së përcaktuar; ii. të mërkurën e dytë (ose nëse kjo datë nuk është ditë pune, menjëherë pas Ditës së Punës), pas datës së marrjes nga huadhënësi të kërkesës për Disbursim, nëse kjo datë nuk është të paktën 2 (dy) Ditë të plota Pune para të mërkurës së parë të përcaktuar në paragrafin (a) më sipër; b) në rast të konvertimit të Normës: i. të mërkurën e parë (ose nëse kjo datë nuk është Ditë Pune, menjëherë pas Ditës së Punës) pas datës së marrjes nga ana e huadhënësit të kërkesës për Konvertim të Normës nga Huamarrësi, me kusht që kjo datë të jetë të paktën 2 (dy) Ditë të plota Pune para të mërkurës së parë; ii. të mërkurën e dytë (ose nëse kjo datë nuk është Ditë Pune, menjëherë pas Ditës së Punës), pas datës së marrjes nga huadhënësi të kërkesës për Konvertim të Normës, nëse kjo datë nuk është të paktën 2 (dy) Ditë të plota Pune para të mërkurës së parë.
“Institucione financiare referuese”	nënkupton një institucion financiar të zgjedhur si një institucion financiar të përshtatshëm referues nga huadhënësi dhe që boton rregullisht kuotimin e instrumenteve financiare në një nga rrjetet ndërkombëtare të informacionit financiar sipas praktikave të njohura nga industria bankare.
“Skedul/e”	nënkupton çdo skedul apo skedulet e kësaj Marrëveshjeje.
“Datë nënshkrimi”	nënkupton datën e ekzekutimit të kësaj marrëveshjeje nga të gjitha palët.
“Ditë TARGET”	nënkupton një ditë në të cilën sistemi TARGET 2 ose çdo pasues i tij është i hapur për pagesat në euro.
“Tatim/e”	nënkupton çdo tatim, taksë, detyrim apo pagesë, tatim të mbajtur në burim apo tjetër të një natyre të ngjashme (duke përfshirë çfarëdo sanksioni apo interesi, që duhet paguar në lidhje me mospagimin ose në lidhje me çdo vonesë në pagesën e shumave të tilla).
“Faqe interneti”	nënkupton faqen e internetit të AFD-së (http://www.afd.fr/) ose çdo faqe tjetër zëvendësuese.
“Tatim i mbajtur në burim”	nënkupton çfarëdo zbritjeje ose mbajtjeje, në lidhje me ndonjë tatim mbi ndonjë pagesë të kryer në bazë apo në lidhje me këtë marrëveshjeje.



SKEDULI 1B – INTERPRETIMI

a) “Asete” përfshin prona të tashme dhe të ardhshme, të ardhura dhe të drejta të çdo lloji;

b) Çdo reference ndaj “Huamarrësit”, një “Pale” ose një “Huadhënësi” përfshin pasuesin e tij në titull, caktimet dhe transferimet e lejuara;

c) Çdo referencë e Marrëveshjes ose dokumenti tjetër është referencë për këtë marrëveshje ose për atë dokument tjetër, të ndryshuar, riparaqitur apo plotësuar dhe përfshin, nëse është e zbatueshme, çdo dokument, i cili e zëvendëson atë nëpërmjet novacionit/zëvendësimit, në përputhje me Marrëveshjen;

d) Një “garanci” përfshin çdo lloj kujdesi, mbështetjeje dhe çdo garanci, e cila është e pavarur nga borxhi të cilit i referohet;

e) “Borxh” nënkupton çdo detyrim të cilitdo person (qoftë i ardhur si principal apo si dorëzani) për pagimin apo shlyerjen e parave, qoftë i tashëm, i ardhshëm, aktual apo i pritshëm;

f) Një “person” nënkupton çdo person, shoqëri, korporatë, partneritet, trust, qeveri, agjenci shtetërore ose shoqatë, ose grup i dy apo më shumë nga sa më sipër (pavarësisht nëse është apo jo person juridik i veçantë);

g) Një “rregullore” përfshin çdo legjislacion, rregullore, rregull, dekret, direktivë zyrtare, udhëzim, kërkesë, këshillim, rekomandim, vendim ose udhëzim (pavarësisht nëse ka apo jo fuqinë e ligjit) të çfarëdo organi qeveritar, ndërqeveritar apo mbikombëtar, autoriteti mbikëqyrës, autoriteti rregullator, autoriteti të pavarur administrativ, agjencie, departamenti apo autoriteti apo organizate tjetër (duke përfshirë çdo rregullore të lëshuar nga një subjekt publik industrial ose tregtar) që ka efekt mbi këtë marrëveshje ose mbi të drejtat dhe detyrimet e një pale;

h) Një dispozitë e ligjit është referencë për këtë dispozitë të ndryshuar;

i) Përveç kur përcaktohet ndryshe, ora e ditës është referencë për orën e Parisit;

j) Titujt e seksionit, klauzolës dhe skedulit janë vetëm për lehtësi referencë dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj marrëveshjeje;

k) përveç kur parashikohet ndryshe, fjalët dhe shprehjet e përdorura në ndonjë dokument tjetër,

që lidhen me këtë marrëveshje apo në ndonjë njoftim të dhënë, në lidhje me këtë marrëveshje, kanë të njëjtin kuptim në atë dokument apo njoftim si në këtë Marrëveshje;

l) një rast i mospërbushjes së detyrimeve është “në vazhdim”, nëse nuk është korrigjuar ose nëse huadhënësi nuk ka hequr dorë nga të drejtat e tij lidhur me të;

m) referenca për klauzolën apo skedulin është referencë për klauzolën apo skedulin e kësaj Marrëveshjeje; dhe

n) fjalët në numrin shumë përfshin njëjës dhe anasjelltas.

SKEDULI 2 – PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Për të mbështetur palët e interesuara shqiptare në zbatimin e një reforme të plotë në sektorin e energjisë, institucionet financiare, KfW-ja dhe AFD-ja po japin një instrument huadhënieje, specifikisht një Hua e Bazuar në Politika (PBL), disbursimi i së cilës do të bazohet në monitorimin e zbatimit të Elementeve të Reformës së Politikave (PRE) të përcaktuara në Udhërrëfyesin për Reformat në sektorin e energjisë.

Objektivat e PBL-së janë:

1. T’i mundësojë Qeverisë së Shqipërisë, nëpërmjet mbështetjes, që të arrijë ose realizojë angazhimin e saj ndërkombëtar, në lidhje me reformën në sektorin e energjisë;

2. Të mbështesë Qeverinë shqiptare në krijimin e një mjedisi tregu, në kuadër të sektorit shqiptar të energjisë, i cili bazohet në praktikat më të mira ndërkombëtare, ka vlerën më të mirë për paratë për shoqërinë shqiptare.

PBL-ja është e strukturuar në dy faza:

- Faza e parë e PBL-së do të lejojë, në parakushtin e një niveli të përshtatshëm të plotësimit të detyrimeve të miratuara, dhënien e transhit të parë në kohën e duhur që të mund të shqyrtohet në buxhetin e vitit 2021.

- Faza e dytë e PBL-së do të ndjekë menjëherë të parën me disbursimin e trashit të dytë të PBL-së, në varësi të përmbushjes së duhur të detyrimeve të përcaktuara në Matricën e Stimulit për fazën e dytë.



Matrica e stimulit për fazën e parë të PBL-së është si më poshtë:

PRE Nr.	Nisja
1	Marrëveshja për shumat e papaguara dhe përmirësimi i moralit për pagimin e subjekteve publike: Gjetja e një rezolute mbi të ardhurat e papaguara midis njësive të ndryshme shtetërore. Ky stimul kërkon miratimin zyrtar të një marrëveshjeje shlyerjeje nga të gjithë aktorët përkatës, përfshirë, por mbi baza joshtruese, nga Këshilli i Ministrave dhe në rastin më të mirë përfshin zbatimin e plotë të marrëveshjes gjatë fazës së parë të PBL-së.
2	Ndarja dhe ristrukturimi i OSHEE-së: Ristrukturimi i OSHEE-së për të përmbushur kërkesat ligjore dhe funksionale për ndarjen, në përputhje me direktivën e BE-së 2009/72/EC, neni 26 të miratuar nga Komuniteti i Energjisë dhe që përgatitet për ofertë publike. Ndër të tjera, ky stimul përfshin, nëse është e mundur në mënyrë të arsyeshme, një vlerësim pozitiv nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në lidhje me shoqëritë e ndara të OSHEE-së.
4	Zbatimi i hapjes së tregut dhe derregullimi i çmimeve: Zbaton vendimet lidhur me hapat që duhen ndërmarrë drejt derregullimit të çmimeve dhe ndërprerjes në faza e kontratës së furnizimit universal ndërmjet OSHEE-së dhe KESH-it (siç është përcaktuar në shtojcën 1 të Modelit të Tregut PX të miratuar me VKM-në nr. 519, datë 13.7.2016.
5	Krijimi i Bursës së energjisë: Ngritja ligjore dhe funksionale e “Bursës Shqiptare të Energjisë” (APEX), në përputhje me modelin e miratuar të tregut dhe rregullat e tregut.
6	Zbatimi i mekanizmit dhe i rregullave balancuese të bazuar në treg: Ky stimul kërkon zbatimin e një mekanizmi balancues të mbështetur në treg që përfshin zbatimin e përgjegjësisë balancuese gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese, krijimin e procedurave të prokurimit jodiskriminues për të balancuar rezervat, si dhe një aktivizim të balancimit të energjisë bazuar më së miri në parimin e meritës dhe minimalisht në bazë të një skeme të përshtatshme kompensuese. Gjithashtu, lidhjet ndërmjet çdo detyrimi shërbimi publike dhe shërbimeve të balancimit do të ndërpriten dhe do të vijojnë të mbahen të ndara.
7	Krijimi i RES-it dhe transformimi i Tarifave Mbështetëse (Feed-in): Krijimi i kuadrit institucional dhe rregullator për tregtimin e drejtë, transparent dhe jodiskriminues të energjisë së rinovueshme. Ky stimul përfshin transformimin e tarifave RES Feed-in në Kontrata-për-Diferencat, krijimin e një institucioni që do të menaxhojë CfD-të dhe marketingun e energjisë së rinovueshme rezultuese në baza konkurruese, përmes bursës së energjisë elektrike dhe pa cenuar aktivitetet e deritanishme, miratimin dhe zbatimin e legjislacionit dytësor, në bazë të ligjit nr. 07/2017 për Promovimin e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme. Këto përpjekje do të konsiderohen si një veprim drejt përputhjes me objektivin e burimeve të rinovueshme të përcaktuar në Direktivën EnC acquis të 2009/28/EC.
3	Miratimi i procesit të matjes dhe parashikimit: Vendosja e një procesi dhe metodologjie të koordinuar parashikimi, si dhe kërkesave teknike për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimeve. Kjo do të përfshijë miratimin nga palët e interesuara të proceseve dhe metodologjive parashikuese për parashikimin e ngarkesës, sipas detyrimeve të shërbimit publik. Përveç kësaj, si pjesë e matjes drejt zbatimit, parashikimi do të arrijë një nivel të caktuar saktësie ose objektiva cilësie parashikimi, siç përcaktohet në PRE në shtojcën 3 të udhërrëfyesit.
8	Ofertimi konkurrues për kapacitetet gjeneruese të energjisë së rinovueshme:



	Ekzekutimi i ankandëve të para konkurruese, jodiskriminuese për kapacitetet e reja gjeneruese të rinovueshme.
9	Miratimi dhe zbatimi i Skemës për Mbështetje Sociale: Sigurimi i hapjes së tregut dhe të liberalizimit të çmimeve ka ndikim minimal ekonomik negativ mbi konsumatorët e pambrojtur dhe familjet që vuajnë nga varfëria e energjisë.
10	Finalizohen aktet dytësore/nënligjore në përputhje me <i>acquis</i> të EnC: Krijimi i kuadrit rregullator nëpërmjet akteve nënligjore, të cilat janë në përputhje me ligjet e miratuara nga EnC dhe ato të zbatueshme shqiptare, përfshirë, por jo shprehëse, ligjin për sektorin e energjisë nr. 43/2015, ligjin për përdorimin efikas të energjisë nr. 124/2015 dhe ligjin për burimet e rinovueshme të energjisë nr. 39/03, 07/2017. Një listë gjithëpërfshirëse e akteve nënligjore që formojnë bazën për zbatimin e matjes së fazës së fillimit, mund të gjendet këtu .
11	Rritja e kompetencave dhe pavarësisë së ERE-s: Themelimi i një rregullatori të pavarur i cili është në përputhje me direktivën e BE-së 2009/72/EC, kapitulli IX. Ky stimul përfshin dhënien ERE-s më shumë kompetenca të mjaftueshme sanksionuese, që përshtatin rolin e saj në mjedisin e ri të tregut, si dhe sigurojnë burime të mjaftueshme operationale dhe pavarësi nga ndikimi i tregut dhe ai politik. Zbatimi i këtij stimuli do të matet, për sa lejon koha, me anë të një rishikimi pozitiv të Rregullatorit të Shqipërisë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë apo nga vlerësimi i bazuar në standardet dhe parimet EnC.

SKEDULI 3A - PLANI I FINANCIMIT

Bashkëfinancuesi	Shuma (milione euro)
AFD	50
KfW	100

SKEDULI 3B – SKEMA E MONITORIMIT

Parimet e Skemës së Monitorimit

1. Me qëllim mbështetjen e aktorëve shqiptarë në zbatimin e një reforme të plotë në sektorin e energjisë, institucionet financiare, KfW-ja, në emër të qeverisë gjermane, dhe AFD-ja, në emër të qeverisë franceze, po krijojnë një instrument huadhënës, disbursimi i të cilit do të bazohet në monitorimin e zbatimit të elementeve të reformës së politikave (PRE) të përcaktuara në udhërrëfyesin e aneksit 3: Udhërrëfyesi. Ky dokument paraqet skemën e monitorimit, e cila vlerëson zbatimin e stimujve për vitin përkatës të përfshirë në shtojcën 2: Matrica e Stimulit. Matrica e Stimulit përfshin objektivat e zbatimit, që rrjedhin nga konsultimet me entet/subjektet shqiptare, detyrimet e Komunitetit të Energjisë dhe praktikën më të mira ndërkombëtare lidhur me reformimin e sektorit kombëtar të energjisë.

2. Skema e monitorimit, së bashku me stimujt për secilin vit të disbursimit të parashikuar, formojnë pjesë integrale të instrumentit aktual të huas. Rezultatet e secilit monitorim do t'i raportohen Komitetit Drejtues të instrumentit të huas.

3. Skema e monitorimit të instrumentit të huas synon të përmbushë interesat legjitimë të grupeve shqiptare të interesit për transparencë, e cila nxit pronësinë e reformës së sektorit të energjisë, që rezulton në një politikë të drejtë disbursimi.

4. Monitorimi do të kryhet katër herë për vit kalendarik, me një cikël monitorimi që shtrihet nga tremujori i tretë i çdo viti kalendarik deri në tremujorin e dytë të vitit pasues kalendarik, për disbursimin, me përjashtim të ciklit të parë të monitorimit, ku monitorimi kryhet vetëm [tri] herë. Monitorimi do të kryhet çdo tre muaj pas finalizimit të Memorandumit të Mirëkuptimit (MM). Vitet referuese të cikleve të monitorimit janë ato në të cilat pritet disbursimi i mundshëm. Vlerësimi përfundimtar për propozimin e vendimit për disbursimin të Komitetit Drejtues do të bazohet në monitorimin e tretë dhe të fundit të kryer në vitin e caktuar kalendarik, specifikisht në tremujorin e dytë.

5. Monitorimi vlerëson gjendjen e zbatimit të secilit stimul për çdo periudhë monitorimi, që mbulon të gjithë kohën nga finalizimi i MM-së për çdo vit deri në datën e fundit të ditës së



pesëmbëdhjetë kalendarike të çdo muaji gjatë të cilit është kryer monitorimi.

6. Vlerësimi kryhet nga institucionet financiare ose nga një agjent i caktuar, i cili mund të jetë konsulent monitorues, në bazë të informacionit të dorëzuar nga subjektet zbatuese të parapërcaktuara, të mbledhura përmes misionëve për gjetje të fakteve dhe të pranuar nga burimet publike. Vlerësimi i kryer gjatë monitorimit do të përfshijë analizën cilësore të informacioneve të përmendura dhe pikët sasiore për secilin stimul.

7. Monitorimi kryhet nga institucionet financiare ose agjenti përkatës, duke u bazuar në parimet dhe metodologjinë e përshkruar në këtë shtojcë. Monitorimi i realizuar në këto kushte do të përbëjë bazën për disbursimin e instrumentit të kredisë.

8. Edhe pse agjenti përkatës do të kryejë vlerësimin dhe monitorimin e vazhdueshëm, siç përcaktohet me këtë skemë, vendimi përfundimtar për disbursimin do t'i mbetet vetëm institucionit financiar të mbështetur nga agjenti përkatës dhe rekomandimi i Komitetit Drejtues.

9. Një agjent i caktuar do të financohet nga një fond i posaçëm granti i ofruar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. Prokurimi/sigurimi i shërbimeve të tilla të ekspertëve do të zbatohet në përputhje me udhëzimet e KfW-së për caktimin e konsulentëve në bashkëpunim financiar me vendet partnere.

10. Interpretimi i duhur i suksesit të zbatimit përmes skemës së monitorimit sigurohet nëpërmjet metodologjisë themelore, që ofron parimet udhëzuese, të cilat mundësojnë kriteret e kualifikimit të stimullit dhe kryerjen e vlerësimeve në mënyrë transparente, të përsëritshme dhe proporcionale, duke zbatuar diskrecion të arsyeshëm dhe duke marrë parasysh rrethanat specifike dhe procedurat ligjore, nëse është e nevojshme apo e zbatueshme.

11. Si stimujt edhe skema e monitorimit janë hartuar në mënyrë që të vlerësojnë realisht përpjekjet dhe arritjet e zbatimit të enteve/subjekteve shqiptare. Në këtë mënyrë, duhet të merren parasysh të gjitha përpjekjet në drejtim të zbatimit të stimujve, gjatë kryerjes së vlerësimit të zbatimit gjatë secilit monitorim.

12. Secili stimul i vitit përkatës të monitorimit është faktorizuar në procesin e monitorimit dhe ndikon në disbursimin e instrumentit të kredisë. Një mekanizëm i thjeshtë dhe i qartë për

transformimin e raporteve të ecursisë për të marrë pikët e nevojshme për disbursimin, garanton përgjegjshmërinë e të gjithë aktorëve të përfshirë.

13. Monitorimi i parë kryhet menjëherë pas finalizimit të Memorandumit të Mirëkuptimit dhe shërben si bazë për monitorim të vazhdueshëm.

14. Afati tregues për ekzekutimin e Monitorimit është:

- Maj 2019 (monitorim provë për takimin e parë dhe konstituues të Komitetit Drejtues);
- Korrik 2019;
- Nëntor 2019;
- Janar 2020;
- Prill 2020;
- Korrik 2020;
- Tetor 2020;
- Nëntor 2020;
- Dhjetor 2020 (Raportimi i fundit për zbatimin e parë të afatit kohor, përfshirë dhënien e një rekomandimi të kualifikuar për disbursim).

15. Stimujt për afatin e zbatimit të dytë të afatit kohor do të përcaktohen së bashku me miratimin e monitorimit të fundit në dhjetor të vitit 2020. Komiteti Drejtues mund të vendosë të ndryshojë të gjitha afatet e cikleve të Monitorimit.

16. Së fundi, stimujt e detyrueshëm, që nuk zbatohen në mënyrë të kënaqshme deri në fund të vitit përkatës, duhet të zbatohen deri në tremujorin e parë të ciklit të ardhshëm të Monitorimit. Përveç kësaj, çdo stimul i Preferuar, që nuk është arritur në tremujorin e dytë të vitit të caktuar, fillimisht do t'i caktohet statusi i detyrueshëm në vitin e ardhshëm dhe do të arrihet deri në fund të ciklit të ardhshëm të monitorimit.

SKEDULI 4 – KUSHTET PARARENDËSE PJESA I – KUSHTET PARARENDËSE PËR TË PËRMBUSHUR NË DATËN E NËNSHKRIMIT

a) Dorëzimi nga Huamarrësi të Huadhënësi të shkresave të mëposhtme:

i. Dëshmi se Këshilli i Ministrave ka miratuar “në parim” Marrëveshjen dhe detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

ii. Kopja origjinale e dokumentit përkatës të lëshuar nga autoriteti/et në Republikën e Shqipërisë, që autorizon një ose më shumë se një person ose persona të caktuar për të realizuar marrëveshjen në emër të Huamarrësit

iii. Një komunikim me shkrim nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë që deklaron



se shuma e Linjës së Kredisë që do të merret hua nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes, bie brenda kufijve huamarrës të miratuar në kuadrin makroekonomik të Republikës së Shqipërisë.

PJESA II – KUSHTET PARARENDËSE PËR DISBURSIMIN E PARË DHE UNIK

a) Dorëzimi nga Huamarrësi të Huadhënësi të shkresave të mëposhtme:

i. Dëshmi që, në një mënyrë të pranueshme për Huadhënësin, ligji i posaçëm i kërkuar nga ligjet e Republikës së Shqipërisë për ratifikimin e kësaj Marrëveshjeje është miratuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe ka hyrë në fuqi.

ii. Një opinion ligjor i ekzekutuar siç duhet nga ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë për Huadhënësin që deklaron se Marrëveshja është autorizuar ose ratifikuar siç duhet, dhe është ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe është ligjërish e detyrueshme për Huamarrësin, në përputhje me kushtet e tij, në

formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin.

iii. Dëshmi se Linja e Kredisë është përfshirë në buxhetin vjetor të Huamarrësit.

iv. Një letër e modelit të nënshkrimit të personave të autorizuar për nënshkrimin në emër të Huamarrësi, të Kërkesës për Disbursim dhe çdo certifikate, në lidhje me këtë Marrëveshje dhe për marrjen e të gjitha masave dhe/ose të nënshkrimit të të gjitha dokumenteve të nevojshme në emër të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

v. Raport me shkrim të miratuar nga Komiteti Drejtues që konfirmon ecurinë e kënaqshme të reformës.

b) Dëshmi të Pagesës nga ana e Huamarrësit për Huadhënësin, të tarifës së vlerësimit të pritshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje.

SKEDULI 5A – FORMULARI I KËRKESËS PËR DISBURSIM

1. *[Në letër me kokë të Huamarrësit]*

Për: AGENCE FRANÇAISE DE DÉVELOPPEMENT

Më: *[data]*

Emri i Huamarrësit – Marrëveshja e Linjës së Kredisë së Disponueshme nr. [●] datë [●] Kërkesë Disbursim nr. [●]

Të nderuar,

1. Ne i referohemi Marrëveshjes së Linjës së Kredisë së Disponueshme nr. [●], të lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit, datë [●] (**Marrëveshja**), fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha që nuk janë përkufizuar këtu, kur përdoren në këtë Marrëveshje kanë kuptimin që u jepet në Marrëveshje.

2. Në mënyrë të parevokueshme kërkojmë që Huadhënësi të vendosë në dispozicion një Disbursim sipas termave të mëposhtëm:

Shuma: EURO [●] ose, nëse më pak, Kredia e Disponueshme.

Norma e interesit: *[fikse/ e ndryshueshme]*

Data e vlerës së propozuar për Disbursim: [●]

3. Norma e Interesit do të përcaktohet në përputhje me dispozitat e klauzolës 4 (*Interesi*) dhe klauzolës 5 (*Ndryshimi i llogaritjes së Interesit*) të Marrëveshjes. Norma e interesit që zbatohet për Disbursimin e kërkuar do të na jepet me shkrim dhe ne e pranojmë këtë Normë Interesi (në bazë të paragrafit të mëposhtëm, nëse është e zbatueshme), përfshirë edhe kur Norma e Interesit përcaktohet duke iu referuar një Standardi Zëvendësimi plus Marzhin e Përshtatur, siç njoftohet nga Huadhënësi pas ndodhjes së një Rasti Zëvendësimi të Normës Referuese.

[Vetëm për normën fikse të interesit:] Nëse norma e interesit e zbatueshme për Disbursimin e kërkuar është më e lartë se *[shënoni përqindjen me shifra]* ([●] %), ne kërkojmë që ta anuloni këtë Kërkesë për Disbursim.



4. Ne konfirmojmë se çdo kusht i specifikuar në klauzolën 2.4 (*Kushtet pararendëse*) është plotësuar në datën e Kërkesës për Disbursim dhe nuk ka asnjë Rast të Mospërbushjes së Detyrimeve në vijim apo që mund të ndodhë. Ne jemi dakord që ta njoftojmë huadhënësin menjëherë nëse ndonjë nga kushtet e përmendura më sipër nuk është përmbushur në ose para Datës së Disbursimit.

5. Të ardhurat e këtij Disbursimi duhet të kreditohen në llogarinë e mëposhtme bankare:

- a) Emri [i Huamarrësit]: [●]
- b) Adresa [e Huamarrësit]: [●]
- c) Numri i llogarisë IBAN: [●]
- d) Numri SWIFT: [●]
- e) Banka dhe adresa e bankës [e [●]
Huamarrësit]:
- f) Banka korrespondente dhe numri i [●]
llogarisë i bankës së Huamarrësit:

6. Kjo Kërkesë për Disbursim është e pakthyeshme.

Me respekt,

Nënshkruesi i autorizuar i Huamarrësit

SKEDULI 5B – FORMULARI I KONFIRMIMIT TË DISBURSIMIT DHE NORMËS

[*në letër me kokë të Agence Française de Développement*]

Për: [Huamarrësi]

Data: [●]

Ref.: Kërkesa për Disbursim n° [●] datë [●]

Emri i Huamarrësit – Marrëveshja e Linjës së Kredisë së Disponueshme nr. [●] datë [●]

Konfirmim i Disbursimit nr. [●]

Të nderuar,

1. Në referencë të Marrëveshjes së Linjës së Kredisë së Disponueshme nr. [●], të lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit, datë [●] ("**Marrëveshja**"), fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha që nuk janë përkufizuar këtu, kur përdoren në këtë Marrëveshje, kanë kuptimin që u jepet në Marrëveshje.

2. Huamarrësi, me anë të një Letër Kërkese për Disbursim të datës [●], ka kërkuar që Huadhënësi të vendosë në dispozicion një Disbursim në shumën euro [●], në përputhje me termat dhe kushtet e Marrëveshjes.

3. Disbursimi që është vënë në dispozicion sipas Kërkesës suaj për Disbursim, është si më poshtë:

- Shuma: Euro [● *shuma me fjalë*] (EURO [●])
- Norma e zbatueshme e interesit: [● *përqindja me fjalë*] ([●]) në vit
- Norma efektive globale (në vit): [● *përqindja me fjalë*] ([●] %)
- Data e Disbursimit: [●]
- Vetëm për kredi me Normë fikse Interesi
- Vetëm për qëllime informimi:
- Data e Përcaktimit të Normës: [●]
- Norma Fikse Referuese: [● *përqindja me fjalë*] ([●]) në vit
- Indeksi: [● *përqindja me fjalë*] ([●]) në vit
- Indeksi në Datën e Përcaktimit të Normës: [● *përqindja me fjalë*] ([●]) në vit

Me respekt,

Nënshkruesi i autorizuar i *Agence Française de Développement*



SKEDULI 5C – FORMULAR I KËRKESËS SË KONVERTIMIT TË NORMËS

[Në letër me kokë të Huamarrësit]

Për: AGENCE FRANÇAISE DE DÉVELOPPEMENT

Në datën: *[data]***Emri i Huamarrësit – Marrëveshja e Linjës së Kredisë së Disponueshme nr. [●] datë [●]
Kërkesa për Konvertim të Normës nr. [●]**

Të nderuar,

1. Në referencë të Marrëveshjes së Linjës së Kredisë së Disponueshme nr. [●], të lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit, datë [●] (“**Marrëveshja**”), fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha që nuk janë përkufizuar këtu, kur përdoren në këtë Marrëveshje, kanë kuptimin që u jepet në Marrëveshje.

2. Në përputhje me klauzolën 4.1.3 (*Konvertimi nga një Normë e ndryshueshme në Normë fikse Interesi*) të Marrëveshjes, me anë të kësaj kërkojmë që të konvertoni Normën e ndryshueshme të Interesit të Disbursimit të mëposhtëm:

- *[lista e Disbursimit përkatës]*,

në një Normë fikse Interesi në përputhje me kushtet e Marrëveshjes.

3. Kjo kërkesë për konvertim të normës do të konsiderohet e pavlefshme, nëse Norma fikse e Interesit tejkalon *[shkruani përqindjen me fjalë]* [●%].

Me respekt,

Nënshkruesi i autorizuar i Huamarrësit

SKEDULI 5D – FORMULARI I KONFIRMIMIT TË KONVERTIMIT TË NORMËS

[në letër me kokë të Agence Française de Développement]

Për: [Huamarrësi]

Data: [●]

Re: Kërkesa për Konvertim të Interesit n° [●] datë [●]

**Emri i Huamarrësit – Marrëveshja e Linjës së Kredisë së Disponueshme nr. [●] datë [●]
Konfirmimi i Konvertimit të Interesit nr. [●]**

Të nderuar,

LËNDA: Konvertimi nga një Normë e ndryshueshme Interesi në Normë Fikse Interesi

1. Në referencë të Marrëveshjes së Linjës së Kredisë së Disponueshme nr. [●] të lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit, datë [●] (“**Marrëveshja**”), fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha që nuk janë përkufizuar këtu, kur përdoren në këtë Marrëveshje kanë kuptimin që u jepet në Marrëveshje.

2. Gjithashtu, duke iu referuar Kërkesës tuaj për Konvertim të Normës të datës [●], iu konfirmojmë se norma fikse e interesit e zbatuar në Disbursim/et e përmendur/a në kërkesën për konvertim të normës suaj të dorëzuar në përputhje me nenin 4.1.3 (*Konvertimi nga një normë interesi e ndryshueshme në një normë interesi fikse*) të Marrëveshjes është:

- [●] në vit.

3. Kjo normë fikse interesi, e llogaritur në përputhje me nenin 4.1.4 (*Përzgjedhja e normës së interesit*) do të zbatohet në Disbursimin/et e përmendur/a në kërkesën tuaj për konvertim të normës nga [●] (data e hyrjes në fuqi).

4. Gjithashtu, ju njoftojmë se norma efektive botërore në vit e linjës së kredisë është [●%].

Me respekt,

Nënshkruesi i autorizuar i *Agence Française de Développement*



SKEDULI 6 – INFORMACIONE QË MUND TË PUBLIKOHEN NË FAQEN E INTERNETIT TË QEVERISË FRANCEZE DHE FAQEN E INTERNETIT TË HUADHËNËSIT

1. Informacion mbi Programin

- Numri dhe emri në regjistrin e AFD-së;
- Përshkrimi;
- Sektori i operimit;
- Vendi i zbatimit;
- Data e pritshme e fillimit;
- Data e pritshme e Përfundimit Teknik;
- Statusi i zbatimit i përditësuar mbi bazë gjashtëmujore.

2. Informacion në lidhje me financimin e Programit:

- Lloji i financimit (hua, grant, bashkëfinancim, fonde të deleguara);
- Shuma e Principalit e Linjës së Kredisë;
- Shuma e Linjës së Kredisë, e cila është disbursuar (e përditësuar ndërsa vijon zbatimi i Programit).

3. Të ndryshme

- Njoftim i informacioneve të transaksionit dhe/ose fletë, që paraqesin transaksionin bashkëlidhur këtij skeduli.



SKEDULI 7 – PLANI I ANGAZHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

Tema	Veprimet	Burimet dhe përgjegjësitë	Burimi/et i financimit	Afati kohor dhe afati përfundimtar	Treguesi i realizueshmërisë
1. Vlerësimi I SISTEMIT E&S (ESSA)	Hartimi i ESSA-së, duke përfshirë rekomandimet për t'u integruar në programin e asistencës teknike	Konsulentët	AFD/ KfW	Transhi 1	Termat e referencës të konsideruara të vlefshme nga AFD-ja ESSA-ja e konsideruar e pranueshme nga AFD-ja
2. Ngritja e kapaciteteve dhe Angazhimi	Zbatimi i programit për ngritjen e kapaciteteve lidhur me menaxhimin e risqeve M&S të identifikuara në ESSA	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Expertise France	AFD	Transhi 2	- Programi i është përcjellë AFD-së, përfshirë burimet njerëzore dhe financiare të duhura, të dedikuara; - Raportet e monitorimit të zbatimit të pranueshëm
3. Gjinia	Hartimi i: i. një identifikimi gjinor lidhur me sektorin e energjisë dhe zbatimi i ii. një seminari sensibilizues lidhur me të. Bazuar në sa më lart dhe, nëse është e nevojshme, hartimi i një Plani Veprimi për Çështje Gjinore (GAP) për sektorin e energjisë.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucionet e tjera përkatëse dhe Expertise France	AFD	Kësti 1 (identifikimi) dhe kësti 2 (GAP)	Dokumente që konsiderohen të pranueshme nga AFD-ja; procesverbali/raporti i seminarit i dërguar AFD-së (përfshirë prezantimet dhe listën e pjesëmarrësve); Monitorimi GAP dërguar AFD-së

**DEKRET****Nr. 13459, datë 4.2.2022****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 5/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri””.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 10/2022

**PËR RRËZIMIN E LISTËS NË BLOK
TË KANDIDATËVE
TË PËRZGJEDHUR PËR ANËTARË TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË
FAKULTETEVE TË DREJTËSISË
DHE TË SHKOLLËS SË
MAGJISTRATURËS, SIPAS LIGJIT NR.
115/2016,
“PËR ORGANET E QEVERISJES SË
SISTEMIT TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 147, pika 8, të Kushtetutës dhe nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës në bllok të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin

për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si më poshtë:

1. Yllka Rupa;
2. Oriona Muçollari.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 10.2.2022.

VENDIM
Nr. 11/2022

**PËR RRËZIMIN E LISTËS NË BLOK
TË KANDIDATËVE TË PËRZGJEDHUR
PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË
LARTË TË PROKURORISË
NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË
FAKULTETEVE TË DREJTËSISË
DHE TË SHKOLLËS SË
MAGJISTRATURËS, SIPAS LIGJIT NR.
115/2016,
“PËR ORGANET E QEVERISJES SË
SISTEMIT TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 149, pika 8, të Kushtetutës dhe nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës në bllok të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si më poshtë:

1. Mirela Bogdani;
2. Ilir Rusi.



II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 10.2.2022.

VENDIM
Nr. 12/2022

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË
POSAÇËM PARLAMENTAR
PËR REALIZIMIN E REFORMËS
ZGJEDHORE**

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 24 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore.

II. Komisioni ka për detyrë hartimin e ndryshimeve legislative për reformën zgjedhore, në veçanti trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE-së/ODIHR-it për zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe për zgjedhjet e mëparshme të patrajtuara, rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet, të partive politike parlamentare dhe organizatave jofitimprurëse.

III. Komisioni i Posaçëm ngrihet mbi bazën e barazisë pozitive-opozitive. Në përbërje të tij do të ketë 16 anëtarë, nga të cilët 8 janë përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, 6 përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, 1 përfaqësues i Grupit Parlamentar Aleanca për Ndryshim dhe 1 përfaqësues i Grupit Parlamentar Demokraci dhe Integrim. Emrat e anëtarëve të Komisionit përcaktohen me vendim të Kuvendit.

IV. Komisioni drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një nga Partia Socialiste dhe një nga Partia Demokratike.

V. Pranë Komisionit ngrihet grupi i ekspertëve teknikë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të tij

përcaktohen me vendim të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

VI. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, ekspertë të OSBE-së/ODIHR-it, Këshilli i Evropës, ekspertë të Komisionit të Venecias, si dhe përfaqësues dhe/ose ekspertë të BE-së dhe SHBA-ve ftohen të ndjekin, të japin asistencë dhe ekspertizë teknike në punimet e Komisionit dhe të grupit të ekspertëve teknikë të ngritur pranë tij.

VII. Çdo parti që përfaqësohet në komision ka të drejtë të propozojë amendamente për diskutim dhe miratim. Palët duhet të angazhohen të gjejnë konsensusin në lidhje me to. Për çështje të veçanta për të cilat palët nuk kanë gjetur konsensus do të vlerësohet dhe kërkohet asistencë e ekspertizës së OSBE-së/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias.

VIII. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Komisionit. Vendimarrja e Komisionit do të synojë konsensusin e gjerë për të gjitha propozimet. Vendimet e Komisionit quhen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, por vetëm kur kanë njëkohësisht konsensusin e të dy bashkëkryetarëve.

IX. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 6-mujor nga miratimi i këtij vendimi. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të dy bashkëkryetarëve, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit me një vendim të veçantë të Kuvendit.

X. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës, si dhe për mbështetjen me burime njerëzore, financiare dhe logjistike të veprimtarisë së Komisionit dhe të grupit të ekspertëve të ngritur pranë tij.

XI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 10.2.2022.

**VENDIM
Nr. 13/2022****PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË
POSAÇËM PËR REFORMËN
ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 24 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë.

II. Komisioni i Posaçëm ka për objekt të veprimtarisë së tij:

a) përcaktimin e kriterëve për ndarjen e re administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë;

b) hartimin dhe përcaktimin e kalendarit të zbatimit të reformës administrativo-territoriale;

c) përgatitjen e projektit për ndarjen e re administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë.

III. Komisioni i Posaçëm ngrihet mbi bazën e barazisë pozitive-opozitive. Në përbërje të tij do të ketë 16 anëtarë, nga të cilët 8 janë përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, 6 përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, 1 përfaqësues i Grupit Parlamentar Aleanca për Ndryshim dhe 1 përfaqësues i Grupit Parlamentar Demokraci dhe Integrim. Emrat e anëtarëve të Komisionit përcaktohen me vendim të Kuvendit.

IV. Komisioni i Posaçëm do të kryesohet nga dy bashkëkryetarë, një nga Partia Socialiste dhe një nga Partia Demokratike.

V. Komisioni i Posaçëm do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 6-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të bashkëkryetarëve të tij, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit.

VI. Pranë Komisionit ngrihet grupi i ekspertëve teknikë, numri, afatet e punës dhe detyrat specifike të të cilëve përcaktohen me vendim të komisionit.

VII. Komisioni i Posaçëm në veprimtarinë e tij do të zhvillojë konsultime dhe seanca diskutimi me ministrinë përgjegjëse për çështjet vendore, me përfaqësues të qeverisjes vendore dhe të shoqatave të zgjedhura vendore, ekspertë të fushës, të shoqërisë civile dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, që mbulojnë çështjet e qeverisjes vendore.

VIII. Çdo parti tjetër parlamentare, e cila nuk është e përfshirë në këtë komision, ka të drejtë të bëjë propozime.

IX. Prezenca e Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, si dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, me përvojë në çështjet e qeverisjes vendore, ftohen të ndjekin, të japin asistencë dhe ekspertizë teknike në punimet e komisionit dhe grupit të ekspertëve të ngritur pranë tij.

X. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme, kur në to janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimarrja e komisionit do të synojë të arrijë konsensusin për të gjitha propozimet e marra. Vendimet e Komisionit quhen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, por vetëm kur kanë njëkohësisht konsensusin e dy bashkëkryetarëve.

XI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni të Posaçëm.

XII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 10.2.2022.

**DEKRET**

Nr. 13472, datë 14.2.2022

**PËR PROPOZIMIN E
GUVERNATORIT TË BANKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 93 dhe nenit 161, pika 2
, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Zoti Gent Sejko i propozohet Kuvendit të
Shqipërisë për t'u zgjedhur Guvernator i Bankës së
Shqipërisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ilir Meta**

UDHËZIM

Nr. 3, datë 9.2.2022

**PËR PROCEDURAT E EMËRIMIT,
ULJES NË DETYRË, PEZULLIMIT DHE
SHKARKIMIT TË NËNDREJTORIT TË
INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të
Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të
neneve 26 dhe 55, të ligjit nr. 69/2012, “Për
sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e
Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:**KREU I****EMËRIMI I NËNDREJTORIT TË
INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR****A. Shpallja e vendit për nëndrejtor në
institucionin publik të arsimit parauniversitar**

1. Drejtori i institucionit publik të arsimit
parauniversitar (IPAP), jo më vonë se 5 (pesë) ditë
pune nga krijimi i vendit të lirë për nëndrejtor,
njofton zyrtarisht zyrën vendore të arsimit
parauniversitar (ZVAP), për vendin e lirë të punës.

2. Shpallja e vendit të lirë të punës bëhet nga
ZVAP-ja jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga
njoftimi i drejtorit të IPAP-së.

3. ZVAP-ja shpall vendin e lirë për nëndrejtor të
IPAP-së në faqen elektronike zyrtare të ZVAP-së,
si dhe në këndin e njoftimeve të ZVAP-së. Shpallja
publikohet edhe në këndin e njoftimeve të IPAP-
së, për të cilin bëhet shpallja e vendit të lirë për
nëndrejtor.

4. Shpallja e vendit të lirë të punës duhet të
përmblajë:

a) kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të
aplikuar për vendin e lirë për nëndrejtor të IPAP-
së;

b) dokumentacionin, mënyrën dhe afatin e
dorëzimit të tij;

c) datën e shpalljes së rezultateve të verifikimit
paraprak të dokumentacionit;

d) afatin e plotësimit të dokumentacionit pas
verifikimit paraprak të tij;

e) fushat e njohurive dhe aftësitë mbi të cilat do
të zhvillohet intervista e strukturuar;

f) datën e daljes së rezultateve të konkurrimit
dhe mënyrën e komunikimit të tyre.

**B. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati,
dokumentacioni i aplikimit, afati dhe mënyra e
dorëzimit të tij**

1. Kandidati për nëndrejtor i IPAP-së duhet të
plotësojë kushtet si vijon:

a) Të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në
fushën e arsimit ose diplomë të njëvlershme me të,
sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015, “Për
arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në
institucionet e arsimit të lartë në Republikën e
Shqipërisë”.



b) Përfundimisht, për shkollat e arsimit të orientuar, diploma të jetë në profilin e shkollës. Në rast se nuk ka kandidatë në këtë profil, konkurrimi vazhdon me kandidatë të tjerë.

c) Të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar” me vlerësim jo më pak se “Mirë”, në kualifikimin e fundit.

d) Të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij.

e) Të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar ose të jetë pranuar për të kryer atë.

2. Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e nëndrejtorit në IPAP përmban:

a) jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

b) kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së punës;

c) kopjen e dokumentit të identitetit (ID);

d) tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

e) certifikatën e drejtuesit të IPAP-së ose vërtetimin nga Shkolla e Drejtorëve, që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor;

f) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

g) vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

h) deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Drejtori aktual i IPAP-së ose zëvendësuesi i tij vë në dispozicion të secilit aplikant një kopje të dokumenteve të mëposhtme:

a) planin afatmesëm të shkollës;

b) planin vjetor të shkollës të vitit paraardhës;

c) raportin vjetor të shkollës të vitit paraardhës.

4. Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në

pikën 2, të shkronjës B, dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në IPAP. Dorëzimi i dokumentacionit kryhet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes së njoftimit të vendit të lirë për nëndrejtor të IPAP në faqen elektronike zyrtare të ZVAP-së.

C. Komisioni i shqyrtimit dhe i vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e nëndrejtorit në IPAP

1. Komisioni i shqyrtimit dhe i vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e nëndrejtorit në IPAP, në vijim Komisioni, ngrihet nga drejtori i IPAP-së.

2. Komisioni përbëhet nga:

a) kryetari i bordit të IPAP-së;

b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP-së;

c) dy mësues të IPAP-së të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;

d) një përfaqësues i ZVAP-së, i caktuar nga drejtori i ZVAP-së, pas njoftimit zyrtar të drejtorit të IPAP-së.

3. Këshilli i mësuesve të IPAP-së zgjedh si anëtarë të Komisionit 2 (dy) mësues, të përzgjedhur me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash.

4. Njëri prej 2 (dy) mësuesve, me përvojën më të gjatë në atë IPAP, drejton Komisionin.

5. Anëtarët e Komisionit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikantin, në kuptim të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit. Në mbledhjen e parë të Komisionit, anëtarët plotësojnë deklaratën e konfliktit të interesit, sipas shtojcës 3/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Drejtori i IPAP-së njofton zyrtarisht anëtarët e Komisionit për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së tij.

7. Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote.

8. Komisioni mbledhet në mjediset e IPAP-së, jo më vonë se tri ditë pune pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit për nëndrejtor të IPAP-së dhe kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij.

9. Anëtari i Komisionit që mungon ose që është në konflikt interesi me aplikantin, zëvendësohet. Zëvendësimi kryhet brenda 1 (një) dite pune nga



titullari i ZVAP-së, për anëtarin e zgjedhur prej tij; bordi i IPAP-së; këshilli i prindërve të IPAP-së ose këshilli i mësuesve, për anëtarët e zgjedhur prej tyre.

10. Komisioni kryen këto detyra:

a) bën shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur në dosjen e aplikimit, brenda 2 (dy) ditëve pune nga mbledhja e Komisionit, sipas shtojcave 1 dhe 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) njofton me shkrim/*e-mail* aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në 3 (tri) ditë pune nga njoftimi;

c) pas përfundimit të afatit, sipas shkronjës “b” të kësaj pike, liston aplikantët të cilët kanë dokumentacionin e plotë dhe të saktë dhe vlerëson me pikë aplikantët e pranuar, kandidatët për nëndrejtor të IPAP-së, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi, brenda 2 (dy) ditëve pune nga listimi i aplikantëve.

d) realizon intervistën e strukturuar me secilin kandidat për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit. Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10, brenda 1 (një) dite pune;

e) harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës;

f) brenda 3 (tri) ditëve pune, pas përfundimit të intervistave, shpall në këndin e njoftimeve të IPAP-së tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

11. Kandidatët kanë në drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda 3 (tri) ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit. Komisioni shqyrton ankesat brenda 1 (një) dite pune.

12. Kryetari i Komisionit i dorëzon drejtorit të IPAP-së dosjet e aplikimit dhe të vlerësimit me pikë për 2 (dy) kandidatët me më shumë pikë. Kopjet e këtyre dokumenteve dhe dosjet e aplikantëve të tjerë ruhen në arkivin e shkollës.

D. Procedura e emërimit të nëndrejtorit të IPAP-së nga drejtori i IPAP-së

1. Drejtori i IPAP-së, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike.

2. Drejtori i IPAP-së, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, mbledh këshillin e mësuesve dhe

kërkon pëlqimin e tij për emërimin e nëndrejtorit, duke parashtruar argumentet me shkrim për këtë qëllim. Mbledhja është e vlefshme, kur marrin pjesë të paktën 3/5 e anëtarëve të këshillit të mësuesve. Anëtarët e këshillit të mësuesve diskutojnë argumentet e drejtorit, duke dhënë pëlqimin ose mospëlqimin e tyre për emërimin e nëndrejtorit. Argumentet me shkrim dhe procesverbali i mbledhjes së këshillit të mësuesve i bashkëngjitet vendimit të drejtorit për emërimin e nëndrejtorit.

3. Procesverbali i mbledhjes së këshillit të mësuesve arkivohet në IPAP.

4. Brenda 3 (tri) ditëve pune nga mbledhja e këshillit të mësuesve për dhënien e pëlqimit të kandidatëve, drejtori i IPAP-së shpall vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e nëndrejtorit të IPAP-së.

5. Kandidati jofitues ka të drejtë të paraqesë ankesë në ZVAP brenda 3 (tri) ditëve pune nga shpallja e kandidatit fitues.

6. Drejtori i ZVAP-së shqyrton ankesën dhe jep përgjigjen brenda 3 (tri) ditëve pune, pas përfundimit të afatit për ankim.

7. Drejtori i IPAP-së bën emërimin e nëndrejtorit të IPAP-së. Vendimi i emërimit i komunikohet zyrtarisht nëndrejtorit të sapoemëruar.

8. Nëndrejtori i IPAP-së nuk duhet të bëjë pjesë, pas emërimit, në forumet drejtuese të partive politike.

E. Raste të veçanta

1. Në rastet kur nuk paraqiten aplikantë ose ka vetëm një aplikant, drejtori i IPAP-së rishpall vendin e lirë për nëndrejtor sipas procedurës së mësipërme.

2. Kur ka më shumë se dy kandidatë me numër të njëjtë pikësh, veçohen dy kandidatët për nëndrejtor, që kanë marrë më shumë pikë në intervistën e strukturuar përpara Komisionit.



KREU II

**MBARIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS,
ULJA NË DETYRË, PEZULLIMI DHE
SHKARKIMI I NËNDREJTORIT TË
INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR****A. Mbarimi i marrëdhënies së punës së
nëndrejtorit të IPAP-së**

Mbarimi i marrëdhënies së punës së nëndrejtorit të IPAP-së, bëhet kur:

a) jep dorëheqjen, për arsye personale ose kur nuk pranohet për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar apo nuk certifikohet deri në 2 testime të njëpasnjëshme pas përfundimit të tij;

b) mbush moshën e pensionit;

c) me vendim të komisionit mjekoligjor provohet paaftësia për kryerjen e detyrave;

d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;

e) merret masa disiplinore e largimit nga puna nga drejtori i IPAP-së.

**B. Raste të uljes në detyrë të nëndrejtorit të
IPAP-së**

Nëndrejtori i IPAP-së i nënshtrohet procedurës së vlerësimit vjetor të performancës, nga ana e drejtorit të IPAP-së. Në rast se pas vlerësimit vjetor nëndrejtori rezulton me performancë jo të kënaqshme, ndaj tij merret masa disiplinore e uljes në detyrë nga DRAP-ja dhe kalim në pozicionin e punës si mësues në profilin e tij, brenda të njëjtit institucion arsimor ose në institucionin arsimor më të afërt brenda së njëjtës ZVAP.

**C. Rastet e shkarkimit dhe të pezullimit të
nëndrejtorit të IPAP-së**

1. Drejtori i IPAP-së shkarkon nëndrejtorin e IPAP-së, kur:

a) ka një vendim të formës së prerë ndaj tij nga gjykata kompetente;

b) pas rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për inspektimin, sigurimin e cilësisë, vlerësimin, menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të arsimit parauniversitar, për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për parregullsi ose dobësi të theksuara në realizimin e detyrave të ngarkuara për menaxhimin e IPAP-së;

c) ka rast të përsëritur të shkeljeve, për të cilat është ende në fuqi masa e vendosur nga Komisioni i Disiplinës në IPAP “paralajmërim për largim nga puna”;

d) konstatohet se pas emërimit, nëndrejtori i IPAP-së bën pjesë në forumet drejtuese të partive politike. Në këtë rast, drejtori i IPAP-së merr vendimin përfundimtar për shkarkimin e nëndrejtorit të IPAP-së, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas konstatimit;

e) ka kryer veprimtari në kundërshtim me aktet nënligjore të nxjerra nga ministri përgjegjës për arsimin.

2. Për rastet e parashikuara në pikën 1/a, të shkronjës “C”, të këtij kreu, nëse kanë filluar hetime paraprake ndaj nëndrejtorit të IPAP-së, drejtori i IPAP-së merr vendimin e pezullimit të nëndrejtorit të IPAP-së, deri në shpalljen e vendimit të formës së prerë ndaj tij nga gjykata kompetente. Drejtori i IPAP-së i njofton vendimin ZVAP-së.

3. Vendimi i drejtorit të IPAP-së për pezullimin dhe/ose shkarkimin e nëndrejtorit të IPAP-së ruhet në arkivin e IPAP-së, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

4. Drejtori i IPAP-së fillon procedurën për shkarkim të nëndrejtorit të IPAP-së, duke respektuar Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative.

5. Nëndrejtori i IPAP-së ka të drejtë të dëgjohet nga drejtori i IPAP-së, para se të merret vendimi i shkarkimit të tij. Seanca dëgjimore e drejtorit të IPAP-së me nëndrejtorin e IPAP-së mbahet shënim nga një punonjës i ngarkuar me këtë detyrë nga drejtori i IPAP-së dhe arkivohet.

KREU III

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Kandidati fitues për nëndrejtor të IPAP-së, i cili nuk është certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve, emërohet përkohësisht nga drejtori i IPAP-së deri në certifikimin e tij, pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi.

2. Nëndrejtorët në detyrë të IPAP-së, për vijimin e detyrës, përveç kriterëve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, të shkronjës “B”, të kreut I të këtij udhëzimi, duhet të aplikojnë



dhe të pranohen nga Shkolla e Drejtorëve, për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor.

3. Nëndrejtori në detyrë i IPAP-së, pas certifikimit në përfundim të trajnimit të detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, rikonfirmohet në detyrë nga drejtori i IPAP-së.

4. Procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të IPAP-së janë objekt i inspektimit dhe i vlerësimit të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.

5. Udhëzimi nr. 58, datë 12.11.2013, “Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të nëndrejtorit në institucionin arsimor publik”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe e Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

SHTOJCA 1
JETËSHKRIMI

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

- a) emri, mbiemri;
- b) datëlindja;
- c) adresa;
- d) telefoni;
- e) *e-mail*.

II. ARSIMIMI

III. PUNËSIMI

IV. KUALIFIKIMI

V. CERTIFIKATA

VI. BOTIMET

- a) libra;
- b) shkrime;
- c) referime.

VII. PROJEKTE

VIII. PROVIMET KOMBËTARE

Dëshmoj se i kam kuptuar udhëzimet për plotësimin e shtojcës 1 dhe pasojat nga plotësimi i pasaktë i saj.

Nënshkrimi _____

Data

SHTOJCA 2
FORMULARI I VETËDEKLARIMIT TË GJENDJES GJYQËSORE**Të dhënat e vetëdeklaruesit:**

Emri Mbiemri	
Atësia/amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (numri)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: ☐ i/e padënuar. ☐ i/e dënuar

DEKLARUESI

Emër Mbiemër/firmë

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga IPAP-ja/ZVAP-ja



Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruësit autorizues

Vendi, data e nënshkrimit

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 8517, datë 22.7.1999, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale, sipas ligjit dhe sjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

SHTOJCA 3
DEKLARATË MBI KONFLIKTIN E INTERESIT
TË APLIKANTIT PËR POZICIONIN E NËNDREJTORIT TË IPAP

Deklaruesi: Z./znj. _____
(emër, mbiemër)

Pozicioni aktual i punës: _____

Vendi i punës: _____

Unë, nënshkruesi _____
(emër, atësia, mbiemër)

Kandidat për nëndrejtor i institucionit publik të arsimit parauniversitar _____,

sot, më datë _____._____._____, nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të institucionit publik të arsimit parauniversitar _____, të parashikuara nga ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Vendi _____

Datë _____._____._____

Nënshkruesi _____
(emër, mbiemër, firmë)



SHTOJCA 3/1
DEKLARATË MBI KONFLIKTIN E INTERESIT
TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT DHE TË
VLERËSIMIT TË DOKUMENTACIONIT TË APLIKANTËVE PËR
POZICIONIN E NËNDREJTORIT TË IPAP-së

Deklaruesi: Z./znj. _____
(emër, mbiemër)

Pozicioni në Komision: _____

Përfaqësues i: _____

Unë, nënshkruesi _____
(emër, atësia, mbiemër)

Kryetar/anëtar i Komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikantëve për pozicionin e nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar _____,

sot, më datë _____._____._____, nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit me aplikantët për pozicionin e nëndrejtorit të këtij institucioni publik të arsimit parauniversitar, të parashikuara nga ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Vendi _____

Datë _____._____._____

Nënshkruesi _____
(emër, mbiemër, firmë)

Shënim. Deklarata plotësohet nga deklaruesi me shkrim dore.

SHTOJCA 4
TABELA E TË DHËNAVE PËR APLIKANTIN

Emri dhe mbiemri _____

Aplikanti shënon brenda kllapave, krahas zërit përkatës:

- Numrin, kur kërkohet numri;
- “PO” ose “JO”, kur kërkohet përgjigje e tillë.

Nr.	Përshkrimi	Rezultati
I	ARSIMI	
1	Arsim shtesë në fushën e arsimit (Po/Jo)	
2	Doktoratë (Po/Jo)	
3	Kredite në fushën e arsimit në 3 vitet e fundit (numri i tyre)	



II	LIBRA	
1	Autor në tekstet shkollore (Po/Jo)	
2	Autor në tekstet për mësuesit (Po/Jo)	
3	Autor libri për drejtimin e shkollës (Po/Jo)	
4	Autor libri për çështje të tjera arsimore (Po/Jo)	
III	SHKRIME	
1	Shkrime për drejtimin e shkollës (Po/Jo)	
2	Shkrime për çështje të tjera arsimore (Po/Jo)	
IV	KUMTESA	
1	Kumtesa në takime ndërkombëtare për arsimin (Po/Jo)	
V	GJUHA E HUAJ E MBROJTUR	
1	Gjuha angleze (Po/Jo)	
2	Gjuhë e huaj tjetër e vendeve të BE-së (Po/Jo)	
VI	NOTAT	
1	Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (<i>nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II) ose nota mesatare në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose ekuivalente me to</i>).	
VII	PROVIMET KOMBËTARE (provime lirimi ose matura shtetërore)	
1	Administrator në provimet kombëtare (Po/Jo)	
2	Hartues i testeve në provimet kombëtare (Po/Jo)	
3	Vlerësues i përgjigjeve të nxënësve në provimet kombëtare (Po/Jo)	
VIII	VJETËRSI PUNE NË ARSIM/DREJTIM ARSIMI	
1	Drejtor shkolle (vitet)	
2	Nëndrejtor (vitet)	
3	Vjetërsi si mësues (vitet)	

Dëshmoj se i kam kuptuar udhëzimet për plotësimin e shtojcës 4 dhe pasojat nga plotësimi i pasaktë i saj.

Nënshkrimi

Data

SHTOJCA 5

TABELA E VLERËSIMIT PËR KANDIDATIN PËR NËNDREJTOR TË IPAP

1	Nota mesatare e studimeve të larta, Llogaritet si mesatare aritmetike e të gjitha notave, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (<i>mesatare e notave të ciklit I dhe notave të ciklit II) ose nota mesatare në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose ekuivalente me to</i>), pjesëtuar me numrin 2 (dy) e rrumbullakosur me një shifër pas presjes. P.sh.: Vlerësimi në pikë: nota mesatare 7.7 pjesëtim për 2 = 3.8 pikë.	0–5 pikë
2	Shkallët e kualifikimit: Mësues i kualifikuar (kategoria III) 0–1 pikë (0 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”; 0.5 pikë për vlerësimin “Mirë”; 1 pikë për vlerësimet “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm”) Mësues specialist (kategoria II) 1–2 pikë (1 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”; 1.5 pikë për vlerësimin “Mirë”; 2 pikë për vlerësimet “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm”)	0–3 pikë



	Mësues mjeshtër (kategoria I) 2–3 pikë (2 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”; 2.5 pikë për vlerësimin “Mirë”; 3 pikë për vlerësimet “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm”)	
3	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja: a) gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 2 pikë; b) gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar, niveli B1 = 2 pikë; c) gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar, niveli B2 = 4 pikë, Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t’i llogariten më shumë se 4 pikë në vlerësimin e dosjes. Kandidatit të profilit gjuhë e huaj i njihen pikët e kësaj rubrike për një gjuhë tjetër të huaj për të cilën është diplomuar.	0–4 pikë
4	Certifikata trajnimesh: Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin në tri vitet e fundit. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: a) deri në 3 kredite = 1 pikë b) mbi 3 kredite = 2 pikë	0–2 pikë
5	Vjetërsi pune në arsim: Vlerësohen deri në 25 vite pune. Vlerësimi i vjetërsisë në punë bëhet duke pjesëtuar numrin e viteve të punës me 5 (pesë), me një shifër pas presjes, me rrumbullakosje, deri në maksimumi 5 pikë: P.sh.: Vlerësimi në pikë: vjetërsia në punë 15.3 pjesëtim për 5 = 3.06 = 3 pikë ose 16.4 vite pjesëtim për 5 = 3.28 = 3.3 pikë etj. Kandidatët me më shumë se 25 vite punë vlerësohen me 5 pikë.	1–5 pikë
6	Vjetërsi pune në pozicion drejtues: Deri 5 vite drejtor/nëndrejtor = 2 pikë. Mbi 5 vite drejtor/nëndrejtor = 4 pikë.	0–4 pikë
7	Arsim shitesë në fushën e arsimit	0–2 pikë
8	Studime doktorate në fushën e arsimit	0–2 pikë
9	Provimet kombëtare – administrator/hartues testi/korrigjues teste kombëtare	0–1 pikë
10	Autor në tekstet shkollë për mësuesit/për drejtimin e shkollës	0–1 pikë
11	Shkrime për drejtimin e shkollës/kumtesa në takime ndërkombëtare për arsimin	0–1 pikë
12	Intervista e strukturuar	0–10 pikë
	SHUMA E PIKËVE	

Komisioni bën shpalljen rezultateve sipas tabelës së pikëve totale për të gjithë kandidatët, sipas shtojcës 6.

SHTOJCA 6
TABELA E REZULTATEVE

Nr.	Emri dhe mbiemri i kandidatit	Pikë totale
1.		
2.		
3.		



Komisioni

1. _____ kryetar;
(emër, mbiemër) (firma)
2. _____ anëtar;
3. _____ anëtar;
4. _____ anëtar;
5. _____ anëtar.

UDHËZUES 1 PËR PLOTËSIMIN E JETËSHKRIMIT

ARSIMIMI

Diploma/diplomat e shkollës së lartë;

Doktoratë.

KUALIFIKIMI

Kategoria e kualifikimit si mësues dhe vlerësimi i kualifikimit (nëse ka pasur vlerësim);

Nota mesatare;

Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose ekuivalente me to;

Certifikata për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar, lëshuar nga Shkolla e Drejtorëve;

Certifikata për aspekte të tjera arsimore.

Shënim. Certifikatat mund të jenë marrë brenda ose jashtë vendit.

Ndër certifikatat e marra brenda vendit, vendosen vetëm ato që dëshmojnë marrjen e krediteve në 3 vitet e fundit.

PUNËSIMI

Renditen njëra pas tjetrës të gjitha punësimet, duke filluar nga e tanishmja deri te punësimi i parë.

Për çdo punësim shkruhet:

- Viti i fillimit dhe i mbarimit të tij;
- Titulli i vendit të punës (mësues i matematikës në arsimin bazë, mësues i fillores, nëndrejtor, drejtor shkolle, inspektor etj.);
- Adresa e vendit të punës;
- Drejtor/nëndrejtor (shënoni numrin e viteve duke filluar nga zeroja).

BOTIMET

Përmenden vetëm botime të cilat kanë të bëjnë me arsimin duke filluar nga 1 janari 1992. Për çdo botim shkruhet emri e mbiemri i bashkautorëve (nëse ka), titulli i botimit, institucioni botues dhe viti i botimit.

Botimet ndahen në libra dhe shkrime.

LIBRA

Librat ndahen në:

- tekste shkollore;
- tekste për mësuesit;
- libra për drejtimin e shkollës;
- libra për çështje të tjera arsimore.

Secili prej katër llojeve të mësipërme të librave renditet me numrat 1, 2 ...

P.sh.:

Tekste shkollore

Nuk ka

Tekste për mësuesit

1. Me Agim Korabin; teksti i nxënësit “Fizika 7”, Shtëpia Botuese “Egla”, 1997.

Libra për drejtimin e shkollës

Nuk ka.

Libra për çështje të tjera arsimore

1. “Strategjitë e mësimdhënies dhe të të nxënësit”, shtëpia botuese “Egla”, 2004.

2. “Braktisja e shkollës në qarkun e Shkodrës, shtëpia botuese “7 Marsi”, 2010.

SHKRIME

Shkrimet ndahen, në:

- Për drejtimin e shkollës;
- Për çështje të tjera arsimore.

Secili prej dy llojeve të mësipërme renditet me numrat 1, 2 ...

P.sh.:

Drejtimi i shkollës

1. “Drejtori i shkollës – menaxheri i saj”, gazeta “Mësuesi”, 2007.

2. “Reforma e drejtimit të shkollës te ne dhe në vendet fqinje”, gazeta “Shekulli”, 2011.

Çështje të tjera arsimore

Nuk ka.

KUMTESA

Përfshihen kumtesa në konferenca, simpoziume etj., të mbajtura jashtë vendit.



Për çdo referim tregohet emri e mbiemri i bashkautorëve (nëse ka), titulli i kumtesës, emri i konferencës ose i simpoziumit, vendi dhe viti i mbajtjes.

Secila prej tyre renditet me numrat 1, 2 ...

P.sh.:

Kumtesa në takime ndërkombëtare për arsimin

1. “Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në veprimtari jashtëshkollore”, konferenca “Fëmijët me aftësi të kufizuara”, Bukuresht, botuar në revistën “Education for all”, 2003.

PROVIMET KOMBËTARE

Administrator në provimet kombëtare (matura ose lirim) (vitet);

Hartues i testeve në provimet kombëtare (matura ose lirim) (vitet);

Vlerësues i përgjigjeve të nxënësve në provimet kombëtare (matura ose lirim) (vitet);

VINI RE!

- Për kategorinë e kualifikimit si mësues, diploma (diplomat) e shkollës së lartë, licencën dhe notat e shkollës së lartë, certifikata me kredite, paraqiten kopje të tyre të njësuar me origjinalin.

- Për librat paraqiten kopja e ballinës.

- Për shkrimet paraqiten kopje të faqes së parë.

- Për kumtesat paraqiten kopje të faqes së parë.

- Për provimet kombëtare paraqiten dëshmi të firmosura nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe ZVAP përkatëse.

UDHËZUES 2

PËR VLERËSIMIN E

DOKUMENTACIONIT TË APLIKIMIT NGA

KOMISIONI I SHQYRTIMIT DHE I

VLERËSIMIT TË DOKUMENTACIONIT TË

APLIKIMIT

Pranimi ose mospranimi i një aplikimi:

Komisioni nuk pranon aplikimet në të cilat mungon njëra nga këto të dhëna, pas përfundimit të afatit të parashikuar në pikën 10/b, të shkronjës “C”, të kreut I.

- Kopje e njësuar me origjinalin e diplomës/diplomave, shoqëruar me listën e notave ose suplementin e diplomës/ve të shkollës së lartë.

- kopja e njësuar me origjinalin për kategorinë e kualifikimit si mësues;

- kopja e njësuar me origjinalin e certifikatave me kredite;

- vërtetimi që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

- vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore, sipas shtojcës 2;

- deklarata e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të institucionit;

Komisioni pranon aplikimet për çdo mungesë tjetër, por shënon me zero pikët për mungesat përkatëse. P.sh., për një botim, kumtesë etj., që nuk ka provat e kërkuara të “Shtojca 1”, shënohet numri 0 (zero).

Përlllogaritja e pikëve të intervistës së strukturuar

- Në fillim të intervistës së strukturuar, anëtarët e Komisionit hartojnë një listë prej 5 pyetjesh, të cilat vlerësohen me nga 2 pikë secila, gjithsej 10 pikë.

- Pyetjet e hartuara nga Komisioni janë të njëjta për të gjithë kandidatët që realizojnë intervistën e strukturuar.

- Secili anëtar i Komisionit bën vlerësim individual me 0–2 pikë për përgjigjen e dhënë nga kandidati për secilën pyetje.

- Mblidhen pikët e secilit anëtar. Shuma pjesëtohet me numrin e anëtarëve të Komisionit dhe rezultati rrumbullakoset deri në një numër pas presjes dhjetore.

P.sh.:

Pikët e pesë anëtarëve për intervistën e një kandidati janë: 6, 4, 8, 9, 7.

Shuma është 34.

$34 : 5 = 6,8$ pikë

Ky numër vendoset te zëri “intervista” te tabela e mëposhtme.

Pikët e një kandidati

Për të plotësuar pikët e një kandidati, Komisioni bazohet te shtojca 4, duke verifikuar vërtetësinë e dokumentacionit të dorëzuar, duke plotësuar shtojcën 5.



VENDIM
Nr. 478, datë 9.12.2021

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV
ADMINISTRATIV “RREGULLORE PËR
PROCEDURAT E ZGJIDHJES
ALTERNATIVE TË MOSMARRËVESHJES
MIDIS KONSUMATORIT DHE
OPERATORIT UJËSJELLËS-
KANALIZIME, NGA STRUKTURA E
ZGJIDHJES ALTERNATIVE TË
MOSMARRËVESHJES”**

Në mbështetje të nenit 13, pika 1(i), të nenit 14, nenit 28, nenit 29, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102);

nenit 52/2, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 44/2015);

VKM-së nr. 1089, datë 24.12.2020, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, si dhe për përcaktimin e kriterëve shtesë, që duhet të përmbushin strukturat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve” (VKM nr. 1089);

nenit 9 e vijues të rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura (rregullore e brendshme),

**KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,**

në mbledhjen e datës 9.12.2021, pasi u njoh me materialin shkresor, lidhur me çështjen në shqyrtim për vendimarrje në mbledhjen e KKRR-së;

aktin normativ administrativ “Rregullore për procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes midis konsumatorit dhe operatorit UK, nga struktura zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes (akti normativ);

relacion mbi aktin normativ administrativ “Rregullore për procedurat e zgjidhjes alternative të

mosmarrëveshjes midis konsumatorit dhe operatorit UK, nga struktura zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes” (relacioni);

aktin administrativ vendimmarrës për miratimin e aktit normativ (vendimi), si dhe pasi diskutoi mbi këto materiale dhe bëri një vlerësim ligjor,

VËREN SE:

1. Nxjerrja e aktit bazohet në kompetencën e ERRU-së të përcaktuar në nenin 14, germa “i” dhe “j”, nenin 26 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar.

2. Nxjerrja e aktit bazohet në kompetencën e ERRU-së të përcaktuar në nenin 52/2, germa “c”, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, të ndryshuar, sipas të cilit ERRU-ja do të kryejë funksionet e ZAM-së me konsumatorin për veprimtaritë në fushën e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

3. Nxjerrja e aktit bazohet në kompetencën e ERRU-së të përcaktuar në VKM-në nr. 1089, datë 24.12.2020, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, si dhe për përcaktimin e kriterëve shtesë që duhet të përmbushin strukturat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve”.

4. Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e një kuadri rregullator për trajtimin dhe zgjidhjen alternative të një mosmarrëveshjeje, në lidhje me detyrimet kontraktuale midis një operatori UK dhe një konsumatori përmes ndërmjetësimit me anë të një strukture përgjegjëse të ngritur pranë Entit Rregullator të Ujit.

5. Objektivi kryesor i aktit është informimi i cilësdo pale të interesuar, që në mënyrë transparente, të njohë dhe të zbatojë procedurën që do të zbatohet nga organi administrativ kompetent, për ushtrimin e së drejtës për trajtimin dhe zgjidhjen alternative të një mosmarrëveshjeje.

6. Në nenin 29, të ligjit 8102, pika 1(b), përcaktohet që rregullat procedurale që nxjerr ERRU-ja për kryerjen e funksioneve që jep ky ligj, të përmbajnë mundësinë për koment publik. Ky përcaktim gjeti zbatim nëpërmjet publikimit të aktit administrativ për këshillim publik në faqen zyrtare



të ERRU-së: www.erru.al, nga data 5.11.2021 deri më datë 3.12.2021.

Për sa më sipër, duke qenë në kushtet e plotësimit të kërkesave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8102, për nxjerrjen e aktit, si dhe të përputhshmërisë të përmbajtjes së tij me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 44/2015 dhe VKM-në nr. 1089, datë 24.12.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e aktit normativ administrativ “Rregullore për procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes midis konsumatorit dhe operatorit ujësjellës-kanalizime, nga struktura zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes”, sipas dokumentit bashkëlidhur.

2. Ngarkohet Struktura e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjes për njoftimin e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve për miratimin e kësaj rregullore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndiçim Shani

RREGULLORE
PËR PROCEDURAT E ZGJIDHJES
ALTERNATIVE TË MOSMARRËVESHJES
MIDIS KONSUMATORIT DHE
OPERATORIT UJËSJELLËS-KANALIZIME
NGA STRUKTURA ZGJIDHJES
ALTERNATIVE TË MOSMARRËVESHJES
(Miratuar me vendimin e KKRR-së nr. 478,
datë 9.12.2021)

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e një kuadri rregullator për trajtimin dhe zgjidhjen alternative të një mosmarrëveshjeje, në lidhje me detyrimet kontraktuale midis një operatori UK dhe një konsumatori përmes ndërmjetësimit me anë të një strukture përgjegjëse të ngritur pranë Entit Rregullator të Ujit.

Neni 2
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës dhe i mekanizmave për funksionimin e strukturës përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar.

Neni 3
Baza ligjore

- Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar.

- Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar.

- Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

- VKM-ja nr. 1089, datë 24.12.2020, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve, si dhe për përcaktimin e kriterëve shtesë që duhet të përmbushin strukturat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve”.

Neni 4
Përkufizime

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtat kuptime me ato të përcaktuara në nenin 3, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar.

Neni 5
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore është e zbatueshme nga të gjitha subjektet e licencuara nga Enti Rregullator i Ujit, sipas ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe akteve normative të miratuara nga Komisioni Kombëtar Rregullator për ushtrimin e veprimtarisë së grumbullimit, shpërndarjes, trajtimit

të ujit, si dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, për përfitim publik.

KREU II PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 6

Parimi i ligjshmërisë

1. Struktura përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tij dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveçse kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.

Neni 7

Parimi i transparencës

Struktura ZAM (SZAM) duhet të jetë transparente dhe e qartë me konsumatorët, duke publikuar gjithë informacionin e nevojshëm mbi procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes përpara se të përfshihen në këtë procedurë, si dhe duke krijuar një mjet komunikimi të qëndrueshëm me konsumatorin për të lehtësuar paraqitjen e ankesës apo shkëmbimin e informacioneve mes palëve.

Neni 8

Parimi i mbrojtjes së të dhënave

Pjesëmarrësit në një proces zgjidhjeje alternative të mosmarrëveshjes kanë të drejtë të kërkojnë që të dhënat e tyre personale të trajtohen dhe të mbrohen në përputhje, sipas legjislacionit në fuqi, për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndërmarrë masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin.

Neni 9

Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë

Në ushtrimin e funksioneve të tyre, anëtarët e strukturës përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve i zgjidhin ato në mënyrë të drejtë, praktike dhe proporcionale.

Neni 10

Parimi i kontrollit

Veprimtaria administrative e strukturës përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve i nënshtrohet:

a) kontrollit formal dhe mbikëqyrës nga Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar;

b) kontrollit të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Verifikimi i kompetencës

Me fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e ankimit, SZAM-ja verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.

Në rast mungese të kompetencës, SZAM-së i duhet t’u propozojë palëve të paraqesin mosmarrëveshjen të një strukturë tjetër të ZAM-së, institucion tjetër kompetent ose nga një gjykatë.

Neni 12

Pengesat ligjore

Anëtari i SZAM-së nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrëse për shqyrtimin e një ankimi, për rastet e konfliktit të interesit të përcaktuara në nenin 30, të ligjit nr. 44/2015.

Vetëdeklarimi i pengesave ligjore dhe kërkesa për përjashtim zbatohet në përputhje me nenin 31 të Kodit të Procedurës Administrative.



Neni 13

Efektet e përjashtimit

Nëse struktura përjashton një anëtar, për shkak të pengesës ligjore, procedura administrative për shqyrtimin e ankimit vazhdon duke zëvendësuar anëtarin me një person tjetër, të cilit i ngarkohet kryerja e procedurës së ZAM-së për atë mosmarrëveshje.

KREU III

**PROCEDURA E ZGJIDHJES
ALTERNATIVE TË MOSMARRËVESHJEVE
NGA STRUKTURA E ZAM-së**

Neni 14

Struktura për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve

1. Struktura për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (SZAM) është një strukturë e përhershme me 3 anëtarë, të cilët janë pjesë e organikës së ERRU-së, përgjegjës për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje përmes një procedure të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorëve dhe operatorëve UK.

2. Anëtarët e kësaj strukture:

a) duhet të kenë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjes së konsumatorit në fushën përkatëse të kompetencës, si edhe njohuri të përgjithshme të së drejtës, të cilat mund të dëshmojnë nga fusha e studimit, nga eksperiencia e punës apo prova të tjera faktike;

b) caktohen në ushtrimin e këtij funksioni për një afat kohor prej të paktën 4 vjetësh dhe të mos shkarkohen nga ky funksion pa pasur shkaqe të arsyeshme, sipas legjislacionit përkatës në fuqi;

c) nuk marrin apo përdorin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre asnjë udhëzim nga ndonjëra nga palët ose nga përfaqësuesit e tyre dhe në rastet kur një gjë e tillë vërtetohet nga njëra prej palëve, të sigurohet zëvendësimi i personit përgjegjës;

d) të shpërblehen në mënyrë që nuk ndikohet nga rezultatet e procedurës së trajtimit të mosmarrëveshjeve;

e) t'i bëjnë të njohur strukturës së ZAM-së çdo rrethanë, e cila mund të ndikojë ose mund të shihet se ndikon në pavarësinë dhe paanësinë e tyre, ose që mund të shkaktojë një konflikt interesi me

ndonjërin nga palët në mosmarrëveshjen që u është kërkuar të zgjidhin pa vonesa të panevojshme. Detyrimi për të bërë të njohura rrethanat të tilla është një detyrim i vazhdueshëm gjatë gjithë procedurës së ZAM-së, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 15

**Të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë
trajtimit të mosmarrëveshjeve
nga struktura ZAM**

Gjatë procesit të shqyrtimit të mosmarrëveshjes ndërmjet konsumatorit dhe operatorit UK, palët gëzojnë këto të drejta dhe detyrime:

a) palët mund të paraqiten në proces pa qenë të detyruara të përfaqësohen nga një avokat ose një këshilltar ligjor, por procedura nuk mund t'i privojë palët nga e drejta e tyre për t'u përfaqësuar ose për t'u ndihmuar nga një pale e tretë në çdo fazë të procesit;

b) procedura e ZAM-së është pa pagesë për konsumatorin;

c) marrëveshja ndërmjet konsumatorit dhe operatorit UK për të paraqitur ankesa përpara strukturës ZAM nuk është detyruese për konsumatorin, nëse është bërë përpara se mosmarrëveshja të jetë materializuar dhe nëse ka si pasojë privimin e konsumatorit nga e drejta për të bërë një padi në gjykatë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes;

d) operatori UK informon konsumatorët për strukturën ZAM, përgjegjëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, sipas fushës së veprimtarisë që ai kryen, në një mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe lehtësisht të përdorshme, në faqen e tij të internetit.

Neni 16

Forma dhe përmbajtja e ankesës

1. Ankimi paraqitet pranë SZAM-së nga konsumatori:

i. nëpërmjet formularit që gjendet *online* në faqen e internetit të ERRU-së;

ii. me postë; ose

iii. në mënyrë të drejtpërdrejtë.

2. Ankesa regjistrohet në ERRU, sipas rendit kronologjik të paraqitjes në regjistrin e protokollit



dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- i. identitetin dhe adresën e ankimuesit;
- ii. objektin e mosmarrëveshjes dhe parashtrimin e pretendimeve dhe të kundërshtimeve nga trajtimi që ka bërë;
- iii. çdo dokument që lidhet me mosmarrëveshjen dhe ndihmon në zgjidhjen e saj.

Neni 17

Refuzimi i trajtimit të mosmarrëveshjes nga struktura ZAM

1. Struktura ZAM mund ta refuzojë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje midis konsumatorit dhe operatorit UK, në rastet kur:

- a) konsumatori nuk është përpjekur të kontaktojë drejtpërdrejt dhe të kërkojë nga operatori UK për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me anë të një zgjidhjeje miqësore (në mënyrë të dokumentuar);
- b) mosmarrëveshja është e parëndësishme ose abuzuese;
- c) mosmarrëveshja është duke u shqyrtuar ose është shqyrtuar më parë nga një strukturë tjetër, nga një ndërmjetës i licencuar ose nga gjykata;
- d) konsumatori nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë në strukturën ZAM, brenda 1 viti kalendarik, nga data në të cilin konsumatori ka paraqitur ankesën e tij tek operatori UK;
- e) trajtimi i mosmarrëveshjes do të dëmtonte seriozisht funksionimin efikas të strukturës së ZAM-së.

2. Kur struktura ZAM nuk është në gjendje të shqyrtojë një mosmarrëveshje që është kërkuar, i jep të dyja palëve një shpjegim të arsyetuar të shkaqeve për mosshqyrtimin e mosmarrëveshjes, brenda 21 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

Neni 18

Përcaktimi dhe shtyrja e afateve procedurale

1. Rezultati i procedurës së ZAM-së u njoftohet palëve brenda një periudhe prej 90 ditësh kalendarike, nga data në të cilën struktura ZAM ka marrë të gjithë dosjen e ankesës.

Kur e gjykon të nevojshme, struktura ZAM mund ta zgjasë afatin prej 90 ditësh kalendarike.

2. Palët duhet të informohen për çdo zgjatje të asaj periudhe dhe për kohëzgjatjen që mendohet se do të nevojitet për përfundimin e mosmarrëveshjes, por ky afat nuk mund të kalojë 60 ditë kalendarike, përtej afatit 90-ditor.

3. Palët njoftohen për rezultatin e procesit të ZAM-së me shkrim ose me anë të një mjeti të qëndrueshëm komunikimi dhe atyre u jepet një vendim i arsyetuar me shkaqet në të cilat është bazuar rezultati.

Neni 19

Fillimi i procedurës administrative

1. Struktura ZAM shqyrton paraprakisht ankimin lidhur me plotësimin e kriterëve formale ligjore, si: kompetenca, legjitimiteti, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar dhe njofton palën kërkuuese, nëse janë të nevojshme plotësime të tjera, duke caktuar një afat të arsyeshëm për plotësimin e tyre.

2. SZAM-ja fillon procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, në datën kur ka marrë ankesën të plotësuar dhe njofton palët për fillimin e kësaj procedure.

Neni 20

Shqyrtimi i mosmarrëveshjes

1. Pas njoftimit me shkrim nga struktura mbi pranimin e trajtimit të mosmarrëveshjes dhe fillimit të procesit, palët kanë të drejtë të shprehin me shkrim mendimin e tyre, si dhe marrin nga struktura ZAM argumentet, dëshmitë, dokumentet dhe faktet e paraqitura nga pala tjetër, brenda një periudhe prej 15 ditësh kalendarike pas marrjes së njoftimit.

2. SZAM-ja shqyrton mosmarrëveshjen, evidenton shkeljet e pretenduara nga konsumatori mbi respektimin e marrëdhënies kontraktuale dhe, në përfundim, fton të dyja palët, konsumatorin dhe përfaqësuesin e autorizuar nga shoqëria UK, në një seancë dëgjimore.

3. Në përfundim të seancës dëgjimore, SZAM-ja u propozon palëve dy mënyra për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, të cilat janë propozimi i një zgjidhjeje dhe detyrimi i një zgjidhjeje.



Neni 21

Propozimi i një zgjidhjeje

1. Në rastin kur procedura ZAM parashikon për propozimin e një zgjidhjeje, atëherë struktura ZAM njofton palët, se:

a) kanë të drejtë për t'u tërhequr nga procedura në çdo fazë, nëse janë të pakënaqur me ecurinë ose funksionimin e procedurës. Ato informohen për këtë të drejtë përpara se të nisë procedura. Kur rregullat e posaçme parashikojnë pjesëmarrjen e detyrueshme të operatorin UK në procedurat e ZAM-së, kjo pikë do të zbatohet vetëm për konsumatorin;

b) palët, përpara se të bien dakord ose të ndjekin një zgjidhje të propozuar, informohen, se:

i. mund të zgjedhin të pranojnë ose jo zgjidhjen e propozuar;

ii. pjesëmarrja në procedurë nuk përjashton mundësinë për të kërkuar zgjidhje përmes proceseve gjyqësore;

iii. zgjidhja e propozuar mund të jetë e ndryshme nga ajo që mund të vijë, si rezultat i një vendimi gjykate.

2. Palët, përpara se të bien dakord për një zgjidhje të propozuar ose pasi të kenë ndjekur një zgjidhje të tillë, informohen për pasojat juridike të pranimit ose të ndjekjes së një zgjidhjeje të tillë të propozuar.

3. Palëve u lihet një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike për të vendosur, përpara se të shprehin pëlqimin e tyre nëpërmjet një deklarate të nënshkruar nga ana e tyre për një zgjidhje të propozuar ose një marrëveshje miqësore.

4. Në rast se procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve parashikojnë që rezultati i tyre është detyrues për operatorin UK, pasi konsumatori e ka pranuar zgjidhjen e propozuar, përcaktimet e pikës së mësipërme janë të zbatueshme vetëm për konsumatorin.

Neni 22

Detyrimi i një zgjidhjeje

1. Palët, përpara se të bien dakord për këtë mënyrë të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, njoftohen, se:

a) zgjidhja është e detyrueshme;

b) asnjëra prej palëve nuk mund të tërhiqet nga procedura;

c) pjesëmarrja në procedurë nuk pengon mundësinë për të kërkuar mbrojtje në gjykatë;

d) kjo zgjidhje mund të jetë e ndryshme nga ajo që mund të japë gjykata, duke zbatuar normat juridike;

e) për pasojat juridike të kësaj zgjidhjeje.

2. Strukturat ZAM duhet të sigurohen se palët kanë shfaqur në mënyrë të vërtetë e serioze pëlqimin lidhur me natyrën detyruese të zgjidhjes dhe kanë nënshkruar një deklaratë.

Neni 23

Përfundimi i procedurës ZAM

1. Palët janë të detyruara të lidhin marrëveshje, kur pranojnë zgjidhjen e propozuar, ndërsa kur palët nuk e pranojnë zgjidhjen e propozuar, struktura ZAM lëshon një raport, i cili përmban identitetin e palëve, një përshkrim të fakteve, zgjidhjen e propozuar dhe vendimin e palëve. Struktura ZAM njofton konsumatorin, sipas këtij raporti, dhe për procedurat rishikuese ose ankuese administrative dhe gjyqësore, që ai mund të ndërmarrë për të zgjidhur mosmarrëveshjen.

2. Në rastin e zgjidhjes së detyrueshme, struktura ZAM lëshon një vendim të arsyetuar. Vendimi u njoftohet palëve me shkrim, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas shpalljes dhe sjell pasojat për palët nga data e njoftimit. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

3. Në përfundim të çdo procedure, SZAM-ja i raporton Komisionit Kombëtar Rregullator.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDME

Neni 24

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi datën e miratimit të saj nga Komisioni.

**VENDIM****Nr. 536, datë 30.12.2021****PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDRYSHIM TË TARIFAVE TË
SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME
KONISPOL**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

**KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,**

Në mbledhjen e datës 30.12.2021, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizimeve Konispol sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

KONSTATOI SE:

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Konispol është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 39, datë 1.6.2018, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol”, për shkak të rinovimit të licencës pas përfundimit afatit.

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Konispol ka aplikuar pranë ERRU-së për nivel të ri tarifor, për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, me shkresën nr. 123 prot., datë 14.12.2021, me lëndë

“Lista e dokumentacionit të nevojshëm për unifikimin e tarifave të ujit për UK Konispol”.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Konispol është plotësuar sipas Metodologjisë së Vendosies së Tarifave.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Konispol është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol dhe Bashkinë Konispol për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ndriçim Shani**

VENDIM**Nr. 537, datë 30.12.2021****PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDRYSHIM TË TARIFAVE TË
SHOQËRISË UJËSJELLËS-
KANALIZIME KUKËS**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41); vendimit të



Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

**KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,**

në mbledhjen e datës 30.12.2021, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizimeve Kukës sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

KONSTATOI SE:

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kukës është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 122, datë 20.10.2020, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kukës”, për shkak të rinovimit të licencës pas përfundimit afatit.

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kukës ka aplikuar pranë ERRU-së me shkresën nr. 491 prot., datë 19.10.2021, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura”.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Kukës është plotësuar sipas Metodologjisë së Vendosjes së Tarifave.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Kukës është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 40 dhe në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kukës për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Kukës dhe Bashkinë Kukës për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ndriçim Shani**

**VENDIM
Nr. 538, datë 30.12.2021**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDRYSHIM TË TARIFAVE TË
SHOQËRISË UJËSJIJELLËS-KANALIZIME
BULQIZË**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

**KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,**

Në mbledhjen e datës 30.12.2021, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizimeve Bulqizë sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

KONSTATOI SE:

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime ka aplikuar për nivel të ri tarifor pranë ERRU-së, me shkresën nr. 387 prot., datë 1.9.2021, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, plotësuar dokumentacionin e nevojshëm nëpërmjet shkresës nr. 579 prot., datë 16.12.2021.

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Bulqizë është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 91, datë 28.7.2020, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-



Kanalizime Bulqizë sh.a.”, për shkak të rinovimit të licencës pas përfundimit afatit.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Bulqizë është plotësuar sipas Metodologjisë së Vendorsjes së Tarifave.

Sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Bulqizë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 40 dhe në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Bulqizë, për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Bulqizë dhe Bashkinë Bulqizë për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë, 2022

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë

të një procedure automatike nga një sistem elektronik

(Qendra e Botimeve Zyrtare)

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 592 lekë